$140 \leq h < 160$	10

- a) Cila është klasa modale? **1 pikë**  
 b) Cila klasë përmban mesoren? **1 pikë**  
 c) Gjeni dendurinë e grumbulluar për gjatësinë e luleve të diellit deri në 100 cm. **1 pikë**  
 d) Ndërtoni histogramën që paraqet të dhënat e mësipërme ku, në boshtin vertikal vendosni dendurinë. **1 pikë**

33. Megi duhet të kalojë dy semaforë për të shkuar në punë. Probabiliteti që semafori të jetë i kuq kur ajo të arrijë përballë tij, është 0,15 për të parin dhe 0,35 për të dytin.

- a) Ndërtoni një diagram pemë për të paraqitur të gjitha rezultatet e mundshme. **2 pikë**  
 b) Llogaritni probabilitetin që asaj të mos i duhet fare të ndalojë. **1 pikë**  
 c) Llogaritni probabilitetin që asaj t'i duhet të ndalojë të paktën një herë. **1 pikë**



**Matematikë (Gjimnaz) – Sesionii II**

1. Jepet bashkësia  $A = \{x \in N / 2 < x < 18\}$ . Sa elemente  $x \in A$  janë të tillë që  $2^x \in A$ . **1 pikë**
- A) 1  
B) 2  
C) 3  
D) 4
2. Nëse 7% e numrit  $x$  është 63, vlera e  $x$ -it është: **1 pikë**
- A) 9000  
B) 1000  
C) 900  
D) 100
3. Jepen numrat  $\frac{3}{7}; \frac{1}{2}; \frac{\sqrt{3}}{3}; \log_4 2$ . Cili është numri më i madh? **1 pikë**
- A) i pari  
B) i dyti  
C) i treti  
D) i katërti
4. Numri i sekondave në 3 ditë është: **1 pikë**
- A) 5  
B) 182,5  
C) 475  
D) 259 200
5. Një klasë ka 35 nxënës. 5 nxënës luajnë basketboll dhe volejbol. 15 nxënës luajnë vetëm basketboll. Sa nxënës luajnë vetëm volejbol nëse dimë se çdo nxënës luan të paktën një lojë? **2 pikë**
6. Numri  $\frac{27}{50}$  i shprehur në përqindje është: **1 pikë**
- A) 2,7%  
B) 27%  
C) 54%  
D) 81%

7. Nga barazimi  $\log x = 2 \log 3 - 3 \log 5$  rrjedh që  $x$  është: **1 pikë**

A)  $\frac{9}{125}$

B)  $\frac{3}{5}$

C) 1

D)  $\frac{9}{5}$

8. Një makineri prodhon 16 detale për 1 orë. Sa detale prodhon ajo për 2 orë e 30 minuta? **1 pikë**

A) 32

B) 40

C) 48

D) 60

9. Të zgjidhet ekuacioni  $1 + \sin x = 2 \cos^2 x$  në  $[0; 360^\circ[$ . **3 pikë**


10. Katërkëndëshi ABCD është paralelogram. Vlera e  $x+y$  është: **1 pikë**

A) 3

B) 9

C) 12

D) 15



11.

a) Pikat  $A(2; 3)$  dhe  $B(4; 5)$  janë simetrike të njëra tjetrës sipas një drejtëze (d). Gjeni ekuacioni e drejtëzës (d). **3 pikë**

b) Një helikopter ngrihet nga pista për fluturim me kënd  $60^\circ$ . Sa është largësia e tij nga pika e nisjes në çastin që ai ndodhet në lartësinë 150 metra mbi tokë? **2 pikë**

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

12. Jepet vektori  $\vec{a} = \begin{pmatrix} 3 \\ -1 \end{pmatrix}$ . Cili nga vektorët e dhënë është paralel me të? **1 pikë**

A)  $\vec{u} = \begin{pmatrix} 4 \\ -3 \end{pmatrix}$

B)  $\vec{p} = \begin{pmatrix} 6 \\ 2 \end{pmatrix}$

C)  $\vec{v} = \begin{pmatrix} 9 \\ -3 \end{pmatrix}$

D)  $\vec{r} = \begin{pmatrix} -6 \\ -2 \end{pmatrix}$

13. Gjeni perimetrin e një trekëndëshi barabrinjës me brinjë  $2x + 5$ ,  $3x + 2$  dhe  $4x - 1$ . Brinjët e trekëndëshit janë në centimetra. **1 pikë**


14. Këndi  $x$  në fig është: **1 pikë**

A)  $20^\circ$

B)  $40^\circ$

C)  $60^\circ$

D)  $80^\circ$



15. Vëllimi i kubit është  $8\text{cm}^3$ , syprina e përgjithshme e tij është: **1 pikë**

A)  $4\text{ cm}^2$

B)  $16\text{ cm}^2$

C)  $24\text{ cm}^2$

D)  $48\text{ cm}^2$

16. Të gjendet syprina e trekëndëshit dybrinjënjëshëm me brinjë anësore  $10\text{ cm}$ , dhe këndin në kulm  $30^\circ$ . **2 pikë**

17. Numri i kulmeve të piramidës me bazë trekëndore është: **1 pikë**

A) 3

B) 4

C) 6

D) 8

18. ABC dhe DEF janë dy trekëndësha të ngjashëm. Trekëndëshi ABC ka perimetrin 60 mm dhe syprinën 90 mm<sup>2</sup>. Perimetri i trekëndëshit DEF është 120 mm. Syprina e trekëndëshit DEF është: **1 pikë**

- A) 180 mm<sup>2</sup>
- B) 360 mm<sup>2</sup>
- C) 720 mm<sup>2</sup>
- D) 900 mm<sup>2</sup>

19. Simetrikja e pikës A (2, -3) në lidhje me origjinën është pika B.

- a) Gjeni koordinatat e pikës B. **1 pikë**
- b) Gjeni largesën midis A dhe B. **1 pikë**

20. Në qoftë se  $f(x) = \frac{2x-1}{2x}$ , vlera e  $f(2)$  është: **1 pikë**

- A) 0
- B)  $\frac{3}{4}$
- C) 1
- D)  $\frac{4}{3}$

21. Nëse  $f(x) = 3 + x$ ;  $g(x) = 2x$  atëherë  $f(g(x))$  është: **1 pikë**

- A)  $3 + 2x$
- B)  $3x + 2$
- C)  $3 + x$
- D)  $4 + 3x$

22.a) Të thjeshtohet shprehja:  $(\frac{x+1}{x^2-1} - \frac{x+1}{x^2-x}) \cdot (x-x^2)$ . **2 pikë**

b) Jepet  $Q(x) = \frac{x+m}{x+n}$ ;  $Q(2) = 4$  dhe  $Q(-1) = 7$ . Gjeni m dhe n. **3 pikë**

23. Në çiftin e numrave që shërben si zgjidhje e sistemit  $\begin{cases} x+2y=1 \\ 2x-y=7 \end{cases}$ , vlera e y është: **1 pikë**

- A) 1
- B) -1
- C) -2
- D) -5

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

24. Shprehja  $\sqrt{x^2}$  është identike me: **1 pikë**
- A)  $x$   
B)  $-x$   
C)  $|x|$   
D)  $-|x|$
25. Thellësia e ujit të detit  $h$  (m), në pikën P, ndryshon në varësi të cikleve të baticë-zbaticave dhe jepet nga formula  $h = 3 + 2\sin(30^\circ t)$  ku  $t$  është koha në orë pas mesnatës.
- a) Cila është thellësia më e madhe dhe më e vogël e ujit në pikën P? **2 pikë**  
b) Sa është perioda e luhatjes së baticë-zbaticave? **1 pikë**
26. Vlera e  $\int_{-1}^1 2x dx$  është: **1 pikë**
- A) 2  
B) 1  
C) 0  
D) -1
- 27.a) Zgjidhni ekuacionin  $(x^3 - 8)(x^2 + 5x + 6) = 0$ . **2 pikë**
- b) Për cilat vlera të  $x$  shprehja  $2x - 3$  është më e madhe se  $-1$  dhe më e vogël se 3. **2 pikë**
28. Një shkollë ka 4 mësues, 36 nxënëse vajza, 45 nxënës djem.  
Raporti djem-vajza për nxënësit është: **1 pikë**
- A)  $\frac{5}{9}$   
B)  $\frac{4}{5}$   
C)  $\frac{5}{4}$   
D)  $\frac{8}{5}$

29. Një vijë kubike me ekuacion  $y = \frac{1}{3}x^3 - 2x^2 - 5x + 2$  ka tangjente në pikën me abshisë  $x = 0$ .

- a) Gjeni ekuacionin e kësaj tangjenteje. **2 pikë**  
 b) Gjeni ekstremumet e kësaj vije . **2 pikë**

30. Një ndryshore rasti  $X$  ka funksionin e shpërndarjes së probabiliteteve:  $p(X = x) = kx^2$  ku  $x = 1, 2, 3$ . Vlera e  $k$  është: **1 pikë**

- A)  $-\frac{1}{14}$   
 B)  $\frac{1}{14}$   
 C)  $\frac{1}{7}$   
 D) 1

31.

- a) Ndërtoni në të njëjtin rrjet koordinativ grafikët e funksioneve  $y = x + 2$ ;  $y = x^2$ . **1 pikë**  
 b) Gjeni syprinën e figurës së kufizuar nga grafikët e këtyre funksioneve. **2 pikë**

32. 15 nxënës u testuan në lëndën e matematikës dhe u vlerësuan me pikë si më poshtë.

16	16	17	19	22	24	25	27	30	32	34	34	35	35	65
----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

- a) Gjeni mesoren e pikëve të fituara nga nxënësit. **1 pikë**  
 b) Gjeni mesataren aritmetike të vlerësimit me pikë për lëndën e matematikës. **1 pikë**

c) Sa përqind e nxënësve kanë vlerësimin më të madh se mesatarja aritmetike? **1 pikë**

33. 200 persona u intervistuan për llojin e mishit që pëlqejnë: 110 prej tyre pëlqejnë peshk, 135 pëlqejnë pulë dhe 15 prej tyre nuk pëlqejnë as peshk dhe as pulë.

- a) Sa persona pëlqejnë peshk ose pulë? **1 pikë**  
 b) Sa persona pëlqejnë peshk dhe pulë? **1 pikë**  
 c) Gjeni probabilitetin që një person i zgjedhur rastësisht nga të intervistuarit pëlqen vetëm peshk? **1 pikë**

**SEKSIONI 3**  
**LËNDË ME ZGJEDHJE**  
**TESTE**

## BIOLOGJI

Biologjia është shkencë e jetës, prandaj informacioni që mbart kjo kurrikul ka të bëjë me zhvillimin e kompetencave shkencore të cilat e ndihmojnë nxënësin të jetë i aftë për jetën.

Duke iu referuar programit, pyetjet e testit në lëndën e Biologjisë kanë për qëllim të vlerësojnë pyetjet që lidhen kryesisht me identifikimin e strukturave të gjallesave, përshkrimin e ndërtimit të jashtëm (morfologjik) dhe ndërtimit të brendshëm (anatomik) të gjallesave, shpjegimin e dukurive biologjike, analizën e strukturave biologjike dhe vlerësimin e dukurive jetësore.

Hartimi i testit për lëndën e biologjisë mbështetet në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së biologjisë bazohet në:

- programet e lëndës së biologjisë bërthamë për klasën e 10-të;
- programet e lëndës së biologjisë bërthamë për klasën e 11-të;
- programin e lëndës së biologjisë me zgjedhje për klasën e 12-të.

Më poshtë janë renditur kompetencat që janë testuar në provimin e biologjisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë.

### **Rezultatet e të nxënësve për nivelin e parë të vështirësisë:**

- Identifikon monomerët e komponimeve organike.
- Emërton lëndën mbi të cilën veprojnë enzimët.
- Identifikon praninë e ADN-së në formë rrethore te qelizat prokariote.
- Tregon funksionin e organeleve te qelizat eukariote.
- Emërton llojin e përshtatjes.
- Identifikon vektorët gjenetikë
- Tregon kompletin haploid të kromozomeve te qelizat seksuale të njeriut.
- Identifikon organet e riprodhimit te bimët.
- Tregon rrugën që përshkon gjaku në sistemin e qarkullimit te gjitarët.
- Identifikon ksilemën si ind përçues
- Emërton në figurë pjesët ndërtuese të sistemit të frymkëmbimit te njeriu.
- Tregon çfarë ndodh me pjesët përbërëse të sistemit të frymkëmbimit gjatë procesit të frymëthithjes.
- Tregon vendin e formimit të limfociteve B.
- Identifikon pjesët përbërëse të neuronit.



---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- Tregon sistemet që realizojnë bashkërendimin e punës së pjesëve përbërëse të organizmit të njeriut.
- Emërton hormonet bimore.
- Identifikon pjesët ndërtuese të nefronit.
- Identifikon produktet e aparatit të ekskretimit.
- Tregon vendin ku vepron hormoni ADH.
- Emërton në figurë pjesët e sistemit tretës të njeriut.
- Tregon origjinën dhe funksionin e lëngut të tëmthit.

### **Rezultatet e të nxënit për nivelin e dytë të vështirësisë:**

- Njehson numrin e nukleotideve dhe lidhjeve hidrogjenore në strukturën e acideve nukleike.
- Kryen njehsime me gjenetikën e popullatave, kur ato janë në ekuilibër gjenetik.
- Arsyeton për të shkruar reaksionin e përgjithshëm të fotosintezës, duke iu referuar elementëve përbërës të skemës që paraqet këtë proces.
- Shpjegon rolin e komponimeve të sintetizuara në fazën me dritë në reduktimin e CO<sub>2</sub>.
- Tregon dallimet midis glikolizës dhe ciklit të Krebsit.
- Shpjegon përshkueshmërinë e molekulave polare përmes membranës qelizore.
- Shpjegon rolin e pompave natrium – kalium në membranën e fijos nervore për të ruajtur potencialin e qetësisë.
- Shpjegon pse sistemi i qarkullimit të gjitarët quhet i mbyllur dhe i dyfishtë.
- Shpjegon dukurinë e shkëmbimit të gazeve O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> në nivelin e hojzave.
- Shpjegon si realizohet tretja e proteinave përgjatë gypit tretës (në gojë dhe duoden).
- Tregon dallimin midis gjëndrave endokrine dhe gjëndrave ekzokrine, duke iu referuar lëndëve që ato sekretojnë.
- Shpjegon arsyen pse në një zinxhir ushqimor rrallë gjenden më shumë se pesë nivele trofike.
- Tregon dallimin midis biotopit dhe biocenozës.

### **Rezultatet e të nxënit për nivelin e tretë të vështirësisë:**

- Arsyeton mbi bazën e rezultateve të kryqëzimeve për të përcaktuar tipet e gametëve që prodhojnë prindërit.
- Arsyeton mbi bazën e rezultateve të kryqëzimeve për të përcaktuar vendndodhjen e gjeneve në kromozomet homologë (nëse janë të lirë ose të lidhur).
- Njehson probabilitetin e lindjes së individëve me tipare, gjenet përgjegjëse për të cilat janë të pavarura.

- Skematizon vendosjen e gjeneve në kromozomet homologe kur gjenet janë të lidhur.
- Skematizon fazat e ndarjes qelizore për një komplet kromozomik të dhënë.
- Arsyeton për të njëshuar numrin e kromozomeve që do të ketë secila prej qelizave në fund të ndarjes qelizore.
- Vlerëson rëndësinë e injektimit të ruazave të kuqe te një pacient në kushtet e një situatë të dhënë.
- Shpjegon parimin që lidh funksionin e gjëndrës tiroide me hipofizën dhe me hipotalamusin, duke bërë interpretimin e skemës në një situatë të dhënë.
- Shpjegon çfarë ndodh me sasinë e glukozës në nivele të ndryshme të sistemit të ekskretimit duke analizuar të dhënat e tabelës në një situatë të dhënë.

### **Struktura e testit**

Testi i biologjisë ka gjithsej 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 13 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi për lëndën e biologjisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**TABELA E SPECIFIKIMEVE**

	<b>Tematikat</b>	<b>Peshat në %</b>	<b>Totali i pikëve</b>	<b>Niveli I-40%</b>	<b>Niveli II-40%</b>	<b>Niveli III-20%</b>
I.	Diversiteti	30%	18 pikë	7	7	4
II.	Ciklet	16%	10 pikë	4	4	2
III.	Sistemet	51%	30 pikë	12	12	6
IV.	Ndërveprimet	3%	2 pikë	1	1	-
	<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>60 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>12 pikë</b>

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh.

**Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të biologjisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një tabelë me të dhëna, skemë ose figurë. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

**TESTE**

**Biologji - Sesioni I**

1. Proteinat janë polimere të: **1 pikë**  
A) acideve nukleike  
B) acideve Iyrorre  
C) aminoacideve  
D) nukleotideve
2. Lënda mbi të cilën vepron enzima quhet: **1 pikë**  
A) amilazë  
B) katalizator  
C) proteazë  
D) substrat
3. Në një molekulë të ADN-së që përmban 360 çifte nukleotidesh 20% e përbën guanina. Arsyetoni për të njehsuar numrin e timinë - nukleotideve në këtë molekulë. **3 pikë**
4. ADN-ja në formë rrethore është e pranishme te qelizat: **1 pikë**  
A) bakteriale  
B) e gjethes  
C) e velëzave  
D) e veshkave
5. Lizosomet përmbajnë enzima të afta të: **1 pikë**  
A) formojnë sheqernat  
B) sintetizojnë Iyrat  
C) sintetizojnë proteinat  
D) tretin pjesë qelizore
6. Për një lloj gjallese është bërë kryqëzimi i një individi diheterozigot (DdEe) me një individ homozigot recesiv për të dy gjenet (ddee) të llojit përkatës dhe në F<sub>1</sub> janë marrë këto rezultate: F<sub>1</sub>: 1/2DdEe; 1/2ddee
- a) Duke ndërtuar rrjetën Pennet, përcaktoni tipet e gametëve që prodhojnë prindërit. **1 pikë**
- b) Arsyetoni për rezultatet që janë marrë në F<sub>1</sub> nga ky kryqëzim. **1 pikë**
- c) Skematizoni vendosjen e gjeneve D dhe E në kromozomet homologë te individi diheterozigot. **1 pikë**

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

7. Në një familje gruaja me grup gjaku AB dhe normale për hemofilinë, por me baba me hemofili martohet me një burrë me grup gjaku B dhe normal për hemofilinë, babai i të cilit ishte me grup gjaku O dhe me hemofili. Duke ndërtuar rrjetën Pernet arsyetoni sa është mundësia që çifti të ketë një djalë me grup A të gjakut dhe me hemofili. **3 pikë**

8. Ndërtimi i mushkërive te shpendët është përshtatje: **1 pikë**

- A) anatomike
- B) morfologjike
- C) e ndërprerë
- D) sipërfaqësore


9. Në një popullatë që është në ekuilibër gjenetik, 9 % e njerëzve vuajnë nga një sëmundje autosomike reçesive. Arsyetoni për të njehsuar shpeshinë e individëve të shëndoshë që mund ta transmetojnë tek fëmijët e tyre alelin e sëmundjes. **3 pikë**

10. Në aplikimet e inxhinierisë gjenetike si vektorë gjenetikë shërbejnë: **1 pikë**

- A) aparati i golxhit
- B) kromatina
- C) plazmidet
- D) ribozomet

11. Skema paraqet një proces të rëndësishëm jetësor që zhvillohet te gjallesat.

- a) Shkruani reaksionin e përgjithshëm të këtij procesi.
- b) Shpjegoni rolin e dy komponimeve të sintetizuara në fazën me dritë, që marrin pjesë në reduktimin e CO<sub>2</sub>.



**1 pikë**


**2 pikë**

12. Frymëmarrja qelizore është një proces i rëndësishëm jetësor që zhvillohet te gjallesat. Tregoni dy nga dallimet midis glikolizës dhe ciklit të Krebsit. **2 pikë**

13. Qeliza e një gjallese eukariote ndahet me mejozë. Në fund të metafazës së parë numri i kromozomeve është 6.

- a) Skematizoni qelizën në fund të anafazës së parë. **1 pikë**
- b) Skematizoni një nga qelizat në fund të metafazës së dytë. **1 pikë**
- c) Arsyetoni sa është numri i kromozomeve që do të ketë secila qelizë në fund të telofazës së dytë. **1 pikë**

14. Qelizat seksuale femërore te njeriu përmban: **1 pikë**  
 A) 22+X kromozome  
 B) 22+Y kromozome  
 C) 23+XX kromozome  
 D) 23+XY kromozome
15. Organi i riprodhimit mashkullor te bimët përfaqësohet nga: **1 pikë**  
 A) petlat  
 B) pistili  
 C) poleni  
 D) thekët
16. Të gjitha qelizat rrethohen nga një membranë e hollë pjesërisht e përshkueshme:  
 a) Shpjegoni pse është e vështirë për molekulat polare, që të përshkojnë membranën qelizore. **1 pikë**  
 b) Shpjegoni funksionin e pompave natrium - kalium në membranën e fijos nervore, kur është në gjendje qetësie. **2 pikë**
17. Gjaku që kthehet nga mushkëritë shkon në: **1 pikë**  
 A) barkushen e djathtë  
 B) parabarkushen e djathtë  
 C) parabarkushen e majtë  
 D) barkushen e majtë
18. Sistemi i qarkullimit të gjakut është sistemi kryesor transportues i gjitarëve.  
 a) Shpjegoni përse sistemi i qarkullimit te gjitarët quhet i mbyllur dhe i dyfishtë. **2 pikë**  
 b) Tregoni rolin e pllakëzave për mpiksjen e gjakut. **1 pikë**
19. Ksilema është ind: **1 pikë**  
 A) meristematik  
 B) mbrojtës  
 C) përçues  
 D) parenkimor
20. Në figurë shigjeta me numrin 1 tregon: **1 pikë**  
 A) bronket  
 B) bronkiolat  
 C) diafragmën  
 D) trakenë




## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

21. Gjatë frymëthithjes (frymëmarrjes), vëllimi i mushkërive: **1 pikë**
- A) zvogëlohet dhe  $O_2$  hyn brenda
  - B) zmadhohet dhe diafragma ulet poshtë
  - C) zmadhohet dhe  $CO_2$  del jashtë
  - D) zmadhohet dhe diafragma ngrihet lart

22. Figura paraqet prerjen tërthore të një hojëze (alveole), ku kryhet shkëmbimi i gazeve.

- a) Shpjegoni procesin e shkëmbimit të gazeve  $O_2$  dhe  $CO_2$  në nivelin e hojzave.
- b) Te një pacient që ka humbur gjak në një aksident, injektohen rruaza të kuqe të gjakut. Shpjegoni pse ky pacient kalon nga gjendja apatike (i shtrirë në krevat) në një gjendje vitale, që kryen me lehtësi veprimet jetësore të tij.



**1 pikë**

**2 pikë**

23. Limfocitet B formohen në:

- A) gjëndrën e timusit
- B) palcën e kockave
- C) sistemin e ekskretimit
- D) shtyllën kurrizore

**1 pikë**

24. Pjesë përbërëse e neuronit është:

- A) aksoni
- B) alveola
- C) hemoglobina
- D) nefroni


**1 pikë**

25. Në bashkërendimin e punës së sistemeve të organizmit marrin pjesë: **1 pikë**

- A) sistemi nervor dhe sistemi muskolor
- B) sistemi skeletor dhe sistemi muskolor
- C) sistemi nervor dhe sistemi endokrin
- D) sistemi endokrin dhe aparati lokomotor

MATURA SHITETËRORE 2019

26. Një studiues për të hulumtuar mekanizmin e mbajtjes në normë të hormoneve, injektoi te një kavie eksperimentale hormonin tiroksinë. Duke u bazuar te skema shpjegoni parimin që lidh funksionin e gjëndrës tiroide me hipofizën dhe me hipotalamusin për të mbajtur në normë hormonet e sekretuara prej tyre.



27. Auksinat janë:

- A) enzima tretëse
- B) hormone bimore
- C) hormone shtazore
- D) koenzima

1 pikë

28. Pjesë përbërëse e nefronit është:

- A) glomerula
- B) medula
- C) korteksi
- D) pelvisi

1 pikë

29. Hormoni antidiuretik (ADH) vepron te:

- A) glomerula
- B) kapsula
- C) gypi mbledhës
- D) uretra

1 pikë

30. Sistemi i ekskretimit luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e parametrave homeostatikë të organizmit.

a) Duke u analizuar të dhënat e tabelës, shpjegoni çfarë ndodh me glukozën gjatë proceseve të filtrimit dhe ripërthithjes në nivelin e nefroneve. **2 pikë**

Lënda	Plazma e gjakut	Filtrati glomerular	Urina e grumbulluar në fshikëzën urinare
Përqendrimi i glukozës në g/dm <sup>3</sup>	0,9	0,9	0

b) Shpjegoni rëndësinë e procesit të ri përrthithjes së ujit në nivelin e nefronit.

1 pikë




---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

31. Në figurë struktura me numrin 2 tregon:

- A) mëlçinë
- B) stomakun
- C) pankreasin
- D) tëmthin



1 pikë

32. Lëngu i tëmthit:

- A) prodhohet nga muret e stomakut dhe neutralizon pH acid
- B) prodhohet nga fshikëza e pankreasit dhe derdhet në duoden
- C) nxit qelizat e pankreasit të prodhojë lëngun gastrik
- D) bën emulgimin e lyrave dhe prodhohet nga mëlçia

1 pikë

33. Sistemi tretës luan rol të rëndësishëm në asimilimin e lëndëve ushqimore.

- a) Përshkruani procesin e shpërbërjes së proteinave në aparatit tretës. **2 pikë**
- b) Duke u bazuar te lëndët që sekretojnë, tregoni dallimin midis gjëndrave endokrine dhe gjëndrave ekzokrine. **1 pikë**

34. Gjallesat krijojnë marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet tyre dhe me mjedisin ku ato jetojnë.

- a) Tregoni dallimin midis biotopit dhe biocenozës. **1 pikë**
- b) Shpjegoni pse në një zinxhir ushqimor rrallë gjenden më shumë se pesë nivele trofike. **1 pikë**

**Biologji - Sesioni II**

1. Aminoacidet marrin pjesë në ndërtimin e: **1 pikë**  
A) acideve nukleike  
B) karbohidrateve  
C) lyrave  
D) proteinave
2. Gjatë zhvillimit të reaksioneve biokimike në prani të enzimave: **1 pikë**  
A) rritet energjia e aktivizimit  
B) zvogëlohet energjia e aktivizimit  
C) zvogëlohet shpejtësia  
D) rritet temperatura mbi 40° C
3. Një proteinë e ka peshën molekulare 99000 g/mol. Masa molare mesatare e një aminoacidi është 110g/mol. Njehsoni sa nukleotide përmban vargu i ADN-së, përgjegjës për sintezën e kësaj proteine. **2 pikë**
4. Plazmidet janë sekuenca rrethore të ADN-së, që janë të pranishme te qelizat:  
A) e alveolave **1 pikë**  
B) bakteriale  
C) e bishtajoreve  
D) e mëlçisë
5. Tretja e pjesëve qelizore zhvillohet në: **1 pikë**  
A) centromer  
B) centriole  
C) lizozome  
D) ribozome
6. Kryqëzohet një femër diheterozigotë (dE/De) me një mashkull dihomozigotë të fshehtë (de/de). Largësia midis gjeneve **d** dhe **e** është 8 %. Numri i individëve rikombinantë që u përftuan nga ky kryqëzim ishte 40.  
a) Duke ndërtuar rrjetën Pennet, tregoni tipet e gametëve që formojnë prindërit dhe gjenotipet e pasardhësve të lindur nga ky kryqëzim. **2 pikë**  
b) Arsyetoni për të njehsuar përqindjet e gametëve që formon individi femër (dE/De). **1 pikë**  
c) Arsyetoni për të njehsuar numrin e përgjithshëm të pasardhësve të lindur nga ky kryqëzim. **1 pikë**


---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

7. Prindërit kanë shikim normal, kurse djali i tyre është daltonik.  
a) Në rrjetën Pernet shkruani gjenotipet e prindërve dhe të pasardhësve. **2 pikë**  
b) Njehsoni mundësinë që nga ky çift prindërisht të lindin fëmijë normal përsa i përket sëmundjes së daltonizmit. **1 pikë**
8. Orientimi i shpendëve shtegtarë në hapësirë është përshtatje: **1 pikë**  
A) anatomike  
B) fiziologjike  
C) morfologjike  
D) sjellore
9. Njehsoni frekuencën e gjenotipit **Aa** në një popullatë me kryqëzime rastësore në të cilën frekuenca e fenotipeve recesive është 0,04. **3 pikë**
10. E njëjta enzimë e restriksionit pret në të njëjtën sekuençë të gjitha llojet e:  
A) ADN-ve **1 pikë**  
B) monosakarideve  
C) polisakarideve  
D) proteinave
11. Tregoni produktet përfundimtare fazës dritore të fotosintezës dhe nga e kanë origjinën e tyre. **3 pikë**
12. Tregoni 2 nga dallimet midis fotosintezës dhe frymëmarrjes qelizore. **2 pikë**
13. Qeliza e një gjallese eukariote ndahet me mejozë. Në fund të këtij procesi secila qelizë përmban nga 5 kromozome.  
a) Skematizoni qelizën në fund të metafazës së parë. **1 pikë**  
b) Skematizoni një nga qelizat në fund të telofazës së parë. **1 pikë**  
c) Skematizoni një nga qelizat në fund të anafazës së dytë. **1 pikë**
14. Tek njeriu, kromozomet seksuale të femrat janë: **1 pikë**  
A) X0  
B) XX  
C) XY  
D) YY
15. Tek bimët farëveshura bashkimi i një spermatozoidi me qelizën vezë (oosferën) çon në formimin e një qelize me: **1 pikë**  
A) n kromozome  
B) 2n kromozome  
C) 3n kromozome  
D) 4n kromozome


16. Te gjallesat shumëqelizore përqendrimi i lëngut indor, që lag të gjitha qelizat e trupit mbahet në parametra konstant.
- a) Shpjegoni çfarë do të ndodhë me qelizat e trupit në qoftë se rritet përqendrimi i lëngut indor. **1 pikë**
- b) Shpjegoni pse një rruazë gjaku e zhytur në një tretësirë të holluar çahet, kurse parameci mbijeton në këtë mjedis. **2 pikë**
17. Eritrocitet janë qeliza me funksion: **1 pikë**
- A) mbulues  
B) katalizues  
C) transportues  
D) sekretues
18. Sistemi i qarkullimit të gjakut ka evoluar nga format e thjeshta deri te format e ndërlukuara.
- a) Tregoni dy nga dallimet midis qarkullimit të madh të gjakut dhe qarkullimit të vogël të gjakut. **2 pikë**
- b) Tregoni rëndësinë jetike që ka prania e hekurit në strukturën e hemoglobinës te eritrocitet. **1 pikë**
19. Në figurë shigjeta me numri 3 tregon: **1 pikë**
- A) epidermën  
B) floemën  
C) ksilemën  
D) palcën
20. Unazat kërcore janë të pranishme te: **1 pikë**
- A) trakeja dhe bronket  
B) alveolat dhe bronket  
C) faringu dhe bronkiolat  
D) alveolat dhe trakeja
21. Gjatë frymëthithjes, muskujt që relaksohen (lëshohen) janë: **1 pikë**
- A) muskuli i sheshtë i diafragmës  
B) muskujt e brendshëm ndërbrinjorë  
C) muskujt e jashtëm ndërbrinjorë  
D) muskujt e femurit



TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

22. Sistemi i frymëkëmbimit te njeriu luan rol të rëndësishëm për kryerjen e proceseve jetësore.
- a) Tregoni dy karakteristika të sipërfaqeve gaz shkëmbyese në mushkëri. **2 pikë**  
b) Tregoni rolin e diafragmës në procesin e frymshkëmbimit. **1 pikë**
23. Antitruapat që qarkullojnë në plazmën e gjakut janë: **1 pikë**
- A) gliceride  
B) lipide  
C) glikoproteina  
D) amilopektina
24. Adrenalina sekretohet nga: **1 pikë**
- A) gjëndra e pankreasit  
B) gjëndrat mbiveshkore  
C) gjëndra e timusit  
D) gjëndra e tiroides
25. Sistemi parasimpatik është pjesë përbërëse e: **1 pikë**
- A) sistemit nervor somatik  
B) sistemit nervor autonom  
C) shtyllës së trurit  
D) hipotalamusit
26. Sistemi nervor dhe sistemi endokrin kanë lidhje funksionale midis tyre.
- a) Tregoni dy nga dallimet midis mesazhit nervor dhe hormonal. **2 pikë**  
b) Te sinapset shpjegoni veprimin që ka neurotejtçuesi kur bie në kontakt me membranën e neuronit passinaptik. **1 pikë**
27. Etileni është hormon që prodhohet në: **1 pikë**
- A) gjallesat shtazore  
B) gjendje të ngurtë  
C) gjendje të lëngët  
D) gjendje të gaztë

28. Në figurë struktura me numrin 3 tregon:
- A) fshikëzën  
B) veshkën  
C) ureteret  
D) uretrën



**1 pikë**

29. Glomerula është pjesë përbërëse e: **1 pikë**  
 A) fshikëzës  
 B) nefronit  
 C) uretrës  
 D) uretereve


30. Aparati i ekskretimit luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e parametrave homeostatikë të organizmit.  
 a) Duke u analizuar të dhënat e tabelës, shpjegoni çfarë ndodh me glukozën dhe proteinat gjatë procesit të filtrimit në nivelin e nefroneve. **2 pikë**

Lëndët	Gjaku në arterien renale	Filtrati në kapsulën e Baumanit	urina
Glukoza	0,9	0,9	0
Proteinat	82	0	0

- b) Duke iu referuar vendndodhjes së nefronit, tregoni dallimin midis ndërtimit të korteksit dhe ndërtimit të pjesës medulare (palcore) të veshkës. **1 pikë**

31. Në figurë struktura me numrin 4 tregon:

- A) mëlçinë  
 B) pankreasin  
 C) zorrën e hollë  
 D) zorrën e trashë



**1 pikë**

32. Vilozitetet ose rrudhosjet gjenden në:

- A) ezofag  
 B) faring  
 C) stomak  
 D) zorrën e hollë

**1 pikë**

33. Mëlçia është pjesë e rëndësishme e aparatit tretës:

- a) Shpjegoni dy nga funksionet e mëlçisë.  
 b) Tregoni funksionin e amilazës pankreatike.

**2 pikë**

**1 pikë**

34. Gjallesat krijojnë marrëdhënie midis tyre dhe me mjedisin ku ato jetojnë.

- a) Shpjegoni pse lënda nuk humbet por riciklohet. **1 pikë**  
 b) Shpjegoni pse energjia në dallim nga lënda nuk mund të riciklohet. **1 pikë**

## EKONOMI

Ekonomia si lëndë i ofron nxënësit mundësi që të zhvillojë të kuptuarit e organizimit dhe veçorive ekonomike të shoqërisë, domosdoshmërinë e përballimit të problemit të pamjaftueshmërisë së burimeve për të plotësuar nevojat e saj, të cilat jo vetëm janë të pakufizuara, por edhe shtohen, si dhe janë shumë konkurruese me njëra-tjetrën. Ky problem që e ka shoqëruar komunitetin njerëzor gjatë gjithë ekzistencës së tij në kuadër kombëtar, rajonal e botëror, ka mënyra të ndryshme të zgjidhjes. Hartimi i testit për lëndën e Ekonomisë mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së Ekonomisë bazohet në Programin e lëndës së Ekonomisë për klasën e 12-të;

Bazuar në programin orientues, përmbushja e kompetencave ekonomike dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet këtyre tematikave kryesore:

- Njohuri të Ekonomiksit;
- Probleme të Mikroekonomisë;
- Probleme të Makroekonomisë;
- Ekonomia në praktikë.

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të Ekonomisë. Specialistët e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të kësaj lënde, nuk mund përfshijnë në testim çështje mësimore të cilat nuk janë parashikuar në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja. Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues.

Disa nga kompetencat që janë testuar në provimin e Ekonomisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

***Rezultatet e të nxënësve për nivelin e parë të vështirësisë:***

- Identifikon problemin ekonomik themelor;

- Përshkruan mënyrën e zgjidhjes së tij nga sisteme të ndryshme ekonomike;
- përcakton subjektet ekonomike;
- identifikon burimet prodhuese të përdorura nga subjektet ekonomike;
- identifikon aspekte të ndërthurjes së individit si konsumator, firmës dhe qeverisë.
- Liston elementë, faktorë, veçori.

**Rezultatet e të nxënit për nivelin e dytë të vështirësisë:**

- përcakton ndikimin e faktorëve në elasticitetin e kërkesës dhe ofertës së mallrave dhe shërbimeve në treg;
- analizon ndikimin e faktorëve në elasticitetin e kërkesës dhe ofertës së mallrave dhe shërbimeve në treg;
- analizon veçori të organizimit të bizneseve;
- shpjegon aspekte të domosdoshmërisë së ndërhyrjes së qeverisë në ekonominë e tregut;
- krahason forma të biznesit, struktura të tregut;
- analizon politikat stabilizuese;
- klasifikon aftësitë për sipërmarrje të suksesshme.

**Rezultatet e të nxënit për nivelin e tretë të vështirësisë:**

- interpreton mënyrën e zgjidhjes së problemeve ekonomike nga sistemet ekonomike;
- llogarit koeficiente të elasticitetit, ndërton grafikë, llogarit tregues të firmës bazuar në të dhëna;
- argumenton nëpërmjet rasteve të dhëna, shembujt konkretë të ndikimit të institucioneve ekonomike në çdo aspekt të problemeve mikroekonomike dhe makroekonomike.

**Struktura e testit**

Testi i Ekonomisë ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 13 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi për lëndën e Ekonomisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.



**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

Nr.	Tematikat	Pesha në %	Nr. i pikëve	Nivelet		
				I- 40%	II-40 %	III- 20%
1	Çfarë studion ekonomia	6	4		3	1
2	Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut	15	11	2	5	4
3	Konsumatori në ekonominë e tregut	5	3	3		
4	Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	5	3	3		
5	Prodhimi, kosto dhe të ardhurat e firmës	8	6	1	4	1
6	Struktura e tregut	5	4		3	1
7	Tregjet e faktorëve të prodhimit	5	1		1	
8	Qeveria dhe ekonomia	7	4	3	1	
9	Paraja dhe institucionet financiare	5	3		3	
10	Treguesit kryesore makroekonomikë	12	7	4	1 1	2
11	Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	4	3	2	1	
12	Tregtia ndërkombëtare	5	1		1	
13	Etika e Biznesit	5	4	3		1
14	Aftësi për sukses	4	1	1		
15	Financat personale	4	2	1	1	
16	Bëhu sipërmarrës	5	3	1		2
		<b>100</b>	<b>60p</b>	<b>24p</b>	<b>24p</b>	<b>12p</b>

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh. Pra, tematika “Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut” që zë 15 % të peshës së programit është përfaqësuar në test me 6 pyetje dhe 11 pikë, ndërsa tematika “Aftësi për sukses” ka 4% peshë në program është përfaqësuar me 1 pyetje dhe ka 1 pikë.

### **Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të Ekonomisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një situatë, ushtrim apo grafik. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

**T E S T E**

**Ekonomi - Sesiioni I**

1. Kapitali si faktor prodhimi i referohet: **1 pikë**  
A) vetëm kapitalit fizik.  
B) vetëm kapitalit financiar.  
C) të gjitha pasurive të firmës.  
D) të gjitha burimeve prodhuese.
2. Para viteve '90 u dhanë udhëzime që të mbilleshin më shumë ullinj dhe agrume në jug të Shqipërisë. **3 pikë**  
a) Çfarë sistemi ekonomik ekzistonte në Shqipëri në atë kohë?  
b) Renditni dy nga karakteristikat e këtij sistemi.
3. Nëse blerësit besojnë se çmimi i kompjuterëve në të ardhmen do të rritet dhe faktorët e tjerë do të mbeten të pandryshuar, mund të themi se në periudhën e tanishme: **1 pikë**  
A) oferta për kompjuter do të ulet.  
B) oferta për kompjuter do të rritet.  
C) kërkesa për kompjuter do të ulet.  
D) kërkesa për kompjuter do të rritet.
4. Kur lakorja e ofertës për një produkt zhvendoset majtas dhe kushtet e tjera nuk ndryshojnë, në treg: **1 pikë**  
A) ulet çmimi i produktit, ulet sasia.  
B) ulet çmimi i produktit, rritet sasia.  
C) rritet çmimi i produktit, ulet sasia.  
D) rritet çmimi i produktit, rritet sasia.
5. Sipas ligjit të kërkesës, nëse çmimi i makinave në treg do të ulej: **1 pikë**  
A) kërkesa për makina do të ulej.  
B) kërkesa për makina do të rritej.  
C) sasia e kërkuar për makina do të ulej.  
D) sasia e kërkuar për makina do të rritej.

**MATURA SHETËRORE 2019**

---

6. Ndryshimi në ofertë për një mall të caktuar ndodh atëherë kur: **1 pikë**
- A) blerësit besojnë se çmimi do të rritet.
  - B) ndryshojnë të ardhurat e konsumatorit.
  - C) ndryshon çmimi i mallit zëvendësues në konsum.
  - D) përmirësohet teknologjia e prodhimit të produktit.

7. Tabela e mëposhtme na tregon të dhënat mbi çmimin, sasinë e kërkuar dhe sasinë e ofruar të tregut të këpucëve. **3 pikë**

Kombinimet	Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
A	1	90	10
B	2	80	30
C	3	50	50
D	4	30	80
E	5	10	100

- Nëse çmimi i lëkurës që do të përdorej për prodhimin e këpucëve, do të rritej, sasia e ofruar do të ndryshonte me 50 njësi. Kur faktorët e tjerë mbeten të pandryshuar, tregoni:
- a) çfarë do të ndodhë në treg me çmimin e ekuilibrit? Sa do të jetë ai?
  - b) çfarë do të ndodhë në treg me sasinë e ekuilibrit? Sa do të jetë ajo?
  - c) Paraqiteni grafikisht këtë situatë duke përcaktuar çmimin e ri të ekuilibrit dhe sasinë e re të ekuilibrit.

8. Supozojmë se jemi në një treg ku çmimi i produktit ishte 20 njësi paraje dhe sasia ishte 100 njësi. Kur çmimi u rrit me 10 njësi, sasia u ul me 50 njësi. **4 pikë**

- a) Tregoni për çfarë elasticiteti bëhet fjalë: kërkese apo oferte?
- b) Llogarisni përqindjen e ndryshimit në çmim.
- c) Sa është elasticiteti në këtë rast?
- d) Paraqiteni grafikisht këtë elasticitet.

9. Aldo është analist kredie pranë bankës ABC. Një mik i tij paraqitet në bankë që të marrë kredi për të blerë një apartament të ri. **3 pikë**

- a) Identifikoni për çfarë forme kredie bëhet fjalë në këtë rast.
- b) Renditni dy kushte që duhet të plotësojë miku i Aldos për të marrë kredi.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

10. Cila nga shpenzimet që bën firma, përfshihet në kostot fikse në periudhën afatshkurtër? **1 pikë**

- A) Shpenzimet për pagat e punonjësve.
- B) Shpenzimet për qiranë e ndërtesës.
- C) Shpenzimet për blerjen e lëndës së parë.
- D) Shpenzimet për transportin e produkteve.

11. Amara dhe Livia vendosën të fillojnë një biznes për prodhimin e qeseve të letrës. Në fund të vitit të parë, firma shiti 200 000 njësi produkti me 0.4 lekë; dha ambiente me qira me 20 000 lekë; kreu shërbime ndaj të tretëve me vlerë 10 000 lekë. Fondi i amortizimit të kapitalit të firmës ishte 10 000 lekë. Lënda e parë kushtoi 8 000 lekë. Norma e interesit ishte 20 000 dhe pagesa për pagat e punëtorëve 60 000 lekë.

Gjeni:

**3 pikë**

- a) për çfarë forme organizimi biznesi bëhet fjalë?
- b) sa janë të ardhurat e përgjithshme të firmës?
- c) sa është fitimi ose humbja e firmës në këtë rast?

12. Tabela e mëposhtme na tregon funksionin e prodhimit të një firme në periudhë afatshkurtër.

Pas cilit punëtor fillon të veprojë ligji i të ardhurave marginale rënëse? **1 pikë**

L	0	1	2	3	4	5	6	7
TPP	0	10	22	35	43	50	50	48

- A) Pas punëtorit të parë.
- B) Pas punëtorit të dytë.
- C) Pas punëtorit të tretë.
- D) Pas punëtorit të katërt.

13. Firma nuk prodhon asnjë njësi produkti dhe në këtë nivel ka kosto totale 50 njësi paraje. Kostoja fikse mesatare e saj, kur prodhon 5 njësi produkti, është:

- A) 10 njësi paraje.
- B) 20 njësi paraje.
- C) 30 njësi paraje.
- D) 40 njësi paraje.

**1 pikë**

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

14. Jepet tabela e mëposhtme që paraqet koston e firmës në periudhën afatshkurtër.

**3 pikë**

<b>Q</b>	0	1	2	3	4	5	6	7
<b>TC</b>	100	146	196	207	244	310	370	430

- a) Sa është kostoja mesatare fikse kur firma ka prodhuar 4 njësi produkti?
- b) Sa është kostoja marginale kur firma ka prodhuar 6 njësi produkti?
- c) Sa është kostoja mesatare e përgjithshme kur firma ka prodhuar 5 njësi produkti?

15. Tregu i telefonisë celulare në Shqipëri i përket një strukture tregu: **1 pikë**

- A) oligopol.
- B) monopol.
- C) konkurrence të plotë.
- D) konkurrence monopolistike.

16. Kur krahasojmë firmën në konkurrencë të plotë dhe konkurrencë monopolistike, midis tyre ka tipare të përbashkëta dhe dallime.

Zbuloni:

**3 pikë**

- a) dy tipare të përbashkëta.
- b) një tipar dallues midis tyre.

17. Tabela e mëposhtme na jep një firmë që vepron në konkurrencë të plotë si në tregjet e produkteve dhe në tregun e punës.

<b>L</b>	0	1	2	3	4	5
<b>TPP</b>	0	10	15	18	20	21

Nëse çmimi i produktit është 10 njësi paraje dhe paga 20 njësi paraje, sa është numri optimal i punëtorëve që duhet të punësojë firma? **1 pikë**

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

18. Në shpenzimet kapitale të qeverisë përfshihen:

**1 pikë**

- A) shpenzimet për pensionet.
- B) shpenzimet për ndihmën sociale.
- C) shpenzimet për qeverisjen vendore.
- D) shpenzimet për ndërtimin e rrugës së Arbrit.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

19. Në ekonominë e sipërmarrjes së lirë qeveria ndërhyt në forma të ndryshme. Çfarë roli luan qeveria në situatat e mëposhtme? **3 pikë**

- a) Qeveria rriti shpenzimet për ndërtimin e tunelit të Murrizit.
- b) Qeveria krijon agjenci të posaçme që merren me vendosjen dhe zbatimin e standardeve që mbrojnë mjedisin nga ndotja.
- c) Qeveria ndërhyt nëpërmjet programeve për të trajnuar dhe për të kualifikuar njerëzit, me qëllim që ata të rrisin produktivitetin e punës.

20. Institucioni që harton politikën monetare në Shqipëri, është Banka e Shqipërisë. **3 pikë**

- a) Cili është objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë sot?
- b) Tregoni dy aspekte të shprehjes së pavarësisë së Bankës Qendrore, si tipari thelbësor i saj.

21. Inflacioni përfaqëson: **1 pikë**

- A) rritjen e pagave të punonjësve.
- B) uljen e kostos së shportës së mallrave.
- C) uljen e çmimeve të mallrave të veçanta.
- D) rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

22. Çmimi i naftës në treg u rrit; kjo ndikoi edhe në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Shkaku i inflacionit të krijuar në këtë rast është: **1 pikë**

- A) kostoja.
- B) kërkesa.
- C) spiralja pagë-çmim.
- D) spiralja çmim-pagë.

23. Familja e Olës, e cila vazhdon studimet në fakultetin ekonomik, përbëhet nga 5 persona. Babai punon si ekonomist në Ministrinë e Financave. Mamaja dikur punonte si arkitekte pranë një studioje. Duke menduar se paga e saj ishte e ulët, ajo e la punën dhe u vu në kërkim të një pune tjetër me një pagë më të lartë. Dy vëllezërit e saj binjakë kanë mbaruar fakultetin. Njëri ka filluar punë në një kompani programimi, kurse tjetrit i është ofruar punë si menaxher shitjesh, por nuk ka pranuar sepse kërkon të punojë në profesionin e tij si jurist.

Gjeni:

**3 pikë**

- a) sa pjesëtarë të kësaj familjeje janë pjesë e forcës punëtore?
- b) sa pjesëtarë të kësaj familjeje janë të papunë?
- c) për çfarë lloj papunësie bëhet fjalë?

**MATURA SHKETËRORE 2019**

---

24. Çfarë ndodh gjatë rënies ekonomike me treguesit e: **2 pikë**  
a) GDP-së / PBB-së?  
b) papunësisë?
25. Banka Qendrore rrit normën e interesit. Cili nga grupet e mëposhtëm do të prekej më shpejt nga ky veprim? **1 pikë**  
A) Kompanitë private.  
B) Bankat e nivelit të dytë.  
C) Konsumatorët në blerjet e tyre.  
D) Qeveritë e vendeve në tranzicion.
26. Nëse Banka Qendrore rrit normën e rezervës së detyrueshme, shpjegoni ndikimin në: **2 pikë**  
a) ofertën monetare  
b) inflacion
27. Në periudhën e festave të fund vitit vihet re një ulje e kursit të këmbimit të euros ndaj lekut. Kjo shkaktohet nga: **1 pikë**  
A) rritja e eksportit të mallrave.  
B) ulja e ofertës së euros në treg.  
C) rritja e ofertës së euros në treg.  
D) ulja e kërkesës për euro në treg.
28. Bizneset përpiqen të mos bëjnë asnjë dëm dhe të veprojnë në dobi të shoqërisë. Për një biznes, ky përbën një: **1 pikë**  
A) detyrim etik.  
B) detyrim ligjor.  
C) detyrim shtesë.  
D) detyrim financiar.
29. Ju do të dëshironit të ishit një sipërmarrës i suksesshëm. Cilat janë tri shtyllat ku do të mbështetej sipërmarrja juaj për të qenë i tillë? **3 pikë**
30. Dilemat etike zgjidhen në mënyrën e duhur kur: **1 pikë**  
A) mbështeten te besimi juaj.  
B) bazohen në vlerat personale.  
C) zgjedhjet bëhen nga interesat e çastit.  
D) zgjedhjet bëhen nga interesat e miqve.



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---


31. Marrja e kredisë në të tashmen, nënkupton gjetjen e parave: **1 pikë**
- A) për dëshirat dhe nevojat nga e kaluara.
  - B) për blerjen e artikujve në kohët e mëvonshme.
  - C) për të ardhmen, për të shlyer borxhin plus interesat.
  - D) për të ardhmen, për të shlyer borxhin minus interesat.
32. Cila nga zgjedhjet e mëposhtme mund të jetë më e brishtë përballë riskut? **1 pikë**
- A) Blerja e obligacioneve.
  - B) Blerja e aksioneve të një korporate.
  - C) Hapja e një depozite kursimi me 2.5% interes.
  - D) Dhënia borxh një miku me normë interesi 15%.
33. Veprimi i parë që duhet bërë për një sipërmarrje të suksesshme, është: **1 pikë**
- A) plani i Etikës.
  - B) hartimi i planit të biznesit.
  - C) zgjedhja e produktit të duhur.
  - D) marrja e informacionit në treg.
34. Listoni dy mënyra se si një sipërmarrës fiton përparësi konkurruese në raport me sipërmarrësit e tjerë. **2 pikë**

**Ekonomi - Sesioni II**

1. Sistemi ekonomik që bazohet në planifikimin e ekonomisë për zgjidhjen e problemit themelor është: **1 pikë**

- A) ekonomia e tregut.
- B) ekonomia e përzier.
- C) ekonomia tradicionale.
- D) ekonomia e komanduar.

2. Grafiku i mëposhtëm tregon kufirin e mundësive të prodhimit për një vend, në një periudhë të dhënë kohe. Tregoni çfarë përfaqësojnë pikat A,B,C për burimet ekonomike të vendit.



3. Në qoftë se patatet janë mall inferior, atëherë rritja e të ardhurave do të çojë në: **1 pikë**

- A) ulje të ofertës së patateve.
- B) rritje të ofertës së patateve.
- C) ulje të kërkesës së patateve.
- D) rritje të kërkesës së patateve.

4. Si pasojë e rritjes së nivelit të çmimit të produktit me 10%, sasia e ofruar në treg u rrit me 15%. Në këtë rast themi që oferta është: **1 pikë**

- A) elastike.
- B) jo elastike.
- C) plotësisht elastike.
- D) me elasticitet njësi.

5. Në një treg konkurrues, nëse sasia e kërkuar është më e madhe se sasia e ofruar, atëherë: **1 pikë**

- A) ekuilibri është arritur.
- B) çmimi i tregut do të ulet.
- C) çmimi i tregut do të rritet.
- D) në treg kemi tepriçë malli.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

6. Vendosja e një takse mbi prodhimin e një malli, do të sjellë: **1 pikë**
- A) zhvendosjen në të majtë të lakores së ofertës për mallin dhe rritje të çmimit.
  - B) zhvendosjen në të djathtë të lakores së ofertës për mallin dhe ulje të çmimit.
  - C) zhvendosjen në të majtë të lakores së kërkesës për mallin dhe ulje të çmimit.
  - D) zhvendosjen në të djathtë të lakores së kërkesës për mallin dhe rritje të çmimit.

7. Tabela e mëposhtme tregon kërkesën dhe ofertën për një produkt të caktuar. **3 pikë**

P (Çmimi)							
Q <sub>D</sub> (Sasia e kërkuar)	19	18	17	16	15	14	13
Q <sub>S</sub> (Sasia e ofruar)	7	9	11	13	15	17	19

- a) Përcaktoni sasinë ekuilibër.
- b) Përcaktoni çmimin ekuilibër.
- c) Nëse qeveria ndërhyr duke vendosur çmimin 6 njësi para, tregoni si do të quhet ky çmim?

8. Elasticiteti i kërkesës për një mall është i barabartë me 0 ( $E_d=0$ ). **4 pikë**

- a) Si paraqitet kërkesa në lidhje me çmimin ?
- b) Çfarë mund të themi në këtë rast për reagimin e sasisë së kërkuar si pasojë e ndryshimit të çmimit?
- c) Bëni paraqitjen grafike të këtij elasticiteti.
- d) Jepni një shembull për këtë lloj elasticiteti.

9. Ana dëshiron të kursejë një pjesë të të ardhurave të saj. Tregoni tre faktorë në të cilët do të mbështetet ajo për të rritur masën e kursimit. **3 pikë**

10. Cila nga alternativat e mëposhtme përfaqëson burim të brendshëm të financimit të biznesit? **1 pikë**

- A) Kredia bankare.
- B) Fondi i amortizimit.
- C) Shitja e aksioneve.
- D) Shitja e obligacioneve.

11. Eri do të fillojë një biznes së bashku me mikun e tij Oltin. Për të filluar këtë biznes me ortakëri ata duan të dinë: **3 pikë**

- a) dy përparësi të firmave me ortakëri.
- b) një mangësi të firmave me ortakëri.

**MATURA SHKETËRORE 2019**

---

12. Firma nuk prodhon asnjë njësi produkti dhe në këtë nivel ka kosto totale 100 njësi paraje. Kosto fikse mesatare e saj kur prodhon 10 njësi produkti është:

- A) 10 njësi paraje. **1 pikë**
- B) 20 njësi paraje.
- C) 30 njësi paraje.
- D) 40 njësi paraje.

13. Cili tregues i firmës paraqet shtesën në të ardhurat e përgjithshme, kur firma rrit me një njësi sasinë e shitur? **1 pikë**

- A) AR
- B) MR
- C) APP
- D) MPP

14. Një firmë në konkurrencë të plotë, në periudhë afatshkurtër, ka treguesit e tabelës së mëposhtme. **3 pikë**

Sasia e produktit	0	1	2	3	4	5	6
Shpenzimet totale	18	30	45	75	100	120	150

- a) Sa është kostoja fikse e produktit?
- b) Sa është kostoja marginale, kur firma prodhon 5 njësi produkti?
- c) Sa është kostoja e përgjithshme kur firma prodhon 4 njësi produkti?

15. Cila nga alternativat e mëposhtme **nuk** është karakteristikë e një tregu në konkurrencë monopolistike? **1 pikë**

- A) Numri i firmave është i madh.
- B) Firma është çmim pranuese.
- C) Produkti që firma ofron është i diferencuar.
- D) Është e lehtë të hysh dhe të dalësh nga tregu.

16. Duke u bazuar në shembujt e mëposhtëm përcaktoni për çfarë strukture tregu bëhet fjalë. **3 pikë**

- a) Në rrugën 'Myslim Shyri' ka shumë firma që tregtojnë veshje të ndryshme.
- b) Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime në Tiranë është e vetmja që ofron ujë të pijshëm për banorët e saj.
- c) Disa banka të nivelit të dytë në Shqipëri realizojnë 60% të shërbimeve për subjektet ekonomike.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

17. Supozojmë se një numër i madh studentësh diplomohen në degën ekonomi. Në një situatë të tillë çfarë do të ndodhë në tregun e punës së ekonomistëve?  
A) oferta e punës do të rritej, si pasojë niveli i pagës do të ulej. **1 pikë**  
B) oferta e punës do të ulej, si pasojë niveli i pagës do të ulej.  
C) oferta e punës do të rritej, si pasojë niveli i pagës do të rritej.  
D) oferta e punës do të ulej, si pasojë paga nuk do të ndryshonte.
18. Qeveria po koordinon veprimtaritë e saj për mbrojtjen e mjedisit. Cilin nga funksionet po ushtron ajo?  
A) Mbrojtjen e konsumatorit.  
B) Trajtimin e eksternaliteteve.  
C) Garantimin e pronës private.  
D) Garantimin e konkurrencës në treg. **1 pikë**
19. Listoni tri arsye pse paguajmë taksa. **3 pikë**
20. Identifikoni: **3 pikë**  
a) dy funksione të Bankës Qendrore, që lidhen drejtpërdrejtë me Bankat e nivelit të dytë.  
b) një funksion të Bankës Qendrore, që lidhet me qeverinë.
21. GDP –ja / PBB- ja reale përfaqëson: **1 pikë**  
A) vlerën e mallrave dhe shërbimeve prodhuar për një person.  
B) vlerën e mallrave dhe shërbimeve prodhuar nga ekonomitë e nëndheshme.  
C) vlerën e mallrave dhe shërbimeve prodhuar në një vit, të llogaritura me çmimet aktuale.  
D) vlerën e mallrave dhe shërbimeve prodhuar në një vit, të llogaritura me çmimet e vitit bazë.
22. Nëse një vend është në nivelin e punëzënies së plotë kjo do të thotë që norma e papunësisë është e barabartë me: **1 pikë**  
A) zero.  
B) normën e papunësisë ciklike.  
C) normën natyrore të papunësisë.  
D) normën e papunësisë friksionale.
23. Në cilin përbërës të GDP-së/ PBB-së (C,I,G,NX) do të ndikojë secili prej transaksioneve të mëposhtme? **3 pikë**  
a) Blerja e mobilieve të reja nga një familje.  
b) Shitja e një makine nga kompania BMW në vendin tonë.  
c) Ndërtimi i një rruge të re.

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

24. Vlera e CPI-së së SHBA-së në vitin 1927 ka qenë 17.4 ndërsa në vitin 1928 shkoi në 17.1. Bazuar në këto të dhëna zyrtare: **2 pikë**
- a) llogaritni normën e inflacionit ndërmjet këtyre viteve.
  - b) përcaktoni nëse është inflacion, deflacion apo disinflacion.
25. Qeveria në kuadrin e politikës fiskale përdor instrumentin e: **1 pikë**
- A) blerjes së bonove të thesarit.
  - B) rritjes së normës së ri financimit.
  - C) uljes së shpenzimeve qeveritare.
  - D) rritjes së rezervës së detyrueshme.
26. Si ndikojnë veprimet e mëposhtme të Bankës së Shqipërisë në ofertën monetare, kur ajo: **2 pikë**
- a) blen 20 milionë lekë bono thesari.
  - b) rrit normën e rezervës së detyrueshme nga 2% në 5%.
27. Gjatë festave të fund vitit kursi i këmbimit të euros bie në raport me lekun. Kjo shkaktohet nga rritja e: **1 pikë**
- A) importeve në vend.
  - B) normave të interesit.
  - C) ofertës për euro në treg.
  - D) kërkesës për euro në treg.
28. Cili nga pohimet e mëposhtëm përbën detyrim etik sipas teorisë së palëve të interesuara? **1 pikë**
- A) Detyrimi që parësorë janë pronarët e biznesit.
  - B) Detyrimi që biznesi duhet t'i parashikojë dëmet.
  - C) Detyrimi që një biznes duhet t'i bindet vetëm ligjit.
  - D) Detyrimi që nuk duhet të shpenzojë para, nëse nuk sjell para shtesë.
29. Një nga problematikat më të dukshme sot në biznesin global është punësimi i të miturve. Në rast se një drejtues biznesi punëson disa të mitur në kompaninë e tij, cilat mendoni se do të ishin tri nga problemet me të cilat do të përballëj ai? **3 pikë**
30. Bora bën pyetje, parashikon dhe mbledh informacion për arsimin e lartë në Shqipëri dhe në vende të tjera. Cila është aftësia për sukses që po përdor Bora në këtë rast? **1 pikë**
- A) Vrojton me kujdes.
  - B) Përcjell ide me shkrim.
  - C) Mëson përmes kërkimit.
  - D) Dëgjon në mënyrë aktive.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

31. Buxheti individual përfaqëson: **1 pikë**
- A) plan për investimet e të ardhmes në një biznes.
  - B) të ardhurat e individit nga shpërblime të ndryshme.
  - C) plan për të ardhurat, shpenzimet dhe menaxhimin e tyre.
  - D) të ardhurat e individit të siguruara gjatë një periudhe të caktuar.
32. Për një buxhetim të suksesshëm duhet të bëni shpenzime: **1 pikë**
- A) po aq sa fitoni.
  - B) të domosdoshme.
  - C) të ndryshueshme.
  - D) më pak sesa fitoni.
33. Cili është hapi i fundit për një sipërmarrje të suksesshme? **1 pikë**
- A) Përcaktimi i tregut.
  - B) Hartimi i planit të biznesit.
  - C) Zgjedhja e produktit të duhur.
  - D) Marrja e informacionit në treg.
34. Listoni dy nga elementet për një biznes të ri të suksesshëm. **2 pikë**

## FILOZOFI-SOCIOLOGJI

Filozofia dhe Sociologjia si lëndë i ofrojnë nxënësit mundësi që të zhvillojë të kuptuarit e realitetit përmes përdorimit të arsytimit; të përdorë mënyra të ndryshme hulumtimi për zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme; të njohë më mirë veçoritë e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore të vendit tonë dhe vendeve të tjera, si dhe të nxisë zhvillimin e mendimit kritik.

Hartimi i testit për lëndët filozofi dhe sociologji mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndëve filozofi dhe sociologji bazohet në:

- programin e lëndës së filozofisë bërthamë për klasën e 11-të;
- programin e lëndës së sociologjisë me zgjedhje për klasën e 12-të.

Bazuar në programin orientues, përmbushja e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet këtyre tematikave:

### 1. Filozofi

- Periudha helene
- Periudha romake
- Drejtimet filozofike në shekujt e parë të erës sonë
- Mesjeta dhe Rilindja
- Shekulli i XVII
- Shekulli i XVIII
- Shekulli i XIX dhe XX

### 2. Sociologji

- Kultura, individi, shoqëria
- Shoqërizimi
- Devianca
- Shtresimi gjinor dhe familja
- Raca dhe etniciteti
- Analiza sociologjike e besimeve fetare
- Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara
- Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore
- Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne
- Metodatat e kërkimit sociologjik



---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të filozofi-sociologjisë. Specialistët e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të këtyre lëndëve, nuk mund të përfshijnë në testim çështje mësimore të cilat nuk janë parashikuar në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja. Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënës të programit orientues, mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënës të programit orientues.

Kompetencat që janë testuar në provimin e filozofi-sociologjisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

***Rezultatet e të nxënës për nivelin e parë të vështirësisë:***

- identifikon përbërësit e sistemeve kulturore
- përshkruan ndikimin e mjediseve dhe faktorëve në procesin e shoqërizimit
- identifikon funksionet e familjes
- përshkruan marrëdhëniet mes shumicës dhe pakicave etnike në vendin tonë dhe vende të tjera
- identifikon veçoritë e punës në shoqëritë më të industrializuara
- përshkruan rrethanat dhe faktorët që lidhen me zhvillimin e filozofisë në periudha të ndryshme
- identifikon drejtimet kryesore filozofike të shfaqura në periudha të ndryshme

***Rezultatet e të nxënës për nivelin e dytë të vështirësisë:***

- dallon format e lidhjeve martesore
- analizon tipat e ndryshme të krimeve
- analizon funksionet kryesore të besimeve fetare
- klasifikon tipat e lëvizjeve shoqërore
- analizon pikëpamjet e filozofëve të ndryshëm në periudha kohore të ndryshme
- analizon shkaqet dhe mënyrat e evolimit të mendimit filozofik nga antikiteti në periudhën moderne

***Rezultatet e të nxënës për nivelin e tretë të vështirësisë:***

- interpreton situata të jetës së përditshme përmes refleksionit filozofik
- vlerëson ndikimin e elementëve të kulturës shqiptare dhe kulturave të tjera në formimin e personalitetit dhe procesin e shoqërizimit

### **Struktura e testit**

## MATURA SHTETËRORE 2019

Ky test përfshin pyetje nga dy lëndët përkatëse, prandaj ai do të jetë i ndarë në dy pjesë. Secila prej tyre zë 50% të pikëve totale të testit.

### Pjesa I Sociologji

Kjo pjesë e testit përmban 10 pyetje me alternativa dhe disa pyetje të hapura të cilat synojnë të vlerësojnë atë çfarë nxënësi di dhe është në gjendje të bëjë në përfundim të shkollës së mesme në lëndën e sociologjisë.

### Pjesa II Filozofi

Edhe në këtë pjesë të testit do të jenë 10 pyetje me alternativa dhe disa pyetje të hapura që do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në këtë lëndë.

Testi për lëndën e filozofi-sociologjisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

## FILOZOFI

				I-40%	II-40 %	III-20%
1	Periudha helenike	17	5	1	1	3
2	Periudha romake	13	4	4		
3	Drejtimet filozofike në shekujt e parë të erës sonë	3	1		1	
4	Mesjeta dhe Rilindja	13	4	1	3	
5	Shekulli XVII	10	3		3	
6	Shekulli XVIII	17	5	4	1	
7	Shekulli XIX dhe XX	27	8	2	3	3

## SOCIOLOGJI

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

				I-40%	II-40 %	III-20%
1	Kultura, individi, shoqëria	13	4		1	3
2	Shoqërizimi	10	3			3
3	Devianca	10	3		3	
4	Shtresimi gjinor dhe familja	17	5	5		
5	Raca dhe etniciteti	10	3		3	
6	Analiza sociologjike e besimeve fetare	13	4	1	3	
7	Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara	10	3	1	2	
8	Shtresimi I shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore	3	1	1		
9	Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne	7	2	2		
10	Metodat e kërkimit sociologjik	7	2	2		

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh.

**Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të filozofi-sociologjisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla.

**TESTE**

**Filozofi-Sociologji - Sesioni I**

**Sociologji**

1. Mendësitë me natyrë etnocentrike, në sociologji, përcaktohen si: **1 pikë**  
A) mbivlerësim i kulturës së popujve të tjerë.  
B) gjykime të paanshme të vlerave të një kulture.  
C) vlerësim i një kulture nga kriteret e vetë asaj kulture.  
D) vlerësim i një kulture nga kriteret e një kulture tjetër.
2. Veshjet tradicionale shqiptare të grave, përmes elementëve si ngjyrat dhe modeli i prerjes, shprehin moshën dhe statusin social të tyre.  
Kjo dukuri lidhet **më shumë** me: **1 pikë**  
A) normat kulturore.  
B) simbolet kulturore.  
C) difuzionin kulturor.  
D) relativizmin kulturor.
3. Në studimet sociologjike devianca përcaktohet si: **1 pikë**  
A) reagim i pavetëdijshëm ndaj një kulture.  
B) shkelje e normave kulturore të shoqërisë.  
C) respektim i rregullave të moralit tradicional.  
D) përfshirje në veprimtari të pranuar nga ligji.
4. Emigrantët në vendet pritëse përgjithësisht ndryshojnë mënyrën e jetesës, gjuhën, fenë, veshjen, sjelljen etj., për t'u përshtatur më mirë me kulturën sunduese. Në sociologji ky proces quhet: **1 pikë**  
A) veçim shoqëror.  
B) asimilim kulturor.  
C) pluralizëm kulturor.  
D) diskriminim institucional.
5. Laiciteti është procesi i: **1 pikë**  
A) kundërvënies ndaj besimeve fetare.  
B) restaurimit të elementeve themelore të fesë.  
C) përhapjes së feve nga një shoqëri në tjetrën.  
D) ndarjes së institucioneve shtetërore nga feja.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

6. Dukuria e lëvizshmërisë shoqërore në vendet e zhvilluara lidhet me: **1 pikë**  
A) shtresimin e shoqërisë për disa breza me radhë.  
B) kalimin e njerëzve nga njëra klasë shoqërore tek tjetra.  
C) kalimin e pozitës shoqërore të familjes nga brezi në brez.  
D) përcaktimin e pozitës së individit, pavarësisht vullnetit të tij.
7. Shoqëria tradicionale bazohej **më shumë** në: **1 pikë**  
A) respektimin e vlerave kulturore ekzistuese.  
B) zhvillimin e shkencës dhe shpikjeve teknike.  
C) zgjerimin e mundësive për zgjedhje vetjake.  
D) pasurimin e spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore.
8. Në cilën shoqëri njerëzit janë më të vetëdijshëm për vlerën e kohës? **1 pikë**  
A) Në shoqërinë moderne.  
B) Në shoqërinë patriarkale.  
C) Në shoqërinë tradicionale.  
D) Në shoqërinë pasmoderne.
9. Gjatë viteve '80-të të shekullit të kaluar, për shumë vite me radhë, një sociolog jetoi në një krahinë malore të Shqipërisë, për të studiuar nga afër zakonet dhe mendësitë familjare të tyre. Studimi i sociologut lidhet me metodën e: **1 pikë**  
A) intervistës së lirë.  
B) vëzhgimit pjesëmarrës.  
C) eksperimentit sociologjik.  
D) studimit të dokumenteve.
10. Të rinjtë e Tiranës do të bëheshin pjesë e një studimi, lidhur me ndikimin e televizionit në modelimin e tyre psikokulturor. U përzgjedhën 1000 të rinj sipas grupmoshës, nivelit arsimor, profesionit, etj., që do të përfaqësonin këtë grup shoqëror. Kjo metodë studimi është: **1 pikë**  
A) intervistë e lirë.  
B) vëzhgim sistematik.  
C) kampionim rastësor.  
D) kampionim me kuota.
11. Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj jetësore përmes normave kulturore dhe normave ligjore. Tregoni dy dallime mes tyre. **2 pikë**

12. Pas mësimit në lëndë të ndryshme, nxënësit mezi prisnin orën e fizkulturës, ku organizonin lojëra në grup, që shpesh formoheshin nga djem dhe vajza së bashku. Çdo skuadër duhej të respektonte rregullat e lojës, të cilat ktheheshin në një garë të vërtetë. Duke u mbështetur në tekstin e mësipërm, tregoni tri funksione të shkollës si faktor i rëndësishëm i shoqërizimit. **3 pikë**
13. Të gjithë mbajtën qëndrim ndaj sjelljes së Besartit në mbrëmjen e maturës. Ai e kishte tepruar me alkoolin dhe kjo bëri të mos i kontrollonte veprimet. Shokët ishin të të njëjtit mendim, se ai “e kishte kaluar masën”. Bazuar në situatën e mësipërme, shpjegoni funksionet e mëposhtme të deviancës në: **2 pikë**
- a) përcaktimin e kufijve moralë  
b) forcimin e unitetit shoqëror
14. Prirja e rritjes së numrit të divorceve në shkallë botërore në ditët e sotme përcaktohet nga një varg faktorësh të ndryshëm. Identifikoni tri prej tyre. **3 pikë**
15. Marrëdhëniet mes grupeve me përkatësi të ndryshme racore, etnike, kombëtare etj., shpesh janë të ndërlikuara. Një formë e përhapur e mendësive përçmuese ndaj tyre janë paragjykimet. Përshkruani format e mëposhtme të shfaqjes së tyre në shoqëri. **2 pikë**
- a) Stereotipat  
b) Racizmi
16. Feja ka luajtur një varg funksionesh të rëndësishme gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Shpjegoni tri funksionet e mëposhtme. **3 pikë**
- a) Përcaktimi i kuptimit të jetës  
b) Forcimi i unitetit shoqëror  
c) Kontrolli shoqëror
17. Sociologët mendojnë se në ekonomitë industriale shumë të zhvilluara, puna ka disa karakteristika kryesore. Shpjegoni tri të mëposhtmet. **3 pikë**
- a) Papunësia  
b) Ekonomia e paligjshme  
c) Rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardha”
18. Lëvizja feministe është një lëvizje përparimtare, e cila ka si qëllim reformimin e anëve të caktuara të shoqërisë, që lidhen me të drejtat e gruas. Identifikoni dy prej objektivave të kësaj lëvizjeje. **2 pikë**

**Filozofi**

19. Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të filozofisë parasokratike greke ishte Herakliti, i cili mendonte se në themel të çdo gjëje qëndronte: **1 pikë**
- A) zjarri si logosi universal.
  - B) atomet si grimca të pandashme.
  - C) uji si substancë që transformohet.
  - D) numrat si rregull i strukturës kozmike.
20. Dialektika sokratike bazohet në **1 pikë**
- A) të vërtetat e gjithë pranuar.
  - B) dialogun mes të kundërtave.
  - C) bindjen ndaj autoritetit të dijes.
  - D) pranimin e çdo opinionit të dhënë.
21. Platoni arsyetonte se në "Botën e ideve" ndodhen: **1 pikë**
- A) sendet dhe objektet reale.
  - B) idetë e krijuara nga përvoja.
  - C) format e përsosura të sendeve.
  - D) kopjet iluzore të formave ideale.
22. Në etikën stoike romake gjendja ideale, që siguron një jetë të virtytshme tek njeriu, lidhet me: **1 pikë**
- A) mungesën e dijes dhe urtësisë.
  - B) gjykimet e bazuara në pasione.
  - C) ekuilibrin dhe mungesën e pasioneve.
  - D) lirinë e shpirtit dhe dëshirat e njeriut.
23. Çfarë vendos Plotini në krye të modelit të tij hierarkik të ndërtimit të botës? **1 pikë**
- A) Shpirtin botëror.
  - B) Materien lëndore.
  - C) Njëshin ose Zotin.
  - D) Intelektin universal.
24. Rilindja ishte kthesë historike, efektet e së cilës u ndjenë në të gjitha fushat e krijimtarisë njerëzore. Ajo vuri në qendër të filozofisë së saj: **1 pikë**
- A) pushtetin e Zotit dhe shenjtoreve.
  - B) teorinë dogmatike të fesë.
  - C) autoritetin e kishës dhe adhurimin ndaj Zotit.
  - D) autoritetin e njeriut dhe besimin në arsyen e tij.

25. Empirizmi është rryma filozofike që pranon se: **1 pikë**  
A) dija vjen nga arsyetimi deduktiv.  
B) arsyeja integrohet me dijen shkencore.  
C) njohja arrihet përmes përvojës shqisore.  
D) logjika matematike përfton dijen e vërtetë.
26. Në filozofinë iluministe të Volterit, një vend të veçantë zë trajtimi i historisë. Sipas tij, historia është produkt i: **1 pikë**  
A) historianëve dhe opinioneve të tyre.  
B) popujve të zgjedhur dhe të civilizuar.  
C) sundimit dhe mrekullive të mbretërve.  
D) njerëzve dhe veprimeve të tyre shoqërore.
27. Sipas Kantit aftësitë njohëse të njeriut janë të kufizuara, ndërsa njohja e vërtetë realizohet vetëm përmes: **1 pikë**  
A) arsyetimit logjik.  
B) arsyes së kulluar.  
C) përvojës njerëzore.  
D) vëzhgimit të shqisave.
28. Mbështetur në filozofinë pragmatiste të Djuitt, në cilin rast edukimi në shkollë realizohet me sukses? **1 pikë**  
A) Kur ai mbështetet në parime teorike.  
B) Nëse është konkret dhe i lidhur me praktikën.  
C) Në rast se ai riprodhon informacionet e mëparshme.  
D) Vetëm nëse është autoritarist në metodat e mësimdhënies.
29. Është e veçantë thënia filozofike e Sokratit: **“Njeri njih vetveten!”** Bazuar në këtë shprehje, analizoni arsyetimin e tij lidhur me: **2 pikë**  
 njohjen e vetvetes  
 rrugën që të çon drejt lumturisë
30. Në moralin epikurian pohohet se: **“Qëllimi i jetës për çdo individ është arritja e lumturisë.”** Identifikoni tri nga rrugët drejt përmbushjes së saj, sipas kësaj filozofie. **3 pikë**
31. Shpjegoni tri provat e mëposhtme, që Shën Akuini jep për të vërtetuar ekzistencën e Zotit. **3 pikë**  
 Burimi i lëvizjes  
 Shkaku dhe pasoja  
 Rregulli universal



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

32. Shpjegoni thelbin e metodës së dyshimit të Dekartit, të shprehur në thënien e tij: **“Mendoj pra ekzistoj”**, duke veçuar dy momente të saj **2 pikë**
- momenti i dyshimit
  - momenti i sigurisë
33. Rusoi hodhi idenë e lindjes së shtetit si “një kontratë shoqërore qeverisjeje”. Identifikoni tre nga faktorët kryesorë që, sipas tij, e kushtëzuan atë. **3 pikë**
34. Niçe pohon se: **“Njeriu duhet të tejkalojë vetveten dhe objektivi është mbinjeriu, për të cilin asgjë nuk është e ndaluar, përveç asaj që pengon vullnetin e tij për pushtet”**. Shpjegoni dy çështjet e mëposhtme të kësaj filozofie. **2 pikë**
- Mbinjeriu
  - Vullneti për pushtet
35. Sartri si përfaqësues i ekzistencializmit shprehet: **“Njeriu është i dënuar të jetë i lirë, sepse pasi erdhi në këtë botë, ai është përgjegjës për gjithçka që bën”**. Analizoni lirinë duke përfshirë tri aspekte kryesore të saj, sipas Sartrit. **3 pikë**
36. Karl Marksi ka thënë se: **“Feja është opium për popullin”**. Identifikoni dy aspekte të filozofisë ateiste të tij. **2 pikë**

**Filozofi-Sociologji - Seshoni II**

**Sociologji**

1. Cili nga pohimet shpreh sjelljen ksenocentriste të një populli? **1 pikë**  
A) Nënvlërësimi i modeleve kulturore të ndryshme nga ne.  
B) Vlerësimi dhe gjykimi i një kulture nga kriteret e një kulture tjetër.  
C) Mbivlerësimi i kulturave të popujve të tjerë dhe nënvlerësimi i kulturës vetjake.  
D) Vlerësimi i një kulture, mbështetur në kriteret e saj dhe jo të ndonjë kulture tjetër.
2. Normat kulturore që mbështeten përgjithësisht edhe nga normat ligjore janë: **1 pikë**  
A) moret,  
B) tabutë,  
C) folkuejt,  
D) udhëzueset.
3. Kuptimi relativ i deviancës, nënkupton që një veprim konsiderohet si deviant ose jo nga shoqëria, në varësi të: **1 pikë**  
A) formimit psiko-social të individit.  
B) njohurive të individit mbi ligjin.  
C) vlerave dhe normave kulturore.  
D) profesionit aktual të vepruesit.
4. Diskriminimi pozitiv përcaktohet si: **1 pikë**  
A) keqtrajtim i kategorive shoqërore në nevojë.  
B) trajtim i pabarabartë mes anëtarëve të shoqërisë.  
C) pengim në zhvillimin e karrierës profesionale të individëve në shoqëri.  
D) përkrahje në forma të ndryshme e grupimeve të caktuara të popullsisë.
5. Laiciteti i një shteti karakterizohet nga: **1 pikë**  
A) ndarja e shtetit nga feja.  
B) rigjallërimi i besimeve fetare.  
C) bashkekzistenca e feve në shoqëri.  
D) restaurimi i elementeve themelore të fesë.
6. Është karakteristikë e dukurisë së eksurbanizimit: **1 pikë**  
A) rigjallërimi i zonave të ndryshme brenda qytetit.  
B) lëvizja e pakontrolluar e banorëve nga një qytet në tjetrin.  
C) popullimi nga familjet e pasura i zonave jashtë vijës së qytetit.  
D) restaurimi i ndërtesave të vjetra dhe rigjallërimi i qendrës së qytetit.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

7. Cili nga momentet e mëposhtme historike na ndihmon për të diferencuar shoqërinë postmoderne nga shoqëria moderne? **1 pikë**
- A) Revolucioni popullor.
  - B) Revolucioni bujqësor.
  - C) Revolucioni industrial.
  - D) Revolucioni i informacionit.
8. Në cilën shoqëri njerëzit vetëdijesohen për vlerën e kohës duke matur çdo minutë dhe sekondë që kalon? **1 pikë**
- A) Në shoqërinë pa klasa.
  - B) Në shoqërinë moderne.
  - C) Në shoqërinë me klasa.
  - D) Në shoqërinë tradicionale.
9. Studimi i dukurisë të cilën sociologu e kryen me anë të kamerave të fshehta, konsiderohet si metoda e: **1 pikë**
- A) sondazhit.
  - B) vëzhgimit pjesëmarrës.
  - C) kampionimit rastësor.
  - D) eksperimentit.
10. Cila nga metodat e mëposhtme sociologjike na siguron shumë informacion dhe për një kohë të shkurtër? **1 pikë**
- A) Anketa.
  - B) Intervista.
  - C) Vëzhgimi.
  - D) Korrelacioni.
11. Analizoni ndikimin që ka: **2 pikë**
- a) kultura tek shoqëria
  - b) shoqëria tek kultura
12. Shpjegoni tri veçoritë e mëposhtme të ndikimit të familjes në procesin e shoqërizimit të fëmijëve, si përcaktuese e: **3 pikë**
- a) vlerave dhe normave kulturore
  - b) përkatësisë gjinore
  - c) statusit shoqëror

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

13. Përcaktoni tipin e krimit në shembujt e mëposhtëm. **2 pikë**  
a) Dhuna dhe kërcënimi për dhunë.  
b) Vjedhja dhe shkatërrimi i pasurisë që i përket tjetrit.
14. Cili është kuptimi sociologjik i formave të mëposhtme të martesave? **3 pikë**  
a) Poligame  
b) Monogame  
c) Ekzogame
15. Përshkruani dy format e shfaqjes së paragjytimeve në shoqëri. **2 pikë**  
a) Stereotipat  
b) Racizmi
16. Listoni tri tipa të organizatave fetare. **3 pikë**
17. Analizoni karakteristikat e mëposhtme të punës, në shoqëritë e industrializuara. **2 pikë**  
a) Pakësimi i punës së gjallë në bujqësi  
b) Rritja e numrit të punëtorëve "jakëbardhë"
18. Përcaktoni tri fazat e para nëpër të cilat kalon çdo lëvizje shoqërore. **3 pikë**

**Lëvizja shoqërore**



**Filozofi**

19. Mendimi filozofik në Greqinë e lashtë lindi si një: **1 pikë**  
A) shkencë e zakonshme.  
B) shpjegim mitologjik i botës.  
C) interpretim fetar i dukurive të ndryshme.  
D) nevojë e shpirtit njerëzor drejt së vërtetës.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

20. Cili ishte objektivi i kërkimit filozofik të lëvizjes sofiste? **1 pikë**
- A) Zoti  
B) Njeriu  
C) Natyra  
D) Universi
21. Sipas filozofit Pitagora, elementi bazë, fillesë e gjithçkaje që ekziston është: **1 pikë**
- A) uji,  
B) numri,  
C) atomi,  
D) apejroni.
22. Logjika dhe teoria e njohjes në shkollën e Epikurit bazohet tek: **1 pikë**
- A) reminishenca e dijeve.  
B) format ideale të lindura.  
C) ndijimet dhe perceptimet.  
D) racionalizmi dhe deduksioni.
23. Sipas skepticizmit të periudhës romake, ataraksia mund të arrihet duke: **1 pikë**
- A) mbajtur qëndrim dyshues mbi të mirën dhe të keqen.  
B) pranuar se rregulli vendoset nga një mendje universale.  
C) synuar mesin e artë në raport me pasionet dhe kënaqësitë.  
D) eliminuar frikën ndaj perëndive, fataliteteve dhe ndaj vdekjes.
24. Racionalizmi është rryma filozofike që pranon se dija vjen nga: **1 pikë**
- A) arsyeja.  
B) përvoja.  
C) eksperimenti.  
D) rendi teologjik.
25. Mendimi i Xhon Lokut se: “Mendja njerëzore është një **Tabula Rasa.**”, plotëson teorinë e tij të njohjes duke theksuar që: **1 pikë**
- A) idetë e njeriut vijnë nga bota platonike e ideve.  
B) Zoti është burimi i vetëm i të vërtetave absolute.  
C) mendja njerëzore lind bashkë me idetë universale.  
D) idetë fitohen nga procesi i njohjes përmes përvojës.

26. Cili nga filozofët e mëposhtëm mendonte se: **“Zoti është shkaku i të gjitha gjërave”**? **1 pikë**  
A) Lok  
B) Spinoza  
C) Hobs  
D) Hjum
27. Procesin dialektik të zhvillimit të idesë, Hegeli e paraqiti në formën e: **1 pikë**  
A) triadës,  
B) ataraksisë,  
C) silogjizmit,  
D) reminishencës.
28. Dobia si parim i sjelljes dhe burim i lumturisë është në themel të filozofisë:  
A) stoike, **1 pikë**  
B) iluministe,  
C) utilitariste,  
D) racionaliste.
29. Shpjegoni vlerësimin e Protagorës për rregullat morale dhe etike në shoqëri duke u nisur nga shprehja: **“Njeriu, masë e të gjitha gjërave.”** **2 pikë**
30. Plotini pohon se: **“Njëshi është uniteti absolut”**. Tregoni dy tipare të tij. **2 pikë**
31. Listoni katër prova të ekzistencës së Zotit sipas Thoma Akunit. **4 pikë**
32. Evidentoni dy elemente të modelit liberal të shtetit, sipas Xhon Lokut. **2 pikë**
33. Listoni tri tipa të organizimit shtetëror, sipas Monteskjës. **3 pikë**
34. Shpjegoni dy llojet e njohjes sipas Henri Bergsonit duke përcaktuar metodën që përdor secila prej tyre. **2 pikë**  
Njohja relative  
Njohja absolute
35. Përshkruaj fazat e zhvillimit shoqëror sipas Ogyst Kontit. **3 pikë**  
a) Etapa teologjike  
b) Etapa abstrakte / metafizike  
c) Etapa pozitiviste
36. F. Niçe u përpoq të sjellë një kuptim të ri për botën prandaj edhe është cilësuar si filozofi nihilist. Analizoni nihilizmin e tij duke evidentuar dy aspekte. **2 pikë**

## FIZIKË

Fizika është një nga lëndët me të rëndësishme të fushës së shkencave natyrore, me një konceptim të thellë shkencor, që përmes veprimtarive praktike dhe arsyetimeve logjike u mundëson nxënësve studimin sistematik të strukturës së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Mësimi i lëndës së fizikës zbulon lidhjen reciproke ndërmjet dukurive dhe ligjeve të saj, si dhe i aftëson nxënësit për t'i zbatuar ato në situata të jetës së përditshme.

Kurrikula e lëndës së fizikës ndihmon në zhvillimin e kompetencave, që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon kjo lëndë në të gjitha shkallët e kurrikulës kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Mësimi i lëndës së fizikës lidhet ngushtë me teknologjinë dhe integrimi ndërmjet tyre i formon nxënësit në një kontekst më të gjerë shkencor.

Programi orientues i lëndës së fizikës për provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së fizikës bërthamë, klasa 10, 11 dhe fizikës me zgjedhje, klasa e 12-të. Ky program i ndihmon nxënësit në përgatitjen e tyre për provimin me zgjedhje në Maturën Shtetërore. Ai synon përgatitjen e tyre për të vazhduar studimet në degët e Fakultetit të Shkencave Natyrore, Inxhinierike dhe Mjekësore.

Gjatë përgatitjes për provimin me zgjedhje bazuar në këtë program duhet të synojmë tek nxënësi:

- Aftësitë për të zgjidhur ushtrimet e të gjitha niveleve;
- Aftësitë e të menduarit kritik;
- Aftësitë për të përdorur njohuritë fizike në situata të jetës reale;
- Aftësitë për të argumentuar, gjykuar dhe vërtetuar ligjet e fizikës.

Programi orientues për përgatitjen e provimit me zgjedhje të lëndës së fizikës në Maturën Shtetërore është mbështetur në:

- programet e lëndës së fizikës bërthamë për klasat 10-11;
- programin e lëndës së fizikës me zgjedhje për klasën e 12-të;
- udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së gjimnazit;
- nivelet e arritjes së kompetencave për lëndën e fizikës për klasat 10-12;

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban strukturën e testit në të cilën jepen kompetencat e fushës së shkencave të natyrës/lënda fizikë, tematikat si dhe peshën e secilës tematikë; rubrikën “Llojet e pyetjeve/ kërkesave/ ushtrimeve” që vlerëson në mënyrë efektive kompetencat që duhet të zotërojë nxënësi në këtë lëndë. Gjithashtu programi përmban edhe rubrikën e rezultateve të të nxënit ku

**MATURA SHTETËRORE 2019**

përcaktohen konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës së fizikës që zhvillohet për klasat (10-12).

**Kompetencat e fushës së Fizikes**

Nëpërmjet testit të lëndës së fizikës në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave të kësaj lënde sipas peshave të përcaktuara për secilën kompetencë të fushës, të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

<b>Kompetencat e lëndës së fizikës</b>	<b>Përshkrimi i kompetencave të lëndës së fizikës</b>	<b>Pesha %</b>
<b>Identifikimi dhe zgjidhja e problemave në fizikë</b>	<p>Nxënësi identifikon konceptet dhe zbaton ligjet e fizikës, argumenton zgjidhjen dhe planifikon procedurën për zgjidhjen e ushtrimeve:</p> <p>Treguesit kryesorë të kompetencës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ shkruan të dhënat e ushtrimeve duke përdorur simbolet dhe njësitë përkatëse të madhësive fizike skalare dhe vektoriale;</li> <li>➤ përdor saktë formulat për zgjidhjen e ushtrimeve;</li> <li>➤ njehson madhësitë fizike, duke përdorur formulat matematikore që shprehin ligjet e fizikës;</li> </ul>	40%
<b>Përdorimi i njohurive shkencore dhe teknologjik e në fizikë</b>	<p>Nxënësi ilustron dukuritë dhe ligjet e fizikës nëpërmjet diagramave skematike, grafikëve, duke shpjeguar lidhjen ndërmjet madhësive që shprehin këto ligje.</p> <p>Treguesit kryesorë të kompetencës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ ndërton diagramet për konkretizimin e parimeve, dukurive dhe ligjeve të fizikës;</li> <li>➤ ndërton grafikët e varësisë së dy madhësive fizike, duke u mbështetur në formulat matematikore, që shprehin ligjet e fizikës;</li> <li>➤ ndërton grafikun e dy madhësive fizike, duke u mbështetur nga një grafik i dhënë dhe formula që shpreh lidhjen ndërmjet tyre;</li> <li>➤ përcakton vlerat e madhësive fizike, duke u nisur nga grafiku;</li> <li>➤ analizon variablat në grafikët që shprehin ligjet e fizikës;</li> <li>➤ konverton në SI njësitë matëse të madhësive fizike para kryerjes së veprimeve;</li> <li>➤ përdor saktë njësitë matëse të madhësive fizike gjatë zgjidhjes së ushtrimeve.</li> </ul>	40%



## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

<b>Komunikimi duke përdorur gjuhën dhe terminologji në shkencore të lëndës</b>	<p>Nxënësi argumenton rezultatet e ushtrimeve, që lidhen me dukuritë dhe ligjet e fizikës, duke përdorur terminologjinë shkencore të lëndës.</p> <p>Treguesit kryesorë të kompetencës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ interpreton saktë konceptet, parimet dhe ligjet e fizikës, duke u bazuar në formulat matematikore që shprehin ato;</li> <li>➤ bën interpretimin fizik të ligjeve të fizikës, duke përdorur një terminologji të saktë shkencore për të shpjeguar rezultatet e dala;</li> <li>➤ interpreton me gjuhën e duhur shkencore madhësitë fizike të paraqitura në tabela, diagrama dhe grafikë.</li> </ul>	20%
--	---	-----

Realizimi i kompetencave gjatë gjithë zhvillimit të lëndës së fizikës ndihmon nxënësin:

- të zotërojë konceptet, dukuritë dhe ligjet e fizikës dhe t'i përdorë ato për të shpjeguar situatat e dhëna në ushtrimet përmes kërkesave të testit;
- të zbatojë ligjet e fizikës, të nxjerrë përfundime dhe t'i interpretojë ato;
- të bëjë lidhjen ndërmjet koncepteve dhe proceseve për të shpjeguar natyrën dinamike të lëndës.

### Struktura e testit

Testi i Fizikës ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 10 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

Hartimi i testit të fizikës bazohet te bazat metodologjike të hartimit të testeve. Veçoria e testeve të fizikës buron nga natyra e kompetencave me të cilat pajisen nxënësit gjatë nxënies së kësaj lënde. Pjesa më e rëndësishme e fazave/hapave, nëpër të cilat kalon hartimi i testit të vlerësimit lidhet me strukturën e tij, e cila ndërtohet duke u bazuar në këto faza:

- Përcaktimi i tematikave që do testohen;
- Përcaktimi i temave kryesore që përmban secila tematikë;
- Përcaktimi i koncepteve kyçe sipas temave përkatëse;
- Përcaktimi i peshave në përqindje të çdo tematike;

**MATURA SHTETËRORE 2019**

- Përcaktimi i rezultateve të të nxënësve që do të testohen;
- Grupimi i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjeve;
- Ndërtimi i tabelës së specifikimit (Tabela e Blu-Printit);
- Hartimi i skemës së vlerësimit.

Bazuar në kurrikulën e re, përmbushja e kompetencave të lëndës së fizikës, që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të kësaj lënde, arrihet nëpërmjet tematikave kryesore mbi bazën e të cilave janë hartuar programet e kësaj lënde: ndërveprimet, energjia, modelet, shkallëzimi dhe matja. Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të vlera. Për secilën tematikë është paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale të lëndës për zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve, që duhet të demonstrojë nxënësi në përmbushjen e kompetencave të lëndës së fizikës. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Ato janë bazuar në përmbajtjen e temave kryesore të përzgjedhura si më të rëndësishme për nxënësit nga programi “Fizikë bërthamë”, klasa 10-11 dhe “Fizikë me zgjedhje”, klasa e 12-të.

**Tabela e specifikimit**

<b>Nivelet e arritjes së kompetencave dhe peshat në përqindje (%) të pyetjeve për secilin nivel</b>	<b>Treguesit e përmbushjes së kompetencave nga nxënësit për secilin nivel:</b>
Niveli bazë i arritjes së kompetencave 40%	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ identifikon konceptet dhe dukuritë dhe ligjet e fizikës;</li> <li>➤ përshkruan lidhjen ndërmjet dy ose më shumë proceseve, duke njohur karakteristikat kryesore të tyre.</li> </ul>
Niveli mesatar i arritjes së kompetencave 40%	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ përdor konceptet dhe ligjet e fizikës, si dhe i shpjegon ato;</li> <li>➤ përdor informacionin shkencor jo vetëm duke i zbatuar ligjet, por edhe duke bërë interpretimin e tyre.</li> </ul>
Niveli i lartë i arritjes së kompetencave 20%	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ analizon dhe sintetizon informacionin e dhënë nëpërmjet kërkesave, duke përfutur pyetje që do t'i shërbejnë realizimit të zgjidhjes së kërkesës.</li> <li>➤ realizon lidhjet ndërmjet koncepteve dhe proceseve për të shpjeguar natyrën dinamike të lëndës.</li> </ul>

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

Nr	Tematikat	Pesha	Ushtrime me zhvillim		Ushtrime me alternativa	
			Nr. i usht. me zhvillim	Nr. i pikëve	Nr. i usht me alternativa	Nr. i pikëve
1	Kinematika Llojet e lëvizjes	12%	1	4	3	3
2	Dinamika Ligjet e Njutonit Ligji i ruajtjes së impulsit	15%	2	7	2	2
3	Puna dhe energjia. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike.	10%	1	4	2	2
4	Termodinamika Ekuacioni i përgjithshëm i gjendjes së gazit ideal.	8%	1	3	2	2
5	Elektrostatika. Bashkëveprimi elektrostatik. Fusha elektrike.	10%	1	4	2	2
6	Rryma e vazhduar. Ligji i Omit për një pjesë të qarkut dhe qarkun e plotë.	13%	1	6	2	2
7	Magnetizmi. Forca e Amperit. Forca e Lorencit. Ligi I induksionit elektromagnetik.	10%	1	4	2	2
8	Lëkundjet dhe valët. Optika valore	12%	1	4	3	3
9	Fizika kuantike . Teoria e Ajnshtajnit për fotoefektin. Vala e De Brojlit	4%	-	-	2	2
10	Optika gjeometrike. Thjerat, formimi I shëmbëllimit	6%	1	4	-	-
<b>Totali</b>		100%	10	<b>40</b>	20	<b>20</b>

**MATURA SHTETËRORE 2019**

Nr	Linja	Pesha	Pikë Niveli I	Pikë Niveli II	Pikë Niveli III	Totali
1	Kinematika Llojet e lëvizjes	12%	2.	3	2	7
2	Dinamika Ligjet e Njutonit Ligji i ruajtjes së impulsit.	15%	3	4	2	9
3	Puna dhe energjia. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike.	10%	2	4	-	6
4	Termodinamika Ekuacioni i përgjithshëm i gjendjes së gazit ideal.	8%	3	2	-	5
5	Elektrostatika. Bashkëveprimi elektrostatik. Fusha elektrike.	10%	2	2	2	6
6	Rryma e vazhduar. Ligji i Omit për një pjesë të qarkut dhe qarkun e plotë.	13%	3	3	2	8
7	Magnetizmi. Forca e Amperit. Forca e Lorencit. Ligi I induksionit elektromagnetik.	10%	2	2	2	6
8	Lëkundjet dhe valët. Optika valore	12%	3	3	1	7
9	Fizika kuantike dhe bërthamore	4%	2	-	-	2
10	Optika gjeometrike. Thjerat, formimi i shëmbëllimit	6%	2	1	1	4

**Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënimit dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.


Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një skemë, figurë apo grafik. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

TESTE

Fizikë - Sesion I

1. Një nxënës lëviz drejt lindjes duke kryer zhvendosjen  $S_1 = 3\text{m}$  dhe më pas lëviz në drejtim të jugut duke kryer zhvendosjen  $S_2 = 4\text{m}$ . Zhvendosja rezultante që kryhen nxënësi do të jetë: **1 pikë**
- A) 3 m  
 B) 4 m  
 C) 5 m  
 D) 7 m


2. Në figurë janë paraqitur lëvizjet e dy trupave A dhe B. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?



- A) Trupi A kryhen lëvizje drejtvizore të njëtrajtëshme.  
 B) Trupi B qëndron në prehje.  
 C) Të dy trupat lëvizin pa nxitim.  
 D) Të dy trupat lëvizin me nxitim.

**1 pikë**

3. Në figurë paraqitet grafiku i varësisë së shpejtësisë nga koha për një trup. Zhvendosja që kryhen trupi gjatë kohës  $t = 6\text{s}$  është:



- A) 72m  
 B) 48m  
 C) 24m  
 D) 12m

**1 pikë**

4. Një disk rrotullohet rreth një boshti që kalon nga qendra e tij. Dy trupa A dhe B, ndodhen mbi disk, në largësi të ndryshme nga boshti i rrotullimit.

- Cili nga pohimet është i saktë për të dy trupat?
- A) Ata rrotullohen me shpejtësi këndore të ndryshme.  
 B) Ata rrotullohen me frekuenca të ndryshme.  
 C) Ata rrotullohen me nxitime qëndërsynues të ndryshëm  
 D) Ata rrotullohen me nxitime qëndërsynues, të njëjtë

**1 pikë**

MATURA SHKETËRORE 2019

5. Dy sfera A dhe B, bien njëkohësisht nga lartësi të ndryshme. Sfera A bie nga lartësia  $H = 12\text{m}$ , sfera B bie nga lartësia  $h = 5\text{m}$ . ( $g = 10\text{m/s}^2$ )
- a) Sa duhet të jetë shpejtësia fillestare e sferës A, që të dyja sferat të prekin tokën njëkohësisht, nëse sfera B nisët nga prehja? **2 pikë**
- b) Sa janë shpejtësitë e sferave A dhe B, në çastin kur ato prekin tokën? **2 pikë**


6. Një nxënës me masë  $60\text{kg}$  qëndron mbi një peshore në ashensor. Ashensori lëviz poshtë me shpejtësi konstante, ( $g=10\text{m/s}^2$ ). Pesha e nxënësit do të jetë:
- A)  $30\text{N}$ . **1 pikë**  
B)  $60\text{N}$ .  
C)  $300\text{N}$   
D)  $600\text{N}$

7. Trupi nën veprimin e forcës  $40\text{N}$  kryhen lëvizje drejtvizore të njëtrajtshme. Sa është vlera e forcës së fërkimit?
- A)  $0\text{N}$   
B)  $20\text{N}$   
C)  $30\text{N}$   
D)  $40\text{N}$



8. Një sustë mbi të cilën ushtrohet një forcë  $15\text{N}$  zgjatet me  $3\text{cm}$ . Sa do të zgjatet kjo sustë nëse mbi të ushtrohet forca  $30\text{N}$ ? **1 pikë**
- A)  $2\text{cm}$   
B)  $3\text{cm}$   
C)  $4\text{cm}$   
D)  $6\text{cm}$


9. Mbi trupin me masë  $2\text{kg}$ , të vendosur në fundin e një rrafshi të pjerrët, me kënd pjerrësie  $57^\circ$ , vepron forca  $26\text{N}$ , sipas drejtimit të rrafshit. Njehsoni vlerën e nxitimit me të cilin ngjitet trupi, nëse koeficienti i fërkimit ndërmjet trupit dhe rrafshit është  $0.5$ . ( $g = 10\text{m/s}^2$ ,  $\sin 57^\circ = 0.8$ ,  $\cos 57^\circ = 0.6$ ). **4 pikë**




TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

10. Në figurë paraqitet grafiku i varësisë së forcës që vepron mbi një trup në lidhje me koordinatën. Puna që kryen forca, gjatë zhvendosjes 20m është: **1 pikë**

- A) 200J
- B) 400J
- C) 600J
- D) 800J




11. Një top bilardo me masë 500g, lëviz me shpejtësi 4m/s. Ai godet një top tjetër bilardoje, që është në prehje. Mbas goditjes, topi i parë vazhdon lëvizjen, me shpejtësi 2m/s, sipas drejtimit të mëparshëm. Tregoni nëse goditja është ose jo elastike. **3 pikë**



12. Sfera me masë 200g, është varur në skajin e një fijeje me gjatësi 40cm. Skaji tjetër i fijes është fiksuar në një mbajtëse horizontale, si në figurë. E largojmë sferën nga pozicioni vertikal deri sa drejtimi i ri të formojë me drejtimin vertikal këndin  $60^\circ$ . Më pas e lëmë sferën të lirë.

- a) Bazuar në ligjin e ruajtjes së energjisë, njehsoni shpejtësinë e sferës kur ajo kalon nëpër pozicionin e ekuilibrit. ( $f=0$ ) **2 pikë**
- b) Njehsoni tensionin e fijes, në këtë pozicion. **2 pikë**




13. Gjatë një procesi izobarik, një gaz ideal, e rrit vëllimin dy herë. Shtypja e gazit gjatë këtij procesi: **1 pikë**

- A) rritet katër herë
- B) rritet dy herë
- C) zvogëlohet dy herë
- D) nuk ndryshon

14. Gazi ideal, kalon nëpër gjendjet a, b, c, sipas diagramës së paraqitur. Puna e përgjithshme që kryhen gazi do të jetë: **1 pikë**

- A)  $2pV$
- B)  $4pV$
- C)  $6pV$
- D)  $8pV$




15. Në një enë ka oksigjen. Në një enë të dytë me vëllim dy herë më të madh se ena e parë, ka hidrogjen. Masa dhe temperatura e gazeve në të dyja enët është e njëjtë. Cili nga gazet ushtron shtypje më të madhe dhe sa më të madhe? ( $M_O = 32 \cdot 10^{-3} \text{kg/mol}$ ,  $M_H = 2 \cdot 10^{-3} \text{kg/mol}$ ) **3 pikë**

16. Dy trupa të ngarkuar tërheqin njeri tjetrin me një forcë  $F$ . Nëqoftëse largësia ndërmjet ngarkesave do të rritet dy herë, atëherë forca tërheqëse ndërmjet tyre do të bëhet: **1 pikë**

- A)  $2F$
- B)  $4F$
- C)  $F/2$
- D)  $F/4$


17. Tre kondensatorë janë lidhur si në skemën e dhënë. Nëse secili kondensator e ka kapacitetin  $30 \mu\text{F}$ , kapaciteti ekuivalent i skemës do të jetë: **1 pikë**

- A)  $10 \mu\text{F}$
- B)  $20 \mu\text{F}$
- C)  $40 \mu\text{F}$
- D)  $90 \mu\text{F}$



18. Elektroni ndodhet në pllakën negative të një kondensatori të rrafshët. Largësia midis pllakave është  $2 \text{cm}$  dhe diferenca e potencialit ndërmjet pllakave është  $400 \text{V}$ . ( $m_e = 9 \cdot 10^{-31} \text{kg}$ ,  $e = 1.6 \cdot 10^{-19} \text{C}$ .) Njehsoni:

- a) intensitetin e fushës elektrike.
- b) punën e forcave të fushës elektrike gjatë zhvendosjes së elektronit nga pllaka negative, drejt pllakës pozitive.
- c) nxitimin e lëvizjes së elektronit.



**1 pikë**




**1 pikë**

**2 pikë**

19. Në qarkun e figurës rezistencat kanë të njëjtën vlerë  $2 \Omega$ . Rezistenca e ekuivalente e qarkut do të jetë: **1 pikë**

- A)  $2 \Omega$
- B)  $3 \Omega$
- C)  $4 \Omega$
- D)  $6 \Omega$






TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI


20. Në qarkun e dhënë, voltmetri  $V_1$  tregon vlerën 24V. Cilat do të jenë vlerat që tregon ampermetri dhe voltmetri  $V_2$ ? **1 pikë**

- |                       |                            |
|-----------------------|----------------------------|
| Tregimi i ampermetrit | Tregimi i voltmetrit $V_2$ |
| A) $I = 2A$           | $U_2 = 8V$                 |
| B) $I = 4A$           | $U_2 = 2V$                 |
| C) $I = 4A$           | $U_2 = 8V$                 |
| D) $I = 8A$           | $U_2 = 8V$                 |




21. Nisur nga të dhënat e skemës, njehsoni:

- Tregimin e ampermetrit, kur çelësi  $k$  është i hapur. **2 pikë**
- Vlerën e rezistencës  $R$ , nëse mbas mbylljes së çelësit, ampermetri tregon 2A. ( $r = 0$ ) **4 pikë**




22. Ndërmjet poleve të një magneti, mbi përcjellësin me rrymë, vepron forca si në figurë. Polet e magnetit, duke u nisur nga e majta në të djathtë janë: **1 pikë**

- S – N
- N – S
- S – S
- N - N



23. Protoni futet horizontalisht në një fushë magnetike homogjene, pingul me vijat e induksionit të kësaj fushe, me shpejtësi  $V$ . Cila prej katër trajektoreve tregon lëvizjen e protonit brenda fushës? **1 pikë**


- Trajektorja 1
- Trajektorja 2
- Trajektorja 3
- Trajektorja 4



24. Spira përcjellëse në formë katrore me brinjë 10cm, ndodhet brenda fushës magnetike me induksion  $B=0.02T$ , si në figurë. Spirën e rrotullojmë me shpejtësi këndore  $4\pi \text{ rad/s}$ , me kënd  $90^\circ$ , sipas një boshti vertikal, paralel me brinjët ad dhe bc dhe që kalon në qendrën e saj.

Njehsoni:

- forcën elektromotore që induktohet në spirë. **3 pikë**
- rrymën e induktuar që kalon në spirë, nëse rezistenca e spirës është  $1m\Omega$ . **1 pikë**




25. Një lavjerrës i thjeshtë matematik largohet me 10cm nga pozicioni i ekuilibrit dhe lihet i lirë. Frekuenca në këtë rast është 4Hz. Sa do të jetë frekuenca e lavjerrësit në qoftë se lavjerrësin e largojmë nga pozicioni i ekuilibrit me 5cm?

- A) 2Hz
- B) 4Hz
- C) 6Hz
- D) 8Hz

1 pikë

26. Në kordën e tendosur përhapen valë tërthore me frekuencë këndore  $40\pi$  rad/s, nga e majta në të djathtë. Me të dhënat e figurës përcaktoni:

- a) Periodën dhe frekuencën e valës.
- b) Gjatësinë dhe shpejtësinë e valës.




2 pikë

2 pikë

27. Një rreze drite kalon nga qelqi në ajër. Cilnga pohimet është i gabuar? 1 pikë

- A) Këndi i rënies është i njëjtë me këndin e pasqyrimit.
- B) Këndi i rënies është më i vogël se këndi i përthyerjes.
- C) Këndi i pasqyrimit është më i vogël se këndi i përthyerjes.
- D) Këndi i rënies është më i madh se këndi i përthyerjes.

28. Në figurë paraqiten boshti optik kryesor i një thjere, objekti AB dhe shëmbëllimi i tij A'B'. Me anë të ndërtimit, përcaktoni dhe shpjegoni si gjenden qendra e thjerës, lloji i saj dhe vatrat. Tregoni karakteristikat e shëmbëllimit që jep thjera.



4 pikë

29. Në eksperimentin e fotoefektit intensiteti i dritës u rrit 3 herë, kurse frekuenca nuk ndryshoi. Shpejtësia e elektronit të shkëputur:

- A) u rrit 9 herë
- B) u rrit 6 herë
- C) u rrit 3 herë
- D) nuk ndryshon

1 pikë

30. Ç'ndodh me gjatësinë e valës së De Brojlit për një elektron kur diferenca e potencialit që e përshpejton atë rritet 4 herë?

- A) Zvogëlohet 4 herë.
- B) Rritet 2 herë
- C) Zvogëlohet 2 herë.
- D) Rritet 4 herë

1 pikë


Fizikë - Sesioni II

1. Një nxënës lëviz drejt veriut duke kryer zhvendosjen  $S_1 = 50\text{m}$  dhe më pas lëviz në drejtim të jugut duke kryer zhvendosjen  $S_2 = 40\text{m}$ . Zhvendosja rezultante që kryhen nxënësi do të jetë: **1 pikë**

- A) 90 m  
B) 50 m  
C) 40 m  
D) 10 m


2. Në figurë janë paraqitur grafikët e varësisë së shpejtësisë nga koha për dy trupa. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar? **1 pikë**

- A) Trupi A kryhen lëvizje drejtvizore njëtrajtësisht të përshpejtuar  
B) Trupi B kryhen lëvizje drejtvizore njëtrajtësisht të ngadalësuar  
C) Të dyja lëvizjet bëhen me nxitim.  
D) Vetëm trupi B lëviz me nxitim




3. Në figurë paraqitet grafiku i varësisë së shpejtësisë nga koha për një trup. Zhvendosja që kryhen trupi gjatë kohës  $t = 10\text{s}$  është: **1 pikë**

- A) 300m  
B) 150m  
C) 100m  
D) 30m



4. Pikat materiale M dhe N të një disku, rrotullohen rreth një boshti të përbashkët O, si në figurë. Për këta dy pika mund të themi:

- A) ato kanë të njëjtën shpejtësi lineare, por kanë shpejtësi këndore të ndryshme  
B) ata kanë shpejtësi lineare të ndryshme dhe shpejtësi këndore të ndryshme  
C) ata kanë shpejtësi lineare të ndryshme dhe shpejtësi këndore të njëjta  
D) ata kanë të njëjtën shpejtësi lineare dhe të njëjtën shpejtësi këndore.



5. Një trup hidhet vertikalisht lart me shpejtësi fillestare  $V_0 = 8\text{m/s}$ . **4 pikë**  
a) Në çfarë lartësie shpejtësia bëhet sa gjysma e vlerës së shpejtësisë fillestare?  
b) Sa është koha që i duhet trupit, nga çasti i nisjes deri sa të rikthehet në pikën ku shpejtësia ka vlerën sa gjysma e shpejtësisë fillestare të hedhjes?

6. Një nxënës me masë 50kg qëndron mbi një peshore në ashensor. Ashensori lëviz poshtë me rënie të lirë, ( $g=10\text{m/s}^2$ ). Pesha e nxënësit do të jetë: **1 pikë**

- A) 0N.
- B) 20N.
- C) 50N
- D) 500N

7. Trupi nën veprimin e forcës horizontale 60N kryhen lëvizje drejtvizore të njëtrajtshme. Nëse masa e trupit është 60kg, koeficienti i fërkimit do të jetë: ( $g = 10\text{m/s}^2$ ) **1 pikë**


- A) 0.5
- B) 0.4
- C) 0.2
- D) 0.1



8. Në dy susta me koeficient elasticiteti të njëjtë veprojnë forcat  $F_1$  dhe  $F_2$  me kusht që  $F_1=2F_2$ . Cili nga barazimet është i saktë? **1 pikë**


- A)  $x_1=x_2$
- B)  $x_1=2x_2$
- C)  $x_1=3x_2$
- D)  $x_1=4x_2$

9. Trupi me masë 4kg ndodhet në fundin e një rrafshi të pjerrët. Mbi trupin vepron forca 40N sipas drejtimit të rrafshit. Njehsoni vlerën e nxitimit me të cilin ngjitet trupi, nëse koeficienti i fërkimit ndërmjet trupit dhe rrafshit është 0.5. ( $g = 10\text{m/s}^2$ ) **4 pikë**




10. Në figurë paraqitet grafiku i varësisë së forcës që vepron mbi një trup në lidhje me koordinatën. Puna që kryen forca, gjatë zhvendosjes 20m është: **1 pikë**

- A) 200J
- B) 400J
- C) 600J
- D) 800J



TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI


11. Dy topa bilardoje me masa 400gram secili, lëvizin përkundrejt njeri tjetrit si në figurë. Mbas goditjes, ata lëvizin së bashku. Tregoni nëse goditja është ose jo elastike.



3 pikë

12. Sfera me masë 1kg varet në një fije peri me gjatësi 125cm. Sfera zhvendoset nga pozicioni i ekuilibrit, deri sa fija të shtrihet sipas drejtimit horizontal dhe lihet e lirë.

- a) Bazuar në ligjin e ruajtjes së energjisë, njehsoni shpejtësinë e sferës kur ajo kalon nëpër pozicionin e ekuilibrit. ( $f=0$ ) **2 pikë**  
 b) Njehsoni tensionin e fijes, në këtë pozicion. **2 pikë**




13. Gjatë një procesi izohorik, një gaz ideal e zvogëlon shtypjen dy herë. Vëllimi e gazit gjatë këtij procesi: **1 pikë**


- A) rritet katër herë  
 B) rritet dy herë  
 C) zvogëlohet dy herë  
 D) nuk ndryshon

14. Gazi ideal, kalon nëpër gjendjet a, b, c, sipas diagramës së paraqitur. Puna e përgjithshme që kryhen gazi do të jetë: **1 pikë**

- A)  $2pV$   
 B)  $3pV$   
 C)  $-3pV$   
 D)  $-4pV$



15. Dy balona qelqi me vëllim  $V_1$  dhe  $V_2 = 3V_1$ , bashkohen me anë të një tubi të hollë me vëllim të papërfillshëm. Në balona ka gaze të ndryshëm. Shtypja e gazit në balonin e parë është  $2 \cdot 10^5$  Pa, ndërsa shtypja në balonin e dytë është  $4 \cdot 10^5$  Pa. Pasi hapet rubineti, gazet përzihen. Njehsoni shtypjen e gazeve pas hapjes së rubinetit. **3 pikë**




16. Dy trupa të ngarkuar tërheqin njeri tjetrin me një forcë  $F$ . Nëqoftëse ngarkesa e secilit trup përgjysmohet, atëherë forca tërheqëse ndërmjet tyre do të bëhet:

- A)  $2F$
- B)  $4F$
- C)  $F/2$
- D)  $F/4$

**1 pikë**

17. Katër kondensatorë janë lidhur si në skemën e dhënë. Nëse secili kondensator e ka kapacitetin  $20\mu F$ , kapaciteti ekuivalent i skemës do të jetë:

- A)  $10\mu F$
- B)  $20\mu F$
- C)  $40\mu F$
- D)  $60\mu F$



**1 pikë**

18. Elektroni ndodhet në pllakën negative të një kondensatori të rrafshët. Largësia midis pllakave është  $2\text{cm}$ . Koha që elektroni të prekë pllakën pozitive është  $2 \cdot 10^{-8}\text{s}$ . ( $m_e = 9 \cdot 10^{-31}\text{kg}$ ,  $q_e = 1.6 \cdot 10^{-19}\text{C}$ .) Njehsoni: +++++++

- a) nxitimin e lëvizjes së elektronit.
- b) intensitetin e fushës elektrike.

**1 pikë**

**2 pikë**


- c) diferencën e potencialeve ndërmjet pllakave.



**1 pikë**

19. Në qarkun e figurës rezistencat kanë të njëjtën vlerë  $2\Omega$ . Rezistenca e ekuivalente qarkut do të jetë:

- A)  $2\Omega$
- B)  $3\Omega$
- C)  $4\Omega$
- D)  $6\Omega$



**1 pikë**


20. Në qarkun e dhënë përcjellëset janë material argjend dhe hekur, që kanë të njëjtën gjatësi dhe diametër. Cili nga relacionet e mëposhtëm është i saktë për vlerat e rrymave dhe tensioneve në skajet e tyre? ( $\rho_{\text{Ag}} < \rho_{\text{Fe}}$ ) **1 pikë**

**Intensiteti i rrymës**

**Tensioni**

- A)  $I_{\text{Ag}} = I_{\text{Fe}}$
- B)  $I_{\text{Ag}} > I_{\text{Fe}}$
- C)  $I_{\text{Ag}} = I_{\text{Fe}}$
- D)  $I_{\text{Ag}} < I_{\text{Fe}}$


- $U_{\text{Ag}} = U_{\text{Fe}}$
- $U_{\text{Ag}} > U_{\text{Fe}}$
- $U_{\text{Ag}} < U_{\text{Fe}}$
- $U_{\text{Ag}} = U_{\text{Fe}}$



TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

21. Tensioni në skajet e rezistencës R1, është 6volt. Njehsoni:


- a) fuqinë në rezistencën R2.  
 b) vlerën e rezistencës Rx, në skemë. (  $r = 0$  )  
 (Zbatim numerik R1 = 3Ω, R2 = 6 Ω)



2 pikë  
4 pikë


22. Ndërmjet poleve të një magneti, mbi përcjellësin me rrymë, vepron forca si në figurë. Polet e magnetit, duke u nisur nga e majta në të djathtë janë: 1 pikë

- A) N – S  
 B) S – N  
 C) S – S  
 D) N – N




23. Elektroni futet horizontalisht në një fushë magnetike homogjene pingul me vijat e induksionit të kësaj fushe me shpejtësi V. Cila prej katër trajektoreve tregon lëvizjen e elektronit brenda fushës? 1 pikë

- A) Trajektorja 1  
 B) Trajektorja 2  
 C) Trajektorja 3  
 D) Trajektorja 4



24. Spira përcjellëse drejtkëndore, me brinjë  $a = 10\text{cm}$  dhe  $b = 20\text{cm}$ , ndodhet brenda fushës magnetike me induksion  $B = 0.04\text{T}$ , i cili është pingul me sipërfaqen e spirës si në figurë. Spirën e rrotullojmë me kënd  $90^\circ$  me shpejtësi këndore  $2\pi \text{ rad/s}$ , sipas një boshti paralel me brinjët ab dhe cd dhe që kalon në qendrën e saj, në mënyrë që plani i spirës të jetë paralel me induksionin e fushës magnetike. Njehsoni:

- a) forcën elektromotore që induktohet në spirë. 3 pikë  
 b) rrymën e induktuar që kalon në spirë, nëse rezistenca e spirës është  $1\text{m}\Omega$ .



1 pikë


25. Në një fije me masë të papërfillshme varim një sferë me masë m. Vëmë në lëkundje këtë lavjerrës dhe matim frekuencën, e cila është 2Hz. Sa do të jetë frekuenca e lavjerrësit në qoftë se në të njëjtën fije varim një sferë me masë 2m?

- A) 1Hz  
 B) 2Hz  
 C) 4Hz  
 D) 6Hz

1 pikë

26. Vala përhapet sipas drejtimit të boshtit x me frekuencë këndore  $20\pi$  rad/s, si në figurë. Përcaktoni:

- a) Amplitudën dhe gjatësinë e valës.  
b) Shpejtësinë e përhapjes së valës.



**2 pikë**

**2 pikë**

27. Kur një rreze drite kalon nga ajri në ujë, cila nga madhësitë e mëposhtme nuk ndryshon?


**1 pikë**

- A) Gjatësia e valës  
B) Shpejtësia  
C) Frekuenca.  
D) Drejtimi

28. Në figurë paraqiten boshti optik kryesor i një thjere, objekti AB dhe shëmbëllimi i tij A'B'. Me anë të ndërtimit, përcaktoni dhe shpjegoni si gjenden qendra e thjerës, lloji i saj dhe vatrat.

Tregoni karakteristikat e shëmbëllimit që jep thjera.

**4 pikë**



29. Puna e daljes për një metal është 1.6eV. Cili prej fotoneve rënës shkakton fotoefekt për këtë metal?

**1 pikë**

- A) Fotoni me energji 1.7eV  
B) Fotoni me energji 1.5eV  
C) Fotoni me energji 1.4eV  
D) Fotoni me energji 1.2eV

30. Ç'ndodh me gjatësinë e valës së De Brojlit për një elektron kur shpejtësia e tij rritet 2 herë?

**1 pikë**

- A) Zvogëlohet 4 herë.  
B) Rritet 2 herë  
C) Zvogëlohet 2 herë.  
D) Rritet 4 herë



## GJEOGRAFI

Gjeografia si lëndë i ofron nxënësit mundësi të zhvillojë të kuptuarit e veçorive natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetit të rajoneve në botë, ndërvarësisë, ndërveprimit, si dhe marrëdhënieve të njeriut me mjedisin në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.

Hartimi i testit për lëndën e gjeografisë mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së gjeografisë bazohet në:

- programet e lëndës së gjeografisë bërthamë për klasën e 10-të;
- programet e lëndës së gjeografisë bërthamë për klasën e 11-të;
- programin e lëndës së gjeografisë me zgjedhje për klasën e 12-të.

Bazuar në programin orientues, përmbushja e kompetencave gjeografike dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet 2 tematikave kryesore:

- Proceset natyrore dhe shoqërore
- Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve.

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të gjeografisë. Specialistët e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të kësaj lënde, nuk mund të përfshijnë në testim tema mësimore të cilat nuk janë parashikuar në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja. Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues.

Disa nga kompetencat që janë testuar në provimin e gjeografisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

***Rezultatet e të nxënësve për nivelin e parë të vështirësisë:***

- identifikon elementet matematikore dhe gjeografike të hartës;
- përshkruan pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Evropë;
- identifikon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë;

- identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior – Verilindor;
- identifikon Hënën si një nga trupat qiellorë;
- përshkruan kometat, asteroidet, meteorët dhe veçoritë e tyre;
- identifikon veprimtarinë gërryese të ujërave detare;
- identifikon kriteret bazë të rajonizimit.

**Rezultatet e të nxënësve për nivelin e dytë të vështirësisë:**

- diferencon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit;
- analizon përbërjen e atmosferës;
- analizon rrymat oqeanike;
- shpjegon kushtet e formimit të borës së përhershme dhe akullnajave;
- diferencon shtresat e Tokës;
- analizon larinë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë;
- klasifikon llojet e shkëmbinjve;
- analizon faktorët kryesorë që ndikojnë në proceset migratore në botë;
- analizon shkaqet e migracionit të jashtëm dhe pasojat e tij përmes rasteve studimore nga vende të ndryshme;
- përcakton shpërndarjen hapësinore të gjuhëve më të përhapura sot në botë dhe rajonet gjuhësore me veçoritë e tyre të zhvillimit.

**Rezultatet e të nxënësve për nivelin e tretë të vështirësisë:**

- interpreton mënyrën e formimit të ujërave nëntokësore dhe llojet e tyre;
- interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj.

**Struktura e testit**

Testi i gjeografisë ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 14 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi për lëndën e gjeografisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Pyetjet e një tematike në test janë të vendosura njëra pas tjetrës, pavarësisht nëse janë me alternativa apo me zhvillim. Pra, pyetjet nga gjeografia fizike janë në fillim dhe më pas vazhdojnë pyetjet nga gjeografia e klasës së 11 dhe 12.

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

NR.	TEMATIKAT	Pesha %	Nr. pikëve	NIVELET		
				Niveli I - 40%	Niveli II- 40%	Niveli III - 20%
1	Proceset natyrore dhe shoqërore	40	24	10	10	4
2	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve dhe rajoneve	60	36	14	14	8
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>60</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>12</b>

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika që ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh. Pra, tematika “Proceset natyrore dhe shoqërore” që zë 40% të peshës së programit është përfaqësuar në test me rreth 24 pikë, ndërsa tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve dhe rajoneve” që zë 60% të programit, me 36 pikë.

### Llojet e pyetjeve

Pyetjet e testit të gjeografisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një hartë, figurë apo grafik. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

TESTE

Gjeografi - Sesioni I

1. Hëna është: **1 pikë**  
A) satelit natyror i Tokës.  
B) satelit natyror i Diellit.  
C) asteroid i Tokës.  
D) asteroid i Diellit.

2. Gjenden me shumicë në brezin midis Marsit dhe Jupiterit: **1 pikë**  
A) satelitët,  
B) kometat,  
C) meteorët,  
D) asteroidet.


3. Dita më e gjatë në Hemisferën Veriore është në datën: **1 pikë**  
A) 21 mars,  
B) 21 qershor,  
C) 23 shtator,  
D) 22 dhjetor.

4. Në elementet gjeografike të hartës bën pjesë: **1 pikë**  
A) projeksioni hartografik.  
B) rrjeti hartografik.  
C) shkalla e hartës.  
D) relievi.

5. Vëzhgoni me kujdes hartën e dhënë dhe përcaktoni koordinatat gjeografike të pikave C dhe D. **2 pikë**

Pika C: \_\_\_\_\_

Pika D: \_\_\_\_\_



TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI


6. Gazi që luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e Tokës nga rrezet ultravjollcë është: **1 pikë**

- A) azoti,
- B) ozoni,
- C) oksigjeni,
- D) dyoksidi i karbonit.

7. Figurat e mëposhtme tregojnë këndin e rënies së rrezeve të Diellit gjatë një dite, në stinën e verës dhe të dimrit.

a) Cila nga figurat tregon këndin e rënies së rrezeve të Diellit gjatë stinës së dimrit? **1 pikë**

- b) Jepni dy argumente që tregojnë se intensiteti i rrezatimit gjatë stinës së dimrit është më i ulët, edhe pse mund të ketë diell gjatë gjithë ditës.




**2 pikë**

8. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në shmangien e rrymave oqeanike nga drejtimi i tyre fillestar? **1 pikë**

- A) Përbërja gjeologjike dhe mineralogjike e kontinenteve.
- B) Shpërndarja e kontinenteve dhe konfiguracioni i brigjeve detare.
- C) Formimi i puhisë detare dhe puhisë tokësore gjatë ditës dhe natës.
- D) Formimi i baticave dhe zbatave për shkak të forcës gravitacionale të Diellit.

9. Bazuar te grafiku i mëposhtëm, kufiri i borës së përhershme është më i lartë në zonat me gjerësi gjeografike: **1 pikë**

- A) polare,
- B) subpolare,
- C) mesatare,
- D) tropikale.



10. Shpërndarja horizontale e kripësisë në oqeanë është e ndryshme.

a) Në cilat gjerësi gjeografike të planetit tonë kripësia e ujërave në oqeanë është më e lartë? **1 pikë**

b) Jepni të paktën dy arsye pse kripësia e ujërave oqeanike është më e lartë.

**2 pikë**


11. Ndarja e shtresës së Mohoroviçit shërben si kufi midis: **1 pikë**
- A) kores së tokës dhe mantelit.
  - B) kores së tokës dhe bërthamës.
  - C) kores oqeanike dhe asaj kontinentale.
  - D) bërthamës së jashtme dhe asaj të brendshme.

12. Në koren tokësore gjenden lloje të ndryshëm shkëmbinjsh. Shkëmbinjtë magmatikë janë një prej tyre. Shkruani dy dallime midis shkëmbinjve magmatikë efuzivë dhe shkëmbinjve magmatikë intruzivë. **2 pikë**

13. Veprimtaria gërryese e valëve detare quhet: **1 pikë**
- A) Abrasion,
  - B) Erozion,
  - C) Korazion,
  - D) deflacion.

14. Ujërat nëntokësorë që gjenden nën sipërfaqen e Tokës, krijohen në kushte të ndryshme.

- a) Çfarë lloj ujërash nëntokësorë tregon figura?
- b) Jepni dy kushte në të cilat formohen këto lloj ujërash nëntokësorë.



**1 pikë**

**2 pikë**

15. Evropa ndahet nga Afrika nëpërmjet: **1 pikë**
- A) ngushticës së Bosforit.
  - B) ngushticës Pa de Kale.
  - C) ngushticës së Gjibraltarit.
  - D) ngushticës së Dardaneleve.

16. Në rajonin e Evropës Veriore fliten më shumë gjuhët e grupit gjermanik, ndërsa në rajonin e Evropës Jugore fliten më shumë gjuhët latine. Mbështetur në këtë fakt, cili nga kriteret e mëposhtme i dallon këto dy rajone?

- A) Kriteri fizik. **1 pikë**
- B) Kriteri ekonomik.
- C) Kriteri politik.
- D) Kriteri kulturor.

---


**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

17. Konsiderohet si fe etnike: **1 pikë**  
A) Budizmi.  
B) Hinduizmi;  
C) Islamizmi;  
D) Krishterimi;
18. Deti i Vdekur gjendet në: **1 pikë**  
A) Azinë Jugperëndimore,  
B) Afrikën Nënsahariane,  
C) Afrikën Veriore,  
D) Azinë Jugore.
19. Cili nga vendet e mëposhtme të Azisë Juglindore dallohet për shkallë më të lartë urbanizimi? **1 pikë**  
A) Laosi.  
B) Filipinet.  
C) Vietnam.  
D) Singapori.
20. Në Meksikë mbizotëron popullsia: **1 pikë**  
A) metise,  
B) negroide,  
C) indigjene,  
D) evropoide.
21. Cili nga shtetet e mëposhtme dallohet për numrin e madh të ftordeve? **1 pikë**  
A) Suedia,  
B) Islanda,  
C) Norvegjia,  
D) Danimarka.
22. Sot në botë fliten gjuhë të ndryshme.  
a) Në cilën nga familjet gjuhësore bëjnë pjesë gjuhët latine? **1 pikë**  
b) Përcaktoni një nga familjet gjuhësore që fliten nga një grup më i vogël njerëzish. **1 pikë**  
c) Cila nga familjet gjuhësore ka përhapje më të madhe në kontinentin aziatik? **1 pikë**

23. Në figurë paraqitet piramida e popullsisë së Shqipërisë për vitet 2001 dhe 2011.

- a) Gjeni dy ndryshime midis piramidës së vitit 2001 dhe piramidës së vitit 2011.  
 b) Jepni të paktën dy nga arsyet që kanë ndikuar në këto ndryshime.



2 pikë

2 pikë

24. SHBA është vendi më i zhvilluar ekonomikisht në botë. Cilët janë tre nga treguesit që e vërtetojnë këtë pohim? **3 pikë**

25. Ministri i emigracionit të Holandës Mark Harbers, deklaroi në prill të vitit 2019, se gjatë dy viteve të fundit, qindra shqiptarë kanë kërkuar azil në Holandë, por çështjet e tyre kanë pak gjasa të miratohen, pasi Shqipëria konsiderohet një vend i sigurtë i origjinës. Nisur nga ky fakt, përcaktoni:

- a) një nga faktorët që nxit largimin e popullsisë nga vendi i origjinës. **1 pikë**  
 b) një nga faktorët që nxit tërheqjen e popullsisë në vendin e destinacionit. **1 pikë**

26.

- a) Cilin rajon përfaqëson zona e hijezuar në hartë?  
 b) Emërtoni një nga shtetet e këtij rajoni, që është cilësuar si një nga "tigrat e Azisë".  
 c) Kur përcaktohet se ky rajon është pjesë e "Unazës së Zjarrtë të Paqësorit", çfarë karakteristike e tij nënkuptohet?



1 pikë

1 pikë

1 pikë

27. Shqipëria shtrihet në:

- A) Evropën Jugore;  
 B) Evropën Qendrore;  
 C) Evropën Juglindore;  
 D) Evropën Jugperëndimore.

1 pikë



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

28. Sa është numri i bashkive në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së fundit administrative? **1 pikë**
- A) 60 bashki.  
B) 61 bashki.  
C) 62 bashki.  
D) 63 bashki.
29. Shtrihen në perëndim të luginës së Matit: **1 pikë**
- A) malësitë e Çermenikës dhe Gollobordës.  
B) malësitë e Gollobordës dhe Martaneshit.  
C) vargjet malore të Skënderbeut.  
D) vargjet malore të Lurës.
30. Cili nga rajonet e Shqipërisë dallohet për popullim më të hershëm? **1 pikë**
- A) Rajoni Verior – Verilindor.  
B) Rajoni Perëndimor.  
C) Rajoni Juglindor.  
D) Rajoni Jugor.
31. Trevat shqiptare dallohen për hidrografi të pasur. Renditni tri nga veçoritë e përgjithshme të lumenjve në trevat shqiptare. **3 pikë**
32. Shkruani tri karakteristika të luginës së Drinit të Zi në aspektin natyror. **3 pikë**
33. Tiparet strukturore të popullsisë së Shqipërisë kanë ndryshuar vazhdimisht. Kështu, në strukturën gjinore të popullsisë në Republikën e Shqipërisë, tradicionalisht ka mbizotëruar elementi mashkull në krahasim me atë femër. Në periudha të ndryshme kohore kjo strukturë është lëkundur.
- a) Në cilën periudhë të shek. XX struktura gjinore ndryshoi disi në favor të elementit femër? **1 pikë**
- b) Jepni një arsye që shpjegon këtë ndryshim. **1 pikë**
- c) Si ka ndryshuar mosha mesatare e popullsisë së Shqipërisë nga viti 1990 deri më sot? **1 pikë**
34. Rajoni Jugor dhe Juglindor ndryshojnë midis tyre në veçoritë fiziko-geografike.
- a) Jepni një ndryshim midis këtyre dy rajoneve, lidhur me strukturat tektonike mbizotëruese ku formohet relievi. **1 pikë**
- b) Emërtoni një nga pjesët përbërëse të Rajonit Jugor, që është formuar në një graben. **1 pikë**
- c) Cila nga pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor, që është formuar në një graben, shtrihet në një lartësi më të madhe mbi nivelin e detit?

**Gjeografi - Sesioni II**


1. Trupi qiellor më i afërt me Tokën është: **1 pikë**  
 A) Hëna;  
 B) Marsi;  
 C) Dielli;  
 D) Afërdita.

2. Kryen një qarkullim të plotë nga perëndimi në lindje për 365 ditë, 5 h e 49': **1 pikë**  
 A) Toka rreth boshtit;  
 B) Toka rreth Diellit;  
 C) Hëna rreth Tokës;  
 D) Hëna rreth boshtit.

3. Dita më e gjatë në Hemisferën Jugore është në datën: **1 pikë**  
 A) 21 mars;  
 B) 21 qershor;  
 C) 23 shtator;  
 D) 22 dhjetor.

4. Në elementet matematikorë të hartës bën pjesë: **1 pikë**  
 A) Relievi;  
 B) Hidrografia;  
 C) Rrjeti hartografik;  
 D) Shenjat konvencionale.

5. Vëzhgoni me kujdes hartën e dhënë dhe përcaktoni:



- a) Në cilën pikë lumi rrjedh më ngadalë.  
 Lumi rrjedh më ngadalë në pikën \_\_\_\_  
 b) Argumentoni përgjigjen tuaj.

**1 pikë**



**2 pikë**

6. Cila është shtresa e atmosferës ku bëhet i mundur transmetimi i valëve të radios? **1 pikë**  
 A) Troposfera.  
 B) Stratosfera.  
 C) Termosfera.  
 D) Ekzosfera.
7. Figurat përbri tregojnë këndin

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

e rënies së rrezeve të Diellit gjatë një dite në stinën e verës dhe të dimrit.

- a) Cila nga figurat tregon këndin e rënies së rrezeve të Diellit gjatë stinës së verës?





1 pikë

- b) Jepni dy argumente që tregojnë se intensiteti i rrezatimit gjatë stinës së verës është më i lartë.



2 pikë

8. Gjatë cilës fazë të Hënës ndodhin baticat më të mëdha?



1 pikë


- A) 1  
B) 2  
C) 3  
D) 4



9. Cilin nga elementet e valës tregon shkronja D në figurën e dhënë?

1 pikë

- A) Bazën.  
B) Gjatësinë.  
C) Kreshtën.  
D) Lartësinë.



10. Valët në oqeanë krijohen nga shkaqe të ndryshme.

1 pikë

- a) Cili është shkaku i formimit të valëve tsunami?  
b) Jepni një nga karakteristikat e këtyre valëve.

1 pikë

11. Shtresa e sipërme e Tokës është:

1 pikë


- A) bërthama e jashtme;  
B) korja tokësore;  
C) astenosfera;  
D) manteli.

12. Shpjegoni si formohen secili prej shkëmbinjve të mëposhtëm.

2 pikë

Shkëmbinjte sedimentarë: \_\_\_\_\_  
Shkëmbinjte magmatikë: \_\_\_\_\_

13. Nëpërmjet shkronjës B



në figurë është paraqitur:

1 pikë

- A) epiqendra e tërmetit;
- B) hipoqendra e tërmetit;
- C) thyerja tektonike;
- D) valët e tërmetit.

14. Një nga llojet e lëvizjeve të kores tokësore janë lëvizjeve luhatëse (epirogjenike).

2 pikë

- a) Jepni dy nga karakteristikat e këtyre lloj lëvizjeve.
- b) Jepni një nga dëshmitë që tregojnë praninë e lëvizjeve luhatëse.

1 pikë

15. Kontinenti me sipërfaqen më të vogël në rruzullin tokësor është:


1 pikë

- A) Australia;
- B) Antarktida;
- C) Groenlanda;
- D) Zelanda e Re.

16. Duke u bazuar te grafiku, rezervat më të mëdha të naftës në vitin 1986 ishin në:

1 pikë

- A) gjirin e Guinesë;
- B) Siberinë veriore;
- C) rajonin e Gjirit Persik;
- D) rajonin e Karaibeve.



17. Në cilin nga lumenjtë e mëposhtëm mund të lundrojnë anijet oqeanike?

1 pikë

- A) Makenzi.
- B) Misisipi.
- C) Amazona.
- D) Shën Lorenc.

18. Konsiderohet si prodhuesi më i madh botëror i kafesë:

1 pikë

- A) Kuba;
- B) Egjipti;
- C) Argjentina;
- D) Brazili.

19. Liqeni më i thellë në botë është ai:

1 pikë

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

- A) Ladoga;
- B) Balaton;
- C) Bajkal;
- D) Kaspik.

20. Portugalia shtrihet në gadishullin:

**1 pikë**

- A) Apenin;
- B) Iberik;
- C) Bretanjës;
- D) Skandinav.

21. Britania e Madhe dhe Franca lidhen me njëra - tjetrën nëpërmjet ngushticës:

**1 pikë**

- A) La Mansh;
- B) Kategat;
- C) Skagerak;
- D) Gjibraltar.

22. Shkruani tri veçori fiziko – gjeografike të rajonit të Evropës Veriore.

**3 pikë**


23. Hapësirat gjeografike po ndryshojnë gjithnjë e më shuma nga veprimtaria e njeriut. Procesi i vullshëm i industrializimit ka krijuar hapësira të ndryshme ku nga njëra anë shfaqet hapësira qendrore dhe nga ana tjetër ajo periferike. Nisur nga ky fakt, shkruani tri dallime midis hapësirës qendrore dhe asaj periferike.

**3 pikë**

24. Në figurë paraqitet piramida e popullsisë së Shqipërisë për vitet 2001 dhe 2011.

a) Bazuar të figura, në cilën nga piramidat kemi një shtim natyror më të lartë të popullsisë? Ilustroni përgjigjen tuaj me detaje nga figura.

b) Bazuar të figura, ndryshimet më të mëdha në piramidat e popullsisë janë në drejtim të strukturës moshore apo gjinore? Ilustroni përgjigjen tuaj me detaje nga figura.




**2 pikë**

25. Krahasoni Australinë me Zelandën e Re në aspektin natyror dhe jepni dy ndryshime midis tyre. **2 pikë**

26. Për t'ju përgjigjur pyetjes, bazohuni në hartën përbri.

- a) Cili rajon tregohet në hartë?
- b) Identifikoni emrat e dy lumenjve më të rëndësishëm të këtij rajoni.



**1 pikë**

**2 pikë**

27. Cila nga alternativat e mëposhtme paraqet rëndësinë gjeopolitike të trevave shqiptare? **1 pikë**

- A) Shtrirja e tyre në rajonin e Ballkanit.
- B) Tiparet mesdhetare të klimës, bimësisë, tokave etj.
- C) Vendndodhja e tyre në brezin mesatar të Hemisferës Veriore.
- D) Vendndodhja në kryqëzimin e rrugëve që lidhin lindjen me perëndimin.

28. Në rast se udhëtojmë nga Tirana në drejtim të Korçës, drejtimi ynë do të jetë drejt: **1 pikë**

- A) veriut;
- B) verilindjes;
- C) juglindjes;
- D) jugperëndimit.

29. Mali i Çikës është pjesë e maleve: **1 pikë**

- A) Bregdetare;
- B) Lindore të Rajonit Juglindor;
- C) midis Tomorit dhe Melesinit;
- D) midis Vjosës së Sipërme dhe Drinosit.

30. Pllaja karstike Veleçik – Bridash ndodhet në: **1 pikë**

- A) Bllokun e Jezercës;
- B) Malësinë e Madhe;
- C) Luginën e Shalës;
- D) Malësinë e Gashit.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

31. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për 1000 banorë për popullsinë e Shqipërisë dhe të trevave shqiptare.

<b>Popullsia në trevat shqiptare</b>	<b>Lindjet në 1000 banorë</b>	<b>Vdekjet në 1000 banorë</b>
1. Popullsia në Shqipëri	16.0	5.0
2. Popullsia në Kosovë	20.8	5.2
3. Popullsia e trevave shqiptare në Maqedoninë Veriore	24.5	5.9
4. Popullsia e trevave shqiptare në Mal të Zi	15.2	5.0
5. Popullsia e trevave shqiptare në Serbi	25.9	5.5

- a) Cilin tipar strukturor të popullsisë paraqet tabela e mësipërme? **1 pikë**  
b) Ku është më i lartë shtimi natyror i popullsisë? Si e gjetët? **2 pikë**
32. Emigracioni i jashtëm ka qenë një dukuri që e ka shoqëruar vazhdimisht popullsinë shqiptare. Rënditni tre nga faktorët që kanë ndikuar në nivelin e lartë të emigracionit për popullsinë shqiptare. **3 pikë**
- 33.
- a) Krahasoni Rajonin Jugor me Rajonin Juglindor dhe nxirrni nga një ndryshim midis tyre në aspektin e ndërtimit gjeologjik dhe relievit. **2 pikë**  
Një ndryshim në ndërtimin gjeologjik:  
Një ndryshim në format e relievit:
- b) Emërtoni një nga pjesët përbërëse të vargut perëndimor të Rajonit Juglindor. **1 pikë**
34. Përcaktoni një nga sistemet malore në trevat shqiptare që kanë këto drejtime në reliev. **3 pikë**
- Drejtimin Veri – Jug:
  - Drejtimin VP–JL:
  - Drejtimin rrezor:

## HISTORI

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike duke dalluar analogjinë false dhe duke peshuar pasojat që vijnë prej tyre.

Detyra e historisë është të orientojë nxënësit që të trajtojnë në mënyrë kritike një ngjarje të epokës së tyre dhe të së shkuarës si dhe të kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Hartimi i testit për lëndën e historisë mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së historisë bazohet në:

- programet e lëndës së historisë bërthamë për klasën e 10-të;
- programet e lëndës së historisë bërthamë për klasën e 11-të;
- programin e lëndës së historisë me zgjedhje për klasën e 12-të.

Bazuar në programin orientues, përbushja e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet 4 tematikave kryesore:

- Antikiteti;
- Mesjeta (shek. IV – XIV);
- Periudha moderne (shek. XV – fillimi i shekullit XX);
- Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të historisë. Specialistët e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të kësaj lënde, nuk mund përfshijnë në testim tema mësimore të cilat nuk janë parashikuar në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja. Në përgatitjen për përbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues.

Disa nga kompetencat që janë testuar në provimin e historisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

### ***Rezultatet e të nxënësve për nivelin e parë të vështirësisë:***



## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimeve antike;
- përshkruan tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimet antike;
- përshkruan thelbin e përmbajtjes së dokumenteve të rëndësishme historike;
- përcakton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së figurave të rëndësishme historike;
- identifikon tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të të formacioneve të ndryshme me karakter shtetëror;

### **Rezultatet e të nxënit për nivelin e dytë të vështirësisë:**

- shpjegon format e organizimit shtetëror në formacionet shtetërore antike;
- shpjegon dhe analizon faktet dhe burimet mbi origjinën, qytetërimin ilir, zhvillimin e tij ekonomiko-social dhe marrëdhëniet e tij me botën mesdhetare.
- analizon rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”;
- analizon rrethanat, shkaqet dhe pasojat e revolucioneve të mëdha (francez, amerikan etj.) në zhvillimin historik;

### **Rezultatet e të nxënit për nivelin e tretë të vështirësisë:**

- vlerëson rëndësinë e të drejtës romake dhe kodit të Justinianit deri në ditët e sotme;
- vlerëson kontributin e mbretërve ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir;
- gjykon mbi rëndësinë e pashallëqeve të mëdha në procesin e shtet-formimit dhe ndërtimit të identitet kombëtar të shqiptarëve;

### **Struktura e testit**

Testi i historisë ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh;
- 13 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh.

Testi për lëndën e historisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve të testit, në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

NIVELET
---------

**MATURA SHTETËRORE 2019**

<b>Nr.</b>	<b>Tematikat</b>	<b>Peshat në %</b>	<b>Nr. pikëve</b>	<b>Niveli I - 40%</b>	<b>Niveli II- 40%</b>	<b>Niveli III - 20%</b>
<b>1</b>	Antikiteti	12	7	3	3	1
<b>2</b>	Mesjeta	13	8	3	3	2
<b>3</b>	Periudha moderne shek. xv- fillimi i shek.xx	25	15	6	6	3
<b>4</b>	Periudha bashkëkohore	50	30	12	12	6
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>60</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>12</b>

Në bazë të tabelës së specifikimeve, tematika që ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh. Për shembull, tematika “Periudha bashkëkohore ” që zë 50% të peshës së programit orientues është përfaqësuar në test me një numër më të madh pikësh.

**Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të historisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive, subjektive dhe të tipit të esesë.

Pyetjet objektive që janë përdorur janë pyetje me alternativa, ku nxënësi duhet të qarkojë alternativën e saktë.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla.

Pyetjet ese synojnë të testojnë aftësinë e nxënësve për të organizuar, integruar dhe shprehur idetë e tyre. Këto pyetje masin nivelet më të larta të të menduarit, të tilla si, vlerësimi dhe gjykimi personal, bazuar në argumentet/analizën që nxënësi parashtron gjatë zhvillimit të esesë.

**TESTE**

**Histori - Sesion I**

1. Athina ishte një demokraci e kufizuar sepse: **1 pikë**  
A) vetëm filozofët mund të votonin.  
B) vetëm klasa e tregtarëve mund të votonte.  
C) ushtarakët dhe artistët nuk lejoheshin të votonin.  
D) gratë, skllëvërit dhe të huajt nuk lejoheshin të votonin.
2. Shkrimi i ligjeve në Romë, në 12 Tabelat, ishte një hap i rëndësishëm sepse: **1 pikë**  
A) për herë të parë u zbatuan ligjet në Romë.  
B) ato i bënë ligjet publike për të gjithë qytetarët.  
C) plebenjtë fitonin më shumë të drejta se patricët.  
D) ato u jepnin plebejve të drejtën e qytetarisë për herë të parë.
3. Periudha e Perandorisë në Romën antike fillon me: **1 pikë**  
A) Oktavian August,  
B) Mark Antoni,  
C) Jul Cezar,  
D) Kornel Shilla.
4. Identifikoni dy ndryshime të rëndësishme mes polisit të Spartës dhe atij të Athinës. **2 pikë**
5. Pavarësisht rezistencës së gjatë dhe të fortë, Iliria nuk ishte në gjendje t'i bënte ballë superfuqisë romake. Pushtimi romak pati ndikim në të gjitha fushat e jetës së popullsisë ilire për një kohë shumë të gjatë. Shpjegoni dy pasoja të pushtimit romak në Iliri. **2 pikë**
6. Kuvendi themelues i Lidhjes së princërve shqiptarë u mbajt në Lezhë sepse: **1 pikë**  
A) Lezha kishte terren të thyer malor.  
B) Lezha ishte larg çdo zotërimi të pjesëmarrësve kryesorë në kuvend.  
C) në këtë mënyrë i bëhej një ftesë për bashkëpunim edhe Venedikut.  
D) Zoti i Lezhës ishte përkrahësi kryesor i Skënderbeut.
7. Në Perandorinë Bizantine pushteti ishte i përqendruar në duart e: **1 pikë**  
A) perandorit,

- B) fisnikëve,
- C) senatit,
- D) klerit.

8. Prona shtetërore e kushtëzuar dhe e pa trashëgueshme, që i jepej feudalit ushtarak, ishte: **1 pikë**

- A) stratotika,
- B) pronja,
- C) bashtina,
- D) territoria.

9. Miratimi i "Ediktit Ikonoklast" shënoi një nga momentet e çarjes së madhe mes Kishës së Lindjes dhe asaj të Perëndimit. Pavarësisht se ky edikt u tërhoq pas disa vitesh, marrëdhëniet mes dy kishave nuk u përmirësuan. Çfarë u vendos me aprovimin e "Ediktit Ikonoklast" nga perandori Leon III? **1 pikë**

- A) Nxitja e prodhimit të ikonave fetare.
- B) Përcaktimi i madhësisë së ikonave fetare.
- C) Ndalimi i përdorimit dhe prodhimit të ikonave fetare.
- D) Vendosja e ikonave fetare në ambiente civile publike.

10. Principata e Arbrit shënoi organizimin e parë politik në trevat arbërore, falë të cilit u krijuan kushte të përshtatshme për zhvillimet e mëvonshme. Ajo vendosi themelet e traditës shtet formuese të shqiptarëve.

a) Shpjegoni tri elemente që provojnë organizimin shtetëror të Principatës së Arbrit.

**3 pikë**

b) Identifikoni një prej shteteve që e rrezikuan ekzistencën e kësaj principate.

**1 pikë**

11. Lëvizja për Reformacion i pati fillesat e saj në:

**1 pikë**

- A) Gjermani,
- B) Francë,
- C) Angli,
- D) Itali.

12. "Të gjithë njerëzit janë prej natyre të lirë, të barabartë dhe të pavarur, asnjë prej tyre nuk mund të privohet nga prona dhe t'i nënshtrohet fuqisë politike të dikujt"

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

*tjetër pa pëlqimin e tij, që bëhet duke rënë dakord me njerëz të tjerë, për t'u bashkuar në një bashkësi për jetesën e tyre të rehatshme, të sigurt dhe paqësore dhe duke gëzuar pasuritë e tyre."*

Pasazhi i mësipërm është shkruar nga:

**1 pikë**

- A) Adam Smith,
- B) Xhon Loku,
- C) Frensis Bekon,
- D) Edmond Burke.

13. Revolucioni i Lavdishëm i vitit 1688 shënoi një pikë kthese në historinë e Anglisë, sepse pas tij:

**1 pikë**

- A) "Kokërrumbullakëtit" mundën Kavalierët dhe ekzekutuan mbretin.
- B) u rikthye katolicizmi roman në Angli dhe Skoci si fe zyrtare e shtetit.
- C) puritanët fituan pushtetin në vend dhe kërcënuan me një luftë të re civile.
- D) u miratua Karta Angleze e Lirive dhe e të Drejtave që kufizoi autoritetin e monarkut.

14. Cili prej sundimtarëve të familjes së Bushatllinjve krijoi "Konfederatën Ilirike"?

**1 pikë**

- A) Mustafa pasha,
- B) Ibrahim pasha,
- C) Mahmut pasha,
- D) Mehmet pasha.

15. Vendimi për hapjen e shkollës së parë Normale për përgatitjen e mësuesve, u mor në:

**1 pikë**

- A) Kongresin e Dibrës,
- B) Kongresin e Elbasanit,
- C) Kongresin I të Manastirit,
- D) Kongresin II të Manastirit.

16. Përse Britania e Madhe, Franca dhe Rusia e kurorëzuan formimin e Antantës në vitin 1907?

**1 pikë**

- A) Për të mbajtur nën kontroll lëvizjet e armatosura në kolonitë e tyre.
- B) Për të zhvilluar një aleancë ekonomike bazuar mbi tregjet e hapura.
- C) Për të shtypur pakicat kombëtare në vendet e tyre.
- D) Për t'iu kundërpërgjigjur krijimit të Bllokut Qendror.

17. Fjalët e mëposhtme janë të Oto fon Bismark-ut, kryeministri i Prusisë në 1866, ku ai shpjegon procesin e bashkimit të Gjermanisë.

*“Unë e kam treguar qartë drejtimin ku po shkoja. Prusia...nuk mund të mbajë më e vetme peshën e sigurisë për Gjermaninë. Ajo duhet të ndahet në mënyrë të barabartë mes gjithë popullit gjerman. Ne nuk do të arrijmë qëllimet tona përmes fjalimeve, shoqatave ose vendimmarrjeve me shumicë. Ne nuk do të jemi në gjendje të evitojmë konfliktin serioz me Francën. Ky konflikt mund të zgjidhet vetëm me gjak dhe hekur. Ka vetëm një rrugë për të garantuar suksesin tonë. Deputetët duhet të vendosin peshën më të madhe të gjakut dhe hekurit në duart e mbretit të Prusisë.”*

Shpjegoni tri pasojat e luftës franko – prusiane, të provokuar nga kancelari Bismark. **3 pikë**

18. *“Ai që zakonisht e quajmë revolucionin industrial, shndërroi fund e krye ekzistencën e njerëzimit dhe përshpejtoi ritmin e historisë së tij. Por shfaqja e tij nuk qe e rastësishme. Për të garantuar triumfin e shpirtit të mekanizimit, duhet të puqeshin bashkë disa kushte dhe kjo ndodhi pikërisht në Angli”.*

**Karl Grimberg,**

**“Historia botërore dhe qytetërimi”**

Cilët ishin tre nga faktorët që e favorizuan Anglinë të industrializohej? **3 pikë**

19. *“Nga gjysma e dytë e shek.XVI filluan të rriten gjithmonë e më shumë roli dhe ndikimi i islamit dhe i parimeve të tij. Gjithnjë e më shumë dallohej kufiri midis myslimanëve dhe të krishterëve. Islamizimi përfshiu më gjerësisht sferën ideologjike, politike, administrative, ushtarake, gjuhësore dhe të jetës në perandori. Legjislacioni osman i jepte përparësi dhe favore popullsisë që përfaqonte fenë islame. I gjithë sistemi shoqëror, politik dhe ekonomik i shtetit osman e vuri ekzistencën e të krishterëve në varësi të myslimanëve, në kushtet e një joshjeje të vazhdueshme.”*

**Petrika Thëngjilli: “Faktorët për përhapjen e fesë islame në Shqipëri”, 2005**

Renditni tri prej formave që u ndoqën për islamizimin e popullsisë shqiptare nga Perandoria Osmane. **3 pikë**

20. Shqipëria u shpall për herë të parë “principatë autonome sovraane dhe e trashëgueshme” në: **1 pikë**

- A) Konferencën e Ambasadorëve në Londër,
- B) Konferencën e Paqes në Paris,
- C) Konferencën e Firences,
- D) Kongresin e Berlinit.

21. Qëllimi kryesor i politikave ekonomike të ndjekura nga Stalini, ishte të: **1 pikë**

- A) thithte investime të huaja.

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- B) zhvillonte më shumë industrinë e rëndë.
- C) prodhonte me bollëk mallra konsumi.
- D) ndihmonte financiarisht të varfrit për të rritur prodhimin bujqësor.

22. Ligjet e Nurembergut lidheshin me:

**1 pikë**

- A) ndalimin e lirisë së shtypit.
- B) ndryshimin e formës së regjimit.
- C) mohimin e të drejtave të hebrenjve.
- D) eliminimin e veprimtarisë së partive politike.

23. Përdorni informacionin e mëposhtëm për t'iu përgjigjur pyetjes.

*“Miq të e mi të mirë, për herë të dytë në historinë tonë, një kryeministër britanik është kthyer nga Gjermania duke sjellë paqe me nder. Unë besoj se kjo është paqja e kohës sonë... . Shkoni në shtëpi dhe flini të qetë.”*

**Neville Chamberlain, (Deklaratë pas kthimit të tij nga Konferenca e Mynihut.)**

Bazuar në deklaratën e mësipërme, cila prej politikave të mëposhtme do të parandalonte një luftë të re?

**1 pikë**

- A) Politika e izolimit.
- B) Politika e lëshimeve.
- C) Politika e kundërpërgjigjes.
- D) Politika e dëmshpërblimeve.

24. *“Faktet provojnë se shumë abuzime ndodhën me urdhër të Stalinit, pa marrë parasysh normat e partisë dhe ligjshmërisë sovjetike. Stalini ishte një njeri shumë dyshues... . Kur Stalini thoshte që dikush duhet të arrestohet, ishte e domosdoshme që të besohej që ai person ishte një “armik i popullit””.*

Bazuar në pasazhin e mësipërm, cili nga udhëheqësit e BRSS mbajti një qëndrim kritik ndaj figurës së Stalinit?

**1 pikë**

- A) Nikita Hrushov
- B) Leonid Brezhnjev
- C) Juri Andropov
- D) Konstatin Çernjenko

25. Cili ishte statusi që fitoi Shqipëria, pas pushtimit nga Gjermania naziste?

- A) Mosnjohje sovraniteti.

**1 pikë**

- B) Sovranitet popullor.  
C) Sovranitet i plotë.  
D) Sovranitet relativ.
26. Prilli i vitit 2009 shënon një nga momentet më të rëndësishme të Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist. Për cilën ngjarje bëhet fjalë? **1 pikë**
- A) Anëtarësimi në Paktin e Stabilitetit.  
B) Marrja e statusit kandidat për BE.  
C) Anëtarësimi në NATO.  
D) Liberalizimi i vizave.
27. Historia politike e shtetit shqiptar, në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e theksuar, me rrëzime të shpeshta të qeverive, revolta të armatosura dhe përpjekje për njohjen dhe konsolidimin e pavarësisë në planin ndërkombëtar. Duke krahasuar organizimin shtetëror gjatë periudhës së republikës dhe monarkisë shqiptare, identifikoni dy ndryshime institucionale midis tyre. **2 pikë**
28. Procesi i projektimit të së ardhmes pas Luftës së Dytë Botërore, u kristalizua në vendimet e disa konferencave që bënë aleatët (BS, Anglia dhe ShBA). Një ndër Konferencat që mori vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e sistemit botëror, ishte ajo e Jaltës.
- a) Renditni tri vendimet kryesore që u morën në këtë konferencë. **3 pikë**  
b) Cila ishte konferenca e radhës që pasoi Jaltën, ende pa përfunduar Lufta e Dytë Botërore? **1 pikë**
29. Në fillim të viteve '30 të shek. XX, Shqipëria bëri përpjekje për të zhvilluar një politikë të jashtme të pavarur nga Italia, duke bërë edhe hapa konkretë në këtë drejtim.
- a) Cili ishte hapi i parë që ndërmoi Shqipëria në këtë drejtim? **1 pikë**  
b) Cilat ishin dy nga veprimet e ndërmarra nga Italia si kundërpërgjigje ndaj kësaj politike të pavarur? **2 pikë**
30. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik vuri nën kontrollin e tij një pjesë të mirë të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, ku u imponua modeli i tij në të gjitha fushat e jetës. Shpjegoni dy tipare të përbashkëta, në planin politik dhe atë ekonomik, që Bashkimi Sovjetik u imponoi vendeve të Evropës Lindore. **2 pikë**



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

31. Dekada 1980 – 1990 shënoi thellimin e krizës politike, shoqërore dhe ekonomike në ish - Jugosllavi. Përfundimi i saj ishte shpërbërja diku paqësore, e diku e dhunshme e këtij shteti shumëkombësh.

- a) Shpjegoni tre faktorë të krizës që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë. **3 pikë**
- b) Cila ishte republika e parë që fitoi pavarësinë në kuadrin e shpërbërjes së ish - Jugosllavisë? **1 pikë**

32. Për një dekadë, Shqipëria dhe Kina komuniste ndërtuan dhe zhvilluan marrëdhënie të ngushta politike dhe ekonomike mes njëra-tjetrës. Prishja e mëvonshme e këtyre marrëdhënieve ishte një goditje e rëndë për ekonominë shqiptare.

- a) Cila ishte ngjarja politike ndërkombëtare që çoi në vendosjen e marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kinës? **1 pikë**
- b) Cila ishte arsyeja që çoi në prishjen e marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kinës? **1 pikë**

33. *“Hoxha qëllimisht dhe sistematikisht e izoloi popullin e tij nga “molepsia” ideologjike, si nga Lindja, ashtu edhe nga Perëndimi. Gazetat, revistat, filmat e huaj dhe udhëtimet jashtë shtetit ishin të ndaluara, turistët e huaj brenda vendit mbikëqyreshin me kujdes. Për dekada të tëra, Shqipëria u karakterizua nga gazetarët e huaj, si një komb i izoluar, si Tibeti i Evropës.*

**” Edwin Jacques, “Shqiptarët”**

Ky izolim ishte një nga pasojat më të rënda të regjimit komunist. Analizoni, se si u reflektua ky izolim në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të shqiptarëve gjatë periudhës komuniste.

**4 pikë**

**Histori - Sesioni II**

1. Në Greqinë antike sistemi qeverisës i qytet- shtetit të Spartës ishte: **1 pikë**  
A) demokraci;  
B) timokraci;  
C) oligarki;  
D) autokraci.
2. Kur mbreti i fundit i Romës u rrëzua nga pushteti, vendi i tij u zëvendësua nga:  
A) dy konsuj; **1 pikë**  
B) dy tribunë;  
C) dy plebej;  
D) dy arhond.
3. Cila prej reformave të mëposhtme që u ndërmorën në Athinë, i takon Perikliut?  
A) Ndarja e shoqërisë në kategori sipas censit të pasurisë (timokracia). **1 pikë**  
B) Dhënia e pagave zyrtarëve të shtetit.  
C) Dëbimi nga qyteti i të padëshiruarve.  
D) Krijimi i Këshillit të të Pesëqindëve.
4. Mbretëria Ilire në fillimet e saj e kishte qendrën politike në territorin juglindor të Ilirisë, rreth liqenit të Ohrit, te fisi i enkelejdëve. Më pas, me ardhjen në pushtet të Glaukias, qendra u zhvendos tek fisi i taulantëve.  
Vini në dukje dy arritje të shtetit ilir nën drejtimin e Glaukias. **2 pikë**
5. Gjatë shek. VIII-V pr.K, ilirët njohën një zhvillim të ri e më të përparuar ekonomik e shoqëror, i cili çoi në krijimin e formacioneve të para shtetërore. Listoni dy nga faktorët kryesorë, që ndikuan në krijimin e formacioneve shtetërore tek ilirët.  
**2 pikë**
6. Traktati i Gaetës u nënshkrua ndërmjet Skënderbeu dhe: **1 pikë**  
A) Mbretërisë së Milanos;  
B) Mbretërisë së Napolit;  
C) Republikës së Venedikut;  
D) Republikës së Raguzës.
7. Qendra e Principatës së Balshajve ishte: **1 pikë**  
A) Kruja;  
B) Berati;  
C) Shkodra;  
D) Gjirokastra.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

8. Gjatë sundimit bizantin në tokat arbërore ekzistonin disa kategori të pronës tokësore. Cila nga kategoritë e mëposhtme i përket kësaj periudhe? **1 pikë**
- A) Hasi.
  - B) Ziameti.
  - C) Timari.
  - D) Bashtina.
9. Shoqëria feudale në Francën mesjetare ishte e karakterizuar nga: **1 pikë**
- A) sundimi i një qeverie të fortë;
  - B) ekzistenca e një kishe të dobët;
  - C) mungesa e armiqësive mes feudalëve fqinjë;
  - D) një sistem varësie marrëdhëniesh dhe detyrimesh.
10. Dyndjet sllave në viset e Ballkanit patën pasoja të shumta demografike, ekonomike dhe ushtarake. Përballja e popullsisë ilire me këto dyndje, pati pasoja të ndryshme në Ilirinë Veriore krahasuar me atë Jugore.
- a) Identifikoni dy arsye përse popullsia në Ilirinë jugore nuk u asimilua nga dyndjet sllave. **2 pikë**
  - b) Pavarësisht dyndjeve të huaja, trashëgimia etno-kulturore e vazhdimësisë iliro-arbëro-shqiptare u ruajt e paprekur. Për këtë, ka argumente të shumta arkeologjike, etnografike dhe gjuhësore. Një prej tyre është Kultura e Komanit. Identifikoni dy komponentët që paraqet kjo kulturë, me rëndësi të veçantë për këtë vazhdimësi. **2 pikë**
11. I pari që i kërkoi Papës ndalimin e indulgjencave ishte: **1 pikë**
- A) Zhan Kalvin;
  - B) Martin Luteri;
  - C) Ulrich Cvingli;
  - D) Henri VIII.
12. Shkëputja politike e SHBA me Britaninë e Madhe, u sanksionua në Deklaratën e Pavarësisë, në vitin: **1 pikë**
- A) 1776
  - B) 1787
  - C) 1861
  - D) 1865
13. Sundimtari i parë i Pashallëkut të Shkodrës ishte: **1 pikë**
- A) Mustafa Pasha;
  - B) Mehmet Pasha;
  - C) Ibrahim Pasha;
  - D) Mahmut Pasha.

14. Cili nga atdhetarët e mëposhtëm ishte drejtori i shkollës së parë Normale shqipe në Elbasan? **1 pikë**

- A) Mit'hat Frashëri;
- B) Gjergj Fishta;
- C) Luigj Gurakuqi;
- D) Sami Frashëri.

15. Zbulimet e mëdha gjeografike u përcaktuan nga një sërë shkaqesh dhe kushtesh. Zbulimi i tokave të reja nga eksploratorët, i ndryshoi rrënjësisht faqen njerëzimit. Të gjitha shkaqet e mëposhtme çuan në zbulimet e mëdha gjeografike, **përveç:** **1 pikë**

- A) përhapjes së krishterimit;
- B) etjes për pasurim;
- C) aleancës me Perandorinë Osmane;
- D) bllokimit të rrugëve për në Lindje.

16. Kongresi i Vjenës me vendimet e tij, siguroi gjatë viteve 1815 – 1848: **1 pikë**

- A) promovimin e institucioneve demokratike.
- B) zgjerimin territorial të SHBA.
- C) balancimin e forcës mes shteteve evropiane.
- D) vendosjen e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare.

17. Periudha e Napoleon Bonapartit është një periudhë me ndryshime të rëndësishme në shumë aspekte për Francën. Jepni një nga reformat që u ndërmorën për secilën nga fushat e mëposhtme. **3 pikë**

Reforma në fushën legjislative:

Reforma në fushën ekonomike:

Reforma në fushën arsimore:

18. *“Ahmet Zogu që kthyer në pushtet me ndihmën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, kryesisht sepse ajo shpresonte të kënaqeshin pretendimet e saj territoriale. A. Zogu ishte i vendosur t'i jepte fund vështirësive ekonomike, që cikloheshin në mënyrë të pandërprerë. Në këto rrethana, kursi i tij ishte të kthehej nga Italia dhe njëkohësisht ta zbuste Jugosllavinë duke i njohur pretendimet e saj”.*

**Joseph Sëire, “Ngritja e një Mbretërie”**

- a) Identifikoni ndryshimin territorial që ndodhi mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut. **1 pikë**
- b) Shpjegoni dy nga arsyet pse marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene nuk patën jetëgjatësi. **2 pikë**

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

19. Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte një lëvizje me karakter politik, kulturor e arsimor, e cila synonte ndërgjegjësimin e shqiptarëve për zgjidhjen e çështjes kombëtare, kultivimin e arsimit dhe kulturës në tërësi, me qëllim nxjerrjen e vendit nga prapambetja dhe futjen në rrugën e zhvillimit. Për këtë qëllim, u hartua dhe një program, që rendiste se cilat ishin nevojat e shqiptarëve në atë periudhë. Cilat ishin tre pikat kryesore të programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

**3 pikë**

20. U aplikua sistemi korporativ në ekonomi, rriti sipërfaqen e punëshme të tokës dhe prodhimin e grurit. Prona private u ruajt, por zbatoi politikën e planifikimit dhe ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

Cilat nga udhëheqësit totalitar i përkasin këto reforma ekonomike? **1 pikë**

- A) J. Stalini;
- B) A. Hitleri;
- C) B. Musolini;
- D) E. Hoxha.

21. Vendimi për krijimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara u mor në: **1 pikë**

- A) Konferencën e Otavës;
- B) Konferencën Jaltës;
- C) Konferencën e Potsdamit;
- D) Konferencën e Parisit.

22. Në programin e saj parashikonte “çrrënjosjen e feudalizmit, çarmatosjen e popullsisë, reforma radikale politike, ekonomike e sociale”.

Programit të kujt qeverie i përkasin këto objektiva? **1 pikë**

- A) Qeverisë së Ismail Qemalit.
- B) Qeverisë së Ahmet Zogut.
- C) Qeverisë së Fan Nolit.
- D) Qeverisë së Shefqet Vërlacit.

23. “Rivendosja e pavarësisë së vendit, vendosja e një regjimi demokratik dhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë”, ishin nga objektivat kryesore të programit politik të:

**1 pikë**

- A) Lëvizjes së Legalitetit;
- B) Partisë Komuniste;
- C) Partisë Fashiste;
- D) Ballit Kombëtar.

24. Përdorni informacionin e mëposhtëm për t'ju përgjigjur pyetjes.

"Më 27 nëntor 1946 pasoi një marrëveshje për bashkëpunim ekonomik mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që parashikonte bashkërendimin e planeve ekonomike mes dy vendeve. Nëse do të ishte vënë në jetë ky plan, ekonomia popullore shqiptare do të ishte bërë njësh me ekonominë jugosllave, gjë që nga ana e saj do të kishte sheshuar rrugën për bashkimin shtetëror të të dy vendeve".

**Peter Bartl, "Shqiptarët"**

Cili nga pohimet e mëposhtme ishte pjesë e kësaj marrëveshje? **1 pikë**

- A) Ngritja e një Banke të përbashkët.
- B) Bashkimi doganor dhe monedha e përbashkët.
- C) Krijimi i kooperativave të përbashkëta bujqësore.
- D) Ngritja e fabrikave dhe uzinave ushtarake jugosllave.

25. Në vitin 1961 Shqipëria i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me: **1 pikë**

- A) Bashkimin Sovjetik
- B) Jugosllavinë
- C) Kinën
- D) SHBA

26. Ngjarja e korrikut të vitit 1990, shënon një nga goditjet më të rënda të sistemit komunist në Shqipëri. Për cilën ngjarje bëhet fjalë? **1 pikë**

- A) Hyrja e qytetarëve në ambasadat perëndimore.
- B) Demonstrata antikomuniste e Kavajës.
- C) Protestat në qytetin Studenti.
- D) Shpallja e pluralizmit politik.

27. Cilat ishin tre nga arsytet që e detyruan Ismail Qemalin dhe qeverinë e tij të jepte dorëheqjen? **3 pikë**

28. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik ishte shteti më i rrënuar me pasoja mjaft të rënda si në rrafshin ekonomik ashtu edhe në atë njerëzor. 20 milion vetë kishin humbur jetën dhe dëmet materiale ishin të pallogaritshme. Vendit i duhej të rimëkëmbej dhe të fillonte një jetë tjetër në kohë paqeje.

Identifikoni katër nga masat kryesore që mori qeveria sovjetike për të kapërcyer këtë situatë. **4 pikë**

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

29. Mikael Gorbaçov erdhi me një program të ri reformash për ta nxjerrë Bashkimin Sovjetik nga kriza në të cilën ishte futur. Pavarësisht vullnetit dhe përpjekjeve të tij, ato nuk rezultuan të suksesshme. Jepni tri arsye pse këto reforma nuk funksionuan. **3 pikë**
30. Pas formimit të saj, Republika Federale Gjermane eci me ritme të shpejta në rrugën e zhvillimit. Të ardhurat për frymë u trefishuan dhe eksportet u dyfishuan.
- a) Cili ishte kancelari i parë i RFGJ që bëri të mundur ringritjen ekonomike të Gjermanisë? **1 pikë**
- b) Përshkruani dy nga faktorët që ndikuan në “mrekullinë ekonomike” gjermane. **2 pikë**
31. Bashkimi Evropian lindi si një bashkim ekonomik pas Luftës së Dytë Botërore, për t’u shndërruar edhe në bashkim politik të vendeve të zhvilluara dhe me demokraci të konsoliduar pas vitit 1957. Sot është një organizatë me shumë ndikim në politikën e Evropës dhe jo vetëm. Hapi më i rëndësishëm i zhvillimit të integritimit evropian është Traktati i Mاستrihtit që quhet ndryshe edhe Traktati i Bashkimit Evropian.  
Cilat ishin tri shtyllat kryesore të këtij Traktati. **3 pikë**
32. Margaret Thecer erdhi në krye të qeverisë britanike si përfaqësuese e Partisë Konservatore, në vitin 1979. Programi i saj synonte të reformonte të gjitha fushat e ekonomisë.  
Jepni tre rezultate pozitive që sollën reformat ekonomike të ndërmarra gjatë qeverisjes së Thecerit në Britani. **3 pikë**
33. Perandresha më e njohur e Rusisë ishte Katerina II ose siç njihet në histori Katerina e Madhe. Qëndrimi që ajo mbajti ndaj fisnikërisë ishte i ndryshëm me atë të Pjetrit të Madh. Identifikoni respektivisht dy nga masat e marra nga këta monarkë reformatorë ndaj shtresës së fisnikërisë. **4 pikë**  
Dy masat që mori Katerina e Madhe:  
Dy masat që mori Pjetri i Madh:

## KIMI

Kimia si lëndë shkencore i ofron nxënësit mundësi të zhvillojë aftësi për të:

- kuptuar dukuritë kimike natyrore,
- shpjeguar ligjet që veprojnë në fushën e saj,
- dalluar diversitetin e substancave kimike,
- kryer hulumtime rreth përbërjes dhe vetive të substancave,
- zbuluar ndërvarësinë e vetive kimike të çdo substance nga përbërja kimike e saj,
- njohur dhe zbatuar një serë procesesh teknologjike kimike, si ato që kanë të bëjnë me prodhime substancash, lëndësh larëse, barnash të ndryshme, kozmetika, plastika të shumëllojshme apo dhe procese të tjera si nxjerrje metalesh e përgatitje lidhjesh metalike, prodhime të substancave duke harxhuar energji dhe anasjellas.
- shpjeguar, analizuar dhe përdorur metoda të ndryshme për zgjidhjen e ushtrimeve e problemeve, në të cilat janë zbatuar njohuritë teorike kimike.
- studiuar dhe kuptuar si realizohen një sërë reaksionesh kimike (metabolike) te njerëzit, bimët dhe kafshët.

Pra, kimia është shkencë që studion përbërjen dhe vetitë e substancave përbërëse të botës së gjallë dhe jo të gjallë, si dhe ligjet kimike që lidhin vetitë me përbërjen kimike të substancave.

Hartimi i testit për lëndën e kimit mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së kimit bazohet në:

- programet e lëndës së kimit bërthamë për klasën e 10-të;
- programet e lëndës së kimit bërthamë për klasën e 11-të;
- programin e lëndës së kimit me zgjedhje për klasën e 12-të.

Bazuar në programin orientues, përmbushja e kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet 2 tematikave kryesore:

- diversiteti
- ndërveprimet.

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të kimit.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja.



---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të programit orientues mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënit të programit orientues. Disa nga kompetencat që janë testuar në provimin e kimisë për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

### ***Rezultatet e të nxënit për nivelin e parë të vështirësisë:***

- njehson masën atomike të krahasuar të një elementi duke njohur përqindjen e përhapjes në natyrë të izotopeve dhe anasjellas;
- përshkruan nivelet dhe nënnivelet energjetike për katër shtresat e para elektronike;
- përcakton numrin e nëniveleve energjetike në një nivel energjetik;
- tregon numrin e elektroneve që vendosen te nënnivelet s, p, d , f
- përshkruan format e orbitaleve s dhe p;

### ***Rezultatet e të nxënit për nivelin e dytë të vështirësisë:***

- analizon vendosjen e elementeve në tabelën periodike, vetitë e tyre, duke përdorur konfigurimin elektronik;
- përshkruan tabelën periodike si një sistem për të klasifikuar elementet dhe për të parashikuar përdorimin dhe vetitë e tyre;
- krahason vetitë e elementeve të grupeve IA, IIA, VII A, VIII A dhe tregon se vetitë e tyre varen nga shtresa e jashtme elektronike e atomeve përkatëse;

### ***Rezultatet e të nxënit për nivelin e tretë të vështirësisë:***

- shpjegon formën gjeometrike dhe këndin e lidhjes në molekulat, me anë të teorisë së VSEPR-it (teoria e shtytjes së çifteve elektronike të shtresës valentore), në rastet kur atomi qendror ka 2-4 çifte elektronike;
- interpreton acidet dhe bazat sipas teorisë Bronshtet-Lourit duke përfshirë përdorimin e koncepteve acid-I baze-I, acid-II baze-II.
- interpreton forcën elektromotore të elementeve galvanikë duke shfrytëzuar të dhëna të tabelës së potencialeve elektrodike standarde;
- gjykon mbi produktet që çlirohen gjatë elektrolizës së elektroliteve në gjendje të shkrirë apo të tretur;
- shkruan barazimin e përgjithshëm të elektrolizës, kur elektroliti është në gjendje të shkrirë apo të tretur;
- parashikon reaksionet e mundshme dhe aktivitetin e mundshëm të elementeve nga pozicioni i tyre në tabelën periodike;

### **Struktura e testit**

Testi i kimisë ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

## MATURA SHETËRORE 2019

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 10 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi për lëndën e kimisë ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

NR.	TEMATIKAT	Pesha %	Nr. pikëve	NIVELET		
				Niveli I - 40%	Niveli II - 40%	Niveli III - 20%
1	Diversiteti	46	26	11	11	4
2	Ndërveprimi	54	34	13	13	8
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>60</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>12</b>

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh.

### Llojet e pyetjeve

Pyetjet e testit të kimisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënit dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një grafik, një strukturë, një figurë apo një model hapësinor. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

**TESTE**

**Kimi - Sesion I**

1. Në natyrë, elementi X ndodhet si përzierje e dy izotopeve, njëri me numër mase 107 dhe tjetri me numër mase 109. Nëse përqindja e izotopit të parë është 1,5 herë më e madhe se ajo e izotopit të dytë, atëherë përqindja e izotopit të dytë është: **1 pikë**
- A) 40%  
B) 50%  
C) 60%  
D) 70%
2. Për atomin e elementit me numër atomik  $Z = 35$ : **4 pikë**
- a) paraqitni konfigurimin elektronik (diagramin e shpërndarjes së elektroneve).  
b) përcakttoni vlerat e 4 numrave kuantikë (sipas radhës së mbushjes) për elektronin e katërbëdhjetë.  
c) vizatoni format sipas orientimeve hapësinore të orbitaleve s dhe px.  
d) ndërtoni diagramin e kalimit nga atom në jon të këtij elementi.
3. Një nga atomet apo jonet ka elektrone vetëm në dy nivele energjie. Ai është: **1 pikë**
- A) Na  
B)  $\text{Li}^+$   
C)  $\text{Be}^{2+}$   
D)  $\text{F}^-$   
( $Z_{\text{Na}}=11$ ;  $Z_{\text{Li}}=3$ ;  $Z_{\text{Be}}=4$ ;  $Z_{\text{F}}=9$ )
4. Përgjigjuni kërkesave: **4 pikë**
- a) shkruani barazimet kimike për shndërrimet e mëposhtme:  
 $\text{Ca} \rightarrow \text{Ca(OH)}_2 \rightarrow \text{CaCO}_3 \rightarrow \text{CaO} \rightarrow \text{CaSO}_4$ .
- b) ndërtoni një diagram ku të tregoni si ndryshon rrezja e atomit të kalciumit në lidhje me elementet që e rrethojnë, numrat atomikë Z të cilëve janë:  $Z = 12$ ,  $Z = 38$ ,  $Z = 19$ ,  $Z = 21$ .
- c) renditni bromin, klorin, fluorin dhe jodin, sipas aftësisë për të zëvendësuar njëri-tjetrin.  
Shkruani të paktën një reaksion.
- d) përcakttoni vendndodhjen në sistemin periodik të elementit, numri atomik i të cilit është:  $Z = 25$ .

MATURA SHITETËRORE 2019

5. Nga bashkëveprimi i hidroksidit të natriumit të ftohtë (në 15°C) me klorin, përfitohet: **1 pikë**

- A)  $\text{Cl}_2\text{O}_3$
- B)  $\text{Cl}_2\text{O}_5$
- C)  $\text{NaClO}_3$
- D)  $\text{NaOCl}$

6. Cili nga elementet është më elektropozitiv? **1 pikë**

- A) Fr
- B) K
- C) Ca
- D) Ba

( $Z_{\text{Ca}}=20$ ,  $Z_{\text{Fr}}=87$ ,  $Z_{\text{Ba}}=56$ ,  $Z_{\text{K}}=19$ .)

7. Bariumi është në një grup me Ca. Cili nga pohimet përcakton një veti të Ba:

- A) Vepron me oksigjenin dhe jep oksidin acid  $\text{BaO}$ . **1 pikë**
- B) Tretësira ujore e tij nuk përcjell rrymën elektrike.
- C) Përbërja e tij me klorin e ka formulën  $\text{Ba}_2\text{Cl}$ .
- D) Vepron me vrull me ujë duke çliruar  $\text{H}_2(\text{g})$ .

8. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë simbolet e elementeve të periodës së tretë. **4 pikë**

Na (Z=11)	Mg (Z=12)	Al (Z=13)	Si (Z=14)	P (Z=15)	S (Z=16)	Cl (Z=17)	Ar (Z=18)
--------------	--------------	--------------	--------------	-------------	-------------	--------------	--------------

Tregoni si ndryshon:

- a) shtesa e jashtme elektronike e secilit element (ose si ndryshon rrezja nga e majta në të djathtë të periodës).
- b) vetia reduktuese e secilit brenda periodës nga e djathta në të majtë.
- c) karakteri i oksideve të tyre (nga e majta në të djathtë).
- d) energjia e jonizimit, energjia e afërsisë për elektronin dhe EN brenda periodës, nga e djathta në të majtë.

9. Një lidhje jonike formohet kur: **1 pikë**

- A) çifti elektronik i përbashkët është i baraslarguar nga dy atomet.
- B) zona e mbulimit midis dy orbitaleve atomike është e madhe.
- C) diferenca e EN të dy atomeve që lidhen është më e vogël se 0.5.
- D) çifti elektronik kalon plotësisht drejt atomit më elektronegativ.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

10. Në kushte të caktuara, nga bashkëveprimi i hidrogjenit me oksigjenin formohet ujë. Lidhja ndër molekulare që realizohet midis hidrogjenit të njëjës molekulë dhe oksigjenit të molekulës tjetër është: **1 pikë**
- A) dyfishe,  
B) kovalente jopolare,  
C) hidrogjenore,  
D) jonike.
11. Shpjegoni: **4 pikë**
- a) në cilin grup të sistemit periodik duhet të bëjë pjesë elementi X, që molekula  $XCl_3$  të ketë moment dipolar të barabartë me zero.  
b) sa është këndi që formon atomi qendror në molekulën e ujit,  $H_2O$ , ( $Z_O=8$ ,  $Z_H=1$ ).  
c) cila është forma gjeometrike e molekulës së amoniakut,  $NH_3$ , ( $Z_N=7$ ;  $Z_H=1$ ).  
d) në cilën nga molekulat  $H_2S$ ,  $H_2Te$ ,  $H_2O$ ;  $H_2Se$ , forcat ndër molekulare të Van der Valsit janë më të mëdha. ( $Ar_H=1$ ;  $Ar_S=32$ ;  $Ar_O=16$ ;  $Ar_{Se}= 78,9$ ;  $Ar_{Te}=127,6$ ;  $Ar_{Cl}=35,5$ .)  
(shënim: për pikën a, b, dhe c përgjigjet duhet të shoqërohen me skemat përkatëse).
12. Një lidhje dyfishe ndodhet në molekulën e përbërjes, emërtimi i së cilës është: **1 pikë**
- A) etanol  
B) butanal  
C) propan  
D) amoniak
13. Shkruani formulat e strukturës për përbërjet e mëposhtme: **4 pikë**
- a) etil-3, dimetil -2,5- hepten -1  
b) dimetil -2, 2 - propan  
c) trans diklor - 1,2 - eten  
d) butanol -2
14. Njihsoni: **4 pikë**
- a) vëllimin e oksigjenit (në K.N.) që nevojitet për djegien e 14 gram penten (në K.N.). ( $Ar_C=12$ ;  $Ar_H=1$ )  
b) masën në gram të  $CaO$  që do të veprojë me 300 ml tretësirë 0,5 M HCl. ( $Ar_{Ca}=40$ ;  $Ar_O=16$ )  
c) numrin e mol-atomeve të secilit element që ndodhen në 14,2 gram  $Na_2SO_4$ . ( $Mr_{Na_2SO_4}=142$ )  
d) % e kalciumit që ndodhet në 374 gram xeheror, i cili përmban 89,2 %  $Ca_3(PO_4)_2$ . ( $Ar_{Ca}=40$ ,  $Ar_P=31$   $Ar_O=16$ )
15. Njihsoni: **4 pikë**

MATURA SHITETËRORE 2019

---

- a) përqendrimin molar të një tretësire që përmban 0.6 mol substancë në tre litra të saj.
- b) masën në gram të precipitatit  $\text{PbCrO}_4$  që përfitohet kur futen në reaksion 20g  $\text{Na}_2\text{CrO}_4$  me 1litër tretësirë 0,1M  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$ . ( $M_{\text{rPb}(\text{NO}_3)_2} = 331$ ;  $M_{\text{rPbCrO}_4} = 323$ ;  $M_{\text{rNa}_2\text{CrO}_4} = 162$ )
- c) rendimentin e reaksionit kur dihet se nga veprimi i 44,8 litra azot me hidrogjen u përftuan 33,6 litra amoniak.
- d) për të përcaktuar formulën molekulare të një përbërjeje organike kur dihet se: përqindja e karbonit në një mostër të saj është 24,8 %, e klorit në po atë mostër është 71,2 % dhe pjesa tjetër është hidrogjen. (masa molare e përbërjes është 99g/mol.) ( $A_{\text{rC}}=12$ ,  $A_{\text{rCl}}=35,5$ )

16. pH njehsohet:

1 pikë

- A)  $[\text{H}_3\text{O}^+] \cdot [\text{OH}^-]$   
B)  $-\log 10^{-14}$   
C)  $-\log [\text{H}_3\text{O}^+]$   
D)  $-\log [\text{OH}^-]$

17. Vlera e pOH-së së tretësirës 0,05 M  $\text{Ba}(\text{OH})_2$  është:

1 pikë

- A) 1  
B) 3  
C) 5  
D) 9

18. Nga veprimi i karbonateve të metaleve alkaline apo alkalino - tokësore me HCl përfitohet një substancë në gjendje të gaztë, formula kimike e së cilës është:

1 pikë

- A)  $\text{CO}_2$   
B)  $\text{Cl}_2$   
C)  $\text{H}_2$   
D)  $\text{Cl}_2\text{O}$

19. Reaksion ekzotermik është:

1 pikë

- A)  $\text{CaCO}_3(\text{ng}) \rightarrow \text{CaO}(\text{ng}) + \text{CO}_2(\text{g})$   
B)  $2\text{HgO}(\text{ng}) \rightarrow 2\text{Hg}(\text{ng}) + \text{O}_2(\text{g})$   
C)  $\text{N}_2(\text{g}) + 3\text{H}_2(\text{g}) \rightarrow 2\text{NH}_3(\text{g})$   
D)  $2\text{NH}_3(\text{g}) \rightarrow \text{N}_2(\text{g}) + 3\text{H}_2(\text{g})$

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

20. Në kushte standarde, vlera e  $\Delta H_{r298}$  për reaksionin:  $2\text{Fe}(\text{CO})_5(\text{g}) + 3\text{CO}_2(\text{g}) \rightarrow \text{Fe}_2\text{O}_3(\text{ng}) + 13\text{CO}(\text{g})$ , është: **1 pikë**

- A) - 193 kJ
- B) + 193 kJ
- C) - 394 kJ
- D) + 394 kJ

( $\Delta H_f^\circ \text{Fe}(\text{CO})_5(\text{g}) = -733\text{kJ/mol}$ ;  $\Delta H_f^\circ \text{CO}_2(\text{g}) = -394\text{kJ/mol}$ ;  $\Delta H_f^\circ \text{CO}(\text{g}) = -110\text{kJ/mol}$ ;  $\Delta H_f^\circ \text{Fe}_2\text{O}_3(\text{ng}) = -824\text{kJ/mol}$ )

21. Jepet reaksioni:  $\text{Br}_2(\text{uj}) + \text{HCOOH}(\text{uj}) \xrightarrow{\text{H}^+} 2\text{Br}^- + 2\text{H}^+(\text{uj}) + \text{CO}_2(\text{g})$ . Bazuar në njohuritë e mara, shpejtësia e ndryshimit të përqendrimit të bromit njehsohet nga formula: **1 pikë**

- A)  $+ [\text{Br}_2] / [\text{HCOOH}]$
- B)  $+ \Delta \text{CBr}_2 / \Delta [\text{H}^+]$
- C)  $- [\text{Br}_2] / [\text{HCOO}^-]$
- D)  $- \Delta [\text{Br}_2] / \Delta t$

22. Reaksioni i bashkëveprimit të mermerit (të grimcuar në copa me madhësi të ndryshme) me acidin klorhidrik të holluar përdoret për të hetuar ndikimin e një prej faktorëve në shpejtësinë e reaksionit. Në këtë rast, ky faktor është: **1 pikë**

- A) katalizatori që përdoret në këtë reaksion.
- B) sipërfaqja e kontaktit të mermerit me acidin.
- C) temperatura, në të cilën zhvillohet reaksioni.
- D) natyra e lidhjeve kimike të formulat e reaktantëve.

23. Një reaksion endotermik mund të zhvillohet me ose pa katalizator, por në masë kohore të ndryshme. Vlera e energjisë së aktivizimit në këtë rast, mund të jetë: **1 pikë**

- A) më e madhe të reaksioni me katalizator.
- B) më e vogël të reaksioni pa katalizator.
- C) e njëjtë në të dy llojet e reaksioneve.
- D) më e madhe të reaksioni pa katalizator.

24.

- a) Përqendrimet e  $N_2$ ,  $H_2$  dhe  $NH_3$  (në ekuilibër), në një enë me vëllim 1 litër, sipas radhës janë 0,3 mol/l; 0,4 mol/l; 0,1 mol/l. Sa do të jetë përqendrimi i  $H_2$  në enën (me vëllim 1 litër) në një ekuilibër të ri, nëse përqendrimi i  $NH_3$  dyfishohet (temperatura mbahet konstante). **2 pikë**
- b) Shpjegoni çfarë ndodhi me vlerën e konstantes së ekuilibrit kur përqendrimi i amoniakut u rrit dy herë. **1 pikë**
- c) Në cilin kah do të zhvendoset ekuilibri nëse në reaksionin e mësipërm ulim trysninë. **1 pikë**

25. Përqendrimi i joneve hidrokside në një tretësirë ujore është  $1 \times 10^{-9} M$  (në  $25^\circ C$ ). Përqendrimi i joneve hidron në këtë tretësirë do të jetë: **1 pikë**

- A)  $10^{-5} M$   
B)  $10^{-7} M$   
C)  $10^{-9} M$   
D)  $10^{-11} M$

26. Bazuar në teorinë acido - bazike të Bronshted –Luvri, themi se joni që shfaq **vetëm** veti acide është: **1 pikë**

- A)  $OH^-$   
B)  $HSO_3^-$   
C)  $NH_4^+$   
D)  $NO_2^-$

27. Vlera e pH të një tretësire të përfutuar nga përzierja e 100 ml tretësirë 0,1M e LiOH me 200 ml tretësirë 0,2 M të acidit klorhidrik është: **1 pikë**

- A) 1  
B) 3  
C) 5  
D) 7




---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

28. Elektrokimia është degë e shkencës së kimisë që studion proceset që zhvillohen gjatë kalimit të rrymës elektrike në tretësirat ujore të elektrolitëve dhe proceset që zhvillohen në elementet galvanikë. **4 pikë**

- a) Shpjegoni si zhvillohet elektroliza e tretësirës ujore të përqendruar të NaCl.
- b) Paraqitni skematikisht elementin galvanik, i cili përbëhet nga gjysmë elementi i zinkut dhe gjysmë elementi i bakrit.
- c) Njehsoni f.e.m e këtij elementi kur dihet se  $E^{\circ}_{\text{Cu}^{2+}/\text{Cu}} = + 0,34 \text{ V}$  dhe  $E^{\circ}_{\text{Zn}^{2+}/\text{Zn}} = - 0,76 \text{ V}$ .
- d) Përcaktoni jonin që sillet si agjent oksidues më i fuqishëm në mjedis acid:



29. Një nga reaksionet e mëposhtme është reaksion zëvendësimi nukleofilik. Ai është: **1 pikë**

- A)  $\text{C}_6\text{H}_6 + \text{Cl}_2 \rightarrow \text{C}_6\text{H}_5\text{-Cl} + \text{HCl}$
- B)  $\text{C}_2\text{H}_4 + \text{HCN} \rightarrow \text{C}_2\text{H}_5\text{CN}$
- C)  $\text{C}_2\text{H}_5\text{Cl} + \text{OH}^- \rightarrow \text{C}_2\text{H}_5\text{OH} + \text{Cl}^-$
- D)  $\text{C}_2\text{H}_5\text{-OH} + \text{Na} \rightarrow \text{C}_2\text{H}_5\text{-ONa} + \frac{1}{2} \text{H}_2$

30. Bazuar në njohuritë e mara për hidrokarburet dhe përbërjet e oksigjenuara shkruani: **4 pikë**

- a) stadin e parë të mekanizmit të reaksionit të zëvendësimit radikal, në prani të dritës të metani.
- b) reaksionet e plota të kalimit:  $\text{CH}_3\text{OH} \rightarrow \text{HCHO} \rightarrow \text{HCOOH}$ .
- c) reaksionin e eliminimit të një mol acidi halogjenhidrik nga një mol rrjedhës i halogjenuar (KOH/etanol).
- d) formulat për një grimcë elektrofilike dhe një grimcë nukleofilike.

**Kimi - Sesioni II**

1. Dy atome të të njëjtit element duhet të kenë numër: **1 pikë**  
 A) të njëjtë elektronesh,  
 B) të njëjtë nukleonesh,  
 C) të ndryshëm protonesh,  
 D) të njëjtë mase.
2. Rubidiumi (grupi IA) formon dy izotope natyrorë, njëri me numër mase  $A=85$  dhe tjetri me numër mase 87. Përqindjet e tyre sipas radhës janë përkatësisht 72 % dhe 28 %. Numri atomik i tij është 37. **4 pikë**  
 a) Njihsoni masën mesatare të rubidiumit.  
 b) Shkruani formulën elektronike të atomit të rubidiumit.  
 c) Shkruani formulën oksidit të rubidiumit.  
 d) Njihsoni masën në gram të klorit ( $\text{Cl}_2$ ) që futet në reaksion me 20 gram rubidium ( $A_r=85$ ), për të përfutur klorur rubidiumi,  $\text{RbCl}$ . ( $A_r\text{Cl}=35,5$ )
3. Dihet që vendndodhja e një elektroni në atom përcaktohet nga vlerat e 4 numrave kuantikë. Cili nga kombinimet e mëposhtme të vlerave të katër numrave kuantikë i përket elektronit që ndodhet në  $3p^6$ . **1 pikë**  
 A)  $n = 3 \quad l = 1 \quad m = 0 \quad m_s = + 0,5$   
 B)  $n = 3 \quad l = 1 \quad m = - 1 \quad m_s = + 0,5$   
 C)  $n = 3 \quad l = 1 \quad m = + 1 \quad m_s = - 0,5$   
 D)  $n = 3 \quad l = 1 \quad m = + 1 \quad m_s = + 0,5$
4. Jepen shndërrimet e mëposhtme: **4 pikë**  
 $\text{Ca} \rightarrow \text{CaO} \rightarrow \text{CaCl}_2$   
 a) Shkruani barazimet kimike të reaksioneve.  
 b) Shkruani formulën elektronike të jonit  $\text{Ca}^{2+}$  ( $Z = 20$ ).  
 c) Në cilin grup të oksideve bën pjesë oksidi i kalciumit?  
 d) Tregoni si ndryshon rrezja e atomit të kalciumit në lidhje me elementet që e rrethojnë. ( $Z = 38, Z = 19, Z = 21, Z = 12$ )
5. Numri atomik i elementit X është  $Z = 17$ . Ngarkesa e jonit dhe grupi ku bën pjesë ky element janë: **1 pikë**  
 A)  $\text{X}^{2+}$  grupi IIB  
 B)  $\text{X}^{5+}$  grupi VB.  
 C)  $\text{X}^-$  grupi VIIA  
 D)  $\text{X}^{3-}$  grupi VA;

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

6. Jepen çiftet e elementeve të mëposhtme. Cili prej tyre e ka më të vogël shumën e vlerave të elektronegativitetit? **1 pikë**

- A) Cs, Ca;
- B) O, F;
- C) Na, Mg;
- D) Li, C.

( $EN_{Li} = 1,2$ ;  $EN_C = 2,5$ ;  $EN_O = 3,16$ ;  $EN_F = 4$ ;  $EN_{Na} = 0,9$ ;  $EN_{Mg} = 1,2$ ;  
 $EN_{Cs} = 0,8$ ;  $EN_{Ca} = 1$ )

7. Kalciumi është në një grup me Mg. Cili nga pohimet përcakton një veti të Ca:

- A) vepron me oksigjenin dhe jep oksidin acid CaO, **1 pikë**
- B) tretësira ujore e tij nuk përcjell rrymën elektrike,
- C) përbërja e tij me klorin e ka formulën  $Ca_2Cl$ ,
- D) vepron me vrull me ujin duke çliruar  $H_{2(g)}$ .

8. Janë dhënë elementet S, Si, Cl, P. **4 pikë**

- a) Shpjegoni cili nga elementet e ka më të madhe vlerën e afërsisë për elektronin.
- b) Listoni ata sipas rritjes së vlerës së potencialit të jonizimit.
- c) Shkruani formulat e oksideve që ato formojnë (për valencën më të lartë).
- d) Shkruani formulat e oksiacideve që formon squfuri (IV dhe VI valent).  
( $Z_{Si} = 14$ ,  $Z_P = 15$ ,  $Z_{Cl} = 17$ ,  $Z_S = 16$ )

9. Një lidhje kovalente është aq më e dobët sa:

- A) më e madhe të jetë zona e mbulimit,
- B) më e madhe të jetë energjia e lidhjes,
- C) më afër të jenë bërthamat e atomeve,
- D) më e madhe të jetë gjatësia e lidhjes. **1 pikë**

10. Një nga karakteristikat e mëposhtme nuk i përket lidhjes sigma: **1 pikë**

- A) realizohet me anë të mbulimit boshtor të orbitaleve s-s, s-px, px-px.
- B) formohet me anë të mbulimit anësor të dy orbitaleve atomike,
- C) energjia që nevojitet për prishjen e lidhjes sigma është e madhe,
- D) lidhja sigma është më e fortë dhe më e qëndrueshme se lidhja pi.

11. Jepen formulat kimike të përbërjeve:  $CH_4$ ,  $NH_3$ , **4 pikë**

- a) Përcaktoni atomin qendror për çdo molekulë.
- b) Vizatoni formën gjeometrike të molekulës së amoniakut.
- c) Krahasoni lidhjet C-H, N-H, bazuar në polaritetin e tyre.
- d) Shpjegoni cila molekulë është polare dhe pse.

( $Z_C = 6$ ;  $Z_N = 7$ ;  $Z_H = 1$ ;) ( $EN_C = 2,5$ ;  $EN_N = 3$ ;  $EN_H = 2,1$ )

12. Lidhja dyfishe përbëhet nga: **1 pikë**

- A) dy lidhje sigma dhe një pi,
- B) një lidhje pi dhe një sigma,
- C) vetëm dy lidhje sigma,
- D) vetëm dy lidhje pi.

13. Shkruani formulat e strukturës së plotë për përbërjet e mëposhtme: **4 pikë**

- a) acid etanoik,
- b) metil -2 pentan,
- c) diklor - 1,2 – etan,
- d) butanol -2.

14. Masa molare e një hidrokarburi është 57 herë më e madhe se masa molare e hidrogjenit ( $H_2$ ). 18 g të kësaj mase e përbën hidrogjeni. **4 pikë**

- a) Përcaktoni formulën molekulare të përbërjes.
- b) Shkruani formulat e dy prej izomerëve të vargut të kësaj përbërjeje.
- c) Emërtoni izomerët që shkruajtet sipas IUPAC.
- d) Shkruani formulat gjysmë strukturore për dy alkoole vargore të ngopura, të cilët kanë po aq atome karboni në molekulat e tyre sa ka dhe ky hidrokarbur.  
( $A_C=12$ ,  $A_H=1$ )

15. Njehsoni: **4 pikë**

- a) masën në g të acidit sulfurik që ndodhet në 1000ml tretësirë me përqendrim 0,1M. ( $M_r H_2SO_4 = 98$ );
- b) përqindjen e kalciumit që ndodhet në 500 gram fosfat kalciumi,  $Ca_3(PO_4)_2$ . ( $A_rCa=40$ ;  $A_rP = 31$ ;  $A_rO=16$ .)
- c) përqendrimin molar të tretësirës së acidit klorhidrik, HCl, që përmban 0,1 mol acid në 100 ml të saj.
- d) vëllimin që zënë në kushte normale 22 g  $CO_2$ . ( $A_rC = 12$ ;  $A_rO = 16$ )

16. Baza e konjuguar për  $H_3O^+$  është: **1 pikë**

- A)  $H_3O^-$
- B)  $H_3O^+$
- C)  $H_2O$
- D)  $O^{2-}$

17. Cili nga reaksionet nuk ndodh? **1 pikë**

- A)  $SO_2 + 2H_2O \rightarrow S(OH)_4$
- B)  $K_2O + H_2O \rightarrow 2 KOH$
- C)  $CaO + CO_2 \rightarrow CaCO_3$
- D)  $CO_2 + H_2O \rightarrow H_2CO_3$

18. Cili nga elementet nuk vepron me acidin sulfurik të holluar? **1 pikë**

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

- A) Cu
- B) Fe
- C) Al
- D) Zn

19. Reaksion endotermik është:

**1 pikë**

- A)  $N_{2(g)} + 3H_{2(g)} \rightarrow 2NH_{3(g)}$   $\Delta H < 0$
- B)  $2SO_{2(g)} + O_{2(g)} \rightarrow 2SO_{3(g)}$   $\Delta H < 0$
- C)  $CaCO_{3(ng)} \rightarrow CaO_{(ng)} + CO_{2(g)}$   $\Delta H > 0$
- D)  $2Hg_{(ng)} + O_{2(g)} \rightarrow 2HgO_{(ng)}$   $\Delta H < 0$

20. Jepet reaksioni  $CH_{4(g)} + Cl_2 \rightarrow CH_3Cl_{(g)} + HCl_{(g)}$ . Duke ditur se energjitë e lidhjeve të reaktantëve dhe produktëve sipas radhës janë: C-H, 410 kJ/mol; Cl-Cl, 242 kJ/mol; C-Cl, 340 kJ/mol; H-Cl, 431 kJ/mol, vlera e  $\Delta H$ - së së reaksionit është:

**1 pikë**

- A) + 270 kJ
- B) - 270 kJ
- C) - 119 kJ
- D) + 119 kJ

21. Në shpejtësinë e reaksionit ndikojnë disa faktorë. Prania e një katalizatori gjatë zhvillimit të reaksionit ndikon në:

**1 pikë**

- A) rritjen e energjisë së reaktantëve
- B) rritjen e temperaturës së sistemit
- C) kthimin e kahut të reaksionit
- D) uljen e energjisë së aktivizimit

22. Jepet reaksioni:  $H_2O_{2(uj)} + 2I^-_{(uj)} + 2H^+_{(uj)} \rightarrow 2H_2O_{(l)} + I_{2(uj)}$

Për 20 sek përqendrimi i jodit rritet nga 0,01 mol/l në 0,05 mol/l. Shpejtësia e reaksionit është:




**1 pikë**

- A)  $2 \times 10^{-6}$  mol/l
- B)  $2 \times 10^{-3}$  mol/l
- C)  $2 \times 10^{-4}$  mol/l
- D)  $2 \times 10^{-5}$  mol/l

23. Acidi nitrik përftohet duke kaluar nëpërmjet disa hallkave:

**1 pikë**

Pt



Nëse përqendrimi i NO është 0,7 mol/l, përqendrimi i O<sub>2</sub> është 0,45 mol/l dhe

K = 5,8 x 10<sup>-6</sup> L<sup>2</sup> mol<sup>-2</sup> s<sup>-1</sup>, vlera e shpejtësisë së reaksionit është:

- A) 1,20 x 10<sup>-3</sup> mol L<sup>-1</sup> s<sup>-1</sup>,
- B) 1,42 x 10<sup>-4</sup> mol L<sup>-1</sup> s<sup>-1</sup>,
- C) 1,50 x 10<sup>-5</sup> mol L<sup>-1</sup> s<sup>-1</sup>,
- D) 1,27 x 10<sup>-6</sup> mol L<sup>-1</sup> s<sup>-1</sup>,

24.

a) Njehsoni përqendrimin e NO<sub>2(g)</sub> në ekuilibër në tretësirën e përftuar nga tretja e 0,40 mol N<sub>2</sub>O<sub>4(g)</sub> në 400 ml kloroform (reaksioni arrin në ekuilibër, në një temperaturë të caktuar). Më poshtë jepet reaksioni dhe vlera e konstantes së ekuilibrit: N<sub>2</sub>O<sub>4(g)</sub> ↔ 2NO<sub>2(g)</sub> (K<sub>e</sub> = 10<sup>-5</sup>) **2 pikë**

b) shpjegoni çdo të ndodhë me vlerën e konstantes së ekuilibrit nëse përqendrimi i dioksidit të azotit rritet dy herë. **1 pikë**

c) në cilin kah do të zhvendoset ekuilibri nëse në reaksionin e mësipërm rrisim trysinë. **1 pikë**

25. Përqendrimi i joneve hidrogjen në një tretësirë ujore është 10<sup>-5</sup> M (në 25°C).

Përqendrimi i joneve hidrokside në këtë tretësirë do të jetë: **1 pikë**

- A) 10<sup>-9</sup> M
- B) 10<sup>-7</sup> M
- C) 10<sup>-5</sup> M
- D) 10<sup>-3</sup> M

26. Cila nga tretësirat ujore të bazave të mëposhtme shfaq veti bazike më të forta?

**1 pikë**

- A) CH<sub>3</sub>NH<sub>2</sub>      K<sub>b</sub> = 4,4 x 10<sup>-4</sup>
- B) N<sub>2</sub>H<sub>4</sub>        K<sub>b</sub> = 3,0 x 10<sup>-6</sup>
- C) S<sup>2-</sup>            K<sub>b</sub> = 7,7 x 10<sup>-2</sup>
- D) NH<sub>3</sub>          K<sub>b</sub> = 1,8 x 10<sup>-5</sup>

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

27. Në 0,5 litra ujë të pastër, në 25 °C u shtuan  $2 \times 10^{-5}$  mol  $H_2SO_4$ . Vlera e pH të kësaj tretësire është: **1 pikë**

- A) 4,1
- B) 2,0
- C) 4,4
- D) 4,7

28. Elektrokimia është degë e shkencës së kimisë që studion proceset që zhvillohen gjatë kalimit të rrymës elektrike në tretësirat ujore të elektrolitëve, në shkrirjet e tyre, si dhe proceset që zhvillohen në elementet galvanikë. **4 pikë**

- a) Shkruani reaksionet që ndodhin në elektroda gjatë elektrolizës së klorurit të kaliumit, KCl në gjendje të shkrirë.
- b) Shkruani reaksionet për elementin galvanik, i cili përbëhet nga gjysmë elementi i argjendit dhe gjysmë elementi i bakrit.
- c) Njehsoni f.e.m e këtij elementi.  
(potencialet e reduktimit elementeve bakër dhe argjend janë përkatësisht + 0,34 V dhe + 0,80 V).
- d) Përcaktoni numrat e oksidimit të elementeve në reaksionin redoks:  
 $Zn + H_2SO_4 = ZnSO_4 + H_2$

29. Një prej reaksioneve të mëposhtme është një reaksion esterifikimi **1 pikë**

- A)  $C_2H_4 + C_2H_4 + C_2H_4 \rightarrow [-CH_2 - CH_2-]_3$
- B)  $C_2H_5ONa + H_2O \rightarrow C_2H_5OH + Na^+ + OH^-$
- C)  $CH_3-COOH + CH_3OH \leftrightarrow CH_3COO CH_3 + H_2O$
- D)  $C_2H_5-COOH + Na \rightarrow C_2H_5-COONa + \frac{1}{2} H_2$

30.

- a) Alkenet bëjnë pjesë në grupin e hidrokarbureve të pangopura. Shkruani reaksionet e bashkëveprimit të: **2 pikë**
  - 1. etenit me ujin.
  - 2. propenit me HCN.
- b) Aldehidet dhe ketonet janë përbërje organike të oksigjenuara. Shkruani formulën e: **2 pikë**
  - I) një aldehidi.
  - II) një ketoni.

## QYTETARI – PSIKOLOGJI

Ky test përfshin pyetje nga lënda e qytetarisë dhe psikologjisë. Për këtë arsye testi është i ndarë në dy pjesë, ku secila prej tyre zë 50% të pikëve totale të testit.

### **Pjesa I Qytetari**

Kjo pjesë e testit përmban 10 pyetje me alternativa dhe 10 pyetje të hapura, të cilat do të testojnë njohuritë dhe aftësitë themelore që synohen të arrihen në këtë lëndë duke u bazuar në kërkesat e programit orientues të Maturës Shtetërore.

### **Pjesa II Psikologji**

Edhe në këtë pjesë të testit do të jenë 10 pyetje me alternativa dhe 6 pyetje me shtjellim që do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lëndën e psikologjisë.

Hartimi i testit për lëndët qytetari - psikologji mbështetet tërësisht në programin orientues të Maturës Shtetërore. Programi orientues për përgatitjen e provimit të testit qytetari - psikologji bazohet në:

- programin e lëndës së qytetarisë bërthamë për klasën e 10-të;
- programin e lëndës së psikologjisë me zgjedhje për klasën e 12-të.

Programi orientues i Maturës Shtetërore zbatohet me korrektësi nga specialistët dhe mësuesit e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të qytetari - psikologjisë. Specialistët e përfshirë në hartimin e pyetjeve të provimit të kësaj lënde, nuk mund përfshijnë në testim çështje mësimore të cilat nuk janë parashikuar në programin orientues të Maturës Shtetërore.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste me nxënësit, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve që publikon QSHA-ja. Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues mund të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja, si edhe materiale të tjera, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues. Kompetencat që janë testuar në provimin e qytetari - psikologji për Maturën Shtetërore 2019, të ndara sipas niveleve të vështirësisë, janë:

### **Rezultatet e të nxënësve për nivelin e parë të vështirësisë:**

- përshkruan tiparet e personalitetit;
- identifikon parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- identifikon rolet e mësuesit në shkollë;
- përcakton funksionet e reklamës;
- liston nënfushat e psikologjisë.

### **Rezultatet e të nxënësve për nivelin e dytë të vështirësisë:**

- shpjegon strategjitë e mbrojtjes nga stresi;



## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

- analizon funksionet e ligjit;
- shpjegon detyrat e shtetit ndaj shëndetit të qytetarit;
- analizon karakteristikat e emocioneve;
- klasifikon llojet e sinjaleve rrugore.

### Rezultatet e të nxënit për nivelin e tretë të vështirësisë:

- interpreton llojet e inteligjencës;
- interpreton drejtimet e psikologjisë mbi sjelljen jonormale.

### Struktura e testit

Testi i qytetari - psikologji ka në total 60 pikë, të cilat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 20 pyetje me alternativa, të cilat kanë një total prej 20 pikësh
- 16 pyetje të hapura, të cilat kanë një total prej 40 pikësh

Testi për lëndën e qytetari – psikologji ndërtohet në mënyrë të tillë që të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë (40%), niveli mesatar (40%) dhe niveli i lartë (20%). Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test bëhet në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel vështirësie.

Më poshtë paraqitet tabela e specifikimeve të testit, e cila tregon shpërndarjen e pikëve në bazë të përqindjes së tematikave në programin orientues dhe niveleve të vështirësisë.

### QYTETARI

NR.	TEMATIKAT	Pesha %	Nr. pikëve	Niveli I-40%	Niveli II-40%	Niveli III-20%
1	Ligji	8	3	2		1
2	Kushtetuta	7	3	1		2
3	Të drejtat e njeriut	14	4	2	1	1
4	Arsimimi	11	3	2	1	
5	Shëndeti	8	3	2	1	
6	Mjedisi	8	2		2	
7	Konsumatori	12	3		3	
8	Puna dhe e drejta e punës	8	2		2	
9	Siguria në rrugë	12	3	2	1	
10	E drejta për informim dhe ligj për medien	8	3		1	2
11	Bashkëjetesa në komunitet	4	1	1		
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>30</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>6</b>

### PSIKOLOGJI

<b>NIVELET</b>
----------------

---

**MATURA SHETËRORE 2019**

---

<b>NR.</b>	<b>TEMATIKAT</b>	<b>Pesha %</b>	<b>Nr. pikëve</b>	<b>Niveli I - 40%</b>	<b>Niveli II - 40%</b>	<b>Niveli III - 20%</b>
1	Ligji	10	3	3		
2	Kushtetuta	28	8	3	5	
3	Të drejtat e njeriut	22	6	1	4	1
4	Arsimimi	22	7	4	2	1
5	Shëndeti	18	6	1	1	4
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>30</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>6</b>

Nxënësit duhet të kenë parasysh se tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pikësh.

**Llojet e pyetjeve**

Pyetjet e testit të qytetari - psikologji hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënësve dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues. Pyetjet që përdoren janë objektive dhe subjektive, të cilat testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në të gjitha tematikat.

Në pyetjet subjektive përfshihen pyetjet e strukturuar, të cilat janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të tilla. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një situatë. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin nga të dhënat që jepen në pyetje.

**T E S T E**

**Qytetari - Psikologji - Sesion I**

**Qytetari**

1. Sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, ndalohet puna e fëmijëve:  
A) nën moshën 12 vjeç. **1 pikë**  
B) nën moshën 14 vjeç.  
C) nën moshën 16 vjeç.  
D) nën moshën 18 vjeç.
  
2. Mësuesja i shoqëroi nxënësit e klasës së 10-të, në një sallë gjyqate, për të parë se si zhvillohej një seancë gjyqësore. Mbi tavolinën e gjykatësit qëndronte një peshore, e cila simbolizon parimin e: **1 pikë**  
A) zgjedhjeve të lira.  
B) shtetit të së drejtës.  
C) barazisë para ligjit.  
D) ndarjes së pushteteve.
  
3. Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë: **1 pikë**  
A) detyruese,  
B) ndihmëse,  
C) orientuese,  
D) sugjeruese.
  
4. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë: **1 pikë**  
A) statike,  
B) relative,  
C) universale,  
D) të tjetërsueshme.
  
5. Të mësuarit gjatë gjithë jetës është një proces që ndodh në mënyrë: **1 pikë**  
A) sporadike,  
B) ideologjike,  
C) të detyrueshme,  
D) të vazhdueshme.

6. Programet depistuese që ndërmerr Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e saj të varësisë, synojnë: **1 pikë**
- A) kapjen e hershme të sëmundjeve.
  - B) kontrollin e pasojave të sëmundjeve.
  - C) nxitjen e veprimtarive të shëndetshme.
  - D) dhënien e informacionit rreth shëndetit.
7. Marrja përsipër ligjërisht nga shitësi apo prodhuesi, pa pagesë shtesë, e detyrimeve ndaj konsumatorit lidhet me: **1 pikë**
- A) cilësinë,
  - B) reklamën,
  - C) garancinë,
  - D) prodhueshmërinë.
8. Sinjalet rrugore, që u japin përdoruesve të rrugës informacionin e nevojshëm për të gjetur sa më lehtësisht zona të caktuara apo shërbime, janë sinjale: **1 pikë**
- A) rreziku,
  - B) ndalimi,
  - C) detyrimi,
  - D) treguese.
9. Mjetet e informimit publik kanë si qëllim dhënien e informacionit. Shpejtësia në dhënien e informacionit është përparësi e: **1 pikë**
- A) filmit,
  - B) radios,
  - C) gazetës,
  - D) televizionit.
10. Nga programet e bashkisë, për mbështetjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit, përfitojnë ato Asamble Bashkëpronarësh që: **1 pikë**
- A) kanë paguar plotësisht taksën e pasurisë së paluajtshme.
  - B) kanë paguar pjesërisht taksën për pasurinë e paluajtshme.
  - C) kërkojnë përshtatjen e hyrjeve të shkallëve për banorë të caktuar.
  - D) kërkojnë ribërjen e fasadës sepse banorëve nuk u pëlqen ajo aktuale.
11. Përshkruani funksionin e ligjit si: **2 pikë**
- a) ruajtës i rendit
  - b) mjet për zgjidhjen e konflikteve

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

12. Me cilin parim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë lidhet secila nga situatat e mëposhtme? **2 pikë**
- a) Realizimi i referendumeve
  - b) Ekzistenca e disa partive politike
13. Më poshtë janë paraqitur shembuj lidhur me të drejtat e njeriut. Përcaktoni të drejtën mbi të cilën bazohet secili rast. **2 pikë**
- a) Mira ishte e lumtur sepse së shpejti do të fillonte klasën e parë.
  - b) Denisi i dërgoi një letër njësisë administrative në të cilën ai banonte, përmes së cilës kërkonte të dinte më tepër për një projekt që do të realizohej pranë banesës së tij.
14. Identifikoni dy aspekte të rëndësishme të rolit të mësuesit në shkollë. **2 pikë**
15. Përshkruani dy detyra të shtetit lidhur me shëndetin e qytetarëve të tij. **2 pikë**
16. Duke kuptuar rëndësinë e mjedisit, studiuesja Margaret Mid (Margaret Mead) shprehet: **"Ne nuk do të kemi një shoqëri nëse ne shkatërrojmë mjedisin"**. Tregoni dy veprime konkrete sesi mund të japim kontributin tonë për ruajtjen e mjedisit. **2 pikë**
17. Duke analizuar shembujt e mëposhtëm, përcaktoni funksionin përkatës të reklamës. **2 pikë**
- a) Andi po ndiqte një reklamë në televizor dhe po dëgjonte me vëmendje cilësitë e produktit që sapo kishte hyrë në treg.
  - b) Klea pa në televizor një reklamë rreth një produkti trajtues të lëkurës, për efektet pozitive të të cilit kishte dëgjuar edhe nga shoqja e saj. Ajo vendosi të telefononte për të porositur një prej tyre.
18. Shpjegoni: **2 pikë**
- a) skemën e detyrueshme në sistemin e sigurimeve shoqërore.
  - b) skemën vullnetare në sistemin e sigurimeve shoqërore.
19. Sinjalet rrugore janë simbole të vendosura në rrugë për të dhënë informacion për përdoruesit e saj. Përshkruani llojet e mëposhtme të sinjaleve rrugore. **2 pikë**
- a) Sinjale horizontale
  - b) Sinjale të ndritshme
20. Analizoni rolin e internetit në shoqëri, duke evidentuar dy nga efektet negative të tij tek fëmijët. **2 pikë**

**Psikologji**

21. Ana është duke analizuar një situatë problemore. Pjesa e sistemit nervor qendror që po punon më shumë në këtë moment është: **1 pikë**

- A) hemisfera e majtë.
- B) hemisfera e djathtë.
- C) sistemi nervor periferik.
- D) sistemi nervor autonom.

22. Njerëzit kanë nevojë të vazhdueshme për ushqime dhe lëngje sepse uria dhe etja janë motive: **1 pikë**

- A) sociale,
- B) biologjike,
- C) amënore,
- D) universale.

23. Kur fëmija eksploron botën dhe mëson aftësi të reja, sipas Frojdit, ai po kalon stadin: **1 pikë**

- A) oral,
- B) fallik,
- C) latent,
- D) gjenital.

24. Ina ka vendosur t'i bëjë një shaka shoqes së ngushtë, sepse mendon që ajo e ka tepruar me komentet e saj. Por një zë i brendshëm i thotë se kjo "nuk është e drejtë". Ajo më vonë heq dorë. Sipas teorisë psikodinamike të personalitetit, Ina në vendimin e saj u ndikua nga: **1 pikë**

- A) idi,
- B) ego-ja,
- C) superidi,
- D) superego-ja.

25. Një nga zhvillimet më të rëndësishme të stadiit sensoro - motor është: **1 pikë**

- A) ndërtimi i marrëdhënieve me të tjerët.
- B) zhvillimi i identitetit dhe personalitetit.
- C) zhvillimi i pavarësisë në marrjen e vendimeve.
- D) njohja e botës përmes shqisave dhe motorikës.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

26. Reagimi që shkaktohet nga çdo ngacmues neutral, i cili lidhet me ngacmuesin e pakushtëzuar është: **1 pikë**

- A) reagim i lindur.
- B) reagim i kushtëzuar.
- C) reagim që shkaktohet nga çdo ngacmues neutral.
- D) reagim që shkaktohet nga ngacmuesi i pakushtëzuar.

27. Një baba përforcon një tërësi veprimesh që synojnë të afrojnë gradualisht vajzën e tij drejt realizimit të veprimit të dëshiruar. Në këtë rast ai përdor teknikën e:

**1 pikë**

- A) vëzhgimit,
- B) formësimit,
- C) kushtëzimit,
- D) përgjithësimit.

28. Toni, edhe pse kishte vite pa luajtur basketboll, sapo u fut në fushë tregoi se mbante mend mirë mënyrat dhe lëvizjet më të përshtatshme për pengimin e kundërshtarit. Kjo lidhet me kujtesën: **1 pikë**

- A) shqisore,
- B) episodike,
- C) semantike,
- D) procedurale.

- **1 pikë** nëse paraqet grafikisht informacionin e problemës **ose** gjen numrin e nxënësve që luajnë të paktën një nga lojërat
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

9.

- **2 pikë** nëse i shkruan si fuqi me baza të njëjta **dhe** nëse gjen vlerën e  $x$  – it;

$$3^{x+1} - \frac{2}{3^{-x}} = 27 \Rightarrow 3 \cdot 3^x - 2 \cdot 3^x = 3^3 \Rightarrow 3^x (3 - 2) = 3^3 \Rightarrow 3^x = 3^3 \Rightarrow x = 3$$

- **1 pikë** nëse i shkruan si fuqi me baza të njëjta;
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

11/a.

- **2 pikë** nëse tregon se vektorët  $\overline{AB} // \overline{AC}$  dhe argumenton që pikat A, B dhe C janë në një drejtëz;

$$\overline{AB} = \begin{pmatrix} 1+2 \\ 3-5 \end{pmatrix} = \begin{pmatrix} 3 \\ -2 \end{pmatrix} \text{ dhe } \overline{AC} = \begin{pmatrix} 10+2 \\ -3-5 \end{pmatrix} = \begin{pmatrix} 12 \\ -8 \end{pmatrix}. \text{ Tregon se koordinatat e}$$

$$\text{këtyre vektorëve janë të përpjesshme } \frac{3}{12} = \frac{-2}{-8} = \frac{1}{4} \Rightarrow \overline{AB} // \overline{AC}.$$

Meqenëse këta vektorë kanë pikën A të përbashkët, tregon që vektorët shtrihen në një drejtëz. Për rrjedhojë edhe pikat A, B dhe C janë në një drejtëz.

- **1 pikë** nëse tregon se vektorët  $\overline{AB} // \overline{AC}$ ;  
 ➤ **0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk shkruan fare.


11/b.

- **2 pikë** nëse ndërton figurën ku përcakton edhe këndet dhe gjen largesën ndërmjet anijeve;

$$AB^2 = 6^2 + 9^2 - 2 \cdot 6 \cdot 9 \cdot \cos 65^\circ = 117 - 45.64 = 71.36 \Rightarrow AB \approx 8,4 \text{ km.}$$

Pra, anijet janë 8.4 km larg njëra – tjetrës.

- **1 pikë** nëse ndërton figurën ku përcakton edhe këndet;  
 ➤ **0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk shkruan fare.



13.


- **1 pikë** nëse gjen brinjën e katrorit

$$P_{\square} = P_{\square} \Rightarrow 3x - 4 + 5x - 6 + 2x - 2 = 4x \Rightarrow 10x - 12 = 4x \Rightarrow 6x = 12 \Rightarrow x = 2 \text{ cm.}$$

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk shkruan fare.

16.

- **3 pikë** nëse gjen CH dhe gjen lidhjen midis dy bazave dhe njehson syprinën e trapezit. Heq lartësinë CH dhe gjen



$$AH = CH = x \Rightarrow AC^2 = 2x^2 \Rightarrow 2x^2 = 100 \Rightarrow x = 5\sqrt{2} \text{ cm.}$$


$$AE = HB; EH = DC \text{ dhe } AB + DC = AE + EH + HB + DC = 2AH$$

$$S = \frac{(AB + DC)}{2} \cdot CH = \frac{2AH}{2} \cdot CH = AH \cdot CH = 5\sqrt{2} \cdot 5\sqrt{2} = 50 \text{ cm}^2.$$

- **2 pikë** nëse gjen CH dhe gjen lidhjen midis dy bazave  
 ➤ **1 pikë** nëse gjen vetëm CH.  
 ➤ **0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk shkruan fare.

19/a.

- **1 pikë** nëse gjen koordinatat e pikës B.  
Heq nga pika A(1; 4) pingulën AB me drejtëzën d:  $y = x$  dhe përfton  $AM = MB$ . Pika B është simetrikja e kërkuar. Koordinatat e pikës B do të jenë B(4; 1).



- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

19/b.

- **1 pikë** nëse gjen distancën midis A dhe B.

$$AB = \sqrt{(x_B - x_A)^2 + (y_B - y_A)^2} = \sqrt{3^2 + (-3)^2} = 3\sqrt{2}.$$

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

22/a.

- **2 pikë** nëse faktorizon si numëruesin ashtu edhe emëruesin **dhe** nëse thjeshton thyesën;

$$\frac{x^2 + 9x + 14}{x^2 + 4x - 21} = \frac{(x+7)(x+2)}{(x+7)(x-3)} = \frac{x+2}{x-3}$$

- **1 pikë** nëse faktorizon numëruesin dhe emëruesin
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

22/b.

- **2 pikë** nëse kryen veprimet dhe redukton kufizat e ngjashme **dhe** nëse argumenton se shprehja që del është pozitive;

$$P(x) = (x+8)(x-6) - 2(x-25) = x^2 + 8x - 6x - 48 - 2x + 50 = x^2 + 2$$

Polinomi merr vetëm vlera pozitive sepse  $x^2 + 2$  është gjithmonë pozitiv

- **1 pikë** nëse kryen veprimet dhe redukton kufizat e ngjashme;
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

25/a.

- **2 pikë** nëse argumenton dhe gjen vlerën e x për të cilën uji arrin lartësinë më të madhe **dhe** nëse gjen vlerën më të madhe të lartësisë.

$$\text{Funksioni } y = -\frac{1}{10}x(x-50) = -\frac{1}{10}x^2 + 5x \text{ paraqet grafikisht një parabolë}$$

me degët poshtë dhe si rrjedhim currili i ujit arrin lartësinë më të madhe në

kulmin e kësaj parabole  $x = -\frac{b}{2a} = \frac{-5}{-\frac{1}{5}} = 25$

Lartësia më e madhe që arrin currili i ujit është

$$y(25) = -\frac{1}{10} \cdot 625 + 125 = 62,5 \text{ cm.}$$

- **1 pikë** nëse argumenton dhe gjen vlerën e  $x$  për të cilën uji arrin lartësinë më të madhe.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**25/b.**

- **1 pikë** nëse argumenton dhe gjen largesën nga burimi në të cilën currili takon përsëri ujin.

Currili i ujit takon përsëri sipërfaqen e ujit kur  $y = 0$  dhe gjen

$$y = -\frac{1}{10}x(x-50) = 0 \Rightarrow x_1 = 0 \text{ ose } x_2 = 50$$

Pra, currili takon përsëri ujin 50 cm larg burimit

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**27/a.**

- **2 pikë** nëse gjen zgjidhjet e secilit ekuacion **dhe** jep bashkësinë e zgjidhjeve të ekuacionit.

$$(x^2 - 4)(x^2 + 7x + 6) = 0 \Rightarrow x^2 - 4 = 0 \text{ ose } x^2 + 7x + 6 = 0$$

$$x^2 = 4 \Rightarrow x = \pm 2 \text{ ose } x^2 + 7x + 6 = 0 \Rightarrow x = -6 \text{ ose } x = -1$$


Ekuacioni fillestar ka 4 rrënjë që janë:  $\{\pm 2; -1; -6\}$

- **1 pikë** nëse gjen zgjidhjet e njërit prej ekuacioneve
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**27/b.**

- **3 pikë** nëse formon sistemin e dy inekuacioneve **dhe** gjen zgjidhjen për secilin prej tyre **dhe** jep bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacionit.

$$\begin{cases} 4x - 20 < 7 - x \\ 4x - 20 \geq -6 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} 5x < 27 \\ 4x \geq 14 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} x < \frac{27}{5} \\ x \geq \frac{7}{2} \end{cases}$$



Zgjidhje e inekuacionit është  $[3,5; 5,4[$ .

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

- **2 pikë** nëse formon sistemin e dy inekuacioneve **dhe** gjen zgjidhjen për secilin prej tyre
- **1 pikë** nëse formon sistemin e dy inekuacioneve **ose** gjen zgjidhjen për secilin prej tyre
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**29/a.**

- **2 pikë** nëse shkruan ekuacionin e tangjentes , gjen derivatin e funksionit në pikën 0 dhe i zëvendëson tek formula  $y - f(a) = f'(a)(x - a)$   
 $f'(x) = (x^3 - 3x^2 - 9x + 1)' = 3x^2 - 6x - 9$ ;  $f'(0) = -9$  dhe  $f(0) = 1$   
 $y - 1 = -9(x - 0) \rightarrow y = -9x + 1$  ekuacioni i tangjentes
- **1 pikë** nëse shkruan ekuacionin e tangjentes, **ose** gjen derivatin e funksionit në pikën 0:
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**29/b.**

- **2 pikë** nëse gjen derivatin e rendit parë, gjen pikat stacionare dhe përcakton llojin e ekstremumeve  
 $f'(x) = 3x^2 - 6x - 9 = 0 \Rightarrow x^2 - 2x - 3 = 0 \Rightarrow (x - 3)(x + 1) = 0 \Rightarrow x = 3$  dhe  $x = -1$
- $f''(x) = (3x^2 - 6x - 9)' = 6x - 6$
- $f''(3) = 18 - 6 = 12 > 0 \Rightarrow x = 3$  *minimum*
- $f''(-1) = -6 - 6 = -12 < 0 \Rightarrow x = -1$  *maksimum*
- (3; -26) është pikë minimale e funksionit f(x) dhe (-1; 6) është pikë maksimale e funksionit f(x)
- **1 pikë** nëse gjen vetëm pikat stacionare .
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare

**31.**

- **2 pikë** nëse paraqet grafikisht zonën së cilës duhet ti gjejmë syprinën **dhe** gjen syprinën me anë të integralit.

$$S = \int_0^{1/2} (1 - 3x^2) dx = [x - x^3]_0^{1/2} = \frac{1}{2} - \frac{1}{8} = \frac{3}{8} \text{ njësi katrore.}$$



- **1 pikë** paraqet grafikisht zonën së cilës duhet ti gjejmë syprinën **ose** gjen syprinën me anë të integralit.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**32/a.**

- **1 pikë** nëse gjen klasën modale.  
Klasa modale është  $[100;120[$
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat ose nuk shkruan fare.

**32/b.**


- **1 pikë** nëse gjen klasën ku ndodhet mesorja  
Shuma e dendurive është 120, mesorja është vlera mesatare midis kufizës së 60 dhe 61 e cila ndodhet në klasën  $[100;120[$ .
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat ose nuk shkruan fare.

**32/c.**

- **1 pikë** nëse gjen dendurinë e grumbulluar të gjatësisë së luleve të diellit deri në 100cm  
Denduria e grumbulluar e gjatësisë së luleve të diellit deri në 100cm është  $2+17+28=47$
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat ose nuk shkruan fare.


**32/d.**

- **1 pikë** nëse ndërton saktë histogramin
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat ose nuk shkruan fare.



**33/a.**

- **2 pikë** nëse ndërton një diagram pemë për semaforin e parë dhe më pas për semaforin e dytë;



- **1 pikë** nëse ndërton një diagram pemë për semaforin e parë;
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk shkruan fare.



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**33/b.**

- **1 pikë** nëse gjen probabilitetin që Merit të mos i duhet fare të ndalojë;  
 $P(\text{nuk i duhet fare të ndalojë}) = P(\text{jo i kuq, jo i kuq}) = 0,85 \cdot 0,65 = 0,5525$
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**33/c.**

- **1 pikë** nëse gjen probabilitetin që Merit do t'i duhet të ndalojë të paktën një herë;  
 $P(\text{i duhet të ndalojë të paktën një herë}) = 1 - P(\text{nuk i duhet fare të ndalojë})$   
 $= 1 - 0,5525 = 0,4475.$
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**Shënim:** Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një zgjidhje ndryshe nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Matematikë (Gjimnaz) – Sesioni II

Përgjigjet për pyetjet me alternativa:

Pyetja	1	2	3	4	6	7	8	10	12	14
Alternativa e saktë	B	C	C	D	C	A	B	D	C	C
Pyetja	15	17	18	20	21	23	24	26	28	30
Alternativa e saktë	C	B	B	B	A	B	C	C	C	B

Një mënyrë zgjidhjeje:

5.

- **2 pikë** nëse gjen numrin e nxënësve që luajnë vetëm volejbol

**15 nxënës luajnë vetëm volejbol.**

- **1 pikë** nëse paraqet grafikisht informacionin e problemës;
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

9.

- **3 pikë** nëse gjen zgjidhjet e ekuacionit

$$1 + \sin x = 2(1 - \sin^2 x) \quad (1)$$

$$1 + \sin x = 2 - 2\sin^2 x$$

$$2\sin^2 x + \sin x - 1 = 0$$

$$(2\sin x - 1)(\sin x + 1) = 0$$

$$2\sin x = 1$$

$$\left. \begin{array}{l} \sin x = \frac{1}{2} \Rightarrow x = \frac{\pi}{6} \text{ ose } x = \frac{5\pi}{6} \\ \sin x = -1 \Rightarrow x = \frac{3\pi}{2} \end{array} \right\} (2)$$

$$A = \left\{ \frac{\pi}{6}; \frac{5\pi}{6}; \frac{3\pi}{2} \right\}$$

- **2 pikë** nëse shpreh ekuacionin në trajtën (2)
- **1 pikë** nëse e shpreh ekuacionin në trajtën (1)
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

11/a.

- **3 pikë** nëse gjen ekuacionin e drejtëzës (d)

$$x_M = \frac{2+4}{2} = 3$$

$$y_M = \frac{3+5}{2} = 4$$

$$M(3,4)$$

$$m_{AB} = \frac{5-3}{4-2} = 1$$

$$d \perp AB \Rightarrow m_d = -1$$

$$\text{Ekuacioni i drejtëzës: } y - 4 = -1(x - 3) \Rightarrow y = -x + 7$$


- **2 pikë** nëse gjen koordinatat e mesit të AB dhe koeficientin këndor të d  
 ➤ **1 pikë** nëse gjen koordinatat e mesit të AB ose koeficientin këndor të d  
 ➤ **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

11/b.

- **2 pikë** nëse gjen largesën e helikopterit nga pika e nisjes

$$\frac{150}{x} = \sin 60^\circ$$

$$x = \frac{150}{\frac{\sqrt{3}}{2}} = \frac{300\sqrt{3}}{3} = 100\sqrt{3}$$



- **1 pikë** nëse ndërton figurën  
 ➤ **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

13.

- **1 pikë** nëse gjen perimetrin e trekëndëshit

$$2x + 5 = 3x + 2 = 4x - 1$$

$$x = 3 \Rightarrow \text{brinja e trekëndëshit është } 11 \text{ cm.}$$

$$P = 3 \cdot 11 = 33 \text{ cm.}$$

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

16.

- **2 pikë** nëse gjen syprinën e kërkuar

$$S = \frac{1 \cdot 10 \cdot 10}{2} \cdot \sin 30^\circ = \frac{1}{2} \cdot 100 \cdot \frac{1}{2} = 25 \text{ cm}^2$$

- **1 pikë** nëse gjen vetëm lartësinë e trekëndëshit **ose** shkruan formulën e syprinës me anë të sinusit
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

19/a.

- **1 pikë** nëse gjen koordinatat e pikës B.  
**Koordinatat e pikës B do të jenë B(-2; 3)**

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

19/b.

- **1 pikë** nëse gjen largesën midis A dhe B.

$$AB = \sqrt{(2+2)^2 + (-3-3)^2} = \sqrt{16+36} = \sqrt{52}.$$

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

22/a.

- **2 pikë** nëse thjeshton shprehjen

$$\left( \frac{(x+1)}{(x-1)(x+1)} - \frac{x+1}{x(x-1)} \right) \cdot [x(1-x)] = \frac{x-x-1}{x(x-1)} \cdot x(1-x) = \frac{x-1}{x-1} = 1$$

- **1 pikë** nëse thjeshton vetëm kllapën e parë
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

22/b.

- **2 pikë** nëse formon sistemin gjen vlerat m dhe n

$$\begin{cases} \frac{2+m}{2+n} = 4 \\ \frac{-1+m}{-1+n} = 7 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} 2+m = 8+4n \\ m-1 = 7n-7 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} m-4n = 6 \\ m-7n = -6 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} n = 4 \\ m = 22 \end{cases}$$

- **1 pikë** nëse formon vetëm sistemin
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**25/a.**

- **2 pikë** nëse argumenton dhe gjen vlerën më të madhe **dhe** vlerën më të vogël të thellësisë.  
 Dimë se  $-1 \leq \sin x \leq 1$  prandaj:
  - thellësia më e madhe që arrin uji në pikën P është  

$$h_{max} = 3 + 2 \cdot 1 = 5 \text{ m.}$$
  - thellësia më e vogël që arrin uji në pikën P është  

$$h_{min} = 3 + 2 \cdot (-1) = 1 \text{ m}$$
- **1 pikë** nëse argumenton dhe gjen vlerën më të madhe **ose** vlerën më të vogël të thellësisë.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**25/b.**

- **1 pikë** nëse argumenton dhe gjen periodën e luhatjes së baticë zbatcave.  
 Dimë se funksioni  $y = \sin x$  është funksion periodik me periodë  $T = 360^\circ$  dhe perioda e funksionit  $y = \sin kx$  është  $T = \frac{360^\circ}{k}$ . Atëherë perioda e luhatjes së baticë zbatcave është  $T = \frac{360^\circ}{30^\circ} = 12$  orë.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**27/a.**

- **2 pikë** nëse gjen zgjidhjet e secilit ekuacion **dhe** jep bashkësinë e zgjidhjeve të ekuacionit.  

$$(x^3 - 8)(x^2 + 5x + 6) = 0 \Rightarrow x^3 - 8 = 0 \text{ ose } x^2 + 5x + 6 = 0$$

$$x^3 = 8 \Rightarrow x = 2 \text{ ose } x^2 + 5x + 6 = 0 \Rightarrow x = -2 \text{ ose } x = -3$$
 Ekuacioni fillestar ka 3 rrënjë që janë:  $\{\pm 2; -3\}$
- **1 pikë** nëse gjen zgjidhjet e njërit prej ekuacioneve
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**27/b.**

- **2 pikë** nëse formon inekuacionin **dhe** gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacionit.  

$$-1 < 2x - 3 < 3 \Rightarrow 2 < 2x < 6 \Rightarrow 1 < x < 3$$
 Zgjidhje e inekuacionit është  $]1; 3[$ .
- **1 pikë** nëse formon inekuacionin e dyfishtë.

- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

29/a.

- **2 pikë** nëse shkruan ekuacionin e tangjentes, gjen derivatin e funksionit në pikën 0 dhe i zëvendëson tek formula  $y - f(a) = f'(a)(x - a)$

$$y = \frac{1}{3}x^3 - 2x^2 - 5x + 2 \Rightarrow y' = x^2 - 4x - 5 \Rightarrow f'(0) = -5$$

$$\text{ekuacioni i tangjentes është: } y - 2 = -5(x - 0) \Rightarrow y = -5x + 2$$

- **1 pikë** nëse shkruan ekuacionin e tangjentes, **ose** gjen derivatin e funksionit në pikën 0
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

29/b.

- **2 pikë** nëse gjen derivatin e rendit parë, gjen pikat stacionare dhe përcakton llojin e ekstremumeve dhe vlerat e tyre.

$$f'(x) = 0 \Rightarrow x^2 - 4x - 5 = 0 \Rightarrow x_1 = -1 \text{ dhe } x_2 = 5$$

$$f''(x) = 2x - 4. \text{ Gjejmë vlerat e derivatit të dytë në pikat stacionare.}$$

Atëherë:

$$f''(-1) = -6 \Rightarrow \text{në pikën } x = -1 \text{ funksioni ka max}$$

$$f''(5) = 6 \Rightarrow \text{në pikën } x = 5 \text{ funksioni ka min}$$

$$f(-1) = \frac{14}{3} \Rightarrow \left(-1; \frac{14}{3}\right) \text{ është max;}$$

$$f(5) = -\frac{94}{3} \Rightarrow \left(5; -\frac{94}{3}\right) \text{ është min;}$$

- **1 pikë** nëse gjen vetëm pikat stacionare.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare

31/a.

- **1 pikë** nëse ndërton të dy grafikët e kërkuar
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare

31/b.

- **2 pikë** nëse paraqet grafikisht zonën së cilës duhet ti gjejmë syprinën dhe gjen syprinën me anë të integralit.

$$S = \int_{-1}^2 (x + 2 - x^2) dx = \left[ \frac{x^2}{2} + 2x - \frac{x^3}{3} \right]_{-1}^2 = \frac{9}{2} \text{ njësi katrore}$$

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

- **1 pikë** nëse paraqet grafikisht zonën së cilës duhet ti gjejmë syprinën **ose** gjen syprinën me anë të integralit.
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**32/a.**

- **1 pikë** nëse gjen mesoren  
Mesorja është **27**
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**32/b.**

- **1 pikë** nëse gjen mesataren aritmetike  
**m = 28,7 pikë**
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat **ose** nuk shkruan fare.

**32/c.**

- **1 pikë** nëse gjen përqindjen e nxënësve me vlerësim më të madh se mesatarja aritmetike  
**7 nxënës kanë vlerësim më të madh se mesatarja aritmetike që janë 47% e nxënësve**
- **0 pikë** nëse nuk gjen asnjë nga karakteristikat **ose** nuk shkruan fare.

**33/a.**

- **1 pikë** nëse gjen numrin e personave që pëlqejnë peshk ose pulë  
**200 – 15 = 185**  
**Pra, 185 persona pëlqejnë peshk ose pulë**
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**33/b.**

- **1 pikë** nëse gjen numrin e personave që pëlqejnë peshk dhe pulë  
60 persona pëlqejnë peshk dhe pulë
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**33/c.**

- **1 pikë** nëse gjen probabilitetin që personi i zgjedhur rastësisht pëlqen vetëm peshk  
$$P(A) = \frac{50}{200} = \frac{1}{4}$$
- **0 pikë** nëse e zgjidh gabim **ose** nuk shkruan fare.

**Shënim:** Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një zgjidhje ndryshe nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

BIOLOGJI

Biologji – Sesioni I

---

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë

---

Pyetja 3            3 pikë

**Përgjigje:**

**3 pikë**

*Njehson numrin e guaninë – nukleotideve*            **1 pikë**

$360 \times 2 = 720$  nukleotide

$20/100 \times 720 = 144$  **guaninë – nukleotide.**

*Njehson numrin e (G+C)*            **1 pikë**

$144 \times 2 = 288$  **(G + C)**

*Njehson numrin e timinë – nukleotideve*            **1 pikë**

$720 - 288 = 432$  (A + T)

$432 : 2 = 216$  **timinë – nukleotide**

**2 pikë**

*Njehson numrin e guaninë - nukleotideve*            **1 pikë**

*Njehson numrin e G+C*            **1 pikë**

**1 pikë**

*Njehson numrin e guaninë - nukleotideve*            **1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare*            **0 pikë**

---

Pyetja 4            A            1 pikë

Pyetja 5            D            1 pikë

---

Pyetja 6

Pyetja 6 (a)      1 pikë

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë të dy prindërit* **1 pikë**

P: ♀ DdEe x ♂ ddee



**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

♀/♂	DE	--	--	de
de	DdEe	--	--	ddee

F<sub>1</sub>: 1/2DdEe; 1/2ddee

Prindi DdEe formon 2 tipe gametësh me përqindje të barabartë:

1/2 ose 50% DE; 1/2 ose 50% de.

Prindi ddee formon 1 tip gameti de.

**0 pikë**

*Përcakton gametët që prodhon njëri prind **0 pikë***

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë***

**Pyetja 6 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Arsyeton për rezultatet që janë marrë në F<sub>1</sub> nga ky kryqëzim **1 pikë***

P: ♀ DdEe x ♂ ddee

F<sub>1</sub>: 1/2DdEe; 1/2ddee

Gjenet D dhe E janë të lidhur, por nuk ka ndodhur kryqkëmbimi, sepse janë shumë pranë njëri-tjetrit.

Meqë nuk ka ndodhur kryqkëmbimi, nuk formohen gametët rikombinantë, prandaj nuk formohen dhe pasardhësit rikombinantë.

**OSE**

P: ♀ DdEe x ♂ ddee

F<sub>1</sub>: 1/2DdEe; 1/2ddee

Gjenet D dhe E janë të lidhur, por nuk ka ndodhur kryqkëmbimi, sepse janë shumë pranë njëri-tjetrit.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë***


**Pyetja 6 (c) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Skematizon vendosjen e gjeneve D dhe E në kromozomet homologë **1 pikë***

*Skema e vendosjes së gjeneve në kromozomet homologe është:*



**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

**Pyetja 7      3 pikë**

**Përgjigje:**

**3 pikë**

**Mënyra e parë**

Përcakton gjenotipet e prindërve **1 pikë**

P: ♀ I<sup>A</sup>I<sup>B</sup>X<sup>H</sup>X<sup>h</sup> x ♂ I<sup>B</sup>I<sup>O</sup>X<sup>H</sup>Y

♀ I<sup>A</sup>I<sup>B</sup> x ♂ I<sup>B</sup>I<sup>O</sup> ♀ X<sup>H</sup>X<sup>h</sup> x ♂ X<sup>H</sup>Y

Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë të dy prindërit **1 pikë**

I<sup>A</sup>I<sup>B</sup> x I<sup>B</sup>I<sup>O</sup>

♀/♂	I <sup>A</sup>	I <sup>B</sup>
I <sup>B</sup>		
I <sup>O</sup>		

X<sup>H</sup>X<sup>h</sup> x X<sup>H</sup>Y

♀/♂	X <sup>H</sup>	X <sup>h</sup>
X <sup>H</sup>		
Y		

Njehson probabilitetin që të lindi një djalë me grup gjaku A dhe me hemofili **1 pikë**

P: I<sup>A</sup>I<sup>B</sup>X<sup>H</sup>X<sup>h</sup> x I<sup>B</sup>I<sup>O</sup>X<sup>H</sup>Y

I<sup>A</sup>I<sup>B</sup> x I<sup>B</sup>I<sup>O</sup>

♀/♂	I <sup>A</sup>	I <sup>B</sup>
I <sup>B</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>B</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>B</sup>
I <sup>O</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>O</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>O</sup>

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

Mundësia që të lindi një fëmijë me grup gjaku A është **1/4**.

$X^H X^h \times X^H Y$

♀/♂	$X^H$	$X^h$
$X^H$	$X^H X^H$	$X^H X^h$
Y	$X^H Y$	$X^h Y$

Mundësia që të lindi një djalë hemofilik është **1/4**.

Mundësia (probabiliteti) që të lindi një djalë me grup A të gjakut dhe me hemofili është:

**$1/4 \times 1/4 = 1/16$**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare **0 pikë***

**Mënyra e dytë**

*Përcakton gjenotipet e prindërve **1 pikë***

P:  $I^A I^B X^H X^h \times I^B I^O X^H Y$

*Përcakton tipet e gametëve **1 pikë***

P:  $I^A I^B X^H X^h \times I^B I^O X^H Y$

♀/♂	$I^A X^H$	$I^A X^h$	$I^B X^H$	$I^B X^h$
$I^B X^H$				
$I^B Y$				
$I^O X^H$				
$I^O Y$				

*Njehson probabilitetin që të lindi një djalë me grup gjaku A dhe me hemofili **1 pikë***

P:  $I^A I^B X^H X^h \times I^B I^O X^H Y$

♀/♂	$I^A X^H$	$I^A X^h$	$I^B X^H$	$I^B X^h$
$I^B X^H$				
$I^B Y$				
$I^O X^H$				

MATURA SHITETËRORE 2019

---

10 Y		1A 10 X <sup>h</sup> Y		
------	--	------------------------	--	--

1/16 është mundësia (probabiliteti) që të kenë një djalë me grup gjaku A dhe me hemofili.

**2 pikë**

Përcakton gjenotipet e prindërve **1 pikë**

Përcakton tipet e gametëve **1 pikë**

**1 pikë**

Përcakton gjenotipet e prindërve **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

**Pyetja 8            A            1 pikë**

---

**Pyetja 9            3 pikë**

**Përgjigje:**

**3 pikë**

Njihson vlerën e (q)-së **1 pikë**

$$q^2 = 0,09$$

$$q = 0,3$$

Njihson vlerën së (p)-së **1 pikë**

$$p = 1 - q$$

$$p = 0,7$$

Njihson vlerën e  $2pq$ -së **1 pikë**

$$2pq = 2 \times 0,7 \times 0,3 = 0,42$$

**2 pikë**

Njihson vlerën e (q)-së **1 pikë**

Njihson vlerën e (p)-së **1 pikë**

**1 pikë**

Njihson vlerën e (q)-së **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

Pyetja 10      C      1 pikë

---


Pyetja 11

Pyetja 11 (a)      1 pikë

Përgjigje:

**1 pikë**

Shkruan reaksionin e përgjithshëm të fotosintezës **1 pikë**



**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

Pyetja 11 (b)      2 pikë

Përgjigje:

**2 pikë**

Tregon rolin e dy komponimeve që marrin pjesë në reduktimin e CO<sub>2</sub> **2 pikë**

ATP dhe NADPH të sintetizuara në fazën me dritë përdoren si burim energjie dhe si burim i hidrogjenit për reduktimin e PGA në PGAL dhe deri në glukozë në ciklin Calvin.

**OSE**

ATP dhe NADPH kanë rëndësi se përdoren si burim energjie dhe si burim i hidrogjenit për reduktimin e CO<sub>2</sub> deri në glukozë në fazën e pavarur nga drita.

**1 pikë**

Emërton dy komponimet që marrin pjesë në reduktimin e CO<sub>2</sub> **1 pikë**

**Ose**

Tregon rolin e një prej komponimeve që merr pjesë në reduktimin e CO<sub>2</sub> **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

**Pyetja 12      2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga dallimet midis ciklit të Krebsit dhe glikolizës **2 pikë***

Glikoliza	Cikli i Crebsit
Zhvillohet në citoplazëm	Zhvillohet në mitokondri
Zhvillohet në mungesë të oksigjenit (proces anaerob)	Zhvillohet në prani të oksigjenit (proces aerob)
Përftohen: piruvat + ATP + NADH	Përftohen: CO <sub>2</sub> + ATP + NADH + FADH <sub>2</sub>

**1 pikë**

*Tregon një nga dallimet midis ciklit të Krebsit dhe glikolizës **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë***

**Pyetja 13**


**Pyetja 13 (a)      1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Skematizon qelizën në fund të anafazës së parë **1 pikë***

a) Anafaza e parë



**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë***


Pyetja 13 (b) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Skematizon një rën prej qelizave në fund të metafazës së dytë **1 pikë**

b) Metafaza e dytë



0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---


Pyetja 13 (c) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Arsyeton për të njehsuar numrin e kromozomeve në fund të telofazës së dytë

1 pikë



Secila nga 4 qelizat, në fund të telofazës së dytë ka nga 3 kromozome.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare

**0 pikë**

---

Pyetja 14 A 1 pikë

Pyetja 15 D 1 pikë

---

**Pyetja 16**

**Pyetja 16 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon përshkueshmërinë e molekulave polare përmes membranës qelizore*

**1 pikë**

Fosfolipidet në membranën qelizore formojnë shtresë të dyfishtë dhe duke qenë se bishtat e fosfolipideve janë jopolare (hidrofobe) ato shërbejnë si barrierë për shumë lëndë të tretshme në ujë siç janë molekulat polare.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

**Pyetja 16 (b) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon rolin e pompave natrium - kalium në membranën e fijos nervore për ruajtjen e potencialit të qetësisë* **1 pikë**

Pompat natrium - kalium shërbejnë për të ruajtur potencialin e qetësisë, (diferencën e potencialeve në të dy anët e membranës së fijos nervore). Në këtë mënyrë krijohet tepricë të ngarkesave pozitive në anën e jashtme të membranës së fijos nervore dhe tepricë të ngarkesave negative në anën e brendshme të membranës së fijos nervore.

*Shpjegon parimin e funksionimit të pompave natrium - kalium në membranën e fijos nervore, kur është në gjendje qetësie* **1 pikë**

Pompat natrium - kalium lëvizjen e joneve Na<sup>+</sup> dhe K<sup>+</sup> e realizojnë nëpërmjet transportit aktiv.

Për çdo molekulë ATP që zërthehet, energjia që çlirohet përdoret për të nxjerrë nga brenda - jashtë përmes proteinave pompa të membranës jonet Na<sup>+</sup> dhe për të futur nga jashtë - brenda jonet K<sup>+</sup>.

**1 pikë**

*Shpjegon rolin e pompave natrium - kalium në membranën e fijos nervore për ruajtjen e potencialit të qetësisë* **1 pikë**

**Ose**

*Shpjegon parimin e funksionimit të pompave natrium - kalium në membranën e fijos nervore, kur është në gjendje qetësie* **1 pikë**

**0 pikë**



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

**Pyetja 17      C      1 pikë**

---

**Pyetja 18**

**Pyetja 18 (a)    2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon pse sistemi i qarkullimit quhet i mbyllur **1 pikë***

Sistemi qarkullimit quhet i mbyllur sepse gjaku qarkullon vetëm brenda enëve të gjakut.

*Shpjegon pse sistemi i qarkullimit quhet i dyfishtë **1 pikë***

Sistemi quhet i dyfishtë sepse gjaku kalon dy herë në zemër gjatë një cikli të plotë të qarkullimit. Një herë përmes qarkullimit mushkëror dhe një herë gjatë qarkullimit sistematik.

**1 pikë**

*Shpjegon pse sistemi i qarkullimit quhet i mbyllur **1 pikë***

**Ose**

*Shpjegon pse sistemi i qarkullimit quhet i dyfishtë **1 pikë***

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

**Pyetja 18 (b)    1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon rolin e pllakëzave në mpiksjen e gjakut **1 pikë***

Pllakëzat prodhojnë një lëndë e cila shndërron proteinën fibrinogjen të plazmës në fibrinë që formon një rrjetë për bllokimin e rrjedhjes së gjakut.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

---

Pyetja 19	C	1 pikë
Pyetja 20	D	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë

---

**Pyetja 22**

**Pyetja 22 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon drejtimin e lëvizjes së gazeve O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> 1 pikë*

Gazet O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> lëvizin në sajë të difuzionit nga përqendrimi më i madh te përqendrimi më i vogël.

O<sub>2</sub> lëviz nga mjedisi i jashtëm te mjedisi i brendshëm.

CO<sub>2</sub> lëviz nga mjedisi i brendshëm te mjedisi i jashtëm.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare 0 pikë*

---

**Pyetja 22 (b) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon lidhjen e oksigjenit me hemoglobinën 1 pikë*

Rruazat e kuqe të gjakut përmbajnë hemoglobinën, që lidhet me molekulat e oksigjenit dhe formon oksihemoglobinën. Shtimi i rruazave të kuqe të gjakut rrit sasinë e oksigjenit në organizëm.

*Shpjegon rritjen e sasisë së energjisë në trupin e pacientit 1 pikë*

Gjatë procesit të frymëmarrjes:

**Glukoz + oksigjen → dyoksid karboni + ujë + ATP (energj)**

Shtimi i rruazave të kuqe të gjakut rrit sasinë e energjisë në organizmin e pacientit, gjë që ndikon në rritjen e vitalitetit të organizmit të tij.

**1 pikë**

*Tregon lidhjen e oksigjenit me hemoglobinën 1 pikë*

**0 pikë**

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë**

---

Pyetja 23	B	1 pikë
Pyetja 24	A	1 pikë
Pyetja 25	C	1 pikë

---

Pyetja 26      3 pikë

**Përgjigje:**


**3 pikë**

*Përcakton llojin e parimit feedback **1 pikë***

*Shpjegon çfarë ndodh në hipotalamus kur rritet përqendrimi i tiroksinës **1 pikë***

*Shpjegon çfarë ndodh në hipofizë kur rritet përqendrimi i tiroksinës **1 pikë***

Rregullimi i sekretimit të tiroksinës bëhet në sajë të parimit feedback (-).



Kur injektohet tiroksinë në gjak:

- atëherë vetë rritja e përqendrimit të tiroksinës ndikon te hipotalamusi me feedback (-), kështu që hipotalamusi do të sekretojë më pak hormon lirues.
- atëherë vetërritja e përqendrimit të tiroksinës ndikon te hipofiza me feedback (-), kështu që hipofiza do të sekretojë më pak hormon TSH.

Kështu që gjendra tiroide e kavies në momentin pasardhës do të sekretojë më pak tiroksinë për të kundërshtuar veprimin e dhënë sipas parimit feedback (-).

**OSE**

Rregullimi i sekretimit të tiroksinës bëhet në sajë të parimit feedback (-).

---

Kur injektohet tiroksinë në gjak:

- atëherë vetë rritja e përqendrimit të tiroksinës ndikon te hipotalamusi me feedback (-), kështu që hipotalamusi do të sekretojë më pak hormon lirues.
- atëherë vetë rritja e përqendrimit të tiroksinës ndikon te hipofiza me feedback (-), kështu që hipofiza do të sekretojë më pak hormon TSH.

Kështu që gjëndra tiroide e kavies në momentin pasardhës do të sekretojë më pak tiroksinë për të kundërshtuar veprimin e dhënë sipas parimit feedback (-).

**2 pikë**

*Përcakton llojin e parimit feedback **1 pikë***

*Shpjegon çfarë ndodh në hipotalamus kur rritet përqendrimi i tiroksinës **1 pikë***

**Ose**

*Përcakton llojin e parimit feedback **1 pikë***

*Shpjegon çfarë ndodh në hipofizë kur rritet përqendrimi i tiroksinës **1 pikë***

**1 pikë**

*Përcakton llojin e parimit feedback **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare **0 pikë***

---

Pyetja 27	B	1 pikë
Pyetja 28	A	1 pikë
Pyetja 29	C	1 pikë

---

**Pyetja 30**

**Pyetja 30 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të filtrimit **1 pikë***

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të ripërthithjes **1 pikë***

Gjatë procesit të **filtrimit**:

Glukoza do të kalojë nga plazma e gjakut të glomerulës në kapsulën e Baumanit në sajë të difuzionit, sepse përmasat e molekulës së saj janë shumë të vogla (vlera 0,9).

Gjatë procesit të **ripërthithjes**:

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

E gjithë glukoza do të ripërthithet sepse është e nevojshme për organizmin. Ripërthithja kryhet në tubthin e nefronit me transport aktiv (vlera 0,9). Prandaj në urinën përfundimtare vlera e glukozës është 0.

**1 pikë**

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të filtrimit* **1 pikë**

**Ose**

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të ripërthithjes* **1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

---

**Pyetja 30 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon pse është i rëndësishëm procesi i ripërthithjes së ujit në nivelin e nefronit*  
**1 pikë**

Gjatë procesit të filtrimit të plazmës së gjakut kalon një sasi e madhe e ujit nga plazma e gjakut në filtrat. Gjatë procesit të ripërthithjes përrthithet një sasi e madhe e ujit në tubthin e nefronit, gjë që siguron ruajtjen në normë të sasisë së ujit në mjedisin e brendshëm (osmorregullimi).

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

---

**Pyetja 31 B 1 pikë**

**Pyetja 32 D 1 pikë**

---

**Pyetja 33**

**Pyetja 33 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Përshkruan shpërbërjen e proteinave në stomak*

**1 pikë**

*Përshkruan shpërbërjen e proteinave në duoden*

**1 pikë**

*Shpërbërja e proteinave bëhet:*

---

Në stomak nga veprimi i pepsinës që vepron në mjedis acid (HCl).  
Në duoden nga veprimi i enzimës tripsinë të lëngut pankreatik.

**1 pikë**

*Përshkruan shpërbërjen e proteinave në stomak* **1 pikë**

**Ose**

*Përshkruan shpërbërjen e proteinave në duoden* **1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

---

**Pyetja 33 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon dallimin midis gjëndrave endokrine dhe gjëndrave ekzokrine* **1 pikë**

Gjëndrat endokrine sekretojnë hormone (lajmëtarë kimikë) që derdhen në gjak, kurse gjëndrat ekzokrine sekretojnë lëndën në sipërfaqe të trupit ose në gypat që kanë lidhje me mjedisin e jashtëm.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

---

**Pyetja 34**

**Pyetja 34 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Përshkruan dallimin midis biotopit dhe biocenozës* **1 pikë**

Biotopi përbën tërësinë e faktorëve fizikë, kimikë dhe klimatikë që veprojnë mbi gjallesat e një ekosistemi, kurse biocenoza përbën tërësinë e gjallesave që popullojnë një biotop.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare* **0 pikë**

---

**Pyetja 34 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon arsyen pse një zinxhir ushqimor rrallë ka më shumë se pesë nivele trofike*

**1 pikë**

Në bazë të ligjit të të dhjetit vetëm 1/10 e energjisë kalon nga një nivel trofik në atë pasardhës, prandaj duke kaluar nga niveli i parë deri tek i katërti sasia e energjisë zvogëlohet aq shumë sa nuk mund të formojë nivel të ri trofik (me përjashtime të rralla).

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare 0 pikë*

---

**Shënim:**

- Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.
- Kur pyetja kërkon që nxënësi të tregojë dallimet midis dy koncepteve ose dy proceseve, nxënësi do të marrë pikë të plotë kur tregon dallimin midis dy koncepteve ose dy proceseve, (jo kur tregon karakteristikat vetëm të njërit prej tyre).





**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

♀ / ♂	dE	de	DE	De
de	ddEe	ddee	DdEe	Ddee

**1 pikë**

*Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë prindërit **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 6 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Arsyeton për të njehsuar përqindjet e gametëve që formon individi femër (dE/De) **1 pikë***

P: ♀ (dE/De) x ♂ (de/de)

♀ / ♂	dE (P <sub>1</sub> ) 46%	de (R <sub>1</sub> ) 4%	DE (R <sub>2</sub> ) 4%	De (P <sub>2</sub> ) 46%
de	ddEe (P <sub>1</sub> )	ddee (R <sub>1</sub> )	DdEe (R <sub>2</sub> )	Ddee (P <sub>2</sub> )

Meqë distanca midis gjeneve **d** dhe **e** është 8%, atëherë përqindja e gametëve rikombinantë është:

**de (R<sub>1</sub>) 4%**

**DE (R<sub>2</sub>) 4%**

**Ose**

Meqë distanca midis gjeneve **d** dhe **e** është 8%, atëherë përqindja e gametëve rikombinantë është:

**de (R<sub>1</sub>) 4%**

**DE (R<sub>2</sub>) 4%**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 6 (c) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Arsyeton për të njehsuar numrin e përgjithshëm të pasardhësve të lindur nga ky kryqëzim **1 pikë***

$d = 8\%$  ose  $d = 0,08$

$8/100 = 40/X$

$X = 500$  është numri i përgjithshëm i pasardhësve

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 7**

**Pyetja 7 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

Përcakton gjenotipin e prindërve **1 pikë**

P: ♀  $X^A X^a$  x ♂  $X^A Y$

Përcakton gjenotipin e pasardhësve **1 pikë**

♀ / ♂	$X^A$	$X^a$
$X^A$	$X^A X^A$	$X^A X^a$
Y	$X^A Y$	$X^a Y$

Djemtë daltonikë kanë gjenotipin: ( $X^a Y$ )

**1 pikë**

Përcakton gjenotipin e prindërve **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 7 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

Përcakton mundësinë që nga ky çift të lindin fëmijë normalë **1 pikë**

P: ♀  $X^A X^a$  x ♂  $X^A Y$

♀ / ♂	$X^A$	$X^a$
$X^A$	$X^A X^A$	$X^A X^a$
Y	$X^A Y$	$X^a Y$

75% ose 3/4 e fëmijëve janë normalë përse i përket sëmundjes së daltonizmit.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 8**      **D**      **1 pikë**

---

**Pyetja 9**      **3 pikë**

**Përgjigje:**  
**3 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së **1 pikë***

$$q^2 = 0,04$$

$$q = 0,2$$

*Njehson vlerën e  $p$ -së **1 pikë***

$$p = 1 - q$$

$$p = 1 - 0,2$$

$$p = 0,8$$

*Njehson vlerën e  $2pq$  **1 pikë***

$$2pq = 2 \times 0,8 \times 0,2$$

$$2pq = 0,32$$

**2 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së **1 pikë***

*Njehson vlerën e  $q$ -së **1 pikë***

**1 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 10**      **A**      **1 pikë**

---

**Pyetja 11      3 pikë**

**Përgjigje:**

**3 pikë**

*Emërtimi dhe përcaktimi i origjinës së 3 produkteve përfundimtare të fazës dritore të fotosintezës vlerësohet me **3 pikë***

- 1) O<sub>2</sub> që çlirohet në mjedis e ka origjinën nga fotoliza e molekulës së ujit.
- 2) ATP sintetizohet në fotosistemin e II
- 3) NADPH sintetizohet në fotosistemin e I

**2 pikë**

*Emërtimi dhe përcaktimi i origjinës së 2 prej produkteve përfundimtare të fazës dritore të fotosintezës vlerësohet me **2 pikë***

**1 pikë**

*Emërtimi dhe përcaktimi i origjinës së 1 prej produkteve përfundimtare të fazës dritore të fotosintezës vlerësohet me **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 12      2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon 2 nga dallimet midis fotosintezës dhe frymëmarrjes qelizore **2 pikë***

- 1) Fotosinteza zhvillohet te gjallesat autotrofe që përmbajnë pigmentin e klorofilit  
Frymëmarrja qelizore zhvillohet te të gjitha gjallesat eukariote
- 2) Fotosinteza zhvillohet në kloroplaste  
Frymëmarrja qelizore zhvillohet në mitokondri
- 3) Në procesin e fotosintezës sintetizohet lënda organike  
 $6\text{CO}_2 + 6\text{H}_2\text{O} + \text{Energji diellore} = \text{C}_6\text{H}_{12}\text{O}_6 + 6\text{O}_2$   
Në procesin e frymëmarrjes qelizore ndodh oksidimi i lëndës organike për sigurimin e energjisë së nevojshme për jetën.  
 $\text{C}_6\text{H}_{12}\text{O}_6 + 6\text{O}_2 = 6\text{CO}_2 + 6\text{H}_2\text{O} + \text{Energji}$

**1 pikë**

*Tregon 1 nga dallimet midis fotosintezës dhe frymëmarrjes qelizore **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.*

---


Pyetja 13

Pyetja 13 (a) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Ilustron me skemë qelizën në fund të metafazës së parë **1 pikë**



0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.


---

Pyetja 13 (b) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Ilustron me skemë një nga qelizat në fund të telofazës së parë **1 pikë**



0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.


---

Pyetja 13 (c) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Ilustron me skemë një nga qelizat në fund të anafazës së dytë **1 pikë**



0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

---

Pyetja 14 B 1 pikë

Pyetja 15 B 1 pikë

---

Pyetja 16

Pyetja 16 (a) 1 pikë

Përgjigje:

1 pikë

Shpjegon dukurinë që ndodh me qelizat e trupit, kur rritet përqendrimi i lëngut indor

**1 pikë**

Qelizat e trupit do të rrudhosen ose vyshken, sepse ndodh dukuria e osmozës. Uji do të kalojë nga mjedisi me përqendrimi më të ulët (përmbajtja qelizore) drejt mjedisit me përqendrim më të lartë (lëngu indor).

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 16 (b)                      2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon dukurinë që ndodh me rruazën e kuqe të gjakut të zhytur në një tretësirë të holluar*

**1 pikë**

*Shpjegon dukurinë që ndodh me paramecin të zhytur në një tretësirë të holluar*

**1 pikë**

Rruaza e kuqe e gjakut do të fryhet dhe çahet, sepse uji kalon nga mjedisi në brendësi të qelizës (me osmozë).

Parameci mbijeton në këtë mjedis, sepse ujin e tepërt e nxjerr me anë të vakuolave tkurrëse.

**1 pikë**

*Shpjegon dukurinë që ndodh me rruazën e kuqe të zhytur në një tretësirë të holluar*

**1 pikë**

**Ose**

*Shpjegon dukurinë që ndodh me amebën të zhytur në një tretësirë të holluar*

**1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 17                      C                      1 pikë**

---

**Pyetja 18**

**Pyetja 18 (a)                      2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga dallimet midis qarkullimit të madh dhe qarkullimit të vogël të gjakut.*

*Qarkullimi madh i gjakut fillon nga barkushja e majtë.*

*Qarkullimi madh i gjakut fillon nga barkushja e djathtë.*

Gjatë qarkullimit të madh gjaku transporton në të gjitha indet e trupit lëndë ushqimore, hormone, O<sub>2</sub> dhe kthehet në parabarkushen e djathtë i pasur me CO<sub>2</sub>.

Gjatë qarkullimit të vogël gjaku shkon në mushkëri, ku lë CO<sub>2</sub> dhe pasurohet me O<sub>2</sub> dhe kthehet në parabarkushen e majtë.

**1 pikë**

*Tregon një nga dallimet midis qarkullimit të madh dhe qarkullimit të vogël të gjakut*

**1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---


**Pyetja 18 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon funksionin e rruazave të kuqe të gjakut **1 pikë***

Hekuri që është në qendër të hemoglobinës ka aftësinë të lidhet në mënyrë të kthyeshme me oksigjenin. Prandaj eritrocitet kanë si funksion të kryejnë transportin e oksigjenit në të gjitha qelizat e trupit. Në nivelin qelizor në prani të oksigjenit zhvillohet frymëmarrja qelizore, që shoqërohet me çlirim energjie.



Kjo energji është e nevojshme për kryerjen e proceseve jetësore të organizmit.

**Ose**

Hekuri që është në qendër të hemoglobinës ka aftësinë të lidhet në mënyrë të kthyeshme me oksigjenin. Prandaj eritrocitet kanë si funksion të kryejnë transportin e oksigjenit në të gjitha qelizat e trupit.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 19 C 1 pikë**

**Pyetja 20 A 1 pikë**

**Pyetja 21 B 1 pikë**

---



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 22**

**Pyetja 22 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy karakteristika të sipërfaqeve gazshëmbyese në mushkëri*

**2 pikë**

Shkëmbimi i gazeve O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> në mushkëri kryhet në alveola ose hojëza.

Alveolat kanë këto karakteristika:

- kanë sipërfaqe të madhe
- kanë parete shumë të holla
- janë të lagështa
- pranë tyre kalojnë shumë kapilarë gjaku me parete shumë të hollë.

**1 pikë**

*Tregon një nga karakteristikat e sipërfaqeve gazshëmbyese në mushkëri*

**1 pikë**

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 22 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregoni rolin e diafragmës në procesin e frymëkëmbimit **1 pikë***

Gjatë frymëmarrjes diafragma ulet poshtë që të rritet vëllimi i kafazit të kraharorit, kurse gjatë frymënxjerrjes diafragma ngrihet lart që të zvogëlohet vëllimi i kafazit të kraharorit.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 23 C 1 pikë**

**Pyetja 24 B 1 pikë**

**Pyetja 25 B 1 pikë**

---

**Pyetja 26**

**Pyetja 26 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga dallimet midis mesazhit nervor dhe hormonal 1 pikë*

- Mesazhi nervor tejçohet përgjatë fijes nervore.  
Mesazhi hormonal realizohet me anën e qarkullimit të gjakut.
- Mesazhi nervor tejçohet shumë shpejt dhe rruga është e përcaktuar me saktësi, ku fillon dhe mbaron.  
Rruga që përshkon hormoni është më e gjatë, sepse ai shkon në shumë qeliza, por njohja e tij realizohet vetëm në qelizat shenjë.

**1 pikë**

*Tregon një nga dallimet midis mesazhit nervor dhe hormonal 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 26 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon veprimin që ka neurotejtuesi kur bie në kontakt me membranën e neuronit pasinsinaptik 1 pikë*

Neurotransmetuesit kur bien në hapësirën sinaptike, lidhen me receptorët molekularë që ndodhen në membranën e neuronit postsinaptik, duke shkaktuar depolarizim.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 27 D 1 pikë**

**Pyetja 28 A 1 pikë**

**Pyetja 29 B 1 pikë**

---

**Pyetja 30**

**Pyetja 30 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të filtrimit 1 pikë*

*Shpjegon çfarë ndodh me proteinat gjatë procesit të filtrimit 1 pikë*

**Gjatë procesit të filtrimit:**

Glukoza do të kalojë nga plazma e gjakut të glomerulës në kapsulën e Baumanit në sajë të difuzionit, se përmaset e molekulës së saj janë shumë të vogla në krahasim me proteinat. **(Vlera 0,9).**

Proteinat janë molekula me përmasa të mëdha, prandaj nuk filtrohen, por mbeten në rrymën e gjakut. **(Vlera 0).**

**1 pikë**

*Shpjegon çfarë ndodh me glukozën gjatë procesit të filtrimit 1 pikë*

**Ose**

*Shpjegon çfarë ndodh me proteinat gjatë procesit të filtrimit 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 30 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Dallimi midis korteksit dhe pjesës palcore të veshkës 1 pikë*

Korteksi përmban kapsulat e Baumanit dhe pjesën fillestare të tubthit të nefronit, kurse në pjesën medulare ndodhen lakoret e Henlit dhe gypat kolektorë (mbledhës).

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 31 D 1 pikë**

**Pyetja 32 D 1 pikë**

---

**Pyetja 33**

---

**Pyetja 33 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga funksionet e mëlçisë 2 pikë*

*Mëlçia luan rol në:*

- *prodhimin e lëngut të tëmthit, i rëndësishëm për përpunimin e lipideve.*
- *proceset e detoksimit të alkoolit dhe drogave, pra i bën ato të padëmshme.*
- *grumbullimin e vitaminave të tretshme në yndyra, si vitaminat A, D dhe K.*
- *shkatërrimin e hemoglobinës së rruazave të kuqe dhe grumbullimin e atomeve të hekurit që merren prej saj.*
- *metabolizmin e sheqernave.*

Mëlçia rregullon metabolizmin e sheqernave dhe sasinë e glukozës në gjak duke e depozituar sheqerin në formën e glikogjenit dhe duke e shndërruar atë sipas nevojës në glukozë. Mëlçia gjithashtu është e aftë të prodhojë glukozë të re nisur nga yndyrat dhe proteinat.

- *metabolizmin e proteinave.*

Mëlçia rregullon metabolizmin e proteinave. Nëse në mëlçi shkojnë më shumë aminoacide sesa është e nevojshme ato shkatërrohen. Grupi aminik (-NH<sub>2</sub>) i aminoacidit i shkëputur nga pjesa tjetër e molekulave në procesin që quhet deaminizim, shndërrohet në ure, që eliminohet nga veshkat me anë të urinës. Pjesa tjetër e molekulës futet në metabolizmin e sheqernave.

**1 pikë**

*Tregon një nga funksionet e mëlçisë 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 33 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon funksionin e amilazës pankreatike 1 pikë*

Pankreasi si gjëndër ekzokrine sekretion amilazën pankreatike në duoden.

Amilaza pankreatike shërben për tretjen e karbohidrateve në duoden.

Ose

Amilaza pankreatike shërben për tretjen e karbohidrateve në duoden.

---

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 34**

**Pyetja 34 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon përse lënda nuk humbet por riciklohet 1 pikë*

**Lënda**

Mbetjet që nxjerrin gjallesat gjatë proceseve jetësore (frymënxjerrja, jashtëqitja etj) dhe trupat pa jetë të gjallesave i nënshtrohen procesit të dekompozimit nga dekompozuesit (baktere dhe kërpudha), gjë që siguron riciklimin e lëndëve në natyrë.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Pyetja 34 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shpjegon përse energjia nuk mund të riciklohet 1 pikë*

**Energjia**

Energjia nga prodhuesit te konsumatorët vjen duke u zvogëluar.

Pjesa më e madhe e energjisë shndërrohet në formë nxehtësie që shpërhapet në mjedis, prandaj energjia nuk riciklohet.

**Ose**

Shkencëtarët kanë llogaritur se në çdo kalim, vetëm 10% e energjisë që ka një nivel përcillet në nivelin pasues. Kjo rregullsi në zvogëlimin e energjisë dhe ushqimit nga një nivel trofik në një tjetër quhet **ligji i të dhjetit**.

Pjesa më e madhe e energjisë shndërrohet në formë nxehtësie që shpërhapet në mjedis, prandaj energjia nuk riciklohet.

**Ose**

Sa më tepër ecni ju në zinxhirin ushqimor, aq më pak energji është e disponueshme nga energjia fillestare e ardhur nga Dielli. Kjo sepse në çdo nivel trofik organizmat

---

përdorin një sasi të madhe energjie që të jetojnë dhe të rriten, kështu që më pak energji është e disponueshme të kalojë te kafshët që i hanë ato. Pas rreth pesë hallkash të zinxhirit energjia faktikisht ka mbaruar.

Pjesa më e madhe e energjisë shndërrohet në formë nxehtësie që shpërhapet në mjedis, prandaj energjia nuk riciklohet.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

---

**Shënim:**

- Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.
- Kur pyetja kërkon që nxënësi të tregojë dallimet midis dy koncepteve ose dy proceseve, nxënësi do të marrë pikë të plotë kur tregon dallimin midis dy koncepteve ose dy proceseve, (jo kur tregon karakteristikat vetëm të njërit prej tyre).

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

EKONOMI

Ekonomi – Sesioni I

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1                      A              1 pikë

Pyetja 2                                      3 pikë

Model përgjigjeje

a) Sistem i ekonomisë së komanduar.

b)

- Pronë shtetërore mbi burimet.
- Planifikim se çfarë, si dhe për kë do të prodhohet.
- Çmime fikse.
- Sistemi i triskëtimit.

3 pikë nëse shkruan sistemin ekonomik dhe dy karakteristika të tij;

2 pikë nëse shkruan sistemin ekonomik dhe një karakteristikë të tij;

1 pikë nëse shkruan sistemin ekonomik;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 3                      D              1 pikë

Pyetja 4                      C              1 pikë

Pyetja 5                      D              1 pikë

Pyetja 6                      D              1 pikë


Pyetja 7                                      3 pikë

Model përgjigjeje

a)  $P_E = 4$ , rritet.

b)  $Q_E = 30$ , ulet.

c)



MATURA SHKETËRORE 2019


---

- 3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për tri kërkesat a), b) dhe c);  
**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjen vetëm për një nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 8** **4 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Elasticitet kërkesë.  
b) 40 % nëse llogaritet me metodën e pikës së mesit / 50 % nëpërmjet formulës  $\Delta P / P$   
c)  $E = 1.6$  me metodën e pikës së mesit /  $E = 1 (\Delta Q / Q) / (\Delta P / P)$



- 4 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për të katërta kërkesat a), b), c) dhe d);  
**3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për tri nga kërkesat;  
**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjen vetëm për një nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 9** **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Kredi afatgjatë / Hipotekore.  
b)  
• Karakteri.  
• Kapaciteti.  
• Kapitali.
-



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

<b>3 pikë</b>	nëse përcakton formën e kredisë dhe dy kushte që duhet të plotësojë ai;
<b>2 pikë</b>	nëse përcakton formën e kredisë dhe një kusht që duhet të plotësojë ai;
<b>Ose</b>	
<b>2 pikë</b>	nëse përcakton dy kushte që duhet të plotësojë ai;
<b>1 pikë</b>	nëse përcakton formën e kredisë;
<b>Ose</b>	
<b>1 pikë</b>	nëse përcakton një kusht që duhet të plotësojë ai;
<b>0 pikë</b>	nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 10      B                      1 pikë**

---

**Pyetja 11                              3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Firmë me ortakë.
- b) Të ardhurat e përgjithshme = 110 000 lekë.
- c) 12 000 lekë.

<b>3 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjet për të tria kërkesat a), b) dhe c);
<b>2 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
<b>1 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjen vetëm për një nga kërkesat;
<b>0 pikë</b>	nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 12                              C                      1 pikë**

**Pyetja 13                              A                      1 pikë**

---

**Pyetja 14                              3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a)  $AFC = FC / Q$ ;  $AFC = 100 / 4 = 25$
- b)  $MC = \Delta TC / \Delta Q$ ;  $MC = (370 - 310) / (6 - 5) = 60$
- c)  $ATC = TC / Q$ ;  $ATC = 310 / 5 = 62$

<b>3 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjet për të tria kërkesat a), b) dhe c);
<b>2 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
<b>1 pikë</b>	nëse shkruan saktë përgjigjen vetëm për një nga kërkesat;
<b>0 pikë</b>	nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

---

---

**Pyetja 15**                      **A**                      **1 pikë**

---

**Pyetja 16**    **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

a) tipare të përbashkëta:

- Shumë firma në treg.
- Hyrje dalje e lirë nga tregu.

b) tipare dalluese:

- Produkt homogjen / produkt i diferencuar.
- Çmimpranuese / Çmimkërkuese.

**3 pikë**                      nëse tregon dy tipare të përbashkëta dhe një tipar dallues;

**2 pikë**                      nëse tregon dy tipare të përbashkëta;

**Ose**

**2 pikë**                      nëse tregon një tipar të përbashkët dhe një tipar dallues;

**1 pikë**                      nëse tregon një tipar të përbashkët;

**Ose**

**1 pikë**                      nëse tregon një tipar dallues;

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 17**    **C**    **1 pikë**

**Pyetja 18**    **D**    **1 pikë**

---

**Pyetja 19**    **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

a) Pjesëmarrës / agjent në treg / Ofron të mira publike.

b) Arbitër / Garantuese e rregullave/ Trajton eksternalitetet.

c) Menaxhere / Rishpërndan të ardhurat / Ul varfërinë.

**3 pikë**                      nëse shkruan saktë përgjigjet për të tria kërkesat a), b) dhe c);

**2 pikë**                      nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;

**1 pikë**                      nëse shkruan saktë përgjigjen vetëm për një nga kërkesat;

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Pyetja 20**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

a)

- Stabiliteti i çmimeve. / Kontrolli i inflacionit. / Mbajtja e inflacionit në nivel të qëndrueshëm 3 + - 1%.

b)

- Në mënyrën e emërimit të guvernatorit / Zgjedhja e guvernatorit.
- Në politikën monetare dhe instrumentet e realizimit të saj.

**3 pikë**

nëse përcakton objektivin dhe dy shkaqet e pavarësisë së Bankës Qendrore;

**2 pikë**

nëse përcakton objektivin dhe një nga shkaqet e pavarësisë së Bankës Qendrore;

**OSE**

**2 pikë**

nëse përcakton shkaqet e pavarësisë së Bankës Qendrore;

**1 pikë**

nëse përcakton objektivin e Bankës Qendrore;

**OSE**

**1 pikë**

nëse përcakton një nga shkaqet e pavarësisë së Bankës Qendrore;

**0 pikë**

nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 21**

**D**

**1 pikë**

**Pyetja 22**

**A**

**1 pikë**

---

**Pyetja 23**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

a) 4

b) 2

c) Të dy bëjnë pjesë në papunësi friksionale.

**3 pikë**

nëse përgjigjet saktë për të tria kërkesat a), b) dhe c);

**2 pikë**

nëse përgjigjet saktë për dy kërkesa;

**1 pikë**

nëse përgjigjet saktë për një kërkesë;

**0 pikë**

nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Bie për dy tremujorë radhazi.  
b) Rritet.

**2 pikë** nëse shkruan saktë dy përgjigjet a) dhe b);  
**1 pikë** nëse shkruan saktë vetëm një nga përgjigjet;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 25** **B** **1 pikë**

---

**Pyetja 26** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Oferta monetare ulet.  
b) Inflacioni bie.

**2 pikë** nëse tregon ndikimin për a) dhe b);  
**1 pikë** nëse tregon ndikimin për a) ose b);  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 27** **C** **1 pikë**

**Pyetja 28** **A** **1 pikë**

---

**Pyetja 29** **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Besimi.
  - Vlerat.
  - Fryma e grupit.
  - Menaxhimi.
  - Komunikimi.
  - Kursimi.
  - Guximi.
  - Etj.
-

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

<b>3 pikë</b>	nëse përcakton tri shtylla;
<b>2 pikë</b>	nëse përcakton dy shtylla;
<b>1 pikë</b>	nëse përcakton një shtyllë;
<b>0 pikë</b>	nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

---

<b>Pyetja 30</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 31</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 32</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 33</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 34** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Mund të ndryshojë / përmirësojë cilësinë.
- Mund të ndryshojë vlerën.
- Mund të ndryshojë mënyrën se si e ofron produktin.
- Mund të hedhë në treg produkte alternative.

<b>2 pikë</b>	nëse liston dy nga mënyrat;
<b>1 pikë</b>	nëse liston një nga mënyrat;
<b>0 pikë</b>	nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

**Ekonomi – Sesioni II**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

---

**Pyetja 1**                      **D**              **1 pikë**

---

**Pyetja 2**                                      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Pika A tregon përdorim maksimal ose efektiv të burimeve ekonomike.
- b) Pika B tregon mospërdorim maksimal ose joefektiv të burimeve ekonomike.
- c) Pika C tregon që vendi nuk ka burime në dispozicion për të arritur atë kombinim prodhimi.

**3 pikë** nëse shkruan saktë të tria përgjigjet për kërkesat a), b) dhe c);

**2 pikë** nëse shkruan saktë dy prej përgjigjeve;

**1 pikë** nëse shkruan saktë vetëm një prej përgjigjeve;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 3**                      **C**              **1 pikë**

**Pyetja 4**                      **A**              **1 pikë**

**Pyetja 5**                      **C**              **1 pikë**

**Pyetja 6**                      **A**              **1 pikë**

---

**Pyetja 7**                                      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a)  $Q_e=15$  njësi.
- b)  $P_e=5$  njësi paraje.
- c) Nëse qeveria ndërhyr duke vendosur çmimin  $P=6$  ky do të quhet çmim dysHEME ose minimal.

**3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);

**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;

**1 pikë** nëse shkruan saktë vetëm një nga kërkesat;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI


---

Pyetja 8

4 pikë

**Model përgjigjeje**

- a) Kërkesë krejtësisht jo elastike.  
b)  $\% \Delta Q_d = 0$  / Sasia nuk ndryshon pavarësisht nga ndryshimi i çmimit.  
c)



- d) Psh: kërkesa për bukë / për mallra shumë të domosdoshëm.

- 4 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për kërkesat a), b), c), d);  
**3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për tri nga kërkesat;  
**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për një nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

Pyetja 9

3 pikë

**Model përgjigjeje**

Kursimi varet nga:

- a) parashikimet për të ardhmen;  
b) të ardhurat e individit;  
c) norma e interesit bankar;  
d) taksat mbi interesin bankar.

- 3 pikë** nëse shkruan saktë tre faktorë;  
**2 pikë** nëse shkruan sakte dy faktorë;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë një faktor;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

Pyetja 10

B

1 pikë

---

**Pyetja 11**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Përparësitë e firmave me ortakëri
- Organizimi dhe krijimi i lehtë.
  - Më shumë fonde financiare në dispozicion.
  - Ndarja e përgjegjësi.
  - Taksimi bëhet vetëm me një shkallë.
- b) Te metat
- Kapital i kufizuar.
  - Jetëgjatësi e kufizuar.
  - Përgjegjësi e pakufizuar.
  - Mundësi për mosmarrëveshje.

- 3 pikë** nëse identifikon dy përparësi dhe një të metë;  
**2 pikë** nëse identifikon dy përparësi;  
**OSE**  
**2 pikë** nëse identifikon një përparësi dhe një të metë;  
**1 pikë** nëse identifikon një përparësi;  
**OSE**  
**1 pikë** nëse identifikon një të metë;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

<b>Pyetja 12</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 13</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 14**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a)  $FC=18$  sepse kur  $Q=0 \rightarrow TC=FC$ .  
 b)  $MC = \Delta TC / \Delta Q$ ;  $MC = 120 - 100 / 5 - 4 = 20$ .  
 c)  $ATC = TC / Q \rightarrow ATC = 100 / 4 = 25$ .

- 3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për të tria kërkesat a), b) dhe c);  
**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjen për një nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

---

**Pyetja 15**      **B**                      **1 pikë**

---

**Pyetja 16**                                      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) konkurrencë monopolistike.
- b) monopol.
- c) oligopol.

**3 pikë**                      nëse shkruan saktë përgjigjet për të tria kërkesat a), b) dhe c);  
**2 pikë**                      nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;  
**1 pikë**                      nëse shkruan saktë vetëm një nga kërkesat;  
**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 17**                                      **A**                      **1 pikë**

**Pyetja 18**                                      **B**                      **1 pikë**

---

**Pyetja 19**                                      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Për të paguar shpenzimet qeveritare.
- Për të zbutur pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave.
- Për uljen e konsumit të produkteve të dëmshme.
- Qeveria përdor taksat për të stabilizuar ekonominë.
- Për të nxitur prodhimin vendas (taksat doganore).

**3 pikë**                      nëse liston tri arsye pse paguajmë taksa;  
**2 pikë**                      nëse liston dy arsye pse paguajmë taksa;  
**1 pikë**                      nëse liston një arsye pse paguajmë taksa;  
**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 20**                                      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a)
    - Shërben si bankë për bankat e nivelit të dytë.
-

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Përcakton normën e rezervës së detyrueshme.
- Mbikëqyr bankat e nivelit të dytë.
- Etj.

b)

- Shërben si bankë e qeverisë./ Shet bono thesari.

**3 pikë** nëse identifikon dy funksione të Bankës Qendrore që lidhen drejtpërdrejtë me Bankat e nivelit të dytë dhe një funksion të Bankës Qendrore që lidhet me qeverinë;

**2 pikë** nëse identifikon dy funksione të Bankës Qendrore që lidhen drejtpërdrejtë me Bankat e nivelit të dytë;

OSE

**2 pikë** nëse identifikon një funksion të Bankës Qendrore që lidhet drejtpërdrejtë me Bankat e nivelit të dytë dhe një funksion të Bankës Qendrore që lidhet me qeverinë;

**1 pikë** nëse identifikon një funksion të Bankës Qendrore që lidhen drejtpërdrejtë me Bankat e nivelit të dytë ose me qeverinë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

<b>Pyetja 21</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
------------------	----------	---------------

<b>Pyetja 22</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
------------------	----------	---------------

---

**Pyetja 23** **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- c) Ndikon në konsum C.
- d) Ndikon në eksport neto Nx.
- e) Ndikon në shpenzimet qeveritare G.

**3 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);

**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;

**1 pikë** nëse shkruan saktë vetëm një të një nga kërkesat;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Pyetja 24** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Norma e inflacionit =  $[\text{CPI (1928)} - \text{CPI (1927)} / \text{CPI (1927)}] \times 100 = [17.1 - 17.4 / 17.4] \times 100 = -1.7\%$ .
- b) Në këtë rast kemi deflacion.

**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për të dy kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjen për njërin nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 25** **C** **1 pikë**

---

**Pyetja 26** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Oferta monetare rritet.  
b) Oferta monetare ulet.

**2 pikë** nëse shkruan saktë përgjigjet për dy kërkesat;  
**1 pikë** nëse shkruan saktë vetëm njërin nga kërkesat;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 27** **C** **1 pikë**  
**Pyetja 28** **B** **1 pikë**

---

**Pyetja 29** **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Ligji që ndalon punën e të miturve / Lloji i punës / Konventa e Fëmijëve.
- Pengon arsimimin / Kohën e lirë në përputhje me zhvillimi moshor, etj.
- Pasojat sociale / Opinioni / Paragjykimet shoqërore.

**3 pikë** nëse evidenton tri elemente;  
**2 pikë** nëse evidenton dy elemente;  
**1 pikë** nëse evidenton një element;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---



FILOZOFI-SOCIOLOGJI

Filozofi-Sociologji – Sesioni I

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë
Pyetja 8	A	1 pikë
Pyetja 9	B	1 pikë
Pyetja 10	D	1 pikë

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje

Normat kulturore	Normat ligjore
<ul style="list-style-type: none"> <li>kanë lindur më herët në histori, për të rregulluar marrëdhëniet mes individëve;</li> <li>vendosen nga shoqëria;</li> <li>kanë fushë më të gjerë veprimi;</li> <li>janë më të shumëllojshme se normat ligjore;</li> <li>ndryshojnë më ngadalë në kohë, sepse mentaliteti i njerëzve përfaqëson bindjet e njerëzve që janë të qëndrueshme;</li> <li>shoqërohen me reagime të opinionit shoqëror;</li> <li>zbatohen me dëshirën e gjithsecilit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>lindën më vonë në histori, pra me lindjen e shtetit;</li> <li>vendosen nga organet kompetente, organi më i lartë ligjvënës është parlamenti;</li> <li>kanë fushë më të kufizuar veprimi sesa normat kulturore, ato hyjnë në veprim në rastet kur shkeljet e normave kulturore janë të rënda;</li> <li>janë më pak të shumëllojshme se normat kulturore;</li> <li>ndryshojnë më shpejt se sa normat kulturore, në përputhje me nevojat e shoqërisë;</li> <li>shoqërohen me sanksione ligjore ose dënime për ata që nuk respektojnë rregullat e pranuar nga shumica;</li> </ul>

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

	<ul style="list-style-type: none"><li>• zbatohen me detyrim, me forcën shtrënguese të shtetit dhe janë të barabarta për të gjithë etj</li></ul>
--	---

- 2 pikë** nëse evidenton dy dallime mes normave kulturore dhe normave ligjore;
- 1 pikë** nëse evidenton një dallim mes normave kulturore dhe normave ligjore;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 12**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Aftësimi intelektual dhe profesional – / nxënësit marrin njohuri në shkencë të ndryshme ekzakte dhe shoqërore, si matematikë, kimi, gjuhë, letërsi, histori etj., duke i aftësuar ata intelektualisht dhe profesionalisht; / I përgatit dhe i aftëson për tregun e punës; / U jep informacion, dije, kulturë, të nevojshme për t'u përshtatur në shoqërinë ku jetojnë etj.
- Zgjerimi i ndërveprimit me të tjerët –/ zgjeron rrethin shoqëror mes racave, nënkulturave, gjinive, besimeve dhe bindjeve të ndryshme.
- Programi mësimor i fshehtë – / kultivimi dhe zhvillimi i talenteve, prirjeve, pasioneve në fusha të ndryshme si arti, sporti etj.
- Stimulimi dhe motivimi i shpirtit konkurrues dhe ambicies për të qenë të suksesshëm etj.
- Edukimi -/ me rregulla dhe norma të sjelljes dhe bashkëveprimit me të tjerët; përcaktimi i kufijve të sjelljes normale brenda grupit shoqëror;/ përcaktimi i sanksioneve ose dënimeve në raste të shkeljes së kriterëve të sjelljes apo normave etj.

- 3 pikë** nëse tregon tri funksione të shkollës lidhur me shoqërizimin;
- 2 pikë** nëse tregon dy funksione të shkollës lidhur me shoqërizimin;
- 1 pikë** nëse tregon një funksion të shkollës lidhur me shoqërizimin;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 13**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

---

---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- a) Përcaktimi i kufijve morale - rregullat në shoqëri përcaktojnë kufijtë moralë të sjelljeve, që i detyrojnë njerëzit të sillen brenda tyre. / Sjelljet deviante janë shkelja ose kapërcimi i kufijve të vendosura nga shoqëria, pra kur sjellja e individit, grupit etj., bëhet shqetësim për të tjerët ose shkel të drejtat e tyre. / Ndaj sjelljeve deviante që shkelin “kufijtë e të moralshmes” reagon shoqëria, por shpesh edhe ligjet. / Reagimet kundërshtuese të opinionit ose ligjeve ndaj shkeljes së kufijve moralë shërbejnë për të mirën e shoqërisë, sepse u mësojnë të tjerëve si të sillen brenda normave shoqërore.
- b) Forcimi i unitetit shoqëror - shumica e njerëzve përjetojnë ndjenjën e zemërimit ndaj atyre që shkelin normat dhe rregullat e vendosura nga shoqëria, veçanërisht ndaj krimeve. Kjo i bën njerëzit më të vetëdijshëm për vlerat dhe normat që i bashkojnë. / Për t'u mbrojtur nga sjelljet deviante njerëzit forcojnë unitetin mes tyre.

**2 pikë** nëse shpjegon përkatësisht funksionin a) dhe b);  
**1 pikë** nëse shpjegon përkatësisht funksionin a) ose b);  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 14

**3 pikë**

#### Model përgjigjeje

- Pavarësia ekonomike e grave. / Punësimi i grave.
- Rritja e nivelit të arsimit dhe e personalitetit të grave. / Gratë e arsimuara, të emancipuara dhe me personalitet, nënshtrohen më pak ndaj dhunës fizike, psikologjike, emocionale, ekonomike, etj. të bashkëshortëve. / Psh vajzat me arsim të lartë, që kanë liri ekonomike, intelektuale dhe emocionale, përzgjedhin bashkëshortin, kanë më shumë kërkesa ndaj jetës dhe nuk i nënshtrohen dhunës.
- Ndryshimet në statuset e bashkëshortëve / Ndryshimet gjatë jetës të statuseve të njerit ose të të dy bashkëshortëve (pasurimi, karriera në profesion etj).
- Jetesa më e individualizuar. / Përkushtimi ndaj profesioneve private si mjekët, artistët, juristët, bizneset private etj., bën që njerëzit të jenë më të lire, të kalojnë më pak kohë pranë familjes dhe për pasojë të shtyhen drejt divorceve.

**3 pikë** nëse identifikon tri faktorë të rritjes së numrit të divorceve;  
**2 pikë** nëse identifikon dy faktorë të rritjes së numrit të divorceve;  
**1 pikë** nëse identifikon një faktor të rritjes së numrit të divorceve;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 15**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

Forma të shfaqjes së paragjytimeve janë:

- Stereotipat – përcaktohen si përshkrime të kategorive të ndryshme të njerëzve, të cilat vazhdojnë edhe përballë fakteve që i kundërshtojnë. / Stereotipat paragjykes mund të jenë me natyrë racore, etnike, kombëtare etj.
- Racizmi – besimi se racat kanë më shumë ose më pak përparësi apo mangësi gjenetike në krahasim me njëra – tjetrën. / Këto besime janë të paprovuara shkencërisht.

**2 pikë** nëse përshkruan dy forma të shfaqjes së paragjytimeve në shoqëri;

**1 pikë** nëse përshkruan një formë të shfaqjes së paragjytimeve në shoqëri;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 16**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- d) Përcaktimi i kuptimit të jetës - besimet fetare ndikojnë në drejtpeshimin psikologjik të njerëzve, i ngushëllojnë dhe i vetëdijësojnë ata për të përballuar dhimbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë ose vështirësitë e jetës së përditshme.
- e) Forcimi i unitetit shoqëror - Feja ndikon në forcimin e unitetit të anëtarëve të shoqërisë nëpërmjet predikimit dhe kontrollit të zbatimit të vlerave dhe normave të njëjta.
- f) Faktor i kontrollit shoqëror - përmes mistifikimit, besimet fetare i detyrojnë njerëzit të zbatojnë me korrektësi normat kulturore, sidomos ato më jetike për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

**3 pikë** nëse shpjegon përkatësisht funksionet a), b) dhe c);

**2 pikë** nëse shpjegon përkatësisht dy prej funksioneve a), b) dhe c);

**1 pikë** nëse shpjegon përkatësisht një prej funksioneve a), b) dhe c);

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---



**Pyetja 17**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

1. **Papunësia:** për shkak të: modernizimit të prodhimit dhe pajisjeve teknike që zëvendësojnë punën e krahut të punëtorëve; / mungesës së shkollimit të duhur; / mungesës së përvojës ose kualifikimit të nevojshëm; / të moshës (në moshë shumë të re 16-19 ose në moshë të shtyrë); / të gjinisë, përgjithësisht është më e lartë tek gratë sesa tek burrat, për shkak të detyrimeve familjare ose paragjyqimeve gjinore; / migrimit dhe emigrimit (lëvizja nga një vend në tjetrin sjell papunësinë deri në një stabilizim të ri); / shtimit të popullsisë në qendrat e zhvilluara urbane, për pasojë mungesës së vendeve të punës etj.
2. **Ekonomia e paligjshme:** ka shumë bizneseve dhe veprimtari ekonomike të peregjistruara dhe që nuk paguajnë taksa ndaj shtetit. Kjo ndodh për shkak të punës së pasiguruar të punonjësve, sepse:
  - pronarët kanë interes të deklarojnë më pak të ardhura dhe të paguajnë më pak taksa ndaj shtetit;
  - të punësuarit kanë interes të marrin më shumë para (pa ju mbajtur pjesa e kontributeve), si psh të rinjtë, nevojtarët, të dypunësuarit etj.;
  - ndalimi me ligj i dypunësimit, i detyron njerëzit të mos deklarojnë punën e dytë;
  - të punësuarit nuk kanë mundësi tjetër zgjedhje (detyrohen, për shkak të papunësisë), si p.sh punëtorët e krahut që punojnë me orë ose ditë pune;
  - të punësuarit nuk sigurohen dot për shkak të moshës, si p.sh të miturit, nën moshën 18 vjeç.
3. **Rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardha”** ose të punësuarit në sektorin e punës mendore dhe të shërbimeve, për shkak të rritjes së:
  - kërkesave të njerëzve për shërbime, për një jetë sa më cilësore dhe me lehtësira. Kjo çon në rritjen e numrit të sektorëve të shërbimeve, si psh në arsim, shëndetësi, banka, tregti, transport, shërbime telefonike, hidrosanitare, turizëm, administratë publike shtetërore ose private etj.
  - kërkesave të njerëzve për punësim në këto sektorë, për shkak të: rritjes së numrit të atyre që mbarojnë studimet në këto sektorë; preferencave për sektorët e shërbimit, që nuk kanë shumë lodhje fizike ose mendore, prandaj kryhen lehtësisht nga të gjithë, pa përjashtuar të rinjtë dhe gratë; fitohet mirë; kanë variacion pasi kanë kontakte me njerëzit dhe mundësojnë njohje të shumta; ofrojnë mundësi për të bërë karrierë etj.

- 3 pikë** nëse shpjegon përkatësisht karakteristikat a), b) dhe c);  
**2 pikë** nëse shpjegon përkatësisht dy prej karakteristikave a), b) dhe c);  
**1 pikë** nëse shpjegon përkatësisht një prej karakteristikave a), b) dhe c);  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.  
**Pyetja 18** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Lëvizja feministe ka këto objektiva:

- zbutjen e pabarazisë gjinore: Ndryshimi i mendësive ose mentalitetit të shoqërisë, mbi dallimet gjinore, si modele të reja sjelljeje, mendimi dhe veprimi, që i shikojnë burrat dhe gratë të barabartë në të drejta.
- përmirësimin e legjislacionit përkatës: për mbrojtjen e grave nga dhuna, diskriminimi.
- ndryshimin e politikave për punësimin dhe aktivizimin e grave në fusha të ndryshme të jetës.
- përkrahja e lirisë seksuale: gratë të vendosin kontrollin mbi seksualitetin dhe riprodhimin, si psh. për martesën, lindjen e fëmijëve ose ndërprerjen e shtatzënisë.

- 2 pikë** nëse identifikon dy prej objektivave të lëvizjes feministe;  
**1 pikë** nëse identifikon një prej objektivave të lëvizjes feministe;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë
Pyetja 21	C	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	C	1 pikë
Pyetja 24	D	1 pikë
Pyetja 25	C	1 pikë
Pyetja 26	D	1 pikë
Pyetja 27	B	1 pikë
Pyetja 28	B	1 pikë

---

**Pyetja 29** **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) **njohjen e vetvetes:** Sipas Sokratit njohja e vetes, e natyrës njerëzore është shumë e rëndësishme, sepse duke njohur shpirtin tonë mësojmë për:

---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- padijen, dobësitë, dhe iluzionet tona;
- atë çfarë e bën shpirtin tonë të lumtur, pra çfarë veprimesh i sjellin atij lumturi. / Njohja e vërtetë e shpirtit është baza e një jete të lumtur dhe të moralshme. / Njohja fillon nga vetja, tek thellimi dhe kthimi ndaj vetes, ku ndodhen të gjitha përgjigjet e pyetjeve tona. Ne thjesht duhet t'i zbulojmë ato brenda nesh.

b) **rrugën drejt lumturisë**: lumturia, sipas tij, është mirëqenia e shpirtit; çdokush ka dëshirë të jetë i lumtur. Si arrihet lumturia:

- **Dija** mbi shpirtin të çon drejt virtytit dhe lumturisë. / Për të patur një shpirt të lumtur duhet të dish dallimin mes të mirës dhe të keqes, vesit dhe virtytit. / Dija mbi to, na ndihmon të zbulojmë dobësitë dhe padijen tonë, të cilat na largojnë nga rruga e lumturisë dhe na çojnë drejt iluzioneve dhe veprimeve të gabuara. / Dituria është virtyt, ndërsa ligësia është mungesa e dijes, injoranca. / **Padija** i shtyn njerëzit të bëjnë sjellje dhe veprime të gabuara në jetë, si psh: pushteti, pasuria etj.
- **Kujdesi ndaj shpirtit**, që ai të jetë i lumtur, është shqyrtimi i vazhdueshëm i jetës, në çdo hap që hedh, për të njohur gabimet dhe për t'i përmirësuar ato. Një jetë me virtyt çon drejt lumturisë. Bërja e shpirtit sa më të mirë që të ishte e mundur çdo ditë.
- **Filozofia**, që ka si detyrë kryesore të kuptuarit e vetes dhe arritjen e lumturisë. / Sokrati mendonte se filozofët, si njerëzit më të ditur, janë në gjendje t'i japin shpjegim të keqes dhe të gjejnë rrugën e lumturisë së shpirtit për çdo individ.

**2 pikë** nëse shpjegon **a) edhe b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

**1 pikë** nëse shpjegon **a) ose b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 30**

**3 pikë**

### **Modele përgjigjeje**

Rrugët që të çojnë drejt lumturisë, sipas Epikutit, janë:

- çlirimi i njeriut nga frika e perëndive;
- çlirimi i njeriut nga frika e vdekjes;
- pushimi, ekuilibrimi dhe shmangia e dhimbjeve të trupit;
- paqja dhe qetësia e shpirtit, duke larguar shqetësimet e panevojshme;
- mençuria dhe dija e njeriut;
- respektimi i parimeve që na mëson filozofia;

- plotësimi i kërkesave të natyrës njerëzore (ushqimi, pushimi i trupit dhe mendjes dhe kënaqësi të tjera të trupit);
- mos tejkalimi i kufijve të dëshirave dhe kontrolli i tyre përmes mendjes;
- vënia e interesit shoqëror në shërbim të individit;
- përmbushja e dëshirave në të tashmen, pa u shqetësuar për të shkuarën dhe të ardhmen.

- 3 pikë** nëse identifikon tri nga rrugët e mësipërme;  
**2 pikë** nëse identifikon dy nga rrugët e mësipërme;  
**1 pikë** nëse identifikon një nga rrugët e mësipërme;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 31**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Burimi i lëvizjes: në natyrë gjenden gjëra në lëvizje dhe të tjerat në qetësi, por që mbartin në vetvete mundësinë e lëvizjes. Shkaku fillestar është në gjendje të vërë në lëvizje trupat, pa qenë vetë në lëvizje dhe ky mund të jetë vetëm Zoti.
- Shkaku dhe pasoja: sendet dhe fenomenet nuk ekzistojnë dhe nuk ndodhin pa një shkak të caktuar, por zinxhiri shkak-pasojë është i pafundmë. Shkaku i parë duhet të jetë ndryshe nga qeniet tokësore që kanë një shkak paraardhës. Kjo fuqi është Zoti.
- Rregulli universal: në natyrë ekziston një rregullsi perfekte, si lindja dhe perëndimi i diellit, etj. M.q.s këtu nuk mund të flitet për planifikim të arsyeshëm dhe as për rastësi, atëherë duhet të ekzistojë një inteligjencë universale që planifikon gjithçka dhe vendos rregull. Kjo forcë mund të jetë vetëm Zoti.

- 3 pikë** nëse shpjegon tri provat e mësipërme;  
**2 pikë** nëse shpjegon dy nga provat e mësipërme;  
**1 pikë** nëse shpjegon një nga provat e mësipërme;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

**Pyetja 32**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

Sipas Dekartit:

- **Momenti i dyshimit:** Ne jemi qenie të papërsosura, që mund të mashtrohemi lehtë, për pasojë duhet të dyshojmë për çdo gjë dhe në çdo çast, deri edhe në ekzistencën tonë. “A ekzistoj unë?” – pyet Dekarti.
- **Momenti i sigurisë:** bindja që ne ekzistojmë vjen nga fakti se ne mendojmë. Gjithsecili nga ne mund të thotë me bindje se ekziston. Në çastin që është duke menduar këtë gjë, është e qartë se ky pohim është i vërtetë. Pra, siguria e parë dhe mbështetëse për ekzistencën tonë, për të kaluar nga dyshimi tek e vërteta, sipas Dekartit, është vetë procesi i të menduarit apo të dyshuarit. “Mendoj, pra ekzistoj” – përgjigjet Dekarti.

**2 pikë** nëse shpjegon dy momentet e mësipërme;

**1 pikë** nëse shpjegon një nga momentet e mësipërme;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 33**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

Sipas Rusoit shteti lindi si marrëveshje mes njerëzve ose si një kontratë shoqërore kushtëzuar nga nevoja:

- për të mbrojtur: - jetën, nga sjellja agresive ndaj njëri – tjetrit;
- për të mbrojtur - paqen, dhe harmoninë mes njerëzve
- për të mbrojtur - pronën private, të cilën Rusoi e quan shkaktare të pabarazisë shoqërore dhe ndarjes në klasa të pasura dhe të varfra;
- për të mbrojtur - rregullin dhe drejtësinë, përmes ligjeve dhe ushtrimit të forcës dhe dhunës mbi ata që nuk i binden vullnetit të shumicës;
- për të mbrojtur - barazinë e të drejtave të individëve.
- për të arritur të mirën e përbashkët;
- për të garantuar një shoqëri më të mirë, një shtet demokratik, që siguron barazinë para ligjit të qytetarëve;
- për të ushtruar pushtetin e popullit sovran, ku gjithçka vendoset me votën e qytetarëve.

**3 pikë** nëse identifikon tre nga faktorët;

**2 pikë** nëse identifikon dy nga faktorët;

**1 pikë** nëse identifikon një nga faktorët;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 34**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- **Mbinjeriu** – Niçe e mohonte konceptin e barazisë, sepse sipas tij, vlerat morale janë të ndryshme tek çdo individ, nuk mund të ketë të mirë të përgjithshme. Historia, sipas Niçes, ecën drejt krijimit të mbinjeriut, pra të një individi:
  - të jashtëzakonshëm, që tejkalon çdo ditë vetveten, duke zbuluar një vete të re, përtej asaj që është. Këta individë janë vërtet pak, por iu takon e ardhmja e evolucionit historik;
  - të lartë, me vlera të rralla, që guxon të rivlerësojë vlerat ekzistuese të shoqërisë;
  - me nivelin më të lartë të zhvillimit të fuqisë fizike, intelektuale dhe emocionale;
  - vërtetë të lirë, të cilin nuk e ndalon asgjë;
  - ideal, tek i cili ekuilibrohen intelektin, racionalitetin dhe pasionin dhe energjinë;
  - i fortë që lufton dhe fiton ndaj vetvetes, duke u përballur me rreziqet;
  - kapërcen realitetin faktik dhe kufizimet e tij.
- **Vullneti për pushtet** – Për të krijuar “mbinjeriun” është i nevojshëm “vullneti për pushtet”, që Niçe e shikon si:
  - një fuqi të brendshme të njeriut, një shtytje e brendshme për të tejkaluar të mirën dhe të keqen;
  - fuqi krijuese, që është e aftë të formojë dhe krijojë ngjarje;
  - shprehje e fuqisë natyrore të njeriut, për të nxjerr në pah forcën dhe për të ushtruar pushtet;
  - fuqi që shfaq vetveten kudo dhe në çdo gjë;
  - fuqi që nuk e gëzojnë të gjithë në masë të njëjtë. Për këtë arsye, njerëzit nuk mund të jenë të barabartë.
  - përpjekje për rritjen dhe ushtrimin e pushtetit, me qëllim kapërcimin e pengesave dhe të keqes në jetë; Por, këtë vullnet njeriut ia kanë shtypur kisha dhe dogmat e saj, si dhe shoqëria me sistemin e vlerave.
  - fitore mbi vetveten, pra si kapërcim i vështirësive;
  - gëzim, kënaqësi, që vjen nga ndjenja e fuqizimit të pushtetit.

**2 pikë**

nëse shpjegon dy çështjet e mësipërme;

**1 pikë**

nëse shpjegon një nga çështjet e mësipërme;

**0 pikë**

nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 35**

**3 pikë**

---

### Model përgjigjeje

Sipas Sartrit si ekzistencialist:

- vullneti njerëzor nuk varet nga forca hyjnore, ai është i lirë; njeriu është i plotfuqishëm për të vendosur për jetën dhe nuk ka nevojë për një forcë tjetër, që të vendosë. Pa Zotin gjithçka është e mundur. Ai nuk ekziston, sepse nuk mund të ekzistojë asnjë qenie e përsosur. Kjo është liria për Sartrin.
- nuk ka qëllim të paracaktuar në ekzistencën tonë, pra fati nuk është i përcaktuar, çdo njeri vendos për veprimet e veta. Njeriu mund të ndryshojë veten, në bazë të zgjedhjeve të lira; asgjë nuk na pengon të ndërmarrim veprimet që duam, të bëjmë atë që duam në jetë, duke ndërtuar jetën që dëshirojmë.
- Sartri pranon edhe se liria kufizohet nga gjykimi i të tjerëve, sepse ne nuk jemi qenie të vetmuara, por individë shoqërorë; Sartri pranon rolin e shoqërisë mbi ne, ne nuk jemi të shkëputura prej saj dhe gjykimeve të të tjerëve, kjo na krijon një ankth të vazhdueshëm. Por, në fund të fundit, individi e zgjedh vetë rrugën e tij drejt lirisë, duke qenë i përgjegjshëm për rëndësinë e zgjedhjeve të tij në jetë, për vete dhe për të tjerët.
- Çdo gjë që bëjmë zbulon se çfarë mendojmë se duhet të jemi, çdo zgjedhje që bëjmë na përcakton si individë dhe kjo barrë e përgjegjësisë, që njeriu i lirë duhet të mbajë, i shkakton atij, po ashtu, një ankth të vazhdueshëm. Ne jemi vetë përgjegjës për kufizimin e lirisë tonë, sepse jeta na i jep të gjitha mundësitë. Duhet ta pranojmë lirinë tonë dhe ta jetojmë jetën ashtu siç dëshirojmë.
- Gjërat materiale dhe paraja, sipas tij, e kufizojnë lirinë e njeriut, sepse nevoja për para është justifikimi i njerëzve për të kufizuar lirinë e tyre. Domosdoshmëria për gjëra materiale nuk ekziston në realitet, ajo është një konstruksion shoqëror, që nxit njerëzit të mohojnë lirinë e tyre.

- 3 pikë** nëse analizon lirinë duke evidentuar tri nga aspektet e mësipërme;
- 2 pikë** nëse analizon lirinë duke evidentuar dy nga aspektet e mësipërme;
- 1 pikë** nëse analizon lirinë duke evidentuar një nga aspektet e mësipërme;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 36**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Sipas Marksit:**

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Feja lindi nga injoranca dhe padija e njerëzve primitivë, në pamundësi për të shpjeguar fenomenet e botës që i rrethonte.
- Feja vazhdon të ekzistojë për shkak të rrethanave të palumtura dhe vështirësive ekonomike të njerëzve në sistemin kapitalist, të cilët nuk gjejnë rrugëdalje tjetër nga realiteti i tyre.  
Feja, sipas Marksit, është si opium, që nuk e lejon popullin:
  - të ketë një ndërgjegje të saktë për botën, duke i ofruar atij një botë iluzionesh;
  - të kuptojë padrejtësitë që i bëhen, duke e vënë në gjumë;
  - të ngrihet kundër padrejtësive dhe shtypjes, për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.

- 2 pikë**            nëse identifikon dy aspekte të filozofisë ateiste të Marksit;  
**1 pikë**            nëse identifikon një aspekt të filozofisë ateiste të Marksit;  
**0 pikë**            nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Filozofi-Sociologji – Sesioni II**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

---

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë
Pyetja 8	B	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	A	1 pikë

---

**Pyetja 11** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

a) Ndikimi që ka kultura tek shoqëria.

Kultura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i jep gjithnjë shtysë zhvillimit të shoqërisë.

b) Ndikimi që ka shoqëria tek kultura.

Sa më e përparuar të jetë shoqëria aq më shumë kujdeset ajo për zhvillimin e kulturës.

**2 pikë** nëse analizon a) dhe b);

**1 pikë** nëse analizon a) ose b);

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 12** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Edukimi me vlera dhe norma kulturore - prindërit janë të prirur që t'i përgatisin fëmijët të jenë anëtarë të denjë të shoqërisë.

Përkatësia gjinore - që në fëmijëri, fëmijët në mënyrë të vetëdijshme ose jo marrin mësim nga familja për modelet përkatëse të sjelljes si vajza apo si djem.

Përcaktimi i statuseve - familja përveç të tjerave u siguron fëmijëve edhe pozitën shoqërore derisa ata ta ndryshojnë vet atë.

**3 pikë** nëse shpjegon tri veçoritë e mësipërme;

---

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- 2 pikë** nëse shpjegon dy nga veçoritë e mësipërme;  
**1 pikë** nëse shpjegon një nga veçoritë e mësipërme;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 13** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- a) Krime ndaj personit.
- b) Krimi kundër pasurisë / pronës.

- 2 pikë** nëse përcakton saktë kategorinë a) edhe b);  
**1 pikë** nëse përcakton saktë kategorinë a) ose b);  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 14** **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Quhet martesë që i lejon një individ të ketë më shumë se një bashkëshort ose bashkëshorte të seksit tjetër në të njëjtën kohë.
- b) Quhet martesë që bashkon në të njëjtën kohë një grua me një burrë.
- c) Quhet martesë ndërmjet dy individëve me përkatësi gjinore të ndryshme, që i përkasin grupeve ose kategorive shoqërore të ndryshme.

- 3 pikë** nëse shpjegon saktë të tre format e martesës;  
**2 pikë** nëse shpjegon saktë dy forma të martesës;  
**1 pikë** nëse shpjegon saktë një formë të martesës;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 15** **2 pikë**

---

---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

### Model përgjigjeje

- Stereotipat përcaktohen si paragjyime ndaj kategorive të ndryshme, të cilat vazhdojnë edhe përballë fakteve që i kundërshtojnë ato.
- Racizmi është një nga format më të skajshme të paragjyimeve i cili mbështetet në besimin se disa raca kanë më shumë ose më pak përparësi apo mangësi gjenetike në krahasim me të tjerat.

**2 pikë** nëse përshkruan të dy format e shfaqjes së paragjyimeve;

**1 pikë** nëse përshkruan një nga format e shfaqjes së paragjyimeve;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 16

**3 pikë**

#### Model përgjigjeje:

1. Sekti.
2. Kulti.
3. Eklesia.
4. Dinominejshën.

**3 pikë** nëse liston tri nga organizatat e mësipërme;

**2 pikë** nëse liston dy nga organizatat e mësipërme;

**1 pikë** nëse liston një nga organizatat e mësipërme;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 17

**2 pikë**

#### Model përgjigjeje:

1. Shtohet përdorimi i teknologjisë në bujqësi dhe pakësohen njerëzit që punojnë në atë sektor.
2. Rritet pesha specifike që kanë në shoqëri punëtorët e kualifikuar, të shkolluar dhe që i përkushtohen dijës dhe teknologjisë në përgjithësi.

**2 pikë** nëse analizon dy karakteristika;

**1 pikë** nëse analizon një karakteristikë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 18

**3 pikë**

---

**Model përgjigjeje:**

- a. Shfaqja e lëvizjes shoqërore.
- b. Masivizimi dhe organizimi.
- c. Burokratizimi.

**3 pikë** nëse përcakton tri fazat;  
**2 pikë** nëse përcakton dy faza;  
**1 pikë** nëse përcakton një fazë;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

Pyetja 19	D	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	A	1 pikë
Pyetja 24	A	1 pikë
Pyetja 25	D	1 pikë
Pyetja 26	B	1 pikë
Pyetja 27	A	1 pikë
Pyetja 28	C	1 pikë

---

**Pyetja 29** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Përgjigje e plotë

Sipas Protagorës rregullat morale dhe etike kanë karakter relativ dhe subjektiv. / Rregullat morale dhe etike ndryshojnë sipas shoqërive ( kulturave ) dhe vet individit. / Ai shprehet se njeriu është masa e të gjitha gjërave duke qenë ai subjekti i vlerësimit të rregullave morale dhe etike. / Sipas Protagorës njeriu është ai që vlerëson rregullat morale dhe etike në shoqëri.

Përgjigje e pjeshme

Sipas Protagorës njeriu është ai që vlerëson gjërat.

**2 pikë** nëse shpjegon në mënyrë të plotë mendimin e Protagorës;  
**1 pikë** nëse shpjegon në mënyrë të pjeshme mendimin e Protagorës;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 30** **2 pikë**

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Modele përgjigjeje:**

Njëshi është:

- e mira supreme;
- burim i gjithçkaje / Bota është krijuar nga parimi i parë;
- vendi, ku shpirti i njeriut kthehet përsëri;
- ai që përcakton objektet e veçanta, por nuk është material;
- i pandryshueshëm,
- i pafundmë,
- i pakapshëm nga ne;
- i përhershëm;
- i pakrijueshëm;
- është i pandashëm, etj.

**2 pikë** nëse përmend dy tipare;

**1 pikë** nëse përmend një tipar;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 31**

**4 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- burim i lëvizjes
- shkaku dhe pasoja
- qenia e domosdoshme nga vetvetja
- shkalla e përsosmërisë
- rregulli universal

**4 pikë** nëse liston katër nga provat e mësipërme;

**3 pikë** nëse liston tri nga provat e mësipërme;

**2 pikë** nëse liston dy nga provat e mësipërme;

**1 pikë** nëse liston një nga provat e mësipërme;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 32**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Shteti i Xhon Lok konsiderohet si modeli i shtetit liberal modern për këto arsye:

- mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë natyrore dhe civile të njeriut / mbrojtje e pronës, etj.
- parashikon ndarjen e pushteteve që ruan qeverinë nga korrupsioni.
- pranon të drejtën e qytetarëve për të kundërshtuar mënyrën e qeverisjes.
- toleranca dhe liria e besimit fetar. / Kisha e ndarë nga shteti.

**2 pikë** nëse evidenton dy elemente;

**1 pikë** nëse evidenton një element;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 33**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Republikë
- Monarki
- Despotizëm

**3 pikë** nëse liston tri tipa të organizimit shtetëror sipas Montesksesë;

**2 pikë** nëse liston dy tipa të organizimit shtetëror sipas Montesksesë;

**1 pikë** nëse liston një tip të organizimit shtetëror sipas Montesksesë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 34**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

**Sipas Bergson:**

a) Njohja relative

Përmes saj njeriu njih pjesërisht, sipas vetes së tij, duke përdorur si metodë intelektin / inteligjencën. Nuk është njohje e thellë.

b) Njohja absolute

Është njohja e vërtetë dhe e gjallë e objektit, është njohja e thellë duke përdorur intuitën.

**2 pikë** nëse shpjegon a) dhe b);

**1 pikë** nëse shpjegon a) ose b);

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 35**

**3 pikë**

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Model përgjigjeje**

- Etapa teologjike – shpjegimi i dukurive të natyrës përmes forcave hyjnore./ Politeizëm.
- Etapa abstrakte – Zoti është ai që shpjegon natyrën në tërësinë e saj./ Monoteizëm.
- Etapa pozitiviste - studimi i dukurive të veçanta përmes shkencave.

**3 pikë** nëse përshkruan të tri gjendjet;

**2 pikë** nëse përshkruan dy nga gjendjet;

**1 pikë** nëse përshkruan një nga gjendjet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 36**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

Analiza duhet të bëhet duke u mbështetur mbi këto dy aspekte:

- mohimi i historisë dhe kulturës së trashëguar / vlerave, etj
- mohimi i Zotit dhe ekzistencës së tij.

**2 pikë** nëse analizon duke evidentuar dy aspekte;

**1 pikë** nëse analizon duke evidentuar një aspekt;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

FIZIKË

Fizikë – Sesioni I

• Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	6	7	8	10	13	14
Përgjigja e saktë	C	D	A	C	D	B	D	B	D	C
Numri i Pyetjes	16	17	19	20	22	23	25	27	29	30
Përgjigja e saktë	D	D	B	C	B	B	B	D	D	C

Ushtrimi 5.

5/a Pikë të plota (2 pikë)

- ✓ Shkruan ekuacionin e lëvizjes për sferën B  $h = \frac{gt_B^2}{2}$  dhe përcakton kohën e rënies së

$$\text{sferave A dhe B. } t_B = \sqrt{\frac{2h}{g}}$$

- ✓ Shkruan ekuacionin e lëvizjes për sferën A  $H = V_{0A}t + \frac{gt_A^2}{2}$  dhe përcakton

Pikë të pjesshme (1 pikë)

- Shkruan vetëm ekuacionin e lëvizjes për sferën B  $h = \frac{gt_B^2}{2}$  dhe përcakton kohën e rënies së sferave A dhe B.  $t_B = \sqrt{\frac{2h}{g}}$
- Shkruan vetëm ekuacionin e lëvizjes për sferën A  $H = V_{0A}t + \frac{gt_A^2}{2}$
- Shkruan vetëm ekuacionet e lëvizjes për sferën A dhe B.

Asnjë pikë (0 pikë)

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar



**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**5/b Pikë të plota (2 pikë)**

**Mënyra e parë**

- ✓ Shkruan ekuacionin e shpejtësisë për sferën A  $V_A = V_0 + gt$  dhe njehson atë
- ✓ Shkruan ekuacionin e shpejtësisë për sferën B  $V_B = gt$  dhe njehson atë

**Mënyra e dytë**

- ✓ Shfrytëzon formulat :  $V_A^2 - V_0^2 = 2gH$  dhe nxjerr po vlerën
- ✓  $V_B^2 = 2gh$  dhe nxjerr po vlerën

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Shfrytëzon një të njënjtë prej formulave të mësipërme dhe përcakton vetëm shpejtësinë e sferës A.
- Shfrytëzon një të njënjtë prej formulave të mësipërme dhe përcakton vetëm shpejtësinë e sferës B.


**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 9.**

**Pikë të plota (4 pikë)**

- ✓ Vizaton forcat si në figurë.



- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy  $N - Gy = 0$

Ox:  $F - G_x - f = ma$  (1)

Oy:  $N - Gy = 0$  (2)



- ✓ Përcakton vlerat e  $G_x$  dhe  $f$   $G_x = mgsin57$   $f = \mu mgcos57$ , dhe i zëvendëson te ekuacioni (1)

$F - mgsin57 - \mu mgcos57 = ma$

- ✓ Pas transformimesh gjen nxitimin.  $a = \frac{F - mgsin57 - \mu mgcos57}{m}$

**Pikë të pjesshme ( 3 pikë)**

- ✓ Vizaton forcat në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy
- ✓ Përcakton vlerat e  $G_x$  dhe  $f$   $G_x = mgsin57$   $f = \mu mgcos57$ , dhe nuk i zëvendëson te ekuacioni që shpreh ligjin e dytë të Njutonit.

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Vizaton forcat në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy  $N - Gy = 0$   
 $Ox: F - G_x - f = ma$  (1)  
 $Oy: N - Gy = 0$  (2)

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Vizaton vetëm forcat në figurë.
- Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas, ox pa bërë zbërthimin e forcave duke argumentuar se sipas oy trupi nuk lëviz.  
 $Ox: G_x - f = ma$  (1)

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 11.**

**Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit,  $m_1v_1 = m_1v_1' + m_2v_2'$  dhe përcakton shpejtësinë  $v_2'$  të topit të dytë pas goditjes.



- ✓ Njehson energjinë kinetike të topave të bilardos para goditjes. Tregon se  $E_{k2} = 0$   $E_k = E_{k1} = \frac{1}{2}mv_1^2$
- ✓ Njehson energjinë kinetike të topave të bilardos pas goditjes.  
 $E_k' = E_{k1}' + E_{k2}'$  dhe argumenton se meqënëse energjia kinetike e topave para goditjes, është më e madhe se energjia kinetike e tyre pas goditjes, goditja nuk është elastike.

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit  $m_1v_1 = m_1v_1' + m_2v_2'$  dhe përcakton shpejtësinë  $v_2'$  të topit të dytë pas goditjes.
- ✓ Njehson vetëm energjinë kinetike të topave të bilardos para goditjes. Tregon se  $E_{k2} = 0$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit,  $m_1v_1 = m_1v_1' + m_2v_2'$  dhe përcakton shpejtësinë  $v_2'$  të topit të dytë pas goditjes.

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 12.**

**12/a**


**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin e ekuilibrit

$$E_A = E_B \quad E_{kA} + E_{pA} = E_{kB} + E_{pB} \quad mgh = m \frac{v^2}{2} \text{ nga ku } v = \sqrt{2gh}$$

- ✓ Njehson  $h$ , duke shfrytëzuar të dhënat e figurës  $h = l \cos 60^\circ$   $h = \frac{l}{2}$

$h = 20\text{cm}$ . Këtë vlerë e zëvendëson tek vlera e shpejtësisë.



**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Zbaton vetëm ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin e ekuilibrit dhe nuk përcakton lartësinë  $h$ .

$$E_A = E_B \quad E_{kA} + E_{pA} = E_{kB} + E_{pB} \quad mgh = m \frac{v^2}{2} \text{ nga ku } v = \sqrt{2gh}$$

- Njehson  $h$ , duke shfrytëzuar të dhënat e figurës  $h = l \cos 60^\circ$   $h = \frac{l}{2}$ , pa zbatuar ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin e ekuilibrit

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**


- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

12/b

Pikë të plota (2 pikë)

- ✓ Bën paraqitjen vektoriale të forcave që veprojnë mbi sferën kur kalon në pikën B si në figurë.
- ✓ Zbaton ligji e dytë të Njutonit për pikën B, duke argumentuar se kur trupi kalon në pikën B, rezultatja e forcave që e mban në lëvizje rrethore, është forca qendërsynuese.

$$T - mg = m \frac{v^2}{l} \text{ dhe përcakton } T = m(g + \frac{v^2}{l})$$



Pikë të pjesshme (1 pikë)

- Bën vetëm paraqitjen vektoriale të forcave që veprojnë mbi sferën kur kalon në pikën B, pa argumentuar që forca rezultante është forca qendërsynuese.

Asnjë pikë (0 pikë)

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

Ushtrimi 15.

Pikë të plota (3 pikë)

- ✓ Shkruan ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit për enën e parë ku ka gaz oksigjen. dhe përcakton shtypjen për këtë gjendje.  $p_1 V_1 = \frac{m}{M_O} RT_1$

$$p_1 = \frac{mR}{V_1 M_O} T_1$$

- ✓ Shkruan ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit për enën e dytë ku ka gaz hidrogjen. dhe përcakton shtypjen për këtë gjendje.  $p_2 V_2 = \frac{m}{M_H} RT_2$

$$p_2 = \frac{mR}{V_2 M_H} T_2$$

- ✓ Duke shfrytëzuar kushtet e problemit,  $T_1 = T_2$ ,  $m_1 = m_2$  dhe  $V_2 = 2 V_1$ , bën raportin

$$\frac{p_2 = \frac{M_O}{p_1} 2M_H}{p_1} \quad p_2 = 8p_1$$

Pikë të pjesshme (2 pikë)

- ✓ Shkruan ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit për enën e parë ku ka gaz oksigjen. dhe përcakton shtypjen për këtë gjendje.

$$p_1 V_1 = \frac{m}{M_O} RT_1 \quad p_1 = \frac{mR}{V_1 M_O} T_1$$

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- ✓ Shkruan ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit për enën e dytë ku ka gaz hidrogjen. dhe përcakton shtypjen për këtë gjendje.

$$p_2 V_2 = \frac{m}{M_H} RT_2 \quad p_2 = \frac{mR}{V_2 M_H} T_2$$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Shkruan vetëm ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit për enën e parë ku ka gaz oksigjen.  $p_1 V_1 = \frac{m}{M_H} RT_1$  dhe për enën e dytë

$$p_2 V_2 = \frac{m}{M_H} RT_2$$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
  - Përgjigje të gabuar
- 

**Ushtrimi 18.**

**18/a**

**Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Njehson intensitetin e fushës elektrike nga formula  $E = \frac{U}{d}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**18/b**

**Pikë të plota (1 pikë)**

**Mënyra e parë**

- ✓ Njehson punën e forcave të fushës elektrike gjatë zhvendosjes së elektronit nga pllaka negative, drejt pllakës pozitive nga formula  $A = qU$

**Mënyra e dytë**

- ✓ Njehson punën e forcave të fushës elektrike gjatë zhvendosjes së elektronit nga pllaka negative, drejt pllakës pozitive nga formula  $A = qEd$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**18/c**

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Analizon forcat që veprojnë mbi elektronin brenda fushës elektrike dhe sqaron se meqenëse masa e elektronit është shumë e vogël, nuk merret
-

parasysh forca e rëndesës së elektronit. Forca e vetme që vepron mbi elektronin, është forca e fushës elektrike, duke e paraqitur atë në figurë.

- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e elektronit në formën

$$qE = ma \text{ prej nga } a = \frac{qE}{m}$$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Tregon se forca e vetme që vepron mbi elektronin, është forca e fushës elektrike, duke e paraqitur atë në figurë, duke mos zbatuar ligjin e dytë të Njutonit për këtë rast.
- Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e elektronit në formën  $F = ma$ , por nuk tregon se kjo forcë është forca e fushës elektrike.

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 21.**

**21/a**

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Gjen rezistencën ekuivalente të rezistencës  $2\Omega$  dhe  $4\Omega$ . Janë të lidhura në seri
- ✓ Përcakton rrymën për këtë rast nga ligji i Ohmit  $I = \frac{\varepsilon}{R_{ek}}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Gjen rezistencën ekuivalente të rezistencës  $2\Omega$  dhe  $4\Omega$ . Janë të lidhura në seri
- Shkruan vetëm ligjin e Ohmit  $I = \frac{\varepsilon}{R_{ek}}$ , pa përcaktuar  $R_{ek}$

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**21/b**

**Pikë të plota (4 pikë)**

- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $2\Omega$   $U_{2\Omega} = IR_{2\Omega}$
- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $4\Omega$   
 $U_{4\Omega} = \varepsilon - U_{2\Omega}$
- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $4\Omega$  që është dhe rryma e plotë në qark  
 $I = \frac{U_{4\Omega}}{R_{4\Omega}}$

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

- ✓ Mqs  $U_{2\Omega} = U_R$ , dhe rryma në këtë rezistencë është 1A, njehson vlerën e rezistencës  $R = \frac{U_R}{I}$

**Pikë të pjesshme (3 pikë)**

- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $2\Omega$
- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $4\Omega$
- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $4\Omega$  që është dhe rryma e plotë në qark  
 $I = \frac{U_{4\Omega}}{R_{2\Omega}}$

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $2\Omega$
- ✓ Njehson diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $4\Omega$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njehson vetëm diferencën e potencialit në skajet e rezistencës  $2\Omega$
- Shkruan ligjin e Omit për qarkun, pa analizuar qarkun.

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
  - Përgjigje të gabuar
- 

**Ushtrimi 24.****24/a****Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Ndërton pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa. Fillimisht fluksi magnetik është zero. Mbas rrotullimit, fluksi merr vlerën maksimale
- ✓ Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2}{\Delta t}$   
 $\varepsilon = -\frac{BS}{\Delta t}$
- ✓ Njehson kohën e rrotullimit të spirës.  $\Delta t = \frac{1}{4} T$   $\Delta t = \frac{1}{4} \cdot \frac{2\pi}{\omega}$   $\Delta t = \frac{1}{8} s$ .  
Prej këtej zëvendëson dhe njehson fem e induktuar

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Ndërton pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa. Fillimisht fluksi magnetik është zero. Mbas rrotullimit, fluksi merr vlerën maksimale
  - ✓ Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{BS}{\Delta t}$
-

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Ndërton vetëm pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa. Fillimisht fluksi magnetik është zero. Mbas rrotullimit, fluksi merr vlerën maksimale
- Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{BS}{\Delta t}$ , pa argumentuar se cili është pozicioni i spirës mbas rrotullimit.

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**24/b**

**Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e Ohmit për spirën.  $I = \frac{\varepsilon}{R}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 26**

**26/a**

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Njehson periodën me formulën  $T = \frac{2\pi}{\omega}$
- ✓ Njehson frekuencë me formulën  $f = \frac{1}{T}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njehson vetëm periodën me formulën  $T = \frac{2\pi}{\omega}$
- Njehson vetëm frekuencë me formulën  $f = \frac{\omega}{2\pi}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**26/b**

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Përcakton gjatësinë e valës, nga të dhënat e figurës.
- ✓ Përcakton shpejtësinë e valës, nga formula  $\lambda = vT$  prej nga  $v = \frac{\lambda}{T}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Përcakton gjatësinë e valës, nga të dhënat e figurës. .



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- Shkruan formulat  $\lambda = vT$  ose  $v = \frac{\lambda}{T}$ , pa bërë njehsimet e duhura


**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
  - Përgjigje të gabuar
- 

**Ushtrimi 28.**

**Pikë të plota (4 pikë)**

- ✓ Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.
- ✓ Nga ndërtimi, tregon se meqenëse shëmbëllimi ndodhet në anë të kundërt të thjerës, thjera është përmbledhëse
- ✓ Përcakton vatrën e thjerës Nga pika A objekt, ndërton rrezen paralel me boshtin optik kryesor.



Bashkon pikën A' shëmbëllim me pikën ku kjo rreze pret thjerën. Aty ku kjo rreze pret boshtin, e thjerës, përcakton një rreze vatrë. Simetrikja e saj është vatra e dytë.

- ✓ shëmbëllimi është real, i përmbysur dhe i zmadhuar.

**Pikë të pjesshme (3 pikë)**

- ✓ Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.
- ✓ Nga ndërtimi, tregon se meqenëse shëmbëllimi ndodhet në anë të kundërt të thjerës, thjera është përmbledhëse
- ✓ Përcakton vatrën e thjerës Nga pika A objekt, ndërton rrezen paralel me boshtin optik kryesor. Bashkon pikën A' shëmbëllim me pikën ku kjo rreze pret thjerën. Aty ku kjo rreze pret boshtin, e thjerës, përcakton një rreze vatrë. Simetrikja e saj është vatra e dytë.

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.
- ✓ Nga ndërtimi, tregon se meqenëse shëmbëllimi ndodhet në anë të kundërt të thjerës, thjera është përmbledhëse

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Përcakton vetëm pozicionin e thjerës, pra qendrën optike të saj.

**Asnjë pikë ( 0 pikë)**

- Pa përgjigje
  - Çdo ndërtim i gabuar
-

Fizikë – Sesioni II

Lënda: Fizikë

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	6	7	8	10	13	14
Përgjigja e saktë	D	D	B	C	A	D	B	C	D	C
Numri i Pyetjes	16	17	19	20	22	23	25	27	29	30
Përgjigja e saktë	D	B	B	C	B	B	B	C	A	C

• **Pyetjet me zgjedhje**

**Ushtrimi 5.**

**5/a Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Shkruan formulën që përcakton lartësinë e ngjitjes së trupit kur njuh shpejtësinë fillestare dhe shpejtësinë në një pikë të lartësisë  $v^2 - v_0^2 = -2gh$

ku  $v = 4\text{m/s}$ . Prej nga  $h = \frac{v^2 - v_0^2}{-2g}$   $h = 2.4\text{m}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**5/b Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Njuhson kohën e ngjitjes  $t_1$  të trupit në lartësinë maksimale.  $t_1 = \frac{-v_0}{-g}$   $t_1 = 0.8\text{s}$
- ✓ Njuhson kohën e zbritjes  $t_2$  të trupit, deri në pikën ku shpejtësia ka vlerën  $4\text{m/s}$ .  
 $t_2 = \frac{v}{g}$   $t_2 = 0.4\text{s}$
- ✓ Njuhson kohën e plotë nga pika e nisjes deri në rikthimin ku shpejtësia bëhet  $4\text{m/s}$   
 $t = t_1 + t_2$   $t = 1.2\text{s}$

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Njuhson kohën e ngjitjes  $t_1$  të trupit në lartësinë maksimale.  $t_1 = \frac{-v_0}{-g}$   $t_1 = 0.8\text{s}$
- ✓ Njuhson kohën e zbritjes  $t_2$  të trupit, deri në pikën ku shpejtësia ka vlerën  $4\text{m/s}$ .  
 $t_2 = \frac{v}{g}$   $t_2 = 0.4\text{s}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njuhson vetëm kohën e ngjitjes  $t_1$  të trupit në lartësinë maksimale.  
 $t_1 = \frac{-v_0}{-g}$   $t_1 = 0.8\text{s}$

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

- Njehson vetëm kohën e zbritjes  $t_2$  të trupit, deri në pikën ku shpejtësia ka vlerën 4m/s.



Asnjë pikë ( 0 pikë)

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

Ushtrimi 9.

Pikë të plota (4 pikë)

- ✓ Vizaton forcat si në figurë.



- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy  $N - Gy = 0$

$$Ox: F - Gx - f = ma \quad (1)$$

$$Oy: N - Gy = 0 \quad (2)$$

- ✓ Përcakton vlerat e  $Gx$  dhe  $f$   $Gx = mg \frac{h}{l}$   $f = \mu mg \frac{d}{l}$ , ku  $l = \sqrt{d^2 + h^2}$  dhe i zëvendëson te ekuacioni (1) |

$$F - mg \frac{h}{l} - \mu mg \frac{d}{l} = ma$$

- ✓ Pas transformimesh gjen nxitimin.  $a = \frac{F - \frac{mg}{l}(h + \mu d)}{m}$   $a = 0$  Trupi ngjitet me lëvizje të njëtrajtëshme.

Pikë të pjesshme ( 3 pikë)

- ✓ Vizaton forcat në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy  $N - Gy = 0$

$$Ox: F - Gx - f = ma \quad (1)$$

$$Oy: N - Gy = 0 \quad (2)$$

- ✓ Përcakton vlerat e  $Gx$  dhe  $Gx = mg \frac{h}{l}$   $f = \mu mg \frac{d}{l}$ , ku  $l = \sqrt{d^2 + h^2}$ , dhe nuk i zëvendëson te ekuacioni që shpreh ligjin e dytë të Njutonit.

Pikë të pjesshme (2 pikë)

- ✓ Vizaton forcat në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas dy drejtimeve, ox dhe oy dhe tregon se sipas oy  $N - Gy = 0$

$$Ox: F - Gx - f = ma \quad (1)$$

$$Oy: N - Gy = 0 \quad (2)$$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Vizaton vetëm forcat në figurë.
- Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e trupit sipas, ox pa bërë zbërthimin e forcave duke argumentuar se sipas oy trupi nuk lëviz.  
Ox:  $G_x - f = ma$  (1)

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 11.**

**Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit,  $\overline{m_1 v_1} + \overline{m_2 v_2} = \overline{m_1 v'_1} + \overline{m_2 v'_2}$  ose  $m_1 v_1 - m_1 v_1 = (m_1 + m_2) v'$  dhe përcakton shpejtësinë e topave pas goditjes.  
 $v' = 2m/s$



- ✓ Njehson energjinë kinetike të topave të bilardos para goditjes.  $E_k = E_{k1} + E_{k2}$   
 $E_k = 8 \text{ J}$
- ✓ Njehson energjinë kinetike të topave të bilardos pas goditjes.  $E'_k = E'_{k1} + E'_{k2}$   
 $E'_k = 1.6 \text{ J}$  dhe tregon se meqënëse energjia kinetike e topave para goditjes, është më e madhe se energjia kinetike e tyre pas goditjes, goditja nuk është elastike.

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit,  $\overline{m_1 v_1} + \overline{m_2 v_2} = \overline{m_1 v'_1} + \overline{m_2 v'_2}$  ose  $m_1 v_1 - m_1 v_1 = (m_1 + m_2) v'$  dhe përcakton shpejtësinë e topave pas goditjes.  
 $v' = 2m/s$
- ✓ Njehson energjinë kinetike të topave të bilardos para goditjes.  $E_k = E_{k1} + E_{k2}$   
 $E_k = 8 \text{ J}$


**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit,  $\overline{m_1 v_1} + \overline{m_2 v_2} = \overline{m_1 v'_1} + \overline{m_2 v'_2}$  ose  $m_1 v_1 - m_1 v_1 = (m_1 + m_2) v'$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

Ushtrimi 12.



12/a

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin vertikal

$$E_A = E_B \quad E_{kA} + E_{pA} = E_{kB} + E_{kB} \quad mgh = m \frac{v^2}{2} \text{ nga ku } v = \sqrt{2gh}$$

- ✓ Njehson  $h$ , duke shfrytëzuar të dhënat e figurës  $h = l = 1.25\text{m}$   
Këtë vlerë e zëvendëson tek vlera e shpejtësisë.  $v = 5\text{m/s}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Zbaton vetëm ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin vertikal dhe nuk përcakton lartësinë  $h$ .

$$E_A = E_B \quad E_{kA} + E_{pA} = E_{kB} + E_{kB} \quad mgh = m \frac{v^2}{2} \text{ nga ku } v = \sqrt{2gh}$$

- Njehson  $h$ , duke shfrytëzuar të dhënat e figurës  $h = l \cdot \cos 60^\circ$   $h = \frac{l}{2}$ , pa zbatuar ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike kur sfera kalon nga pozicioni fillestar, në pozicionin vertikal

**Asnjë pikë (0 pikë)**


- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

12/b

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Bën paraqitjen vektoriale të forcave që veprojnë mbi sferën kur kalon në pikën B si në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për pikën B, duke argumentuar se kur trupi kalon në pikën B, rezultantja e forcave që e mban në lëvizje rrethore, është forca qendërsynuese.

$$T - mg = m \frac{v^2}{r} \text{ dhe përcakton } T = m(g + \frac{v^2}{r}) \quad T = 30\text{N}$$



**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Bën vetëm paraqitjen vektoriale të forcave që veprojnë mbi sferën kur kalon në pikën B, pa argumentuar që forca rezultante është forca qendërsynuese.

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 15.**

**Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Tregon se mbas hapjes së rubinetit, gazet do të zënë vëllimin e të dy enëve,  $V=4V_1$   
Shkruan ekuacionet e kalimit të gazit të parë nga vëllimi  $V_1$  në vëllimin  $4V_1$  dhe nxjerr shtypjen  $p_1$  për gazin e parë  $p_1V_1 = p_1'4V_1$   $p_1' = \frac{p_1}{4}$  (Proces izotermik)
- ✓ Shkruan ekuacionet e kalimit të gazit të dytë nga vëllimi  $3V_1$  në vëllimin  $4V_1$  dhe nxjerr shtypjen  $p_2$  për gazin e dytë  $p_23V_1 = p_2'4V_1$   $p_2' = \frac{3p_2}{4}$
- ✓ Njehson shtypjen e gazeve pas hapjes së rubinetit  $p = p_1' + p_2' = \frac{p_1}{4} + \frac{3p_2}{4}$   $p = 3.5 \cdot 10^5$  pa

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Shkruan ekuacionet e kalimit të gazit të parë nga vëllimi  $V_1$  në vëllimin  $4V_1$   $p_1V_1 = p_1'4V_1$ , por nuk përcakton  $p_1'$
- ✓ Shkruan ekuacionet e kalimit të gazit të dytë nga vëllimi  $3V_1$  në vëllimin  $4V_1$   $p_23V_1 = p_2'4V_1$ , por nuk përcakton  $p_2'$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- ✓ Tregon se mbas hapjes së rubinetit, gazet do të zënë vëllimin e të dy enëve,  $V=4V_1$
- ✓ Shkruan vetëm ekuacionet e kalimit të gazit të parë nga vëllimi  $V_1$  në vëllimin  $4V_1$   $p_1V_1 = p_1'4V_1$ , por nuk përcakton  $p_1'$
- ✓ Shkruan vetëm ekuacionet e kalimit të gazit të dytë nga vëllimi  $V_1$  në vëllimin  $4V_1$   $p_1V_1 = p_1'4V_1$ , por nuk përcakton  $p_2'$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 18.**

18/a

**Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Njehson nxitimin e lëvizjes së elektronit nga pllaka negative drejt pllakës pozitive, duke përdorur formulën  $d = \frac{1}{2} at^2$  prej nga  $a = \frac{2d}{t^2}$   $a = 10^{14} \text{m/s}^2$


**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

18/b

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Analizon forcat që veprojnë mbi elektronin brenda fushës elektrike dhe sqaron se meqenëse masa e elektronit është shumë e vogël, nuk merret parasysh forca e rëndesës së elektronit. Forca e vetme që vepron mbi elektronin, është forca e fushës elektrike, duke e paraqitur atë në figurë.
- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e elektronit në formën  $qE = ma$  prej nga  $E = \frac{ma}{q}$   $E = 5.6 \cdot 10^2 \text{N/C}$



**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e dytë të Njutonit për lëvizjen e elektronit në formën  $qE = ma$ , pa argumentuar se cila forcë lan rolin e forcës elektrike.

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

18/c

**Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Njehson diferencën e potencialeve ndërmjet pllakave me formulën  $U = Ed$   $U = 11.2 \text{V}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

Ushtrimi 21.

21/a

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Tregon se tensioni në skajet e rezistencës  $R_2 = 6 \Omega$ , është 6V, pasi ajo është në paralel me rezistencën  $R_1 = 3 \Omega$
- ✓ Njehson fuqinë në rezistencën  $6 \Omega$   $P_2 = \frac{U^2}{R_2}$   $P = 6\text{E}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Tregon se tensioni në skajet e rezistencës  $6 \Omega$ , është 6V, pasi ajo është në paralel me rezistencën  $3 \Omega$ , pa gjetur vlerën e fuqisë.

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

21/b

**Pikë të plota (4 pikë)**

- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $R_1 = 3\Omega$   $I_1 = \frac{u}{R_1}$   $I_1 = 2A$
- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $R_2 = 6\Omega$   $I_2 = \frac{u}{R_2}$   $I_2 = 1A$  dhe gjen rrymën e përgjithshme në qark  $I = I_1 + I_2$   $I = 3^\circ$
- ✓ Përcakton tensionin në rezistencën e panjohur  $R_x$ .  $U_{R_x} = \varepsilon - U_{12}$   $U_{R_x} = 6V$
- ✓ Njehson vlerën e rezistencës  $R_x$   $R_x = \frac{U_{R_x}}{I}$   $R_x = 2\Omega$

**Pikë të pjesshme (3 pikë)**

- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $3 \Omega$   $I_1 = \frac{u}{R}$   $I_1 = 2A$
- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $6\Omega$   $I_2 = \frac{u}{R}$   $I_2 = 1A$  dhe gjen rrymën e përgjithshme në qark  $I = I_1 + I_2$   $I = 3A$
- ✓ Shkruan formulën për gjetjen e vlerës së rezistencës  $R_x$   $R = \frac{U_R}{I}$ , pa gjetur tensioni në këtë ekzistencë.

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $3 \Omega$   $I_1 = \frac{u}{R}$   $I_1 = 2A$
- ✓ Njehson rrymën në rezistencën  $6\Omega$   $I_2 = \frac{u}{R}$   $I_2 = 1A$  dhe gjen rrymën e përgjithshme në qark  $I = I_1 + I_2$   $I = 3A$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njehson rrymën në rezistencën  $3 \Omega$   $I_1 = \frac{u}{R}$   $I_1 = 2A$   
Njehson rrymën në rezistencën  $6\Omega$   $I_2 = \frac{u}{R}$   $I_2 = 1A$

**Asnjë pikë (0 pikë)**



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---


- Pa përgjigje
  - Përgjigje të gabuar
- 

**Ushtrimi 24.**

**24/a**

**Pikë të plota (3 pikë)**

- ✓ Ndërton pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa. Fillimisht fluksi magnetik është maksimal. Mbas rrotullimit, fluksi merr vlerën zero.



- ✓ Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = \frac{\Phi_1}{\Delta t}$   
 $\varepsilon = \frac{BS}{\Delta t}$

- ✓ Njehson kohën e rrotullimit të spirës.  $\Delta t = \frac{1}{4} T$   $\Delta t = \frac{1}{4} \cdot \frac{2\pi}{\omega}$   $\Delta t = \frac{1}{4} s$ . Prej këtej zëvendëson dhe njehson  $\varepsilon = 32 \cdot 10^{-4} V$

**Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ Ndërton pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa.
- ✓ Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2}{\Delta t} \varepsilon = \frac{BS}{\Delta t}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Ndërton vetëm pozicionin e spirës përkundrejt fushës magnetike në pozicionin që jepet te kërkesa.
- Zbaton ligjin e Lencit  $\varepsilon = -\frac{\Delta\Phi}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2 - \Phi_1}{\Delta t}$   $\varepsilon = -\frac{\Phi_2}{\Delta t} \varepsilon = \frac{BS}{\Delta t}$ , pa argumentuar se cili është pozicioni i spirës mbas rrotullimit.

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**24/b**

**Pikë të plota (1 pikë)**

- ✓ Zbaton ligjin e Ohmit për spirën.  $I = \frac{\varepsilon}{R}$   $I = 3.2 A$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 26.**

26/a

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Njehson amplitudën e valës nga të dhënat në figurë  $A = 9\text{cm}$
- ✓ Njehson gjatësinë e valës nga të dhënat e figurës  $\frac{\lambda}{2} = 10\text{cm}$   $\lambda = 20\text{cm}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njehson vetëm amplitudën e valës nga të dhënat në figurë  $A = 9\text{cm}$
- Njehson vetëm gjatësinë e valës nga të dhënat e figurës  $\frac{\lambda}{2} = 10\text{cm}$   
 $\lambda = 20\text{cm}$

**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

26/b

**Pikë të plota (2 pikë)**

- ✓ Njehson periodën me formulën  $T = \frac{2\pi}{\omega}$   $T = 0.1\text{s}$
- ✓ Përcakton shpejtësinë e valës, nga formula  $\lambda = vT$  prej nga  $v = \frac{\lambda}{T}$   $v = 2\text{m/s}$

**Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- Njehson periodën me formulën  $T = \frac{2\pi}{\omega}$   $T = 0.1\text{s}$
- Shkruan formulat  $\lambda = vT$  ose  $v = \frac{\lambda}{T}$ , pa bërë njehsimet e duhura, pa përcaktuar periodën.


**Asnjë pikë (0 pikë)**

- Pa përgjigje
- Përgjigje të gabuar

**Ushtrimi 28.**

**Pikë të plota (4 pikë)**

- ✓ Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.
- ✓ Përcakton vatrën e thjerës Nga pika A objekt, ndërton rrezen paralel me boshtin optik kryesor.



---

## TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- ✓ *Bashkon pikën A' shëmbëllim me pikën ku kjo rreze pret thjerën. Aty ku kjo rreze pret bosht, e thjerës, përcakton një rreze të tjetër. Simetrikja e saj është vatra e dytë.*
- ✓ *Nga ndërtimi, tregon se meqenëse shëmbëllimi është i drejtë dhe i zvogëluar, thjera është shpërhapëse dhe shëmbëllimi është virtual.*

### **Pikë të pjesshme (3 pikë)**

- ✓ *Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.*
- ✓ *Përcakton vatrën e thjerës Nga pika A objekt, ndërton rrezen paralel me boshtin optik kryesor.*
- ✓ *Bashkon pikën A' shëmbëllim me pikën ku kjo rreze pret thjerën. Aty ku kjo rreze pret bosht, e thjerës, përcakton një rreze të tjetër. Simetrikja e saj është vatra e dytë.*

### **Pikë të pjesshme (2 pikë)**

- ✓ *Përcakton qendrën optike, duke kaluar rrezen ndërmjet pikave A dhe A'.*
- ✓ *Përcakton vatrën e thjerës Nga pika A objekt, ndërton rrezen paralel me boshtin optik kryesor.*

### **Pikë të pjesshme (1 pikë)**

- *Përcakton vetëm pozicionin e thjerës, pra qendrën optike të saj.*

### **Asnjë pikë (0 pikë)**

- *Pa përgjigje*
- *Çdo ndërtim i gabuar*

**GJEOGRAFI**

**Gjeografi – Sesioni I**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

<b>Pyetja 1</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 4</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 5 2 pikë**

Pika C:  $60^\circ \lambda L$   $60^\circ \varphi V$

Pika D:  $15^\circ \varphi V$   $45^\circ \lambda P$

**2 pikë** nëse gjen saktë  $\varphi$  dhe  $\lambda$  për të dy pikat;

**OSE**

**1 pikë** nëse gjen saktë  $\varphi$  dhe  $\lambda$  për një nga pikat;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 6 B 1 pikë**

**Pyetja 7 (a) 1 pikë**

Figura 1

**1 pikë** Nëse shkruan figura 1.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 7 (b) 2 pikë**

- Këndi i rënies së rrezeve të Diellit është më i vogël.
- Kohëzgjatja e ndriçimit është më e vogël.
- Në një sipërfaqe më të madhe, intensiteti i rrezatimit është më i vogël.

**2 pikë** nëse jep dy argumente;

**1 pikë** nëse jep një nga argumentet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

<b>Pyetja 8</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 9</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 10 (a) 1 pikë**

Në gjerësitë tropikale.

**1 pikë** nëse gjen gjerësinë gjeografike.

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 10 (b) 2 pikë**

- Temperaturat e larta.
- Avullimi i madh.
- Reshjet e pakta.
- Thatësia e madhe e ajrit.
- Etj.

**2 pikë** nëse jep dy nga arsyet.

**OSE**

**1 pikë** nëse jep një nga arsyet.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

<b>Pyetja 11</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
------------------	----------	---------------

---

**Pyetja 12 2 pikë**

- Shkëmbinjtë magmatikë efuzivë formohen kur magma ngurtësohet në sipërfaqe, ndërsa intruzivët në brendësi
-

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Në shkëmbinjtë magmatikë efuzivë magma ngurtësohet me shpejtësi dhe nuk formon kristale ose formon kristale të vogla, ndërsa në ata intruzivë, magma ngurtësohet më ngadalë dhe formon kristale.

**2 pikë** nëse jep dy dallime midis shkëmbinjve magmatikë efuzivë dhe intruzivë.

**OSE**

**1 pikë** nëse jep një nga dallimet midis shkëmbinjve magmatikë efuzivë dhe intruzivë.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 13**                      **A**                      **1 pikë**

---

**Pyetja 14 (a)**    **1 pikë**

Ujërat artezianë

**1 pikë** nëse gjen llojin e ujërave që tregohen në figurë;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 14 (b)**    **2 pikë**

- Shtresa ujëmbajtëse duhet të gjendet midis dy shtresave të papërshkueshme.
- Shtresat e papërshkueshme duhet të jenë në trajtë harku.

**2 pikë** nëse shkruan dy nga kushtet;

**OSE**

**1 pikë** nëse shkruan një nga kushtet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 15**                      **C**                      **1 pikë**

**Pyetja 16**                      **D**                      **1 pikë**

**Pyetja 17**                      **B**                      **1 pikë**

**Pyetja 18**                      **A**                      **1 pikë**

**Pyetja 19**                      **D**                      **1 pikë**

**Pyetja 20**                      **A**                      **1 pikë**

**Pyetja 21**                      **C**                      **1 pikë**

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Pyetja 22 (a) 1 pikë**

Indoevropiane

**1 pikë** Nëse përcakton familjen gjuhësore.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 22 (b) 1 pikë**

- Semito – hamatike
- Niger – Kongo
- Malajo - Polineziane

**1 pikë** nëse përcakton një nga familjet gjuhësore;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 22 (c) 1 pikë**

Sino - tibetiane

**1 pikë** nëse përcakton familjen gjuhësore;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 23 (a) 2 pikë**

- Piramida e vitit 2001 ka bazën më të gjerë se ajo e vitit 2011, që do të thotë se ka patur më shume lindje. / Në vitin 2001 ka patur më shumë lindje se në vitin 2011.
- Në vitin 2011 është rritur moshja mesatare e popullsisë, krahasuar me atë të vitit 2001.
- Në vitin 2011 është rritur pesha e moshës së tretë, krahasuar me atë të vitit 2001.
- Etj.

**2 pikë** nëse shkruan dy nga ndryshimet për të dy piramidat moshore;

**OSE**

**1 pikë** nëse shkruan një nga ndryshimet për të dy piramidat moshore;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 23 (b) 2 pikë**

- Emigrimi i të rinjve.
- Ulja e nivelit të lindshmërisë.
- Ulja e vdekshmërisë.
- Rritja e nivelit të standardit të jetesës.
- Etj.

**2 pikë** nëse shkruan dy nga arsyet;

**OSE**

**1 pikë** nëse shkruan një nga arsyet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 24 3 pikë**

- Vëllimi i madh i prodhimit industrial dhe bujqësor.
- Teknologjia e përparuar.
- Vëllimi i madh i tregut të jashtëm.
- Eksporti i madh i kapitaleve.
- Të ardhurat e larta kombëtare.
- Etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga treguesit;

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga treguesit;

**1 pikë** nëse shkruan një nga treguesit;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 25 (a) 1 pikë**

- Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik;
- Mbipopullimi;
- Niveli i lartë i papunësisë;
- Konflikte të ndryshme etnike, politike etj.;
- Etj.

**1 pikë** nëse përcakton një nga faktorët;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 25 (b) 1 pikë**

- Zhvillimi i dukshëm ekonomik;
- mundësi punësimi;
- mundësi arsimimi;
- infrastrukturë e zhvilluar;
- Etj.

**1 pikë** nëse përcakton një nga faktorët;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 26 (a) 1 pikë**

Azinë Juglindore

**1 pikë** nëse gjen rajonin e treguar në hartë;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 26 (b) 1 pikë**

- Singapori

**OSE**

- Malajzia

**OSE**

- Indonezia

**OSE**

- Tajlanda

**1 pikë** nëse gjen një nga shtetet;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 26 (c) 1 pikë**

Do të thotë që ky rajon karakterizohet nga një aktivitet i vazhdueshëm vullkanik dhe sizmik.

**1 pikë** nëse shkruan se ky rajon karakterizohet nga një aktivitet i vazhdueshëm vullkanik dhe sizmik;

---

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

<b>Pyetja 27</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 28</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 29</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 30</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 31 3 pikë**

- Përgjithësisht burojnë nga zonat e larta malore.
- Kanë luhatje të mëdha të prurjeve.
- Kanë luhatje të mëdha të niveleve.
- Kanë regjim shumë të çrregullt.
- Kanë forcë të madhe erozive.
- Dallohen për prurje të mëdha të ngurta.
- Derdhen në katër dete (Adriatik, Jon, Egje, Deti i Zi).
- Etj.

**3 pikë** nëse rendit tre nga veçoritë;

**OSE**

**2 pikë** nëse rendit dy nga veçoritë;

**1 pikë** nëse rendit një nga veçoritë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 32 3 pikë**

- Gjendet midis vargut të Korabit dhe vargjeve të Lurës.
- Shtrihet nga 250 – 700m mbi nivelin e detit
- ka drejtim veri-jug
- është formuar në një graben
- në disa sektorë është përfshirë nga lëvizjet ulëse duke formuar zgjerime (Dibrës, Peshkopisë dhe Kukësit)
- në disa sektorë të tjerë është përfshirë nga lëvizje ngritëse duke formuar ngushtime ( Skavicës dhe Topojanit)
- Etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga karakteristikat;

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga karakteristikat;

**1 pikë** nëse shkruan një nga karakteristikat;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 33 (a) 1 pikë**

Pas vitit 1990

**OSE**

Pas rënies së regjimit komunist

**1 pikë** nëse shkruan saktë periudhën;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 33 (b) 1 pikë**

Si pasojë e emigracionit të jashtëm të popullsisë, pas vitit 1990, ku shumicën dërrmuese të popullsisë që emigroi e zinte elementi mashkull.

**1 pikë** nëse shkruan arsyen;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 33 (c) 1 pikë**

Është rritur.

**1 pikë** nëse përcakton që mosha mesatare është rritur;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 34 (a) 1 pikë**

- Në Rajonin Jugor mbizotërojnë strukturat rrudhosëse (antiklinale-sinklinale), ndërsa në Rajonin Juglindor ato shpesh janë të shkëputëse (horst-graben).

**Pyetja 34 (b)      1 pikë**

Fushëgropa e Delvinës

**OSE**

Gjiri i Vlorës

**OSE**

Grabeni i Dukatit

**1 pikë**            nëse jep një nga pjesët përbërëse.

**0 pikë**            nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 34 (c)      1 pikë**

Gropa Kolonjës

**1 pikë**            nëse gjen pjesën përbërëse të Rajonit Juglindor.

**0 pikë**            nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Gjeografi – Sesioni II**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

---

<b>Pyetja 1</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 4</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 5**

a) **1 pikë**

**Përgjigje:**

Lumi rrjedh më ngadalë në pikën 3.

**1 pikë** Nëse përcakton pikën ku lumi rrjedh më ngadalë.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **2 pikë**

**Përgjigje e plotë:**

Kjo ndodh pasi në këtë pikë relievi ka pjerrësinë më të vogël. Sa **më pak** të dendura të jenë izohipset, aq më e vogël është pjerrësia e relievit dhe për rrjedhojë aq më e vogël do të jetë shpejtësia e rrjedhjes.

**Përgjigje e pjesshme:**

Kjo ndodh pasi në këtë pikë relievi ka pjerrësinë më të vogël.

**2 pikë** Nëse jep argumentin e plotë.

**OSE**

**1 pikë** Nëse jep argumentin e pjesshëm.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 6** **C** **1 pikë**

---

**Pyetja 7**

a) **1 pikë**

Figura 2

**1 pikë** Nëse shkruan figura 2.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

b) **2 pikë**

Gjatë stinës së verës intensiteti i rrezatimit është më i madh sepse:

- këndi i rënies së rrezeve të Diellit është më i madh;
- kohëzgjatja e ndriçimit është më e madhe;
- në një sipërfaqe më të vogël, intensiteti i rrezatimit do të jetë më i madh.

**2 pikë** nëse jep dy argumente;

**1 pikë** nëse jep një nga argumentet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 8**

**B**

**1 pikë**

**Pyetja 9**

**C**

**1 pikë**

**Pyetja 10**

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Valët cunami formohen si pasojë e:

- tërmeteve nënujore

**OSE**

- shpërthimit të vullkaneve nënujore.

**1 pikë** nëse përcakton shkakun e formimit të valëve cunami.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

- Në det të hapur kanë lartësi të ulët (deri në 0.5 m).
- Lartësinë më të madhe e arrijnë kur përplasen në breg (shkon deri në 30m lartësi).
- Kanë shpejtësi me qindra km/orë.
- Kanë forcë të madhe shkatërruese.
- Etj.

**1 pikë** nëse jep një nga karakteristikat;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

**Pyetja 11**

**B**

**1 pikë**

**Pyetja 12**                      **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

Shkëmbinjtë sedimentarë formohen si rezultat i grumbullimit dhe sedimentimit të produkteve të shkatërrimit të shkëmbinjve ekzistues/procesi i diagjenezës. Shkëmbinjtë magmatikë formohen si pasojë e ngurtësimit të magmës (në brendësi ose në sipërfaqe).

**2 pikë**                      nëse shpjegon se si formohen të dy llojet e shkëmbinjve

**OSE**

**1 pikë**                      nëse shpjegon se si formohet një nga llojet e shkëmbinjve

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 13**                      **C**                      **1 pikë**

---

**Pyetja 14**

**Model përgjigjeje**

**a)                      2 pikë**

- Janë lëvizje të ngadalta shekullore, të vazhdueshme.
- Mund të jenë lëvizje ngritëse ose ulëse.
- Kapin territore të mëdha dhe shfaqen kudo.
- Vihen re më shumë pranë brigjeve detare.
- Kanë amplitudë të vogël.

**2 pikë**                      nëse jep dy nga karakteristikat;

**OSE**

**1 pikë**                      nëse jep një nga karakteristikat;

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b)                      1 pikë**

*Dëshmi për lëvizjet luhatëse pozitive (ngritëse)*

- Formimi i ishujve koralorë.
- Thellimi i shpejtë i shtretërve të lumenjve.
- Krijimi i tarracave lumore dhe detare.
- Tarracat detare mund të arrijnë deri në 1 000m lartësi etj.

*Dëshmi për lëvizjet luhatëse ulëse (negative)*

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Deltat e mbytura.
- Zgjatja e luginave lumore në thellësitë detare.
- Vendbanimet e mbytura.
- Etj

**1 pikë** nëse jep një nga dëshmitë e mësipërme, pavarësisht nëse i takojnë lëvizjeve luhatëse pozitive apo negative.

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

<b>Pyetja 15</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 17</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 18</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 19</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 20</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 21</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 22**      **3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- a) Përfshin gadishullin e Skandinavisë, Jutlandës dhe ishullin e Islandës.
- b) Dallohet për fjordet, vullkanet e gejzerët.
- c) Dallohet për klimë të ftohtë.
- d) Lumenjtë janë të shkurtër dhe me ujë të bollshëm.
- e) Dallohet për liqene të shumtë akullnajorë.
- f) Malet janë me moshë të vjetër.
- g) Etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga veçoritë;

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga veçoritë;

**1 pikë** nëse shkruan një nga veçoritë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**



**Pyetja 23      3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Në hapësirën qendrore mbizotëron industria, shërbimet dhe veprimtaritë ekonomike, që sigurojnë të ardhura të larta, ndërsa në hapësirën periferike mbizotëron ekonomia bujqësore dhe ndërmarrjet prodhuese.
- Në hapësirën qendrore popullsia është e përqendruar, ndërsa në atë periferike e shpërndarë.
- Në hapësirën qendrore vërehet një infrastrukturë e zhvilluar, ndërsa në atë periferike zhvillim i ulët i infrastrukturës.
- Hapësira qendrore i eksporton periferisë produkte industriale dhe mjete shërbimi, ndërsa ajo periferike furnizon hapësirën qendrore me lëndë bujqësore, blegtorale dhe fuqi punëtore.
- Etj.

**3 pikë**                      nëse shkruan tre nga dallimet;

**OSE**

**2 pikë**                      nëse shkruan dy nga dallimet;

**1 pikë**                      nëse shkruan një nga dallimet;

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 24**

**Model përgjigjeje**

**a)                              2 pikë**

- Piramida e vitit 2001 ka patur shtim më të lartë natyror, pasi baza e piramidës është më e gjerë se ajo e vitit 2011.

**2 pikë**                      nëse gjen piramidën e vitit 2001 dhe jep argumentin e bazës së piramidës.

**OSE**

**1 pikë**                      nëse gjen piramidën e vitit 2001.

**0 pikë**                      nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b)                              2 pikë**

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Ndryshimet më të mëdha vihen re në drejtim të strukturës moshore, pasi në bazë të figurës kemi ndryshime të theksuara te baza e piramidës dhe te mosha nga 20-45 vjeç.

**2 pikë** nëse gjen se ndryshimet më të mëdha janë në drejtim të strukturës moshore dhe jep argumentin bazuar te figura.

**OSE**

**1 pikë** nëse gjen se ndryshimet më të mëdha janë në drejtim të strukturës moshore, pa dhënë argumentin.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 25**

**2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Australia ka një reliev përgjithësisht të ulët, ndërsa Zelanda e Re malor.
- Australia ka pasuri të mëdha natyrore ndërsa Zelanda e Re i ka të kufizuara këto burime.
- Zelanda e Re ka klimë më të lagët se Australia.
- Australia ka zona shkretinore, ndërsa Zelanda e re nuk ka.

**2 pikë** nëse shkruan dy nga ndryshimet;

**OSE**

**1 pikë** nëse shkruan një nga ndryshimet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 26**

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Rajoni i Azisë Jugore

**OSE**

Nënkontinenti Indian

**OSE**

Subkontinenti Indian

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**1 pikë** nëse gjen emrin e rajonit;  
**OSE**  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) **2 pikë**

Indi, Gangu, Brahmaputra.

**2 pikë** nëse identifikon dy nga lumenjtë;  
**OSE**

**1 pikë** nëse identifikon një nga lumenjtë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

<b>Pyetja 27</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 28</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 29</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 30</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 31**

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Lëvizjen natyrore të popullsisë

**OSE**

Shtimin natyror të popullsisë

**1 pikë** nëse shkruan tiparin strukturor të popullsisë;

**OSE**

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) **2 pikë**

Shtimin më të lartë natyror e ka popullsia shqiptare që jeton në Serbi. Ajo gjendet duke bërë diferencën midis numrit të lindjeve me numrin e vdekjeve. Në rastin konkret del 20.4 ( $25.9 - 5.5 = 20.4$ ).

**2 pikë** nëse gjen popullsinë që ka shtimin natyror më të lartë **DHE** shpjegon se si e gjen;

**OSE**

**1 pikë** nëse gjen popullsinë që ka shtimin natyror më të lartë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Luftërat e shumta.
- Pushtimet e vendit nga të huajt.
- Gjendja e vështirë ekonomike.
- Etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga faktorët;

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga faktorët;

**1 pikë** nëse shkruan një nga faktorët;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 33**

**Model përgjigjeje**

a) **2 pikë**

*Ndërtimi gjeologjik*

- Rajoni Jugor përbëhet vetëm nga terrigjenë dhe gëlqerorë, ndërsa Rajoni Juglindor përbëhet nga terrigjenë, flishe, gëlqerorë dhe magmatikë.

*Relievi*

- Rajoni Jugor përbëhet nga vargje malorë të rregullt, ndërsa rajoni Juglindor përbëhet nga gropa dhe fushëgropa

**2 pikë** nëse jep një ndryshim për ndërtimin gjeologjik dhe një për relievin.

**OSE**

**1 pikë** nëse jep një ndryshim për ndërtimin gjeologjik **OSE** një për relievin.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

mali i Polisit **OSE** mali i Shpatit, **OSE** mali i Gurit të Zi, **OSE** mali i Gurit të Topit **OSE** mali i Valamarës.

**1 pikë** nëse jep një nga pjesët përbërëse.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 34**

**3 pikë**

- Drejtimi Veri - Jug vargjet e Lurës **OSE** Mali i Thatë
- Drejtimi VP-JL Trebeshinë- Dhëmbel-Nëmërçkë **OSE** Shëndëlli-Lunxheri -Bureto, **OSE** Krujë-Dajt, etj
- Drejtimi rrezor Alpet shqiptare

**3 pikë** nëse përcakton një sistem malor për secilin nga drejtimet;  
**OSE**

**2 pikë** nëse përcakton një sistem malor për dy nga drejtimet;

**1 pikë** nëse përcakton një sistem malor për një nga drejtimet;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**HISTORI**

**Histori – Sesioni I**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

---

<b>Pyetja 1</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 4**                      **2 pikë**

- **Forma e qeverisjes**

Athina pati një kombinim qeverisje aristokratike dhe demokratike, ndërsa Sparta ishte vazhdimisht e qeverisur në formë oligarkike dhe pjesëmarrja e qytetarëve ishte më e kufizuar.

- **Reformat**

Në Athinë u kryen shumë reforma që i dhanë gjithnjë e më shumë pushtet qytetarëve dhe ndryshuan shumë aspekte të jetës, ndërsa Sparta nuk njohu një numër të madh reformash, kishte një strukturë shtetërore dhe qytetare me pak ndryshime në kohë.

- **Ekonomia**

Jeta ekonomike e Athinës ishte më e orientuar nga artizanati dhe tregtia me vende të tjera (kjo për shkak të pozicionit të saj buzë detit), ndërsa ekonomia spartane bazohej kryesisht në bujqësinë. Një pjesë e mirë të të ardhurave shkonte për shpenzime ushtarake.

- **Vlerat shoqërore**

Shoqëria athinase bazohej në kultivimin e kulturës, arteve dhe edukimit të rinisë me dije, ndërsa shoqëria spartane bazohej në një regjim të rreptë ushtarak me qëllim që spartanët të ishin luftëtarë të zotë.

- **Pozicioni i gruas**

Në Athinë, gratë kryesisht merreshin me shtëpinë dhe fëmijët, ndërsa Sparta i njihte grave një rol më të rëndësishëm në shoqëri

- **Marrëdhëniet me të tjerët**

Athina gjithnjë ka pasur synim që të shtrinte kontrollin e saj mbi zonat e tjera në Greqi, ndërsa Sparta ishte një qytet-shtet relativisht i izoluar. Qytetarët spartanë nuk lejoheshin që të largoheshin nga Sparta për të evituar influencat e huaja mbi ta.

- Etj.

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**2 pikë** Nëse identifikon dy nga ndryshimet.

**OSE**

**1 pikë** Nëse vë në dukje një nga ndryshimet.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 5**

**2 pikë**

**Model përgjigje**

- Ndarja administrative në 4 provinca.
- U zhvillua një reformë agrare e thellë dhe shumë toka iu dhanë kolonëve romakë. U krijuan latifondet.
- Një numër qytetesh ilire u rrënuan, ndërsa disa të tjera u kthyen në koloni romake.
- U përhap kultura romake.
- Mori hov ndërtimi i veprave me karakter civil dhe ushtarak, rrugët e komunikimit.
- U ndërtuan shumë rrugë për komunikim siç ishte dhe rruga Egnatia.
- Etj.

**2 pikë** Nëse shpjegon dy nga pasojat.

**OSE**

**1 pikë** Nëse shpjegon një nga pasojat.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

<b>Pyetja 6</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
-----------------	----------	---------------

<b>Pyetja 7</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
-----------------	----------	---------------

<b>Pyetja 8</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
-----------------	----------	---------------

<b>Pyetja 9</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
-----------------	----------	---------------

---

**Pyetja 10 (a)**

**3 pikë**

- 1/3 e trojeve të banuara nga arbrit (Nga Lezha në Dibër dhe nga Ohri deri në Durrës)
  - Kryeqendra që ishte Kruja
  - Simbolet e shtetit
-

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- Njohja ndërkombëtare (titujt e Dhimitrit) dhe aleancat me Republikën e Raguzës, Papa Inocenti III
- Etj.

**3 pikë** Nëse liston tre prej elementeve të mësipërm

**OSE**

**2 pikë** Nëse rendit dy prej prej elementeve të mësipërm

**1 pikë** Nëse rendit një prej elementeve të mësipërm

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 10 (b) 1 pikë**

- Mbretëria serbe e Rashës.
- Dukati i Venedikut.
- Despotati i Epirit.

**1 pikë** Nëse identifikon një prej shteteve.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

<b>Pyetja 11</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 12</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 13</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 14</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 15</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 17 3 pikë**

- Përfitoi pagesën e dëmshpërblimeve.
- Franca dorëzoi krahinën e Alsas Lorenës
- U krijua Gjermania e bashkuar dhe u kurorëzua Perandoria Gjermane.
- U rrit roli i shtetit të ri gjerman në diplomacinë evropiane.

**3 pikë** Nëse rendit tre prej pasojave të mësipërme

**OSE**

**2 pikë** Nëse rendit dy prej pasojave të mësipërme

**1 pikë** Nëse rendit një prej pasojave të mësipërme

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---



---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Pyetja 18**                      **3 pikë**

- Krahu i lirë i punës si pasojë e procesit të gardhimit.
- Flota e fuqishme tregtare.
- Ekzistenca e një perandorie të madhe koloniale.
- Sistemi bankar dhe lehtësira kreditimi të zhvilluara.
- Pasuritë minerare sidomos në qymyrguri dhe hekur.
- Një rrjet i gjerë dhe i zhvilluar kanalesh të përdorshëm për transport.
- Afërsia e qyteteve kryesore me detin.
- Etj.

**3 pikë**                      Nëse jep tre nga faktorët.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse jep dy nga faktorët.

**1 pikë**                      Nëse jep një nga faktorët.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 19**                      **3 pikë**

- Me vullnet të lirë.
- Favorizimi me dhurata dhe të holla.
- Tregtia ishte monopol i myslimanëve.
- Ngjitja e shkallëve në karrierën ushtarake.
- Favorizimi në taksim i myslimanëve (xhizja).
- Dhuna dhe detyrimi sidomos pas shtypjes së kryengritjeve.
- Mungesa e një kiske vendase ku të predikohej shqip.
- Sistemi i devshirmesë që grumbullonte periodikisht fëmijët e krishterë.
- Për shkak të bogomilizmit.
- Etj.

**3 pikë**                      Nëse rendit tre prej formave që u përdorën.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse rendit dy prej formave që u përdorën.

**1 pikë**                      Nëse rendit një prej formave që u përdorën.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

---

MATURA SHETËRORE 2019

---

Pyetja 20	A	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	B	1 pikë
Pyetja 24	A	1 pikë
Pyetja 25	D	1 pikë
Pyetja 26	C	1 pikë

---

**Pyetja 27**                      **2 pikë**

- **Në republikë** presidenti ishte ekzekutiv pra luante edhe rolin e kryeministrit, ai ishte edhe kryetar i shtetit, ndërsa **në monarki** kryetari i shtetit ishte mbreti dhe u vendos posti i kryeministrit si post i veçantë.
- **Në republikë** parlamenti ishte i organizuar me dy dhoma, ndërsa në **monarki** u organizua në një dhomë.
- **Në monarki** u krijua Këshilli i Shtetit si organ i lartë i pavarur, që nuk ekzistonte në periudhën e **republikës**.

**2 pikë**                      Nëse identifikon dy nga ndryshime institucionale.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse identifikon një nga ndryshimet institucionale.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 28 (a)**                      **3 pikë**

- Lufta ndaj Gjermanisë do të përfundonte vetëm me kapitullimin e saj.
- Pas mbarimit të luftës Gjermania të ndahej mes aleatëve.
- Të krijohet Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) për ruajtjen e paqes.
- Dënimi i kriminelëve të luftës.
- Ndryshimet territoriale në lidhje me Poloninë.
- Krijimi i qeverive të përkohshme te koalicionit në vendet e çliruara deri në mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

**3 pikë**                      Nëse rendit tre nga vendimet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse rendit dy nga vendimet.

**1 pikë**                      Nëse rendit një nga vendimet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 28 (b)                      1 pikë**

Konferenca e Potsdamit

**1 pikë**                      Nëse gjen konferencën.

**OSE**

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 29 (a)                      1 pikë**

Mos përtëritja e Paktit të Parë të Tiranës të vitit 1926.

**1 pikë**                      Nëse shkruan hapin e parë që ndërmori Shqipëria në këtë drejtim.

**OSE**

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 29 (b)                      2 pikë**

- U ndërpre në këstet e huasë SVEA.
- U kërkuan pagesat e kësteve të pashlyera.
- 22 luftanije italiane hynë në portin e Durrësit pa lejen e autoriteteve shqiptare, duke kërcënuar sovranitetin e vendit.
- Etj.

**2 pikë**                      Nëse gjen dy veprimet që ndërmori Italia.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse gjen një nga veprimet që ndërmori Italia.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 30 (a)                      2 pikë**

**Plani politik**

- Roli sundues i partive komuniste në të gjitha fushat e jetës private dhe publike (partia-shtet).
-

---

**MATURA SHKETËRORE 2019**

---

- Terrori dhe përndjekja kundërshtarëve politik, në çdo aspekt jetësor.
- Mos respektimi i të drejtave bazë të njeriut si: Liria e shprehje, e organizimit, votim i fshehtë etj.
- Kulturi i udhëheqësit.
- Policia sekrete dhe ndërhyrja e saj në çdo fushë të jetës.
- Propaganda që mbron sistemin.
- Etj.

**2 pikë** Nëse rendit dy nga tiparet e përbashkëta në planin politik.

**OSE**

**1 pikë** Nëse rendit një nga tiparet e përbashkëta në planin politik.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 30 (b)**

**2 pikë**

**Plani ekonomik**

- Centralizim dhe planifikim shtetëror që kufizon iniciativën private në ekonomi
- Shtetëzim dhe shoqërizim i ekonomisë (rol i papërfillshëm i pronës private)
- Prioriteti ndaj industrisë së rëndë, ndërsa nuk ju kushtua vëmendje e duhur industrisë së lehtë dhe asaj ushqimore
- Etj.

**2 pikë** Nëse rendit dy nga tiparet e përbashkëta në planin ekonomik.

**OSE**

**1 pikë** Nëse rendit një nga tiparet e përbashkëta në planin ekonomik.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 31 (a)**

**3 pikë**

- Dallimet e ndjeshme ekonomike mes republikave të ndryshme.
  - Tensionet nacionale mes kombeve të ndryshme që dolën më shumë në pah pas vdekjes së Titos në vitin 1980.
  - Problemet ekonomike që shpreheshin në inflacionin e lartë, papunësinë në rritje, borxhi i madh i jashtëm
-

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

- Kundërshtitë politike mes rrymës liberale që kërkonte një decentralizim dhe liberalizimit të mëtejshëm dhe asaj konservatore që favorizonte ndërhyrjen më të madhe të shtetit dhe forcimin e centralizimit të pushtetit.

- Etj.

**3 pikë** Nëse shpjegon tre nga shkaqet e krizës në ish Jugosllavi.

**OSE**

**2 pikë** Nëse shpjegon dy nga shkaqet e krizës në ish Jugosllavi.

**1 pikë** Nëse shpjegon një nga shkaqet e krizës në ish Jugosllavi.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**Pyetja 31 (b) 1 pikë**

- Sllovenia

**OSE**

- Kroacia

**1 pikë** Nëse shkruan një nga republikat.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 32 (a) 1 pikë**

Prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik.

**1 pikë** Nëse gjen ngjarjen ndërkombëtare.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 32 (b) 1 pikë**

Kursi pajtues mes Kinës dhe SHBA.

(Të dy vendet, në funksion anti-sovjetik, nisën të përmirësojnë marrëdhëniet me tyre që u kurorëzua me vizitën e Niksonit në Kinë. Ky afrim nuk i pëlqeu E. Hoxhës dhe këtu nisi edhe çarja me Kinës dhe Shqipërisë që përfundoi me prishjen e marrëdhënieve dhe ndalimin e ndihmave kineze).

**1 pikë** Nëse jep arsyen e prishjes së marrëdhënieve.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 33

Izolimi politik konkretizohet me:

- prishjen e marrëdhënieve politike me të gjitha vendet e ashtuquajtura socialiste (Blloku Lindor, Jugosllavia, Kina),
- prishja e marrëdhënieve diplomatike me BS,
- marrëdhëniet shumë të kufizuara në planin shtetëror me vendet perëndimore,
- këmbëngulja në mos vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe shtetërore më SHBA dhe Britaninë e Madhe.
- Etj.

Izolimi ekonomik konkretizohet me:

- ndalimin me kushtetutë të marrjes së kredive dhe investimeve direkte nga jashtë,
- ndërprerjen e ndihmave (si pasojë e prishjes së marrëdhënieve politike) nga vendet komuniste ,
- mos inkuadrimi në organizmat ekonomike ndërkombëtare (FMN, Banka Botërore)
- Etj.

Izolimi shoqëror konkretizohet me:

- mohimin e mundësisë për lëvizje të lirë jashtë vendit,
- pengimi i informacionit nga jashtë (mbyllja e sinjaleve televizive, kufizimet ndaj futjes së artit perëndimor etj.),
- kufizimi në maksimum i kontakteve të qytetarëve shqiptarë me të huajt,
- Etj.

**4 pikë** Nëse shkruan për secilin nga aspektet dhe i analizon ato në tërësi.

**OSE**

**3 pikë** Nëse shkruan për tre nga aspektet dhe nuk bën analizë të qartë.

**2 pikë** Nëse shkruan për dy nga aspektet dhe nuk bën analizë të qartë.

**1 pikë** Nëse shkruan për një nga aspektet dhe nuk bën analizë të qartë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Shënim: Nëse nxënësi jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta, do të marrë pikët që meriton.**

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Histori – Sesioni II**

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

---

<b>Pyetja 1</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja 4**                      **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Rimëkëmbi ekonominë.
- Riorganizoi ushtrinë.
- Përfshiu brenda shtetit të tij Dyrrahun dhe Apoloninë.
- Rivalizoi me Mbretërinë e Maqedonisë.
- Ndërhyri në punët e brendshme të Epirit, duke ndihmuar Pirron të vinte në fron.
- Etj.

**2 pikë**                      Nëse vë në dukje dy nga arritjet.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse vë në dukje një nga arritjet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 5**                      **2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Diferencimi shoqëror mbi bazën e ndarjes së punës (bujqësi, blegtori, zejtari, tregti).
- Zotërimi i pronës private.
- Konfliktet mes fiseve ilire për pronë e pasuri.
- Etj.

**2 pikë**                      Nëse liston dy nga pasojat.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse liston një nga pasojat.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

**MATURA SHETETËRORE 2019**

---

<b>Pyetja 6</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 7</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 8</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 9</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

---

**Pyetja10(a)                    2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Iliria e Jugut ishte më e zhvilluar ekonomikisht dhe kulturallisht, kishte qendra të mëdha urbane dhe rrugë të rëndësishme komunikimi.
- Popullsia e saj ishte më kompakte dhe me nivel më të larta edukimi dhe kulture.
- Në këtë pjesë ekzistonin formacionet shtetërore ilire dhe terreni ishte malor dhe me fortifikime të shumta.
- Etj.

**2 pikë**                    Nëse identifikon dy nga arsyet.

**OSE**

**1 pikë**                    Nëse identifikon një nga arsyet.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja10 (b)                    2 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Shtresëzimi i vjetër i gjetur aty lidhet me veglat e punës, armët dhe zbukurimet që datojnë nga periudha e qytetërimit ilir.
- Shtresëzimet më të reja lidhen me kushtet historike dhe ndikimet e kulturave të mëdha të kohës, greke dhe latine.
- Etj.

**2 pikë**                    Nëse shpjegon dy nga arsyet.

**OSE**

**1 pikë**                    Nëse shpjegon një nga arsyet.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---



---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

Pyetja 11	B	1 pikë
Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë

---

**Pyetja 17**                      **3 pikë**

**Model përgjigje**

**Reforma në fushën legislative:**

- U miratua Kodi i Napolonit si një përmbledhje e përpunuar e Kodit Civil, Kodit Penal dhe Kodit Tregtar
- Etj.

**Reformat në fushën ekonomike:**

- Stabilizoi kursin e monedhës

**OSE**

- Krijoi Bankën Kombëtare

**OSE**

- ekuilibroi bilancin shtetëror

**OSE**

- reformoi sistemin e mbledhjes së taksave duke krijuar një institucionin për këtë qëllim.
- etj

**Reforma në fushën Arsimore:**

- Arsimi fillor iu la nën kujdes komunave, ndërsa licetë(arsimi i mesëm) dhe universitetet u morën përsipër nga shteti.

**OSE**

- U krijua Akademia ushtarake.
- Etj.

**3 pikë**                      Nëse jep një nga reformat për të tria fushat.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse jep një nga reformat për dy nga fushat.

**1 pikë**                      Nëse jep një nga reformat për një nga fushat.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 18 (a) 1 pikë**

**Model përgjigje**

Shkëmbimi i Shën Naumit dhe Vermoshit me disa fshatra të vogla.

**1 pikë** Nëse identifikon shkëmbimin territorial.

**OSE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 18 (b) 2 pikë**

**Model përgjigje**

- Politika e afrimit të Shqipërisë me Italinë shkaktuan reagime në Beograd. Ky i fundit pretendonte të kishte pozitën dominuese në politikën shqiptare.
- Duke qenë një shtet jo shumë i zhvilluar, nuk shihej nga Zogu si një partner potencial për të ardhmen.
- Beogradi nxiste lëvizje separatiste në Shqipëri.
- A. Zogu iu përmbajt vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të Parisit, që përcaktoi Italinë si partnerin kryesor që do të përgjigjej për problemet e Shqipërisë.
- Etj.

**2 pikë** Nëse shpjegon dy nga arsyet.

**OSE**

**1 pikë** Nëse shpjegon një nga arsyet.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 19 3 pikë**

**Model përgjigje**

- Çlirimi i territoreve shqiptare nga sundimi osman.
- Formimi i shtetit kombëtar shqiptar.
- Mbrojtja e tokave shqiptare nga copëtimi.
- Përhapja e arsimit dhe kulturës.
- Zhvillimi ekonomik i vendit.

**3 pikë** Nëse jep tre nga pikat e programit.

**OSE**

**2 pikë** Nëse jep dy nga pikat e programit.

**1 pikë** Nëse jep një nga pikat e programit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

Pyetja 20	C	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	D	1 pikë
Pyetja 24	B	1 pikë
Pyetja 25	A	1 pikë
Pyetja 26	A	1 pikë

---

**Pyetja 27**                      **3 pikë**

**Model përgjigje**

- a) Për shkak të konsiderimit të saj si një qeveri lokale nga Fuqitë e Mëdha.
- b) Vendosja e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Vlorë.
- c) Për shkak të qëndrimit sabotues të Esat Pashë Toptanit.
- d) Për shkak të zgjedhjes së një princi të huaj që së shpejti do të mbërrinte në Shqipëri.
- e) Për shkak të mosrealizimit të objektivave që i vuri vetes në programin e saj si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm
- f) Për shkak të mungesës së fondeve.

**3 pikë**                      Nëse shkruan tri nga arsyet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse shkruan dy nga arsyet.

**1 pikë**                      Nëse shkruan një nga arsyet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 28**                      **4 pikë**

**Model përgjigje**

- Puna vullnetare e vetë popullit.
- Shfrytëzimi i robërve të luftës që ishin rreth 2 milion vetë.
- Dëmshtëpërblimet e luftës si dhe mallrat dhe pajisjet e marra nga vendet e mundura.
- Importi i mallrave me çmime të ulëta nga vendet e Evropës lindore.
- Etj.

**4 pikë**                      Nëse identifikon katër nga masat.

**OSE**

---

---

**MATURA SHTETËRORE 2019**

---

- 3 pikë** Nëse identifikon tre nga masat.  
**2 pikë** Nëse identifikon dy nga masat.  
**1 pikë** Nëse identifikon një nga masat.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 29** **3 pikë**

**Model përgjigje**

Reformat e ndërmarra me synimin për të përmirësuar sistemin nxorën në pah dobësi të mëdha në të gjitha fushat.

- a) Administrimi i trashëguar nga e kaluara nuk mund të përshtatej me kërkesat e ekonomisë së tregut.
- b) Teknikat e prodhimit ishin të prapambetura
- c) U rishfaqën problemet nacionaliste të kombësive jo ruse
- d) U shfaqën kërkesat për pavarësi
- e) Reformat hasën në kundërtime si nga forcat konservatore (që i kundërshtonin ato) po ashtu edhe nga radikalët (që kërkonin më shumë dhe ritëm më të shpejtë për to)

- 3 pikë** Nëse shkruan tri nga arsyet.  
**OSE**  
**2 pikë** Nëse shkruan dy nga arsyet.  
**1 pikë** Nëse shkruan një nga arsyet.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 30 (a)** **1 pikë**

**Përgjigje**

Konrad Adenauer

- 1 pikë** Nëse gjen emrin e kancelarit gjerman.  
**OSE**  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

---

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Pyetja 30 (b)                      2 pikë**

**Përgjigje**

- Plani Marshall, nga i cili RFGJ mori ndihmë prej 3.6 miliardë dollarë që u përdor për rinovimin e teknologjisë dhe krijimin e degëve të reja të industrisë.
- Fuqia punëtore që karakterizohej nga disiplina e lartë në punë dhe kualifikimi i vazhdueshëm.
- Bashkëpunimi i shkëlqyer shtet – punëdhënës – punëmarrës.

**2 pikë**                      Nëse përshkruan dy nga faktorët.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse përshkruan një nga faktorët.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 31                              3 pikë**

**Model përgjigje**

- Shtylla e parë përcakton hapësirat brenda të cilave shtetet evropiane përcaktojnë sovranitetin e tyre;
- Shtylla e dytë përcakton politikat e përbashkëta të sigurisë dhe asaj të jashtme;
- Shtylla e tretë ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe asaj të brendshme.

**3 pikë**                      Nëse jep tre nga shtyllat.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse jep dy nga shtyllat.

**1 pikë**                      Nëse jep një nga shtyllat.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 32                              3 pikë**

**Model përgjigje**

- Ulja e inflacionit.
- Përmirësimi i bilancit të pagesave.
- Forcimi i paundit.
- Rritja e peshës së sektorit të shërbimeve.
- Nxitja e sipërmarrjes private
- Etj.

**3 pikë**                      Nëse rendit tre rezultate pozitive.

---

**OSE**

**2 pikë** Nëse rendit dy nga rezultatet pozitive

**1 pikë** Nëse rendit një nga rezultatet pozitive

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 33**      **4 pikë**

**Model përgjigjeje**

Dy masat që mori Katerina e Madhe:

- I çlirroi fisnikët nga detyrimi i karrierës në shërbimin civil e atë ushtarak.
- I nxiti ata zhvillonin dhe menaxhonorin vetë pasurinë e tyre.

Dy masat që mori Pjetri i Madh:

- I detyroi fisnikët të visheshin si perëndimorë
- Hapi shkolla për fëmijët e fisnikëve.

**4 pikë** Nëse jep dy nga masat që mori Katerina e Madhe dhe dy nga masat që mori Pjetri i Madh.

**OSE**

**3 pikë** Nëse jep dy nga masat që mori Katerina e Madhe dhe një nga masat që mori Pjetri i Madh ose anasjelltas.

**2 pikë** Nëse jep dy nga masat që mori Katerina e Madhe OSE dy nga masat që mori Pjetri i Madh

**1 pikë** Nëse jep një nga masat që mori Katerina e Madhe OSE një nga masat që mori Pjetri i Madh

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

KIMI

Kimi – Sesioni I



• *Pyetjet me zgjedhje*

Pyetja	1	3	5	6	7	9	10	12	16	17
Alternativa saktë	e A	D	D	A	D	D	C	B	C	A
Pyetja	18	19	20	21	22	23	25	26	27	29
Alternativa saktë	e A	C	D	D	B	D	A	C	A	C

• *Pyetjet me zgjidhje dhe arsytim*



**Zgjidhja e ushtrimit 2**

- a)  $1s^2 2s^2 2p^6 3s^2 3p^6 4s^2 3d^5$   
 b)  $n=3, l=1, m=0, m_s=+0,5$   
 c)



d) Atomi i bromit Br

joni i bromit Br<sup>-</sup>



**Nxënësi vlerësohet me:**

1 pikë


nëse jep përgjigjen e mësipërme.

0 pikë

nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje ose edhe nëse ka dhënë përgjigje të pjesshme.

**Zgjidhja e ushtrimit 4**

a) Bazuar në vetitë e metaleve alkalino - tokësore, si dhe vetitë e përbërjeve të tyre, mund të shkruajmë reaksionet:



**Nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** nëse ka shkruar të paktën 3 nga katër reaksionet

**0 pikë** nëse shkruan vetëm 2 nga reaksionet, si dhe nëse nuk shkruan asnjë reaksion.

**Nuk do të merren parasysh reaksionet në të cilat nxënësit përdorin dy reaksione për të arritur te një nga kalimet e mësipërme: psh:  $\text{Ca} + \text{O}_2 + \text{CaO}$  dhe  $\text{CaO} + \text{H}_2\text{O} + \text{Ca}(\text{OH})_2$ .** (pra reaksionet do shkruhen me një kalim).

b) Bazuar në numrat atomikë Z, kalciumi zë vendin e 20 në sistemin periodik. Ai kufizohet majtas nga

kaliumi (Z=19); djathtas nga skandiumi, Z=21; lart nga magnezi, Z=12; poshtë nga stronciumi Z=38. Dimë se rrezja rritet kur kalohet nga lart – poshtë brenda grupit d.m.th.  $R_{\text{Mg}} < R_{\text{Ca}} < R_{\text{Sr}}$ , ndërsa kur kalohet nga e majta në të djathtë brenda periodës rrezja zvogëlohet, d.m.th.  $R_{\text{K}} > R_{\text{Ca}} > R_{\text{Sk}}$ .

**Nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** nëse jep përgjigjen e mësipërme.

**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje ose edhe nëse ka dhënë përgjigje të pjeshme.

c) Elementet e grupit VIIA sipas rritjes së aktivitetit renditen: I, Br, Cl, F. Bazuar në vetitë e halogjenëve del se halogjenët më aktive kanë veti të zëvendësojnë halogjenët më pak aktive nga tretësirat ujore të kripërave të tyre. Kështu mund të shkruajmë:  $\text{NaBr}(\text{uj}) + \text{Cl}_2(\text{g}) = \text{NaCl}(\text{uj}) + \text{Br}_2(\text{l})$

**Nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** nëse jep përgjigjen e mësipërme.

**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje ose edhe nëse ka dhënë përgjigje të pjeshme.

d)  $1s^2 2s^2 2p^6 3s^2 3p^6 4s^2$

Ky element ndodhet në periodën 4, grupi VIIB.

**Nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** nëse jep përgjigjen e mësipërme.

**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje ose edhe nëse ka dhënë përgjigje të pjeshme.



**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

**Zgjidhja e ushtrimit 8**

a)

Na (Z=11)	Mg (Z=12)	Al (Z=13)	Si (Z=14)	P (Z=15)	S (Z=16)	Cl (Z=17)	Ar (Z=18)
3s <sup>1</sup>	3s <sup>2</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>1</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>2</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>3</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>4</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>5</sup>	3s <sup>2</sup> p <sup>6</sup>

Vërehet se numri i elektroneve në nivelin e jashtëm rritet duke kaluar nga e majta në të djathtë të periodës, nga Na deri te Ar. Me rritjen e numrit të elektroneve me një njësi në nivelin e jashtëm, rritet njëkohësisht me një njësi edhe ngarkesa pozitive e bërthamës së atomit të çdo elementi, duke kaluar nga Na deri te Ar. Meqenëse numri i shtresave elektronike të atomit të çdo elementi të një periode nuk ndryshon, si dhe meqenëse elektronet konsiderohen me masë shumë të vogël, gati të papërfillshme, del se forca tërheqëse e bërthamës së atomit të çdo elementi të paraqitur më sipër kundrejt elektroneve të nivelit të jashtëm të tij rritet kur kalohet nga e majta në të djathtë të periodës, për pasojë shtresa e jashtme elektronike afrohet dhe rrezja zvogëlohet (kur kalohet nga e majta në të djathtë).

b) Duke kaluar nga e djathta në të majtë të periodës rrezja rritet. Rritja e rrezes ndikon në rritjen e aftësisë për të lëshuar elektronet e nivelit të jashtëm d.m.th. atomi i elementit oksidohet dhe shfaq veti reduktuese.

sipas vetive reduktuese në rritje këta elemente duhet të renditen Cl, S, P, Si, Al, Mg, Na. Natriumi është elementi me veti reduktuese më të theksuara në periodën e tretë.

c) rritja apo zvogëlimi i rrezes atomike brenda periodës apo brenda grupit tregon për aftësitë reduktuese apo oksiduese të atomeve të elementeve të kësaj periode por dhe për elementet e çdo periode tjetër apo grupi të sistemit periodik. Aftësitë reduktuese janë të lidhura me karakterin e metalit apo jometalit. Si pasojë dhe oksidet apo hidratet e oksideve janë të lidhura me karakterin metalik apo jometalik të elementit. Karakteri metalik (vetia reduktuese e metaleve) vjen duke u dobësuar kur kalohet nga e majta në të djathtë, si rezultat edhe vetitë bazike të oksideve të elementeve metalikë të kësaj periode do të dobësohen kur kalohet nga e majta në të djathtë, ndërsa vetitë acide të oksideve të jometaleve do të theksohen.

Na <sub>2</sub> O bazik i fortë	MgO bazik i dobët	Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> amfoter	SiO <sub>2</sub> acid i dobët	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub> acid i fortë	SO <sub>3</sub> acid më i fortë	Cl <sub>2</sub> O <sub>7</sub> acid edhe më i fortë	Ar -
------------------------------------	----------------------	---	----------------------------------	---	------------------------------------	--	---------

d) energjia e jonizimit, energjia e afërsisë për elektronin dhe EN brenda periodës, nga e djathta në të majtë zvogëlohen, meqenëse rrezja rritet dhe këto madhësi janë në përpjesëtim të zhdrejtë me rrezën atomike.


**Për secilën nga pikat a,b,c, dhe d nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** për çdo kërkesë a,b,c,d nëse jep përgjigjen e argumentuar si më sipër.


**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë, ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

**Zgjidhja e ushtrimit 11**

a) Që molekula  $\text{XCl}_3$  të ketë moment dipolar të barabartë me zero duhet që atomi i elementit X të mos ketë çift elektronik vetjak të lirë, d.m.th., kjo molekulë të jetë simetrike. Molekulë të tillë jep bori ( $Z=5$ )  $1s^2 2s^2 p^1$  grupi IIIA. Atomi i këtij elementi ka vetëm tre elektrone në nivelin e jashtëm, asnjë çift të lirë vetjak, me të cilat formon tre lidhje kova lentë polare me tre atome klori. Meqenëse të tre vektorët drejtohen drejt tre atomeve të klorit, rezultatja e tyre tregon se momenti dipolar i molekulës është zero




Moment dipolar zero ka dhe dimeri  $\text{AlCl}_3 + \text{AlCl}_3 \rightarrow \text{Al}_2\text{Cl}_6$ . Po e njëjta gjë të  $\text{AlCl}_3$ , ku Al është element i grupit IIIA dhe ka vetëm tre elektrone në nivelin e jashtëm, nuk ka asnjë çift vetjak (të lirë)



b) Te molekula e ujit, oksigjeni është atomi qendror. ( $1s^2 2s^2 p^4$ )

Ai ka dy çifte lidhëse (lidhet me dy atome hidrogjen) dhe dy çifte vetjake. Këndi I lidhjes së atomit qendror (oksigjenit) me dy atomet e hidrogjenit duhet të ishte  $90^\circ$ , por në fakt është  $104,5^\circ$ , për shkak të shtytjes ÇL-ÇL, ÇL-ÇV, dhe ÇV-ÇV




---

TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI

---

- c) Formula kimike  $\text{NH}_3$ . Azoti, atom qendror, ( $1s^2 2s^2 p^3$ )  
Struktura e molekulës:



Forma gjeometrike është piramidale trekëndore, sepse atomi qendror, azoti, lidhet me tre atome të tjera dhe ka një çift vetjak (të lirë). Këndi i lidhjes  $107^\circ$ .

- d) Dimë se gjendja fizike e një substance mund të përcaktohet nga forcat ndër molekulare, të cilat janë të lidhura dhe me masat molekulare të krahasuara të substancave. Njehsojmë masat molekulare të krahasuara të  $\text{H}_2\text{S}$  ( $M_r = 34$ ),  $\text{H}_2\text{Te}$  ( $M_r = 129$ ),  $\text{H}_2\text{O}$  ( $M_r = 18$ ),  $\text{H}_2\text{Se}$  ( $M_r = 81$ ). Forcat e Van Der Valsit duhet të jenë më të mëdha midis molekulave të përbërjes me masë relative më të madhe, d.m.th, midis molekulave  $\text{H}_2\text{Te}$ . Sipas rritjes së forcave të Van Der Valsit këto molekula duhet të renditen  $\text{H}_2\text{O}$ ,  $\text{H}_2\text{S}$ ,  $\text{H}_2\text{Se}$ ,  $\text{H}_2\text{Te}$ , por nuk duhet të harrojmë se në disa substanca si uji, midis molekulave, përveç forcave të Van Der Valsit ekzistojnë dhe forca të tjera si ato të lidhjes hidrogjenore dhe dipol-dipol, të cilat ndikojnë në rritjen e pikës së vlimit të ujit.

**Për secilën nga pikat a,b,c, dhe d nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** për çdo kërkesë a,b,c,d nëse jep përgjigjen e argumentuar si më sipër.

**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë, ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

**1 pikë** nëse për dy nga kërkesat e mësipërme ka dhënë përgjigje të pjesshme të pa argumentuar.


**2 pikë** nëse në 4 kërkesat e mësipërme ka dhënë përgjigje të pjesshme të pa argumentuar.

**2 pikë** nëse në një të një nga kërkesat e mësipërme ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe në dy apo tre të tjerat përgjigje të pa argumentuar.

**3 pikë** nëse në dy nga kërkesat e mësipërme ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe në dy të tjerat përgjigje të pa argumentuar.

**Zgjidhja e ushtrimit 13**

- 1      2      3                      4      5                      6      7  
 a)  $\text{CH}_2 = \text{C}(\text{CH}_3) - \text{CH}(\text{C}_2\text{H}_5) - \text{CH}_2 - \text{CH}(\text{CH}_3) - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$   
 b)  $\text{CH}_3 - \text{C}(\text{CH}_3)_2 - \text{CH}_3$   
 c)



ose

- d)  $\text{CH}_3 - \text{CH}(\text{OH}) - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$

**Zgjidhja e ushtrimit 14**

- a)  $\text{C}_5\text{H}_{10} + 7,5\text{O}_2 \rightarrow 5\text{CO}_2 + 5\text{H}_2\text{O}$   
 $M_{\text{C}_5\text{H}_{10}} = 5 \times 12 + 10 = 70 \text{ g/mol}$   
 $n = m/M = 14/70 = 0,2 \text{ mol}$   
 1 mol penten      7,5 mol oksigjen  
 0,2                       $x = 0,2 \times 7,5 = 1,5 \text{ mol oksigjen} = 33,6 \text{ litra.}$
- b) Shkruajmë reaksionin:  $\text{CaO} + 2\text{HCl} = \text{CaCl}_2 + \text{H}_2\text{O}$   
 $n_{\text{HCl}} = 0,3 \times 0,5 = 0,15$   
 raporti 1 : 2  
 $x : 0,15$   
 $x = 0,15/2 = 0,075 \text{ mol CaO}$   
 $m_{\text{CaO}} = 0,075 \text{ mol} \times 56 \text{ g/mol} = 4,2 \text{ g}$
- c) Njehsojmë numrin e moleve të sulfatit të natriumit.  
 $n = 0,1 \text{ mol Na}_2\text{SO}_4$   
 kemi 0,2 mol - atome Na; 0,1 mol-atome S; 0,4 mol-atome O.
- d)  $M_{\text{Ca}_3(\text{PO}_4)_2} = 3 \times 40 + 2 \times 31 + 8 \times 16 = 310 \text{ g/mol}$   
 Masa e fosfatit të kalciumit  $0,892 \times 374 = 333,6 \text{ g}$   
 Në 310 g  $\text{Ca}_3(\text{PO}_4)_2$  ndodhen 120 g Ca  
 $\frac{333,6 \text{ g}}{310 \text{ g}} = \frac{X}{120 \text{ g}}$   
 $X = 129,1 \text{ g kalcium}$   
 $\% \text{ e Ca në xeheror} = 129,1 \times 100 / 374 = 34,518\%$

**Për secilën nga pikat a,b,c, dhe d nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** për çdo kërkesë a,b,c,d nëse jep zgjidhjen e saktë.


**0 pikë** nëse zgjidhja e dhënë prej tij nuk është e saktë, ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

**TESTE DHE SKEMA VLERËSIMI**

---

**Zgjidhja e ushtrimit 15**

a)  $C_M = 0,6/3 = 0,2M$




$n_{Pb(NO_3)_2} = 0,1 \text{ mol}$

Raporti në reaksion: 1: 1: 1:2 ose 0,1: 0,1: 0,1: 0,2

Del se formohen 0,1 mol precipitat = 33,1 gram dhe futen në reaksion 0,1 mol

$Na_2CrO_4 = 16,2 \text{ gram}$



Raporti 1:3:2

$n_{N_2} = 44,8/22,4 = 2$

1 mol azot jep 2 mol amoniak

2 mol azot      4 mol amoniak = 89.6 litra

Rendimenti =  $33,6 \times 100/ 89,6 = 37,5 \%$

d)  $n_C = 24,8/ 12=2,06 \text{ mol}$

$n_{Cl} = 71,2 /35,5 = 2,006 \text{ mol}$

nH

$= 4/ 1= 4 \text{ mol}$

raporti 1 C: 2 H :1 Cl

formula empirike  $CH_2Cl$

formula

molekulare  $C_2H_4 Cl_2$

$(CH_2Cl)_n = 99$


$n=2$

**Për secilën nga pikat a,b,c, dhe d nxënësi vlerësohet me:**

**1 pikë** për çdo kërkesë a,b,c,d nëse jep përgjigjen e argumentuar si më sipër.

**0 pikë** nëse përgjigja e dhënë prej tij nuk është e saktë, ose nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

**Zgjidhja e ushtrimit 24**



a) konstantja e ekuilibrit =  $[NH_3]^2/ [N_2] \cdot [H_2]^3$

$K = (0,1)^2 / 0,3 \times (0,4)^3 = 0,520$

Nëse shtohet 0,1 mol  $NH_3$  dhe nëse shënojmë përqendrimin e hidrogjenit me X del se:

$[N_2]$ mol/l	$[H_2]$ mol/l	$[NH_3]$ mol/l
0,3 - 0,05	x	0,2

D.m.th. për 0,1 mol amoniak të përfutur duhet 0,05 mol azot i harxhuar meqenëse raporti midis tyre është  $1 N_2 : 2 NH_3$ .

$K = (0,2)^2 / (0,3-0,05) (x)^3 = 0,520$

